

KOLONIZIMI

Jusuf Osmani

SERB I KOSOVËS



2nd Edition

Dr. Jusuf OSMANI

KOLONIZIMI SERB I KOSOVËS

Shb
ERA
Prishtinë 2010

KOLONIZIMI SERB I KOSOVËS
SERBIAN COLONISATION OF KOSOVA
LA COLONISATION SERBE DE KOSOVË
SERBISCHE KOLONISIERUNG VON KOSOVA

Redaktor: *Mr. Bejtullah DESTANI*

Recensues: *Prof. dr. Noel MALCOLM*

Redaktor gjuhësor: *Prof. dr. Mehmet HALIMI*

Korrektor: *Autori*

Ballina: Akad. Shqyri NIMANI

Realimi kompjuterik: *Fisnik OSMANI*

Botues: shb „ERA“ – prof. dr. Begzat Baliu

Botimi i parë në vitin 2000
Botimi i dytë, i plotësuar.

Shtypi: „TREND“ Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

P ë r m b a j t j a

Faqe

- PARATHËNIE.....

- HYRJE.....	
- DEPËRTIMI I SLLAVËVE NË BALLKAN DHE VENDOSJA TYRE NË TREVAT ILIRO-SHQIPTARE.....	
- KOSOVA GJATË SUNDIMIT OSMAN DHE PLANET SERBE PËR SERBIZIMIN E TROJEVE SHQIPTARE.....	
- KOLONIZIMI I KOSOVËS 1912-1914.....	
- KOLONIZIMI I KOSOVËS ME ELEMENTIN SLLAV 1918-1941.....	
- PLANET SERBE PËR SPASTRIMIN ETNIK DHE KOLONIZIMIN E KOSOVËS GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE.....	
- KOLONIZIMI SERB GJATË JUGOSLLAVISË SOCIALISTE	
- Planet për zbatimin e kolonizimit.....	
- Rikolonizimi - kthimi i kolonëve në Kosovë.....	
- Presionet për shpërngulje të shqiptarëve.....	
- Ndërprerja e përkohshme e kolonizimit dhe kthimi i disa kolonëve në vendlindje.....	
- Planet e reja dhe veprimet për rikolonizimin e Kosovës.....	
- Vrasjet, masakrat, dëbimi masiv i shqiptarëve dhe kthyerja e tyre.....	
PËRFUNDIM.....	
SUMMARY.....	
BURIMET DHE LITERATURA.....	

“Dr. Jusuf Osmani has written a very valuable study of the Serbian colonisation of Kosovo. The strength of his work lies in his detailed investigation of archival sources, which has added significantly to our knowledge of this important subject. Naturally, the fact that many Serbian colonists came to Kosovo during the 20th Century does not have any implications for policy towards members of the Serbian minority in Kosovo today - many families have had their home in Kosovo for many generations. Nevertheless, the historical facts of the colonisation process are facts, and need to be known; the tragic history of modern Serb-Albanian relations in Kosovo be fully understood without them.”

*Yours, Noel Malcolm
10/31/2000*

“Dr. Jusuf Osmani ka bërë një studim shumë të vlefshëm mbi kolonizimin serb të Kosovës. Fuqia e punës së tij qëndron në hulumtimin e tij të hollësishëm të burimeve arkivore, të cilat kanë pasuruar në mënyrë signifikante diturinë tonë të këtij subjekti të rëndësishëm. Natyrisht, fakti se shumë kolonistë serbë erëdhën në Kosovë gjatë shekullit XX nuk ka kurrfarë implikime për politikë ndaj anëtarëve të minoritetit serbë sot në Kosovë – shumë familje e kanë pasurë shtëpinë e tyre në Kosovë për shumë gjenerata. Megjithatë, faktet historike të procesimit kolonizues janë fakte, dhe duhet të njihen; historia tragjike e marrëdhënieve serbo-shqiptare në Kosovë nuk mund të kuptohet plotësisht pa to”.

Dr. Noel Malcolm

10/30/2000

PARATHËNIE

Në krijimtarinë shkencore historike, qëllimi kryesor duhet të jetë paraqitja objektive e fakteve dhe trajtimi i tyre sa më i drejtë. Prandaj, detyrë e punëtorëve shkencorë dhe e punëtorëve të tjerë është që të hulumtojnë, të studiojnë dhe të ndriçojnë të kaluarën historike, të prezantojnë dhe të publikojnë të vertetën shkencore historike në mënyrë sa më objektive.

Në historinë e popujve të Evropës, vështirë se mund të gjendet ndonjë popull që të ketë qenë objekt i shtypjes nacionale siç ishte popu-lli shqiptar, i cili jeton në trojet e veta autoktone në Kosovë e gjetiu. Mjeti më drastik, përveç shtypjes, terrorit, dhunës, likuidimit fizik etj. ishte edhe spastrimi etnik i trojeve shqiptare dhe kolonizimi me elementin serb. Serbia gjatë historisë shfrytëzoi të gjitha modelet e kolonizimit të trojeve shqiptare, e në veçanti të Kosovës, e cila është edhe objekt trajtimi në këtë vepër.

Pushtimi i tokave shqiptare dhe kolonizimi i tyre filloi që nga koha e Ilirisë. Pushtuesit e tjerë shkuan, kurse serbet që u vendosën në trojet etnike shqiptare, këtu jetojnë edhe sot. Pozita shumë e rëndësi-shme gjeostrategjike, pasuria natyrore, tokat pjellore si dhe kushtet e favorshme klimatike të viseve shqiptare, i bënë ato objekt të interesi-meve të përhershme të qarqeve serbe.

Me invadimin e sllavëve në tokat shqiptare në shek. XI-XII, synim të përhershëm kishin spastrimin etnik të atyre trojeve. Që të sendërtonin këto synime, ata shfrytëzuan mënyra dhe forma të ndryshme të veprimt, të cilat kuptohet, vareshin nga rrethanat e brendshme dhe të jashtme, nga rrjedhat politiko-shoqërore, si dhe nga mundësitë tjera, që mund të ndikonin në sendërtimin e këtij synimi.

Politika hegjemoniste dhe nacional-shoveniste e pushtetit serb, ndër qëllimet kryesore ka pasur shkombëtarizimin dhe sllavizimin e tokave shqiptare që kur janë dyndur në Gadishullin Ballkanik e deri në ditët e sotme. Ajo ka ndjekur gjithmonë një linjë të pandryshueshme, atë të spastrimit etnik të tokave shqiptare nga banorët e saj të lashtë iliro-shqiptarë, duke përdorur të gjitha mjetet mizore si vrasjet, terrorin, shpërnguljen e një numri sa më të madh shqiptarësh nga atdheu i vet dhe shkombëtarizimin e atyre që mbeteshin deri në asimilimin e plotë, si dhe në anën tjetër kolonizimin e atyre trojeve me elementin serb. Gjatë gjithë historisë, pushteti serb bëri çmos për t'i serbizuar viset etnike shqiptare. Por, fal qëndresës dhe natalitetit, ky vend mbeti shqiptar.

Andaj, qëllimi im është që në pika të shkurtëra të paraqesë kolonizimin serb të Kosovës që nga pushtimi i tokave shqiptare në fillim të shek. XII, e deri me dëbimin masiv të popullatës shqiptare nga Kosova në muajin mars-prill 1999, të mbështetur kryesisht në faktet historike, të burimeve arkivore dhe të burimet të tjera. Kulminacioni i të gjitha atyre, arriti me fillimin e konfliktit të armatosur në Kosovë (mars 1999), ku gjenocidi dhe spastrimi etnik morën formën e një veprimtarie barbare, që sfidoi gjithë bashkësinë ndërkombëtare. Dëbimi i shqiptarëve me dhunë jashtë atdheut ishte eksoduesi, përkatësisht zhvendosja më masive në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Në këtë vepër qëllimi kryesor është që opinionit të gjerë, në pika të shkurtra t'ia prezantojmë me argumente dhe të dhëna fushatën e spastrimeve etnike të trojeve shqiptare dhe të kolonizimit me popullatë të elementit serb.

Për hartimin e këtij teksti shfrytëzuam lëndën arkivore në arkiva të ndryshëm, materialin e publikuar e të papublikuar dhe literaturën përkatëse.

Ky është botimi i dytë, i plotësuar me të dhëna të reja, fotografi, harta, grafikone etj. që i plotësojnë burimet arkivore.

U jemi mirënjohës dhe u shprehim falënderime të gjitë atyre që më ndihmuan në çfarëdo mënyre që ky punim të marrë këtë formë. Natyrisht kam nder të posaçëm që me këtë rast t'i shprehim falende-rimet recensuesit të veprës, historianit të mirënjohur Prof. dr. Noel Malcolm nga Londra, redaktorit të veprës Mr. Bejtullah Destanit, redaktorin gjuhësor dr. Mehmet Halimin dhe të gjithë të tjerëve.

HYRJE

Kosova është treva shqiptare që bënë pjesë në Evropën Juglin-dore, e cila shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, me një sipërfaqe prej 10.877 km². Popullsia e Kosovës në vitin 1994 llogaritej në 2.175.000 banorë, nga 1.584.440 sipas regjistrimit të vitit 1981. Shumica e tyre, mbi 90% janë shqiptarë vendës, ndërsa pjesa tjetër janë pakica kombëtare: serbe, malazeze, rome, turke etj. Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina. Kosova sot përbën vetëm një pjesë të viseve shqiptare. Tokat shqiptare në shekullin e XIX shtrihej në veri deri në Nish, Leskoc e Vranjë, në lindje deri në Kumanovë, Prilep dhe Manastir, në jug deri në Konicë, Janinë dhe Prevezë.¹ Kjo trevë, sipas Sami Frashërit, kap sipërfaqen prej 70.000 km², ndërsa sipas disa studjuesve të tjerë, si p.sh. të I. Yelavitch prej 75.000 km² dhe sipas një studjuesi italian prej 80.000 km².²

Të dhënat arkeologjike, historike, gjuhësore, folklorike etj., dëshmojnë qartë për autoktoninë shqiptare, për vazhdimësinë iliro-shqiptare. Prania e shqiptarëve në këto treva dëshmohet dhe vërtetohet më vonë edhe në krisobulat e diplomat e sundimtarëve mesjetarë serbë, ndërsa në periudhën e sundimit osman ekzistojnë dokumente të hollësi-shme dhe të bollshme mbi popullsinë dhe vendbanimet e Kosovës.

Populli shqiptar ndër popujt më të vjetër të Evropës, mbi të cilin u vërsulën stuhi të shumta dhe rrallë mund të ketë ndonjë popull në botë që të ketë pasur pushtime dhe pushtues kaq të egër, që kanë njohur këto troje të banuara me iliro-shqiptarë. Në tokat ilire, e më vonë të arbërit të paraardhësve të shqiptarëve, u vërsulën një mori pushtuesish me qëllim që të gllabërojnë pjesë sa më të mëdha nga trugu ilir. Ata pushtues, bënë shumë masakra, vrasje, djegie, vjedhje më bizare të kulturës shpirtërore e materiale. Të parët në këto fushata qenë grekët dhe romakët, të cilët jo vetëm që do të robërojnë banorët vendës, duke munduar për t'i helenizuar e romanizuar, por edhe duke plaçkitur çdo gjë. Më vonë gjithë kjo do t'u mundësojë fiseve sllave që posa kishin zbritur nga Karpatet, më lehtë t'i nënshtrojnë.

¹ Sami Frashëri, Dheshkronjë, Bukuresht, 1886, cituar sips Rexhep Qosjes, Çeshtja shqiptare – Historia dhe Politika, IA, Prishtinë, 1994, fq. 29.

² Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), I, ASHSH – IH, Tiranë, 1989, fq. 99; Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-19950, IHK, Prishtinë, 1997, fq. 10.

Popullata serbe erdhi në trevat shqiptare, përkatësisht në Koso-vë si pushtues. Këtu gjetën popullatën iliro-arbërore-shqiptare autoktone, e cila jetoi shumë shekuj më parë pandërprerë në këto troje. Përkundër kësaj, pushteti serb kishte për qëllim dhe synim të përhershëm grabitjen e tokave shqiptare dhe zgjerimin e tyre. Serbia shpresonte që të shfrytëzojë rastin në rrethanat e krijuara, për të pushtuar në tërësi, jo vetëm Kosovën, por edhe tërë Shqipërinë bregdetare, për të dalë në detin e hapur. Që nga viti 1844 ajo kishte përpiluar shumë programe, me të vetmin qëllim për t'i shfarsës shqiptarët si popull - për një moment ose në etapa. Ndërsa, ato vise të vendosen të kolonizohen me elementin sllav. Ata për të shpëputur pjesë nga trojet shqiptare intensifikuan veprimtarinë e tyre diplomatike. Për këtë qëllim monarkia serbe, infensifikoi edhe shtypin, publikimet dhe aktivitetin shkencor, ku synonte t'i vinte një mbështetje gjoja historike shkencore politikës grabitqare pushtuese të borgjezisë serbomadhe ndaj tokave shqiptare në Kosovë e gjetiu.

Në këtë politikë ishte dhe është angazhuar edhe shkenca serbe, sidomos për sa i përket trajtimit të së kaluarës historike dhe autoktonisë së popullit shqiptar në viset e Ballkanit, ku jeton sot, para së gjithash në Kosovë, në Maqedoni e gjetiu. Kjo “shkencë” nuk ka pasur për bazë normat dhe moralin shkencor, të vërtetën shkencore, por vetëm interesat e politikës së ditës, politikës antishqiptare. Shkencëtarët e tillë përpiqen që me çdo kusht ta mohojnë prejardhjen ilire të shqiptarëve. Ata kishin vetëm një qëllim të caktuar - mohimin e së kaluarës historike etnike të shqiptarëve, falsifikimin e historisë dhe të autoktonisë së tyre.³ Shkencëtarët e tillë dhe propaganda e tyre serbe janë munduar dhe ende mundohen që të shtrembojnë dhe të dezinformojnë opinionin botëror, kuptohet për qëllime ekspansioniste, që pjesën dërrmuese të tokave shqiptare t'i paraqet si toka serbe. Ata Kosovën e quanin emrin “Stara Serbia” (Serbi e Vjetër), ndërsa trevat tjera shqiptare së bashku me Maqedoninë e quanin “Južna Srbija” (Serbia Jugore). Në anën tjetër popullin shqiptarë autokton mundoheshin të paraqitnin të ardhur në fund të shek. XVI dhe fillim të shek. XVII. Ata për këtë falsifikomin dhe shtrembonin faktet historike. Kinse për të mbrojtur këto thënie dhe teza, ata janë angazhuar sistematikisht dhe përpiqeshin për të vërtetuar “historikisht” pretendimet e tyre territoriale ndaj trevave shqiptare, madje edhe atë të tezës së njohur për dalje në det nëpërmjet tokave shqiptare. Ajo për këto qëllime kishte angazhuar propagandën e vet dhe pastaj në aspektin historik edhe historianë, gjeografë, etnografë, etj. për të falsifikuar historinë. Për këtë ishte angazhuar edhe vetë Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve në Beograd. Një prej synimeve dhe metodave më eklakante ishte që të bëhet kolonizimi i Kosovës, plan i përgatitur qysh moti. Këtë e dëshmojnë shumë dokumente të kohës. Për realizimin e kësaj, ata përdorën të gjitha format dhe metodat diploma-tike e “shkencore”, duke mos kursyer edhe metodën e dhunës e të terrorit për spastrimin etnik të Kosovës, shkombëtarizimin e saj dhe kolonizimin me elementin sllav.

³ Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XV-XVI, Tiranë, 1984, fq. 4.



Shtrija e popullatës shqiptare sot

1. KOSOVA ZEMRA E DARDANISË

Treva e Kosovës është e banuar prej kohësh më të lashta. Shqiptarët janë pasardhës të fisit ilir, dardanëve. Dardanët ishin një nga fiset e mëdha ilire, që kanë jetuar në pjesën qendrore të Ballkanit. Kosova sot është zemra e Dardanisë antike.

Pozita e mirë gjeografike, rrjedhat e lumenjëve, pasuritë me male, kullosat, mineralet si dhe lidhjet e saj me viset fqinje paraqesin parakushte ideale për banushmërinë e Kosovës së sotme, përkatësisht trevës së Dardanisë së dikurshme që nga parahistoria deri me sot. Sipas numrit dhe llojllojshmërisë së permendoreve të trashëgimisë kulturo-historike, radhitet ndër viset më atraktive dhe më të begatshme të Ballkanit qendror. Gjurmët e para të banimit në Kosovë datojnë nga neoliti i hershëm (6000 vjetë para e.r.). Këto gjurmë janë verifikuar dhe dokumentuar me gjetje nga hulumtimet sistematike arkeologjike. Rezultatet e fituara dëshmojnë për një civilizim të lartë të periudhës së neolitit.

Para pushtimeve romake, Dardania ishte bashkësi e pavarur politike, kulturore e fetare dhe njëhej me emrin Mbretëria Dardane. Në aspektin territorialo-administrativ, Dardania përfshinte një sipërfaqe mjaft të gjërë, sepse e përfshinte pjesën e epërme të rrjedhës së Vardarit, pjesën e epërme të Drinit të Bardhë, Fushën e Kosovës e deri te Nishi. I tërë Ballkani qendror gjatë kohës së sundimit romak quhej *Iliricum* – *Iliri*. Dardania kishte pas shumë vendbanim të vogla dhe qendra të mëdha. Shkupi ishte kryqytet i Dardanisë.⁴ Zemrën e trojeve dardane e përbënte Kosova e sotme.

Robert d'Angely, francez, në veprën e tij "Enigma", kur bënë fjalë për periudhën 610-1453, ndër të tjera thotë: "... *Ne e quajmë të panevojshme ta shpjegojmë këtu, se popullsitë e të gjitha eparkive të Ilirikut ishin shqiptarë....*".⁵

⁴ Dr. Jahja Drançolli, Rrënjët e qytetërimit iliro-arbëror në Kosovë, Buletini i Fakultetit Filozofik, XXV/1995, Prishtinë, 1998, fq. 160-163.

⁵ Robert d'Angely: Enigma, përmbledhi e përkthi Xhevat Loshi, tiranë, 1998.



2. DEPËRTIMI I SLLAVËVE NË BALLKAN DHE VENDOSJA E TYRE NË TREVAT ILIRO-ARBËRORE

Trevat iliro-arbërore të Kosovës së sotme por edhe më gjërë të trevave shqiptare, pas sundimit romak, përkatësisht bizantin, e pastaj një kohë edhe bullgar, kaluan nën sundimin e shtetit të Rashkës në krye me Stefan Nemanjën (1165-1195), që e pushtoi pjesërisht edhe Kosovën. Pushtimi i plotë i Kosovës u bë më 1216.

Sllavët e jugut, të ardhur nga veriu i Karpateve, që nga dita kur u dukën në portat e Perandorisë bizantine nuk bënë asgjë tjetër veçse, u përpoqën me të gjitha mjetet e mënyrat për të zgjeruar hapësirën e tyre në kurriz të popujve të tjerë autoktonë evropianë e ballkanikë. Në shekullin VI-VII, kur sllavët shkelën Ballkanin, shumë prej tyre u dyndën në Ilirik dhe shkaktuan fatkeqësi të papërshkrueshme. Pasi kaluan një kohë të gjatë me grabitje, plaçkitnin, masakronin popullatën, digjin vendbanime, etj. Në tokat ilire ata rrëmbyen e vranë me mijëra njerëz, duke depërtuar edhe në vendet më të fshehura të atyre anëve, prandaj banorët e këtyre vendeve u detyruan të marrin malet dhe të fshehen nëpër pyje. Kështu, duke u lënë lirisht të trashëgojnë të gjitha të arriturat kulturore e shpirtërore që nëpër shekuj i arritën vetë.

Nga Rashka, serbët filluan të depërtonin në shekullin XI-XII, më parë në Fushë-Kosovën pjellore, madje në viset e rrjedhës së epër-me të Moravës së Jugut dhe të Vardarit. Çetat serbe kanë shkatëruar çdo gjë. Zhupani i madh, Vukani ka djegur Lypianin dhe ka shkretëruar edhe viset tjera (1091). Kështu kanë vepruar edhe sundimtarët tjerë. I biri i Stevan Nemanjes, Stevan i Parë i Kurorizuar (Pervovençani), ka shkruar më 1190: *“Nemanja ka okupuar përveç qyteteve të Luginës së Strumës edhe Prizrenin, Shkupin dhe qytetin Leshtak të Pollogut të Poshtëm... Këto qytete i rrënoi dhe i çrrënjosi me themel, sepse nuk mbeti asnjë gur pa u rrënuar....; tokat e pasuritë e tyre ia bashkoi pasurisë dhe famës të sundimtarëve të vet....”*. Pastaj, thuhet: *“se në Serbi është shfaqur herezia e urrejtur dhe e mallkuar, Nemanja ka futur në kuvendin shtetëror përfaqësuesit e kishës e sundimtarët dhe ka vendosur që “herezia” të çrrënjohet me forcë. Nemanja ka dërguar ushtrinë dhe disa i dogji, të tjerët i dënoi me dënime të ndryshme, të tretët i dëboi nga shteti i vet, e shtëpitë e tyre dhe tërë pasuritë ua mori dhe ua dha denonciatorëve dhe bashkëpunëtorëve; mësuesit dhe kryeparit të tyre ua shkuli gjuhën në gërmaz...., kurse librat e tyre të pandershëm i dogji dhe i ndoqi, duke u kërcënuar se ato rrëfejnë dhe përmendin në të gjitha anët atë emër të mallkuar, dhe në të gjitha anët çrrënjosi atë besim të mallkuar që të mos përmendet kurrësi në shtetin e tij”*.⁶

Vendosja e sundimi serb në Kosovë dhe bashkangjitja e Rrafshit të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, në administratën shtetërore të Rashkës shënon fillimin e ekzistimit të etnikumit serb në këto vise dhe fillimin e një prej periudhave më të vështira për popullsinë arbërore -shqiptare të kësaj treve. Kjo popullatë jo vetëm që u privua nga çdo e drejtë politike, por iu nënshtrua edhe shfrytëzimit ekonomik të hierarkisë shtetërore serbe dhe asimilimit. Trysnia asimiluese arriti kulmin në kohën e sundimit të car Stefan Dushanit. Një rol të veçantë luajti kisha serbe me seli në qytetin e Pejës (Patrikana e Pejës), e cila duke pasur edhe mbështetjen e pakursyer të shtetit, punoi sistematikisht për largimin e popullsisë shqiptare nga riti katolik, i përhapur gjerësisht në radhët e kësaj popullsie, sidomos pas vitit 1204, dhe orientimin e saj drejt ortodoksisë sllave. Në këto rrethana një pjesë e mirë e popullsisë shqiptare të Kosovës u shtrëngua të përqafojë ritin ortodoks sllav.⁷

Pushteti mesjetar serb, në viset e pushtuara filloi të organizojë jetën fetare, duke marrë për bazë fenë ortodokse. Kisha ortodokse serbe, duke pasur aspirata të dominimit, fillon asimilim e popujve të tjerë josllavë, e në radhë të parë të shqiptarëve. Pushtetarët serbë merrnin

⁶ Fatmir Fehmiu, Gjenocidi i regjimeve serbe në hapësirat Shqiptare, Referat në tribunën shkencore të Asociacionit për mendim, veprim dhe krijim të lirë “Dardania” në Prishtinë, mbajtur më 19.06.2000; “Bota Sot”, 22.06.2000.

⁷ Kosova në vështrimin enciklopedik, Tiranë, 1999, fq. 79-89.

masa drastike të persekutimeve e ndëshkimit të atyre, që nuk ishin të fesë ortodokse. Kishat shqiptare filluan t'i përvetësojnë dhe t'i uzurpojnë si të tyre, ose bënë rrënimin e tyre dhe në themelet e tyre ngritnin kishat serbe, si psh. të Banjskës, të Graçanicës,⁸ etj.

Me ardhjen e sllavëve në Ballkan, harta toponomastike e tij ndryshoi fytyrë rrënjësisht. Shumë emërtime të vjetra iliro-arbërore-shqiptare u zëvendësuan me emërtime të reja sllave.

Pushtimet dhe sun- dimet e huaja së bashku me rrjedhimet e tyre kanë shkaktuar që hapësira gjeografike, që zinin shqiptarët në mesjetë të jetë rezultat i një ngushtimi territorial. Presioni i gjatë e i fuqishëm i shteteve dhe i kishave serbe, që shoqërohej edhe me kolonizim të trojeve shqiptare nga serbët, veçanërisht të Kosovës, ka bërë që hapësira gjuhësore shqipe të vinte vazhdimisht duke u ngushtuar.

Megjithatë, orvatjet e mbretërisë mesjetare serbe për të ndryshuar fizionominë etnike të trevës së Kosovës nuk dhanë rezultatet e dëshiruara. Popullsia shqiptare i kundërqëndroi me sukses trytnisë serbizuese, duke mbetur shumicë dërrmuese në strukturën etnike të këtyre viseve. Vetë dokumentet e kancellarisë serbe të shek. XIV-XV si dhe ato raguzane provojnë vijimësinë e pandërprerë të etnicitetit shqiptar të Kosovës gjatë sundimit serb.

3. KOSOVA GJATË SUNDIMIT OSMAN DHE PLANET SERBE PËR SERBIZIMIN E TROJEVE SHQIPTARE

Nga gjysma e shekullit XIV, turqit osmanë vunë këmbë në Ballkan dhe nisën pushtimin e Gadishullit. Më 1371, ata thyen një koalicion mbretërisht kristianë gjatë betejës historike në Maricë të Bullgarisë. Carët bullgarë u detyruan të ktheheshin në vasalë. Mbretërit serbë u dobësuan shumë dhe mbretëritë e tyre u copëtuan edhe më shumë. Në ato momente asgjë nuk i pengonte osmanët për të pushtuar edhe gjysmën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Më 28 qershor 1389 u zhvillua Beteja e Kosovës. Ushtria osmane gradualisht nën administrimin e vet përfshinte territoret e Ballkanit, kuptohet edhe të trevave shqiptare.

Vendosja dhe administrimi osman i trevave shqiptare, pas vitit 1389, megjithëse solli me vete ndryshime të rëndësishme në planin politik, ekonomik, shoqëror e ideologjik, nuk e ndryshoi në thelb fizionomin e strukturës etno-kulturore të nacionalitetit shqiptar në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit. U asgjësuan strukturat e pushtetit serb dhe bashkë me to edhe pushteti ekonomik i feudalëve serbë. Me vendosjen e administratës osmane në Kosovë, u shënuan ndryshime thelbësore edhe në jetën shoqërore. U ndërpre procesi i sllavizimit të popullatës vendore arbënore dhe të konvertimit të saj me dhunë nga feja katolike në atë ortodokse. Në rrethana të reja shoqërore-politike një pjesë e popullsisë shqiptare gradualisht filloi të braktisë fenë e krishterë dhe përqafoi fenë islame. Një ndër faktorët, që e lehtësoi depërtimin e islamit në masën e popullsisë kosovare ishte prirja e saj për t'u larguar nga autoriteti fetar i kishës serbe. Ashtu si e gjithë popullsia shqiptare e islamizuar, edhe ajo e Kosovës, ndryshoi vetëm fenë, pa prekur qenien e vet etnike shqiptare.⁹

Në gjysmën e dytë shek. XVI një pjesë e konsideruar e kësaj popullsie islamizohet dhe si rrjedhim, antroponimia e saj shndërrohet në antroponimi të sferës fetare islamike. Prania e popullsisë shqiptare në këtë kohë përbën në vetvete një dëshmi të pakundërshtueshme, që provon se ajo ekzistonte aty edhe në periudhën e sundimit serb, se ishte autoktone dhe vazhduese e popullsisë së dikurshme ilire, se me sukses i kishte bërë ballë procesit të sllavizimit gjatë

⁸ Letopis Gračanički, Gračanica, 1995.

⁹ Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë, 1999, fq. 81.

shekujve XII-XIV. Përveç kësaj, për islamizimin e popullsisë shqiptare vepruan edhe faktorë të tjerë ekonomikë e social-politikë.

Dokumentacioni i periudhës pas sundimit osman të Kosovës hedh dritë edhe më mirë dhe jep të dhëna më të shumta, që dëshmojnë se ato banoheshin nga popullsia shqiptare, kurse serbët të ardhur si kolonistë dhe si shtresë sunduese gjatë kohës së pushtimit serb në këto troje, përbënin një pakicë të parandësishme, por sunduese politikisht.

Si në kohën e Perandorisë së Dushanit, i cili e kishte shpallur vetën “mbret të serbëve, të grekëve dhe të shqiptarëve”, ashtu edhe në kohën e sundimit osman, serbët bënë ndryshime toponomastike, ndër-tuan objekte të veta (kisha e manastire), dhe marrë në përgjithësi, u përpoqën që këto vise t’i veçonin me tipare sllave. Gjithë këtë veprim-tari ata e shoqëruan me përhapjen e propagandës së tyre, kinse për të drejtën e tyre historike dhe natyrore, veçanërisht në shtetet e krishtera. Duke vepruar kështu me kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme forcuan synimet e spastrimit etnik dhe trasuan rrugë të tjera të thellimit të këtij synimi. Priteshin vetëm momenti dhe rrethanat e përshatshme për sendërtimin e qëllimeve të tyre të kahershme pushtuese dhe të spastrimit etnik të viseve shqiptare, por jo vetëm shqiptare.¹⁰

Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, përkundër shpërnguljes së disa famljeve serbe nga Kosova, në anën tjetër në njëfarë mënyre kishte vazhduar edhe vendosja e disa banorëve serbë si nga vetë Serbia, apo viset malore të Malit të Zi, kryesisht si çifçinj në trevat shqiptare. Kështu çifligarët, beglerët i sillnin banorë serbë dhe i vendosnin duke u dhënë tokë në pjesët më pjellore të Kosovës, si p.sh. rreth lumit Sitnica, ku edhe sot ekzistojnë disa vendbanime serbe. Serbët në forma dhe mënyra të ndryshme përvetësuan disa pushtetarët osmanë dhe u bënë zotërues të tërthortë apo të drejtpërdrejtë të vendeve dhe të anëve të ndryshme me shumicë absolute shqiptare, por edhe të territoreve, të cilat deri në atë kohë nuk ishin të banuara.

Në bazë të burimeve arkivore historike e të tjera, të cilat fatkeqësisht janë të pakta, por megjithatë dëshmojnë se në trevat e Sanxhakut të Nishit dhe më gjerë që nga antika e deri në shekullin XIX ekzistonte një kontinuitet i popullsisë shqiptare.¹¹ Këtë e dëshmojnë edhe me faktin, se në një dokument arkivor të datës 30 nëntor 1584, në mes tjerash thuhet: “*Krysheci me pesë fshatra dhe me 1500 frymë shqiptarësh...*”¹² Mirëpo, sikurse edhe në trevat të tjera, edhe këtu kishte lëvizje të mëdha të popullsisë, e sidomos të asaj shqiptare. Kjo lëvizje ishte pasojë e imigrimit dhe emigrimit të popullsisë, që ka qenë gjithnjë dukuri historike e kushtëzuar prej lloj-lloj shkaqeve, por që ka mbizotëruar shkaku ekonomiko-social dhe shoqëror, por shpeshherë edhe ai politik.¹³

Çlirimi i viseve të Pashallëkut të Beogradit¹⁴ dhe 6 nahijet¹⁵ gjatë viteve 1800 e deri në vitet 1875 ishte e drejtë legjitime serbe. Mirëpo, në anën tjetër, ajo largoi popullatën joserbe nga ato treva. Kështu sipas një shënimi historiografik nga periudha 1800 e deri në vitin 1875, theksohet se qarqet ushtarake dhe qeveritare serbe i larguan nga viset e lartpërmendura dhe nga

¹⁰ Dr. Izber Hoti, Vazhdimësia historike e spastrimit etnik, “Bujku”, 7.XI 1998.

¹¹ Jovan Trifunovski, Vranjska Kotlina I, Skopje, 1969, fq. 34; Dr. Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878, libri I. Prishtinë, 1994, fq. 220-21; Dr. M.Gj. Miličević, në librin “Kraleвина Srbije”, Beograd, 1987, fq. 334, cek se banorët e fshatit Ivan Kullë ishin shqiptarë dhe aty ishin që nga Beteja e Kosovës 1389; Në veprën e Adem Haxhiqit, Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455 godine, Sarajevo, 1972, fq. 229, në mes tjerash përmendet edhe fshati Arbanashka etj.

¹² Dokumente të shekullit XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, I. Tiranë, 1989, fq. 373.

¹³ Dr. S. Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit....., v. e c., fq. 23.

¹⁴ R. Djordjević, Srbija pre 100 godina, Beograd, 1946, 1-36; Dr. Sabit Uka, Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX, Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, Prishtinë, 1996, fq. 162.

¹⁵ Dr. Vladimir Stojančević, Iz istorije Leskovačkog kraja u drugoj polovine XIX veka, “Leskovački Zbornik”, IV, 1966, fq. 89-93; Dr. S. Uka, Planet....., p. i c., fq. 162.

Lugina e Moravës.¹⁶ Regjimet e dinastisë së Obrenoviqëve (1817-1903) vazhduan politikën terroriste shtetërore ndaj shqiptarëve e boshnjakëve e gjatë viteve '30 të shekullit XIX, me qëllim të spastrimit etnik. Në frymën e kësaj politike, qeveria e Principatës së Serbisë urdhëroi me 1832 që çdo shqiptari dhe boshnjaku, që kapet në territorin e Serbisë, t'i mëshohen nga 25 të rëna me shkop, ndërsa më 1834 urdhëroi që të përdoret ushtria për t'iu djegur fshatrat.¹⁷


Ish ministri rus i Punëve të Jashtme, Adam Qartorijski në proje-ktin e tij për shtetin e ardhshëm serb, të finalizuar më 1843, "Këshilla Serbisë për sjellje në të ardhmën", në mënyrë të detajuar sqaron se si mund të krijohet e të mbijetoj Serbia si shtet. Në këtë kohë programi i politikës së jashtme të Serbisë për pushtimin dhe kolonizimin e viseve shqiptare u përpunua në "Naçertani" (1844) të Ilia Garashaninit - politikan dhe më vonë kryeministër i Qeverisë së Mbretërisë së Serbisë. Përmbajtja e "Naçertanisë" mbështetet në krijimin e të ashtuquajturës Serbi Jugore me të cilën nënkuptohej Kosova e Maqedonia me tokat shqiptare të saj, por edhe Shqipëria Veriore, për të krijuar kështu të ashtuqujturën "Perandori të car Dushanit". "Naçertania" rrezatoi në shtetin serb, në organet dhe në institucionet e tij, sikurse edhe në aktivitetet e pushtetarëve të tij prej vitit të përpilimit të saj e deri në ditët tona. Në objektivat e "Naçertanisë" kanë gjetur mbështetje sidomos politika e gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve. Format kryesore të politikës gjenocidale të pushtetit serb ishin dhe ngelën dëbimi dhe deportimi i shqiptarëve nga trojet e veta dhe kolonizimi i këtyre trojeve me popullsi sllave.

Pushteti serb më 1856, me Marrëveshjen e Paqës së Parisit kishte fituar njëfarë të drejte që t'i largojë të gjithë shqiptarët nga qytetet e Shumadisë, si dhe nga Hercegovina. Më 2 mars 1965 Knjaz Mihaili kishte nxjerr Ligjin për kolonizimin e të huajve. Me atë ligj territoret të cilët i posedonin shqiptarët, sidomos nga Sanxhaku i Nishit dhe i Pirotit u serbizuan (janë kolonizuar menjëherë pas Kongresit të Berlinit, sepse këtu Serbia pranohet si shtet).¹⁸

¹⁶ Sipas Shaban Brahës, thuhet se nga aty janë larguar më se 150.000 banorë shqiptarë. Shaban Braha, Idriz Seferi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Tiranë, 1982, fq. 23.

¹⁷ Mr. Fatmir Fehmiu, Gjenocidi i regjimeve serbe në hapësirat Shqiptare. Referat në tribunën shkencore të AMVL "Dardania", p. i c.; "Bot Sot", 22.06.2000.

¹⁸ Bahri Cani - Cvijetin Milivojević, KOSMET ili KOSOVA, referat i Dr. Hakif Bajramit, Orijentacija Srbije za kolonizaciju Kosova, Beograd, 1996, fq. 163.



*Harta e Vilajetit të Prizrenit e vitit 1873,
ku ka përfshirë edhe Nishin, Pirotin etj.*

4. SHQIPTARËT NË SANXHAKUN E NISHIT

Duhet theksuar se shqiptarët deri kah gjysma e dytë e shekullit XIX qenë të vendosur në shumicën e qyteteve dhe qytezave, fshatrave të Sanxhakut të Nishit e më gjërë. Pjesa dërmuese e familjeve shqiptare ishin përqëndruar në Qarkun e Toplicës që në atë kohë përfshinte rrethin e Jabllanicës, Kosanicës, Prokuplës dhe vet qytetin e Prokuplës, Qarkun e Nishit që përfshinte rrethet e Vllasotincës, Leskocit, Nishit dhe vet qytetin e Nishit, Qarkun e Vranjës që përfshinte rrethin e Masuricës, Polanicës, Pçinjit dhe qytetin e Vranjës dhe Qarkut të Pirotit (Nishavës).¹⁹ Banorë shqiptarë kishte edhe në vende tjera, e sidomos në qytete, si p.sh. në Qupri, Paraqin, Uzhicë, Krushevc, Aleksinc, Karanovc (Kralejë) e deri te Beogradi.²⁰

¹⁹ Stanovnistvo Narodne Republike Srbije 1834-1953, Beograd, 1953.

²⁰ Dr. Sabit Uka, Dëbimi, v. e c., fq. 24-25.

Disa vendbanime në trevën e Sanxhakut të Nishit, përbëheshin vetëm prej popullatës shqiptare, kurse te disa të tjera, ajo ishte e përzier me popullatën serbe (diç pak me atë çerkeze, etj.).

4.1. Vendbanimet ku jetonte popullata shqiptare

Në bazë të të dhënave të autorëve serbë,²¹ hulumtimeve të Dr. Sabit Ukës dhe vizitave të bëra nëpër çdo vendbanim të Kosovës, familjet shqiptare jetonin në këto vendbanime të Sanxhakut të Nishit:

- ALABANA (rrethina e Bllacës).
- ALAKINCI (rrethina e Surdulicës).
- ARAQA (qarku i Toplicës²²) – Araçët.
- ARBANASHKA (rrethina e Prokuplës) - Arbanashkët. Sipas statistikave e shënuar me emër të deformuar kishte familje shqiptare 38 (st. turke), 20 (st. serbe)²³.
- ARBANASI (rrethina e Meroshinës) - Arbanasit.
- ARBANISHTA²⁴ (e shënon dr. Sabit Uka),
- BABOTINCI (rrethina e Prokuplës, 7 shtëpi shqiptare 12 shtëpi serbe) – Babatincët.
- BACA (rrethina e Prokuplës) - Bacalit – Bacët, familje shqiptare 39 (st. turke), 30 (st. serbe).
- BACIJEVICI (rrethina e Surdulicës).
- BADNJAVCI (rrethina e Zhitoraxhës) 2 shtëpi serbe dhe 32 shtëpi shqiptare).
- Badraxhitë (të ardhur nga Ivaja).
- BAGAROJA (Qarku i Toplicës).
- BAGJURI (Qarku i Toplicës) - Bagjurët.
- BAJÇINCI (rrethina e Prokuplës) - Bajçincët. Sipas burimit tjetër kishte familje shqiptare 51 (st. turke), 10 (st. serbe).
- BAJÇINOVCICI (rrethina e Prokuplës) – Bajçinovcët.
- Bajkollët (si duket të ardhur nga njëra prej vendbanimeve të quajtur Banjë).
- BAJRA (Qarku i Vranjës²⁵) – Bajrajt – Bajralitë.
- BAJRE (rrethina e Leskovcit).
- BELLANOVCE (rrethina e Vlladiqinhanit, rrethi i Polanicës).
- BALINOVCICI (rrethina e Prokuplës)²⁶.
- BALINOVCICI (rrethina e Vranjës).
- BALINOVCICI I EP. (Qarku i Vranjës, Polanicë).
- BALINOVCICI I P. (Qarku i Vranjës, Rrethi i Polanicës).
- BALLAJINCI (rrethina e Zhitoraxhës, 47 shtëpi serbe e 6 shqiptare).

²¹ Vidosava Nikolić – Stojancevic, Leskovac i oslobodjeni predeli, Leskovac, 1975; Dr. Milovan Spasić, Podaci o agrarnim odnosima hriscana u oslobodjenim krajevima, oko Topličkog i Vranjskog okruga za vreme turske vladovine, Glasnik učenog drustva, knj. 71, Beograd, 1890; Jovan Tomić, O arnautima u Staroj Srbiji, Beograd, 1913, etj. Marrë nga Dr. Sabit Uka, Dëbimi i Shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878, Prishtinë, 1994.

²² Qarku i Toplicës në vitin 1884 ka përfshirë këto rrethe: Jabllanicës, Kosanicës dhe Prokupljes. Në vitin 1890 kishte këto rrethe: Kosanicës, Dobriqit, Zaplanskës dhe Nishit. Në vitin 1902 kishte këto rrethe: Kosanicës, Prokuplës dhe Dobriqit.

²³ Disa të dhëna statistikore janë marrë nga libir: Jovan Cvijic, Osnovi za goeografiju i geologiji. III, Beograd.

²⁴ Disa vendbanime nuk kam arritur të konstatoj se ku gjendën.

²⁵ Qarku i Vranjës në vitin 1884 kishte këto rrethe: Masuricës, Polanicës dhe Pçinjit. Ndërsa, në vitin 1890 kishte rretin e Masuricës, Polanicës, Pçinjit, Jabllanicës dhe Leskovcit. Në vitin 1902 kishte këto rrethe: Masuricës, Polanicës, Pçinjit, Jabllanicës, Leskovcit dhe Vllasotincës.

²⁶ Disa vendbanime me të njëjtin emër përmendën në disa komuna.

-
- This ethnographic map of European Turkey, based on C. Sax's 1877 work, illustrates the distribution of various ethnic groups. The legend identifies the following groups and their corresponding patterns:
- Serbes (Diagonal lines, top-left to bottom-right)
 - Serbo-Croates (Diagonal lines, bottom-left to top-right)
 - Bulgares (Horizontal lines)
 - Pomaques (Dotted pattern)
 - Grecs (Wavy lines)
 - Albanais (Cross-hatch pattern)
 - Valaques (Horizontal lines with dots)
 - Turcs (Solid dark grey)
- The map shows the Balkan Peninsula and surrounding regions, with numerous cities and towns labeled, including Thessalonica, Sofia, Belgrade, and Constantinople. The Adriatic Sea (MER ADRIATIQUE) is visible to the west. A scale bar indicates 100 km.

Harta etnografike e Turqisë europiane, 1877.



Harta etnografike e Ballkanit me 1876.

- BANJA – Banjëskollët (nga Banja e Kushumlisë).
- BANJA (Qarku i Toplicës).
- BANJA E REPANJES. (E shënon dr. Sabit Uka).
- BANJA KUMAREVA (rrethina e Vranjës).
- BANJSKA (rrethi i Kosanicës) – Banjस्कët.
- BANKOVIQI (rrethi i Kosanicës).
- BANUSHEVCI (rrethina e Vranjës),
- BAQIQE (Qarku i Toplicës).
- BARA (Qarku i Vranjës, rrethi i Masuricës).

- BARBATOCVI (rrethina e Bllacës) – Berbatofcët, shtëpi shqiptare 17 (st. turke), 15 (st. serbe).
- BARDUSI (Qarku i Toplicës, rrethina e Kushumlisë) – Barduzët²⁷, 16 familje, shqiptare, sipas statistikave turke.
- BARLLOVA (rrethina e Kushumlisë) – Barllovët.
- BEDILA (Qarku i Toplicës, më vonë rrethi i Dobriqit).
- BEJASHTICA E EPËRME (rrethina e Prokuplës),
- BEJASHTICA E POSHTME (rrethina e Prokuplës, 14 shtëpi shqiptare) – Beashticët.
- BELANICA. (Nuk kemi mundur të konstatojmë se ku gjendet ky vendbanim).
- BELIBREGU (Nuk kemi mundur të konstatojmë se ku gjendet ky vendbanim).
- BELLA PALLANKA (sot qendër komunale në Serbi).
- BELLO (Rrethi i Kosanicës).
- BELLOGOSHI (rrethina e Prokuplës) – Bollogoshët.
- BELLOLINI (rrethina e Prokuplës) – Bollainët.
- BELLOPOLJA (rrethina e Kushumlisë) – Bellopojët.
- BELOTINAC (rrethina e Dolevcit).
- BERAXHIKA (Qarku i Toplicës) – Berexhikët.
- BERIANA (Qarku i Toplicës, më vonë Qarku i Vranjës, rrethi i Leskovcit).
- BERILA (rrethina e Prokuplës, 12 shtëpi shqiptare) - Berilët.
- BERJANI (Pusta Reka) – Berjanët.
- BERNJASHA (??) – Bernjashët.
- BESELICA (Qarku i Toplicës) – Beselicët, familje shqiptare 40 (st. turke), 20 (st. serbe).
- BËRNICA, familje shqiptare 36, familje serbe 10.
- BINXHOLLI (??).
- BLLACA (Rrethi i Prokuplës, komuna e Pllanës së Madhe, 35 shtëpi shqiptare, asnjë serbe) – Bllacët – Bllacakët. Burimi tjetër familje shqiptare 36 (st. turke), 30 (st. serbe).
- BOBISHTE (rrethina e Leskovcit)?
- Bodërlakët (nuk dihet nga janë).
- BOGOJEVCI (rrethina e Leskovcit).
- BOGUJEVCI I EP. (rrethina e Prokuplës, 8 shtëpi shqiptare).
- BOGUJEVCI I P. (rrethina e Prokuplës, 16 shtëpi shqiptare) – Bogujevcët.
- BOGUNOVCI (komuna e Medvexhës) – Bogunovcët.
- BOJNIKU (rrethina e Leskovcit) – Bojnikët.
- BOKA (Qarku i Vranjës, rrethi i Pqinjit).
- BORINCI (rrethina e Bojnikut).
- BOROVCI (rrethina e Medvexhës) – Borocët.
- BOZHURNA (rrethina e Prokuplës), 13 shtëpi shqiptare.
- BOZHURNJA (Qarku i Toplicës, më vonë, rrethi i Dobriqit).
- BRADASHI (Qarku i Toplicës) – Bradashët.
- BRAINA (rrethina e Medvexhës, Rrethi i Jabllanicës) – Brainët.
- BRAJSHORI (rrethi i Jabllanicës) – Brajshorët.
- BRALLEVA (rrethi i Kosanicës).
- BREGOVINA (rrethina e Prokuplës) – Bregovinët.
- BRENICA (rrethina e Nishit)²⁸.

²⁷ Banorët shqiptarë muhaxhirë kryesisht e morrën ngallapin e vendbanimit ku kanë jetuar, disa edhe mbiemrat.

- BRESENÇIQI (rrethina e Prokuplës 40 shtëpi shqiptare)²⁹ – Breznicët.
- BRESTI (rrethina e Zhitoraxhës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt popullata ishte shpërngulur).
- BRESTOVCI (rrethina e Bojnikut) – Brestofcët.
- BRESTVOCI (rrethina e Leskovcit).
- BREZNICA E EP. (rrethina e Prokuplës, 2 shtëpi shqiptare dhe 8 shtëpi serbe).
- BREZNICA E P. (rrethina e Prokuplës, 31 shtëpi shqiptare).
- BREZNIKU (Qarku i Toplicës, rrethi i Prokuplës).
- BUBLICA (rrethina e Prokuplës) – Bublicët.
- BUÇINCA (rrethina e Prokuplës).
- BUÇINCI (Rrethi i Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt popullata ishte shpërngulur). – Buçincët.
- BUÇIQI (rrethina e Meroshinës, 17 shtëpi shqiptare),
- BUDECI – Budecët.
- BUJAK, familje shqiptare 26 (st. turke), 16 (st. serbe).
- BUJNOVCI - Bujnocët.
- BUKOLLORANA (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt popullata ishte shpërngulur) – Bukullaramët.
- BUKOVAGLLAVA (rrethina e Leskovcit).
- BULLATOVCI (rrethina e Prokuplës, 13 shtëpi shqiptare) – Bullatofcët.
- BUNBEREKU (Rrethi i Prokuplës).
- BUNJACI (Rrethi i Kosanicës) – Bunjakët
- BURINCI (Rrethi i Kosanicës) – Burincët.
- BUSHTRANI (rrethina e Vranjës).
- BUVCA (Rrethi i Jabllanicës, tani komuna e Lebanës) – Buv(f)cët, Bucollët, Bucajt, Bucalitë.
- BYQMETI I EPËRM (rrethina e Medvexhës).³⁰
- BYQMETI I MESEËM (rrethina e Medvexhës) – Byqmetët.
- BYQMETI I POSHTËM (rrethina e Medvexhës).
- CEKAVICA (rrethina e Lebanës).
- CËRKVICA (rrethina e Bojnikut) - Cërkovicët.
- CERNATOVA – e Epërme dhe e Poshtme (rrethina e Zhitora-xhës).
- CËRNCAVCI I EPËRM (rrethina e Leskovcit).
- CËRNCAVCI I POSHTËM (rrethina e Leskovcit).
- CËRNI LLUG (rrethina e Vranjës).
- CERNOVERHI (rrethina e Medvexhës, Rrethi i Jabllanicës) – Cërnovërhet. Bublakët (Cërnovërhet).
- CEROVICA (Qarku i Toplicës, rrethi i Prokuplës).
- CERVADIKU (rrethi i Jabllanicës) – Cërvadikët.
- CERVONEKU? (rrethi i Pqinjit).
- ÇESTELINI (rrethina e Vranjës) – Çestelinët.
- ÇOKOT (rrethina e Nishit) – Çokotët - Çokotanët.

²⁸ Qarku i Nishit në vitin 1884 përfshinte nkëto rrethe: Vllasotincit, Leskovcit dhe Nishit. Në vitin 1902 përfshinte rrethet e: Nishit, Aleksincit, Banjskës, Moravës dhe Svërlingut.

²⁹ Disa të dhëna për numrin e shtëpive janë gjetur në dokumentet arkivore të kohës.

³⁰ Në regjistrimet e mëvonshme këto lokalitete përfshihen në komuna.

- ÇOKOTIN (rrethina e Medvexhës)
- Cubollët (Janë nga Toplica, por nuk dihet se të cilit fshat).
- ÇUKOVAC (rrethina e Prokuplës).
- ÇUKOVCI (rrethina e Bojnikut, Rrethi i Jabllanicës) – Çukofcët.
- ÇUKOVCI (rrethina e Leskovcit).
- CVIRCA – rrethina e Medvexhës - (në vitit 1878 është ndarë në dy pjesë, Cvetica e brendshme në Serbi dhe e jashtme në Kosovë) - Cvirçët - Cvirçakët
- DABINOVCI (rrethina e Kushumlisë) – Dabinofcët, familje shqiptare 22 (st. turke), 12 (st. serbe).
- Damaçët (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- DANKOVË - DANKOVIQ (rrethina e Kushumlisë) - Dankët (Kelani)-Dankojt, familje shqiptare 26 (st. turke), 6 (st. serbe).
- DAVIDOVCI (rrethina e Vranjës).



Shtëpi shqiptare në Dedincë

- DEDINCA (rrethina e Kushumlisë) - Dedincët – Dediajt, familje shqiptare 36.
- DEDIQI (rrethi i Jabllanicës) – Dediçët.
- DEGËRMANI (rrethina e Kushumlisë).
- DEKUTINCI (Qarku i Vranjës, rrethi i Masuricës).
- DËRVODELI (rrethina e Lebanës) - Dërvodelët.
- DËRVODELJA (Rrethina e Leskovcit).
- DESHISHKA (rrethina e Kushumlisë) – Deshishkët, 25 (st. turke), 5 (st. serbe).
- DESHULLOVA (rrethina e Meroshinës) – Dushullofcët.
- DEVÇA (rrethina e Meroshinës).
- DEVÇA E POSHTME (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit) – Devçët, Devcet.
- DEVOTINI³¹. (E regjistron dr. S. Uka).
- Dibra (shqiptarë nga Dibra kishte shkuar në Toplicë dhe nga aty në Marinë të Skënderaj).
- DLLUGOJNICA (rrethi i Masuricës) - Dllgojnicët – Masuricët.
- DOBËRNJAC (Qarku i Vranjës, Polanicë) – Dobërnjacët.

³¹ E shënon dr. Sabit Uka, në librin Dëbimi i shqiptarëve ..., fq. 33. Nuk kam mundur të gjej sot si vendbanim ose është shënuar me ndonjë emër tjetër.

- DOBRATIQUI (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt 1878, popullata ishte shpërngulur) – Dobratiqët.
- DOBRATINI, familje shqiptare 29.
- DOBRIQUI (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit).
- DOLEVCI (sot qendër komunale).
- DOPLANE (rrethina e Leskovcit) – Doplanët.
- Doshlakët (nga Qarku i Toplicës, nuk dihet fshati).
- DRAGIDEO (rrethina e Prokuplës) – Dragidellët.
- DRAGOBUZHDA (rrethina e Vranjës) – Dragobuzhdët.
- Dragollamët: Janë vendosur në fshatin Dubovc të komunës së Vushtrrisë. Nuk dihet se nga kanë ardhur dhe ku kanë shkuar. Është ruajtur mikrotoponimi *Arat e Dragullamëve*.
- Dragollukët (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- DRAGOVCI (rrethina e Bojnikut).
- DRAGUSHA E EP. (rrethina e Bllacës, 75 shtëpi shqiptare).
- DRAGUSHA E P. (rrethina e Bllacës) – Dragushët.
- DRAGUSHA E VOGËL (rrethina e Bllacës). Si një vendbanim Dragusha familje shqiptare kishte 64 (st. turke), 55 (st. serbe).
- DRAJINCA (rrethina e Surdulicës) – Draincët.
- DRENOVCI – i Epërm dhe i Poshtëm (rrethina e Zhitoraxhës),
- DRENOVCI (rrethina e Prokuplës) – Drenofcët.
- DRENOVCI (rrethina e Vranjes).
- DREVINJA (rrethi i Prokuplës, 11 shtëpi shqiptare) – Drevinjët. Spas burimit tjetër kishte familje shqiptare 31 (st. turke), 15 (st. serbe).
- DUBLINCI (rrethi i Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt 1878, popullata ishte shpërngulur).
- DUBNICA (rrethina e Vranjës).
- DUBOVA (rrethina e Zhitoraxhës) - Dubovët – Dubovcët.
- DUBRANJA (Qarku i Toplicës).
- DUBRAVA (rrethina e Bojnikut).
- DUBRAVA (rrethina e Kushumlisë).
- Dudollët (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- DUGI DOLLI (Qarku i Nishit).
- DUGI DOLLI (rrethi i Kosanicës).
- DUGOLLUKA (rrethi i Kosanicës).
- DUKATI (Qarku i Toplicës).
- DUPOLEVA (rrethina e Vranjës) – Dupulevët.
- GABROVAC (rrethi i Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt popullata ishte shpërngulur).
- GAGINCA (rrethina e Leskovcit) – Gagicët.
- GAJTONI I EPËRM (rrethina e Medvexhës).
- GAJTONI I POSHTËM (rrethina e Medvexhës) – Gajtonët.
- GALLAP, 42 familje shqiptare.
- GAZDARA (rrethina e Medvexhës).
- GAZDARA (rrethi i Prokuplës) – Gazdarët.
- Gecët (nuk dihet se ku gjendet, ose është lagje e ndonjë fshati tjetër).
- GEGLA (rrethina e Lebanës).

- GËRBAVCI (rrethina e Medvexhës) – Gërbacët.
- GËRBAVNICA (rrethi i Jabllanicës), 32 (st. turke), 13 (st. serbe).
- GËRGURI I EPËRM (rrethina e Bllacës).
- GËRGURI I POSHTËM (rrethina e Bllacës) – Gërgurët, familje shqiptare 83 (st. turke), 65 (st. serbe).
- GËRGUROVCI (rrethina e Lebanit) – Gurgullofcët.
- GESOLICA (rrethi i Kosanicës).
- GJAKA (rrethina e Kushumlisë).
- GJAKA E EPËRME (Qarku i Toplicës).
- GJAKA E POSHTME (Qarku i Toplicës) - Gjakalitë-Gjakajt. Me emrin Gjake kishte 41 familje shqiptare.
- GJAKUS (rrethina e Zhitoxhës, 27 shtëpi serbe dhe 2 shqiptare.
- GJEMNICA - Gjepnica (rrethina e Bllacës, 7 shtëpi shqiptare) – Gjennicët.
- GJERAK (Qarku i Toplicës) – Gjerakët.
- GJEREKARJA (Qarku i Toplicës).
- GJINGJUSHA (rrethina e Bojnikut).
- Gjorët (nuk dihet se nga kanë ardhur).
- GJUKELLA (rrethi i Prokuplës).
- GJULEKARI (rrethina e Medvexhës) – Gjelekarët.
- GJUREVCI (rrethina e Prokuplës).
- GJUREVCI (rrethina e Bllacës) 15 shtëpi, 12 serbe e 3 shqiptare - Gjurescët.
- GJURGJEVICA (Qarku i Toplicës).
- Gjushillofcët (Qarku i Toplicës). Nuk është konstatuar ky fshat me këtë emër, ndoshta ka të bëjë me fshatin Dushillovc?
- GJUSHINCA (rrethina e Prokuplës, 20 shtëpi shqiptare) – Gjyshincët. Sipas burimit tjetër kishte familje shqiptare 31 (st. turke), 20 (st. serbe).
- Gllacollët (nuk dihet nga kanë ardhur në Batllavë. I shënon dr. S. Uka në Prishtinë).
- GLLASOVIKU (rrethina e Prokuplës). Vendbanim shqiptar – Gllasovikët.
- Glloboderët (Nuk dihet se nga kanë ardhur).
- Gllogët (nuk është konstatuar se ku gjendet fshati Glllog).
- GOJNOVCI (rrethina e Prokuplës, 30 shtëpi shqiptare) – Gojnofcët - Shutovit (Gojnofcët).
- GOLLAKU – Gollakët.
- Gosturanët (e konsiderojnë veten muhaxhirë, por nuk dihet se nga janë).
- GORINA (rrethina e Leskovcit). Ishte e njohur kulla e begut shqiptar Demir Bajramit.
- GOVORI – Govorët.
- GRABANICA (Qarku i Toplicës) – Grabanicët.
- GRABOVCI (rrethina e Prokuplës) –Grabofcët.
- GRABOVCI (rrethi i Jabllanicës).
- Gracollët (nuk dihet fshati).
- GRADNI? (Gradishte - rrethina e Meroshinës).
- GRAINCA (rrethina e Bojnikut) – Graincët.
- GRANICA (Qarku i Toplicës).
- Grashticët (nuk kemi shënime për ta).
- GREBONICA (rrethina e Kushumlisë, Rrethi i Kosanicës).
- GUBETINI (rrethina e Prokuplës), familje shqiptare 36.

- GUBETINI (Qarku i Toplicës, rrethi i Dobriqit) – Gubetinët.
- GURIVCI (rrethi i Kosanicës).
- HASANOVCİ (rrethina e Zhitoraxhës, vendbanim shqiptar) – Hasanofcët.
- HËRRGAJA (rrethina e Prokuplës) – Herrgajët. Familje shqiptare 54 (st. turke), 40 (st. serbe). Popullata më 1 shkurt 1878 ishte shpërngulur.
- HUMİ (Qarku i Nishit).
- HURUGLİCA E EPËRME (rrethina e Leskovcit).
- HURUGLİCA E POSHTME (rrethina e Leskovcit) –Huruglicët.
- IGRİSHTA (rrethina e Kushumlisë) – Igrishtët, familje shqiptare 23 (st. turke).
- IGRİSHTA (rrethina e Leskovcit).
- İVAJA (rrethina e Bojnikut, rrethi i Jabllanicës) – Ivajët.
- İVANKULLA, familje shqiptare 25 (st. turke), 5 (st. serbe).
- İZUMNO (rrethina e Vranjës).
- JABUÇA (rrethina e Prokuplës vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt 1878, popullata ishte shpërngulur) – Jabuqët.
- JAKOVCI (Qarku i Vranjës, rrethi i Polanicës).
- JASHANICA E EP. (rrethina e Bllacës, 70 shtëpi shqiptare).
- JASHANICA E P. (rrethina e Bllacës, 16 shtëpi shqiptare) –Jashanicët. Si një vendbanim Jashanica kishte familje shqiptare 91 (st. turke), 85 (st. serbe).
- JELLASHNICA (rrethina e Leskocit).
- JELLASHNICA (rrethina e Surdulicës).
- JELLSHNICA (rrethina e Nishit).
- KACABAQI (rrethina e Bojnikut) – Kacabaqët.
- KAÇAPOR (rrethina e Bllacës) - Kaçurët (ndoshta janë nga ky vendbanim).
- KACAPUNA (Qarku i Vranjës, rrethi i Polanicës).
- KAÇMERI – Novosella (Qarku i Toplicës) – Kaçmerët.
- KALİMANCA (rrethi i Polanicës).
- KALLUDRA (rrethina e Prokuplës).
- KALLUGJERICA (rrethina e Leskovcit).
- KAMENICA (rrethina e Bojnikut, rrethi i Jabllanicës).
- KAMENICA (rrethina e Nishit).
- KAMENICA (rrethi i Kosanicës) – Kamenicët.
- KAPITI (rrethina e Medvexhës).
- Karanovcët (si duket janë nga Kraleva që është quajtur Kara-novc).
- KASTRATI (rrethina e Kushumlisë) – Kastratët, familje shqip-tare 31 (st. turke), 15 (st. serbe).
- KATIQI (rrethi i Prokuplës).
- KATUNI (rrethina e Vranjës).
- KËRÇMARA E EP. (rrethina e Kushumlisë).
- KËRÇMARA E P. (rrethina e Kushumlisë) – Kërçmarët.
- KËRÇMARI (Qarku i Toplicës, komuna e Pllanës së Madhe, 30 shtëpi shqiptare).
- KËRTOKU (rrethina e Kushumlisë) – Kërtokët, familje shqiptare 36.
- KIJEVAC (rrethina e Surdulicës) – Kijevët.
- Kitmirët (nga Nishi në Prizren).
- KLAIQI (rrethina e Lebanës) - Klaiqët
- KLİSIRA (rrethina e Surdulicës).

- KLISURA (rrethina e Dolevcit).
- KLISURICA (rrethina e Prokoplës, 19 shtëpi shqiptare) - Klisuricët. Familje shqiptare 51 (st. turke), 11 (st. serbe) dhe 4 familje serbe.
- KLLASHNICA (rrethina e Vranjës).
- KNEZ SELLO (Qarku i Nishit).
- KODRA (Qarku i Toplicës, e shënon dr. S. Uka) – Kodralitë.
- KALLUDRA (rrethi i Kosanicës) – Kolludrët, familje shqiptare 26 (st. turke), 15 (st. serbe).
- KOMRENA E EPËRME (komuna e Nishit?).
- KONÇIQI (rrethina e Prokoplës, 47 shtëpi shqiptare), Kojçiqët. Sipas një burimi tjetër me emrin Kojçinë kishte 39 familje shqiptare dhe 2 familje serbe.
- KONJINA (Qarku i Toplicës).
- KONJUFCA E EPËRME (rrethina e Bojnikut) – Konjufcët.
- KONJUFCA E POSHTME (rrethina e Bojnikut),
- KONJUHI (Qarku i Toplicës) – Konjuhët, familje shqiptare 41 (st. turke), 30 (st. serbe).
- KONJUSHA (rrethina e Prokoplës, 25 shtëpi shqiptare) – Konjushët.
- KONJUSHA E EP. (rrethina e Prokoplës, 15 shtëpi shqiptare).
- KONJUSHA E P. (rrethina e Prokoplës, 16 shtëpi shqiptare).
- KONJUVA (rrethina e Kushumlisë).
- KONXHELI (rrethina e Prokoplës, 5 shtëpi shqiptare dhe 15 shtëpi serbe) – Konxhelët.
- KOPRANI (rrethi i Jabllanicës) – Kopranët.
- KORBEVCI (rrethi i Jabllanicës).
- KORDINCA E P. (rrethina e Prokoplës, 13 shtëpi shqiptare). Kordincët.
- KORDINICA E EP. (rrethina e Prokoplës, 19 shtëpi shqiptare).
- KOSHAREVA³². (E shënon dr. Sabit Uka).
- KOSTANICA (Qarku i Toplicës).
- KOSTENICA (rrethina e Prokoplës) – Kostanicët, familje shqiptare 26 dhe familje serbe 24.
- Kostraçët (nuk kam të dhëna se nga kanë ardhur. Shënimet për këtë familje janë marrë në fshatin Ramjan i Epërm - Viti.
- KOVANLLUKU (rrethina e Meroshinës).
- KOZHINCA (rrethina e Prokoplës, vendbanim shqiptar) – Kozhincët.
- KOZMAQA (rrethina e Kushumlisë) – Kozmaçët, 31 (st. turke), 13 (st. serbe).
- KOZNICA (rrethi i Masuricës).
- Kralanët (të shpërngulur nga Kralani i Dushkajës në trevën e Toplicës dhe nga aty më 1878 në fshatin Vërboc të Drenasit.
- KREMENATA (rrethina e Leskocit) - Kremenadët.
- KRIVA FEJA (rrethina e Vranjës).
- KRIVAQA (rrethina e Lebanit, rrethi i Jabllanicës) – Krivaçët
- KRIVODËRVA (rrethi i Jabllanicës) – Krivodërvet.
- KRUSHEVICA (rrethina e Prokoplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt popullata ishte shpërngulur) – Krushevcët.
- KUÇI (rrethi i Kosanicës) – Kuçët.
- KULLA (rrethi i Kosanicës).
- KULLAQI (rrethi i Jabllanicës) - Kullaqët.

³² Nuk kam mundur që të konstatoj se ku gjendet ky vendbanim. E shënon dr. Sabit Uka.

- KUMAREVA (rrethina e Vranjës).
- KUPILLA (rrethi i Kosanicës).
- KUPINA (rrethina e Leskovcit) – Kupinët.
- KUPINOVA (rrethina e Kushumlisë).
- KURILLI (rrethi i Prokuplës).
- KUSHUMLIJA – Kushumlitë , familje shqiptare 172 (st. turke), 150 (st. serbe), asnjë serbe.
- KUTLESHI (rrethina e Leskovcit) – Kutleshët.
- KUTLLATI (rrethi i Kosanicës).
- KUTLLOVCI I MADH (rrethina e Bllacës).
- KUTLLOVCI I VOGËL (rrethi i Prokuplës, rrethina e Bllacës) – Kutllofcët, familjet shqiptare: 35 (st. turke), 25 (st. serbe).
- LALINCE (rrethina e Vranjes).
- LALINOVCI (rrethina e Lebanës).
- LEBANA (Qendër komunale, në rrethin e Jabllanicës)
- LEBOVCI (Qarku i Vranjës) – Lebovcët.
- LECE (rrethina e Medvexhës, rrethi i Jabllanicës) – Lecët.
- Lenjanët (Sipas informatave të marra në fshatin Karaçevë e P, komuna e Kamenicës, thuhet se janë muhaxhirë).
- LËNMAQA. (Nuk kemi mundur ta ubifikojmë).
- LEPAJA (rrethina e Meroshinës) - Lepajët.
- LEPOSHTICA (rrethi i Jabllanicës).
- LEPOSHTICA (rrethi i Prokuplës) – Leposhtakët.
- LESKOVA (rrethi i Masuricës).
- LESKOVCI - Leskovçanët – Leskovcët.
- LEVQA E EPËRME (Qarku i Toplicës).
- LIPOVICA (rrethina e Lebanës) – Lipovicët.
- LIPOVICA (rrethina e Leskovcit).
- Litenët: Kanë jetuar në Pakashticë të Epërme të Podujevës. Janë shpërngulur në Turqi.
- LLAGATINCA (rrethi i Jabllancës).
- LLALINCA (Qarku i Nishit) – Llalincët – Lalinofcët.
- Llaloshët (thuhet se janë muhaxhirë të vendosur në fshatin Herrticë të Podujevës).
- LLAPASHTICA e EP. (rrethina e Medvexhës).
- LLAPASHTICA E P. (rrethina e Medvexhës) - Llapashticët.
- LLAPATINCA (rrethina e Bojnikut) – Llapatincët.
- LLAZALA (rrethina e Leskocit) Llazallët.
- LLOMNICA (rrethi i Kosanicës) – Llumniceët.
- LLOMNICA E EPËRME (komuna e Vllasotincës).
- LLOMNICA E POSHTME (komuna e Vllasotincës).
- LLOQPOTOKU (Nuk është konstatuar se ku gjendet) – Lloq-potokët.
- LLOZANA (rrethina e Bojnikut) – Llozanët.
- LLOZNA (rrethi i Kosanicës).
- LLUGARI (rrethina e Lebanës).
- LLUGIQI (rrethi i Kosanicës) – Lluginë, familje shqiptare 22 (st. turke), 2 (st. serbe).
- LLUKOVA (rrethina e Kushumlisë).
- LLUKOVA (rrethina e Vranjës).

- LUKOMIRI (rrethina e Zhitoraxhës, 32 shtëpi serbe dhe 4 shtëpi shqiptare).
- LUSHA (rrethina e Kushumlisë) – Lushakët, 29 (st. turke), 25 (st. serbe).
- MAÇKOVCI (rrethina e Kushumlisë) – Maçkofcët, familje shqiptare 38 (st. turke), 20 (st. serbe).
- MAÇKOVCI (Qarku i Toplicës, atëherë komuna e Pllanës së Madhe, 15 shtëpi shqiptare).
- MAGASHI (rrethina e Bojnikut) – Magashët.
- MAGOVO (rrethina e Kushumlisë).
- MAJKOVCI (rrethina e Bojnikut) - Mojkocët – Mujkët.
- Malokët, rrjedhin nga Toplica (nuk e dijmë se nga cili fshat).
- MALQA (rrethina e Nishit).
- MANASTIRI (rrethi i Prokuplës).
- MANASTIRI (rrethina e Nishit).
- MAQEDONCI (rrethina e Medvexhës) – Maqedoncët.
- MAQINA E EP. (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptar).
- MAQJASTENA (rrethina e Kushumlisë) – Maqestenët, familje shqiptare 32 (st. turke), 20 (st. serbe).
- MAQKOVCI (rrethina e Vranjës).
- Mardoqët (e ardhur nga Perpori te Braina).
- MARINAKUTINA (Qarku i Nishit).
- MARKOVICE (rrethina e Kushumlisë) – Markovët.
- MAROVCI (rrethina e Medvexhës) – Marocët.
- Martelët (Në fshatin Prapapshticë të Prishtinës dhe Brainë të Gallapit, janë marrë të dhënat për këta banorë).
- MASURICA (rrethina e Surdulicës) – Masuricët.
- MATAROVA (rrethina e Kushumlisë) – Matarovët.
- Mavriqët (të ardhur nga Medvexha).
- MAXHARA (rrethina e Prokuplës, 21 shtëpi shqiptare) – Maxherët.
- MAZARAQI (rrethi i Polanicës).
- MEDVECI (rrethina e Medvexhës) – Medvecët.
- MEDVEXHA (rrethi i Jabllanicës) - Medvexhët – (quhen edhe Plepollët).
- MEGJA (rrethina e e Leskovcit), familje shqiptare 26 dhe familje serbe 15.
- MEGJUROVA E EPËRME (rrethina e Nishit).
- MEGJUROVA E POSHTME (rrethina e Nishit).
- MEHANJA (rrethina e Kushumlisë) – Mehonët, familje shqiptare 35 (st. turke), 15 (st. serbe).
- MEKISHI (rrethina e Dolevcit, 30 shtëpi serbe dhe 1 shqiptare)
- MELOVA (rrethina e Leskovcit) - Mellovët.
- MERKONJA (rrethina e Medvexhës) – Mërkojë.
- MERLAKU (rrethina e Prokuplës) – Merlakët.
- MERLINCA (Qarku i Toplicës) – Merlincët.
- MEROVCI - Omerovci (rrethina e Prokuplës, 21 shtëpi shqiptare-re) – Merofcët, familje shqiptare 42 (st. turke), 20 (st. serbe).
- MERQEZI (rrethina e Leskovcit).
- MERRNICA (Qarku i Toplicës) – Mërrnicët.
- MERSHELI (rrethina e Prokuplës).

- MERVESHI (rrethina e Bojnikut) – Mërveshët.
- MËSHICA (rrethina e Leskocit) – Mëshicët.
- METEJEVCI I EPËRM (Qarku i Nishit).
- METEJEVCI I POSHTËM (Qarku i Nishit).
- MEXHU-HANA (rrethina e Bllacës, 20 shtëpi shqiptare) – Mexhuanët. Sipas burimit tjetër kishte familje shqiptare 41 (st. turke), 20 (st. serbe).
- MIHALICA (rrethi i Jabllanicës) – Mihalicët.
- MIHOVC (rrethina e Leskocit) – Mihovcët.
- MIKULANI I EPËRM (rrethina e Kushumlisë).
- MIKULANI I POSHTËM (rrethina e Kushumlisë) – Mikulanët. Familje shqiptare 27, familje serbe 9.
- MIKULLOVCI (rrethina e Prokuplës, 10 shtëpi shqiptare, 9 shtëpi serbe). Mikullofcët. Sipas një burimi tjetër: 41 familje shqiptare dhe 16 famije serbe.
- MILIVOJCI (rrethina e Vranjës).
- Millovojllovcët (rrethina e Leskocit).
- MIRNICA (rrethina e Kushumlisë), familje shqiptare 32 (st. turke), 20 (st. serbe).
- MIROQICA (rrethi i Kosanicës).
- MIROSLAVI. (Nuk kam mundur të ubifikoj si vendbanim).
- MIROVCI (rrethi i Kosanicës).
- MISKIQI (rrethi i Jabllanicës) – Miskiqët.
- Mlinakët (Qarku i Toplicës).
- Mlinët: (nga Qarku i Toplicës, migruan në Turqi).
- MLLADOSHEVA (Qarku i Toplicës) – Mlladoshefcët.
- Molliqët - Molliqët (nuk dihet se nga kanë ardhur. Një kohë të shkurtër kanë jetuar në Sllatinë të Fushë-Kosovës, por janë shpërngulur. Mund të jenë nga Molla e Kuqe)?
- MOLLOVA: Mollovit?
- MOMQILLI (rrethina e Zhitoraxhës) – Momqillët.
- Morinët (nga rrethina e Prokuplës). Konsiderohen muhaxhire. Janë vendosur në Shipol të Mitrovicës.
- MOSHTANICA (rrethina e Vranjës).
- MRAMORI (rrethina e Meroshinës) - Mramorët.
- MUÇAKA (lagje e fshatit Llallincës, e Qarkut të Vranjës) - Muçakët.
- MULIQ (nuk e dijmë se a ka të bëjë me Molliqët). Familje shqiptare 14 (st. turke).
- MULEVIQ (rrethi i Kosanicës) - Muloviqët: Vushttri.
- MURIQI - Muriqët. Konsiderohen si muhaxhirë. Kanë jetuar në Pejë dhe në fshatin Pjetërqi i Ep. i Klinës.
- MUZAÇI (rrethina e Bllacës, 23 shtëpi shqiptare) – Muzaçët. Sipas burimeve të tjera familje shqiptare kishte 42 (st. turke), 12 (st. serbe).
- NEGOSAVLE (rrethina e Medvexhës) – Nekusahu.
- NELAKU (rrethina e Leskocit) - Nelakët.
- NERADOVCI I EPËRM (rrethina e Vranjës).
- NERADOVCI I POSHTËM (rrethina e Vranjës).
- NESUSHTA (rrethi i Jabllanicës) - Nesushtët.
- NEVADA (rrethina e Kushumlisë) – Nevadët, familje shqiptare 26 (st. turke).
- NICA (Qarku i Toplicës) – Nicajt. Konsiderohen muhaxhirë dhe jetojnë në fshatin Sibovc të Obiliqit.

- NISHI - Nishlitë (Hadri, Bunjaku).
- NOVO SELLA (rrethina e Leskovcit) – Novosellët.
- NOVO SELLA (rrethi i Pqinjit),
- NOVOSELLA (rrethina e Lebanës).
- NOVOSELLA (rrethina e Prokuplës).
- NOVOSELLA (rrethina e Surdulicës).
- NOVOSELLA (rrethina e Kushumlisë, 10 shtëpi shqiptare).
- OBËRTINCA (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt 1878, popullata ishte shpërngulur) – Obërtincët.
- OBLLAQINA (rrethina e Meroshinës).
- OBRAZHDA (rrethina e Bojnikut) – Obrazhdët, familjet shqiptare 34 (st. turke), 14 (st. serbe).
- ORACI (Qarku i Toplicës) – Oracët.
- ORANA (rrethina e Bojnikut, rrethi i Jabllanicës) - Oranët.
- ORAQA (rrethi i Kosanicës) –
- ORASHACI (rrethina e Leskovicit).
- ORLANA (rrethina e Dolevcit).
- ORLISHTA (rrethi i Kosanicës)–Orlishtët, familje shqiptare 33.
- ORLLOVCI (rrethina e Kushumlisë).
- OSTRAGLLAVA (rrethina e Vranjës) – Ostrogllavët.
- OTULLA KONJSKA (rrethi i Pqinjit).
- PACA (rrethi i Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt 1878, popullata ishte shpërngulur) – Pacët.
- PAÇARA – Paçarët. Jetojnë në Gremnik dhe Drenoc të Klinës.
- PAQARADA (rrethina e Kushumlisë) –Paçaradët, familje shqiptare 19 (st. turke), 4 (st. serbe).
- PARADA (rrethina e Kushumlisë).
- PASHINCA (rrethina e Prokuplës, 1 shtëpi shqiptare dhe 8 shtëpi serbe). Pashincët në Pejë.
- PASJAÇA (Qarku i Nishit) – Pasjaçët.
- PASJAÇA (Qarku i Pirotit).
- PASJAÇA (rrethina e Prokuplës).
- PASJAQA (rrethina e Zhitoraxhës, 24 shtëpi shqiptare).
- PAVLLOVCI (rrethina e Vranjës).
- PËRPORA (rrethi i Jabllanicës) - Përporët.
- PERTATA (rrethina e Lebanës).
- PERUNIKA (rrethina e Kushumlisë) – Pernikët.
- PËRVETICA (rrethina e Kushumlisë) – Përveticët, familje shqiptare 27.
- PESTISHI (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt popullata ishte shpërngulur) – Pestishët.
- PETRESH: familje shqiptare 49 (st. turke), 32 (st. serbe).
- PETROVAC (rrethina e Lebanës).
- PETROVAC (rrethina e Leskovcit)
- PETROVCI (rrethina e Prokuplës, 10 shtëpi shqiptare, 10 shtëpi serbe) – Petrovcët.
- PIROTI (Qarku i Nishavës-Pirotit: Pirotasit. Janë vendosur në Gjakovë).
- PISKALA (rrethina e Prokuplës, 16 shtëpi shqiptare) – Piskalët.

- PLAÇKAVICA (rrethina e Vranjës).
- PLAKOVA (rrethina e Kushumlisë, rrethi i Kosanicës).
- PLAKOVA (Rrethi i Prokuplës) – Plakollët, familje shqiptare 37 (st. turke), 17 (st. serbe).
- PLAKOVIQ (Qarku i Toplicës, 15 shtëpi shqiptare).
- PLLANA E MADHE (rrethi i Prokuplës, 124 shtëpi shqiptare).
- PLLANA E POSHTME (rrethi i Prokuplës, 7 shtëpi serbe dhe 24 shtëpi shqiptare). – Pllanalitë. - Batallovit - nga Pllana e M. e Toplicës janë vendosur në Pestovë të Vushtrrisë.
- PLLANA E VOGËL (rrethina e Prokuplës). Si vendbanim vendbanim shqiptarë me emrin Pllana kishte 178 familje (st. turke), 158 familje (st. serbe).
- PLLAVCI (rrethina e Bojnikut) – Pllavcët.
- PLLOQNIKU I EPËRM (rrethina e Prokuplës).
- PLOQNIKU I POSHTËM (rrethina e Prokuplës) – Pllashnikët.
- POGASHTICA (rrethi i Kosanicës).
- POLLOMI (rrethina e Vlladiqinhanit).
- POLLOMI (Qarku i Toplicës) – Pollomët.
- POLLOMI (Qarku i Vranjës).
- POPOVA (Qarku i Nishit).
- POPOVA (rrethina e Bllacës, 27 shtëpi shqiptare) – Popovët.
- POPOVCI (rrethina e Lebanës, rrethi i Jabllanicës) - Popovcët.
- POROSHTICA (rrethina e Lebanës) – Poroshticët.
- POROSHTICA (rrethina e Medvexhës).
- POTURQOI (Qarku i Toplicës) – Poturqojtë, familje shqiptare 42 (st. turke), 35 (st. serbe).
- PREBEZA E EPËRME (rrethina e Bllacës, 14 shtëpi shqiptare).
- PREBEZA E POSHTME (rrethina e Bllacës, 22 shtëpi shqiptare) – Prebezët.
- PREBOJI (Rrethi i Prokuplës).
- PREKADINI (rrethina e Prokuplës, 30 shtëpi shqiptare) – Prekadinët. Burimi tjetër familje shqiptare 86 (st. turke), 70 (st. serbe).
- PREKASHNICA (rrethina e Prokuplës).
- PREKODOLLCA (rrethina e Vlladiqinhanit, rrethi i Polanicës).
- PREKOPUCA (rrethina e Prokuplës, 30 shtëpi shqiptare) – Prekopucët.
- PREKOQELLNICA (rrethina e Lebanës) – Prekoqellnicët.
- PREKOROGJA (rrethina e Kushumlisë) - Prekët – Prekorogjet.
- PREOBRAZHENJA (rrethina e Vranjës).
- PREPOLLCI (rrethi i Prokuplës) – Prepollcët –Prepollët.
- PRESTRESHNJA (rrethina e Bllacës, 40 shtëpi shqiptare) – Prestreshët.
- PRETREZHANA (rrethina e Bllacës, 18 shtëpi shqiptare) - Pretërzhanët.
- PREVALLCI (rrethi i Pqinjit).
- PRIDVORICA (rrethina e Bllacës, 60 shtëpi shqiptare) – Podvoricët.
- PRIDVORICA (rrethina e Bojnikut), familje shqiptare 55 (st. turke), 35 (st. serbe). Ndoshta ka të bëjë me atë të Bllacës?
- PROKUPLA (kishte 1114 shtëpi, 750 shqiptare dhe 364 serbe), Sipas një burimi tjetër kishte 680 shtëpi shqiptare dhe 120 shtëpi serbe: Prokupët-Prokupalitë – Prokupalanët - Dallkët (Prokuplët).

- PROLOMI (rrethina e Kushumlisë, Rrethi i Kosanicës).
- PROSEKA (Qarku i Nishit).
- PUKOVAC (rrethina e Dolevcit, 113 shtëpi serbe dhe 9 shtëpi shqiptare).
- PUPOVCI I MADH (rrethina e Kushumlisë).
- PUPOVICA E EPËRME (rrethi i Prokuplës).
- PUPOVICA E POSHTME (rrethi i Prokuplës).
- PUSTA (rrethi i Jabllanicës).
- PUSTO VOJLLEVCE (Qarku i Toplicës).
- Qavotët (nuk dihet se nga kanë ardhur. Thuhet se janë muha-xhirë. Janë vendosur në Berrnicë të Epërme dhe në Prishtinë).
- QUNARAKU (rrethi i Prokuplës).
- QUNGULA (rrethina e Bllacës) – Qungullët.
- QUNGULLA (Qarku i Toplicës) – Qungullët – Qungellët, familje shqiptare 42 (st. turke), 35 (st. serbe).
- QYQALLA (rrethina e Bllacës, 16 shtëpi shqiptare) – Qyqallët.
- RABOVCI (rrethi i Prokuplës).
- RAÇA (rrethina e Kushumlisë) – Raçët, familje shqiptare 29.
- RADEVCI (rrethina e Lebanës) – Radecët.
- RADINOVCI (rrethina e Lebanës) – Radinofcët.
- RADOVCE (rrethi i Jabllanicës).
- RAFUNA (rrethina e Lebanës, rrethi i Jabllanicës) – Rafunët.
- RAKOVICA (rrethi i Kosanicës) - Rakovicët – Rakovinët, familje shqiptare 41 (st. turke), 4 (st. serbe).
- RAMABAJA (rrethina e Medvexhës) – Ramabajët.
- RAMADEN – Ramadenët. (Nuk kemi mundur të përcaktojmë se ku gjendet ky vendbanim).
- RAMANOVCI I POSHTËM (rrethina e Surdulicës).
- RAMNISHTA (rrethi i Jabllanicës) – Ramnishtë.
- RANUTOVCI (rrethina e Vranjës).
- RAPEVLA (rrethi i Pqinjit).
- RASHEVCI (rrethi i Prokuplës).
- RASHICA E P. (rrethina e Bllacës, 17 shtëpi shqiptare) – Rashicët. Sipas burimit tjetër Rashica si një vendbanim kishte familje shqiptare 30 (st. turke), 10 (st. serbe).
- RASHKA - Rashkët. Janë vendosur në vendbanimin Dumosh të Podujevës.
- RASKOVAQA – e Epërmja dhe e Poshmja (rrethina e Mero-shinës).
- RASTALICA (rrethina e Kushumlisë) – Restelicët, 21 familje shqiptare, sipas statistikave turke.
- RASTAVNICA (rrethina e Prokuplës). Me emrin Rastavicë, kishte 29 familje shqiptare.
- RATAJI (rrethina e Vranjës).
- RAVNA REKA (rrethi i Polanicës).
- RAVNISHORTI (rrethina e Kushumlisë).
- REBELICA (rrethi i Kosanicës).
- REÇICA (rrethina e Bojnikut) - Reçicët
- REÇICA (rrethina e Zhitoraxhës).
- REÇICA E EP. (rrethina e Prokuplës, 15 shtëpi shqiptare).
- REÇICA E POSHTME (rrethina e Prokuplës, 15 shtëpi shqiptare dhe 22 shtëpi serbe).

- RELINCI (rrethina e Prokoplës, 6 shtëpi shqiptare dhe 24 shtëpi serbe).
- RESINCI I EPËRM (rrethina e Prokoplës, 14 shtëpi shqiptare),
- RESINCI I POSHTËM (rrethina e Prokoplës) – Resincët - Gërrexhalitë (Resincët).
- RETEKOCERI I MAQEDONCIT (rrethina e Medvexhës).
- RETKOCERI I EPËRM (rrethina e Medvexhës),
- RETKOCERI I P. (rrethina e Medvexhës) – Retkocerët. Me emrin Ratocer familje shqiptare kishte 140 (st. turke), 110 (st. serbe).
- RIBINCE (rrethina e Vranjës).
- ROSTAQA – ROZHDANCE (rrethi i Pqinjit).
- RRAPI (rrethi i Kosanicës) – Rrapët, të vendosur në Roganë të Kamenicës.
- RUBANI (rrethi i Prokoplës).
- RUBOVCI – Rubovcët, të vendosur në Velegllavë të Kamenicës.
- RUDARI (rrethina e Kushumlisë) – Rudarët.
- RUDOVCI (rrethi i Prokoplës - Pusta Reka).
- RUJKOVCI (rrethina e Medvexhës) – Rukofcët.
- RUJNIKU (Qarku i Nishit).
- SAGONJEVA (rrethina e Kushumlisë) – Sagojevët, familje shqiptare: 69 (st. turke), 25 (st. serbe).
- SAMAKOVA (rrethina e Kushumlisë).
- SAMARINOVCI (rrethina e Zhitoraxhës), 19 shtëpi serbe dhe 2 shqiptare.
- SEKICOLLI (rrethina e Lebanës) – Sekicollët.
- SEKIRAQA (rrethina e Kushumlisë) – Sekiraqët, familje shqiptare 49 (st. turke), 40 (st. serbe).
- SELISHTA (rrethina e Kushumlisë) - Selishtët.
- SELISHTË (rrethina e Prokoplës).
- SELLOVA (rrethina e Kushumlisë) – Sellovët, familje shqiptare 15 (st. turke), 4 (st. serbe).
- SEOCI (rrethina e Kushumlisë).
- Sforcët (nuk dihet se nga kanë ardhur). Janë vendosur në lagjen Mukatë të Slivovës së Prishtinës.
- SHAHIQI (rrethi i Jabllanicës) – Shahiqët.
- SHAJINOVCI (rrethina e Dolevcit).
- Shalkët (nuk e dijmë nga janë). Kanë jetuar në Batferr të Gojbulës, komuna e Vushtrrisë.
- SHAMALLUKA (rrethina e Kushumlisë, rrethi i Kosanicës) – Shamallukët. (Një pjesë është në Kosovë).
- SHAPRINCI (rrethi i Pqinjit).
- SHARLINCI (rrethina e Dolevcit, 28 shtëpi serbe dhe 1 shqiptare).
- SHATRA E EPËRME (rrethina e Kushumlisë).
- SHATRA E POSHTME (rrethina e Kushumlisë) – Shatrollët, familje shqiptare 26 (st. turke), 17 (st. serbe)..
- SHILEMANJA (rrethina e Bllacës, 18 shtëpi shqiptare) – Shulemajet. Sipas statistikave turke kishte 29 familje shqiptare.
- SHILLOVA (rrethina e Lebanës, rrethi i Jabllanicës)
- SHILLOVA (Qarku i Toplicës).
- SHILLOVA E SHKRETË (rrethina e Medvexhës) – Shillovët.
- SHIROKONJIVE (rrethina e Prokoplës) – Shirokonjivët.

- SHISHMANOVCI (rrethina e Prokuplës, 25 shtëpi shqiptare) – Shishmanofcët.
- SHULLCA (Qarku i Toplicës).
- SHUSHNJAKU (rrethi i Prokuplës) – Shushnjakët.
- SIBNICA (rrethina e Bllacës, 45 shtëpi shqiptare) – Simnicët, familje shqiptare 34 (st. turke), 25 (st. serbe).
- SIJARICA (rrethina e Vranjës) – Sijaricët.
- SIJARINA (rrethina e Medvexhës) – Sijarinët.
- Sikreshët (lagje e Cvirçës), të vendosur në Gjilan.
- SINISHTA (rrethi i Prokuplës).
- SKOVARI (rrethi i Prokuplës).
- SKOVËRQI (rrethi i Jabllanicës) - Skovërçanët – Skovërçët.
- SLISHANI (rrethina i Lebanës) – Slishanët.
- SLIVNICA (rrethina e Vranjës).
- SLIVOVA (rrethi i Prokuplës) – Slivovët.
- SLLATINA (rrethi i Prokuplës).
- SLLAVINCI (rrethi i Prokuplës).
- SLLAVNIKU (rrethina e Bojnikut) – Sllamnikët.
- SMËRÇA (rrethi i Prokuplës) – Smërçakët.
- SMËRDAN (rrethina e Leskocit).
- SMËRDANI (rrethina e Prokuplës, 12 shtëpi shqiptare) –
- SMËRDIQI (rrethina e Zhitoraxhës)
- SMËRXHA (rrethi i Jabllanicës).
- SMILEVIQI (rrethina e Vranjës).
- SOBINA (rrethina e Vranjës).
- SODERCE (rrethina e Vranjës).
- Sofijasit (nuk kemi të dhëna, i shënon dr. Sabit Uka në Prizren).
- Softollët (janë nga Kërçmari i Toplicës). Janë vendosur kryesisht në fshatrat: Sllatinë, Herrticë, Lladovc të Podujevës.
- SPANCA (rrethina e Prokuplës) - Spancët – Spancakët, familjet shqiptare 38 (st. turke), 28 (st. serbe).
- SPONCA (rrethina e Medvexhës).
- STARABAJA (rrethina e Medvexhës) – Starabajtë.
- STARASELLA (rrethina e Prokuplës) – Starasellët, familje shqiptare 16.
- STATOVCI I EPËRM (rrethina e Prokuplës).
- STATOVCI I MESËM (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptarë. Më 1 shkurt 1878, popullata ishte shpërngulur) – Statofcët.
- STATOVCI I POSHTËM (rrethina e Prokuplës).
- STROPSKA (rrethina e Vranjës).
- STUBLLA (rrethina e Bllacës, 30 shtëpi shqiptare).
- STUBLLA (rrethina e Bojnikut), familje shqiptare 59 (st. turke), 50 (st. serbe). Ndoshta ka të bëjë me atë të Bllacës ose të Medvecës apo të treve tjetër, pasi që ka pasur disa Stublla?
- STUBLLA (rrethina e Medvexhës).
- STUBLLA (rrethi i Jabllanicës).
- STUBLLA (rrethi i Polanicës) – Stubllakët.
- STUDIMLE (Qarku i Toplicës - rrethi i Leskovcit)

- STULLCA – Stullcakët.
- SURDULICA (sot komunë) – Surdullët.
- SUVA MORAVA (rrethi i Polanicës).
- SUVI DOLLI (rrethina e Bllacës).
- SUVI DOLLI (Qarku i Nishit).
- SUVI DOLLI (rrethina e Surdulicës).
- SUVI DOLLI (rrethina e Vranjës).
- SUVOJNICA (rrethi i Pqinjit).
- SFARÇA E EPËRME (rrethina e Bllacës, 35 shtëpi shqiptare) – Svarqalitë – Sfarqakët.
- SFARÇA E P. (rrethina e Bllacës, 23 shtëpi shqiptare).
- SVËRBQA (rrethi i Jabllanicës).
- SVINJISHTA (rrethina e Kushumlisë) - Svinjishtët – Svishtët, familje shqiptare 20.
- Talinocët (Muhaxhirë të vendosur në Talinoc të Ferizajt dhe nga aty kanë ardhur në Hajkobillë ku kanë qendruar pak kohë dhe janë shpërngulur në Turqi. Nuk e dijmë se nga cili fshat i Sanxhakut të Nishit ishin).
- TALIROVCI (rrethi i Jabllanciës) - Talirovcët: janë vendosur në fshatin Rahovicë të Kamenicës.
- TASHEVCI (rrethina e Kushumlisë) – Tashefcët, familje shqiptare 31 (st. turke), 10 (st. serbe).
- TEBESHINJA E POSHTME (rrethina e Vranjës).
- TENA (nuk e kemi gjetur si vendbanim në evidence përkatëse, re shënon dr. Sabit Uka).
- TËRBUJA E EPËRME (rrethina e Bllacës).
- TËRBUJA E POSHTME (rrethina e Bllacës) –Tërbujët, familjet shqiptare 19 (st. turke), 12 (st. serbe).
- TERHA (nuk e kemi caktuar lokalitetin), familje shqiptare 22.
- TËRHA (Qarku i Toplicës) – Tërhët – Tërhollët.
- TËRMKA (rrethina e Kushumlisë) – Tërmkollët, familje shqiptare 22 (st. turke), 15 (st. serbe).
- TERNAVA E EPËRME (Qarku i Nishit).
- TËRNAVILLAZI (rrethina e Prokuplës) – Tërnavillazët. Familje shqiptare kishte 15 (st. turke), 10 (st. serbe), asnjë serbe. Me 1 shkurt 1878 popullata në tërësi ishte shpërngulur.
- TËRPEZA (rrethina e Kushumlisë) – Tërpezët, familje shqiptare 30 (st. turke), 10 (st. serbe).
- TERNAVA E EPËRME (rrethina e Prokuplës, 19 shtëpi shqiptare, 6 shtëpi serbe).
- TERNAVA E POSHTME (Qarku i Nishit).
- TERNAVA E POSHTME (rrethina e Prokuplës) –Tërnavët. Si një vendbanim me emrin Ternava ishte 51 shtëpi shqiptare dhe 48 shtëpi serbe.
- TËRRNAVCI - Tërnavcit.
- TERRSTENA (rrethina e Vranjës) – Tërstenët.
- TËRSHKA ARBANISHTA (e shënon dr. Sabit Uka).
- TIHOVCI (rrethina e Kushumlisë) –Tihovcët.
- TMAVA (rrethina e Kushumlisë) – Tmavalitë, familje shqiptare 41 (st. turke), 35 (st. serbe).
- TOÇANI I EPËRM (rrethina e Kushumlisë). Si një vendbanim kishte familje shqiptare 46 (st. turke), 40 (st. serbe).
- TOÇANI I POSHTËM (rrethina e Kushumlisë) 14 shtëpi shqiptare) – Toçanët.

- TOGAQEVCI (rrethina e Lebanës).
- TOPANICA (rrethina e Zhitoxhës). Si një vendbanim me emrin Topanicë, kishte 61 familje shqiptare dhe 32 familje serbe.
- TOPANICA (rrethi i Dobriqit).
- TOPANICA E EPËRME (Qarku i Nishit).
- TOPANICA E EPËRME (rrethi i Prokuplës, 15 shtëpi shqiptare) – Topanicët.
- TOPANICA E POSHTME (Qarku i Nishit).
- TOPANICA E POSHTME (rrethi i Prokuplës, 27 shtëpi serbe dhe 7 shtëpi shqiptare).
- Toplicët (të ardhur nga Cekavica e Jabllanicës dhe Konjuhi i Toplicës).
- TOPLLANCI (rrethina e Vranjës).
- TOSHI - Toshët: Janë vendosur në fshatin Konjuh të Lipjanit, Prishtinë dhe Penuh të Podujevës.
- TOVËRLANI (rrethina e Prokuplës).
- TOVËRLANI (rrethi i Kosanicës) – Tovrlanët.
- TREBESHINA E EPËRME (rrethina e Vranjës).
- TREBINJA (rrethina e Kushumlisë).
- TREQAKU (rrethina e Kushumlisë).
- TUBUZHDE (rrethi i Pqinjit).
- TULLARI (rrethina e Medvexhës).
- TULLARI (rrethi i Prokuplës) – Tullarët, familje shqiptare 32 (st. turke), 20 (st. serbe).
- TUPALLA (rrethina e Medvexhës) – Tupallët.
- TURJANA (rrethina e Bojnikut) – Turjanët.
- TURUQICA. (E shënon dr. S. Uka).
- USHEVCE (rrethina e Vranjës).
- USHI. (E shënon dr. Sabit Uka).
- VAGËRMENI (rrethi i Kosanicës).
- VARDENIKU – (VARADINI) - (rrethina e Medvexhës).
- VASILEVCI (rrethina e Kushumlisë): Vasilevcët.
- VËRBAVA (e shënon dr. Sabit Uka).
- VËRBICA – Vërbicët. (I shënon dr. Sabit Uka).
- VËRBOVCI (rrethina e Bllacës).
- VERBOVCI I EPËRM (Toplicë, 35 shtëpi shqiptare),
- VËRBOVCI I POSHTËM (Qarku i Toplicës, 20 shtëpi shqiptare) - Vërbovcët. Si një vendbanim Vërbovci familje shqiptare kishte 39 (st. turke), 30 (st. serbe).
- VËRSHEVCI (rrethina e Kushumlisë) – Vërshefcët.
- VËRTOPI (rrethi i Jabllanicës).
- VËRTOPI (rrethi i Prokuplës) – Vërtopët.
- VIÇA (rrethina e Prokuplës, 10 shtëpi shqiptare) – Viçollët – Vuçollët.
- VINA. (E shënon dr. Sabit Uka).
- VISHESELLA (rrethina e Bllacës) – Vishesellët.
- VISOKA (rrethina e Kushumlisë) – Visokët, familje shqiptare 32 (st. turke), 12 (st. serbe).
- VITOSHA (Qarku i Toplicës).
- VLLAHIA (Qarku i Toplicës) – Vllahinjët.
- VLLAHINJA (rrethina e Kushumlisë, Rrethi i Kosanicës), familjet shqiptare 31 (st. turke), 20 (st. serbe).

- VLLASA (rrethi i Jabllanicës).
- VLLASA (rrethi i Kosanicës).
- VLLASA e Leskocit -Vllasa –Vllasët - Vllasakët – Vllasalitë 37 (st. turke), 30 (st. serbe).
- VLLASI (rrethina e Vranjes).
- VLLASI I EPËRM (Qarku i Nishit).
- VLLASI I POSHTEM (Qarku i Nishit).
- VLLASINA (rrethina e Surdulicës) - Vllasinët: Kllokot (Vi),
- VLLASOTINCA (qendër komunale) – Vllasotincët.
- VLLASOVA (rrethina e Prokuplës).
- VODICE (rrethina e Prokuplës).
- VODICE (rrethi i Kosanicës).
- VODINCI (rrethi i Kosanicës).
- VOJLLOVCI I MADH (rrethina e Lebanit).
- VOJLLOVCI I VOGËL (rrethina e Lebanit).
- VOVA (rrethi i Kosanicës).
- VRANJA (rrethi i Pqinjit).
- VRANJA E P. (rrethi i Pqinjit) –Vranjanët – Vranjalitë.
- VRANOVC (Qarku i Toplicës) – Vranovcët.
- VRANOVC I EPËRM (rrethina e Lebanit).
- VRANOVC I POSHTËM (rrethina e Lebanit).
- VRAPCA (rrethina e Medvexhës) – Vrapcët.
- VRATOGOSHI I EPËRM (rrethina e Vranjës).
- VRATOGOSHI I POSHTËM (rrethina e Vranjës).
- VRELLA (rrethina e Kushumlisë) – Vrellakët, 26 (st. turke), 6 (st. serbe).
- VRELLA (Qarku i Nishit).
- VREZHINA E EPËRME (Qarku i Nishit).
- VREZHINA E POSHTME (Qarku i Nishit).
- VUÇJAKU (rrethi i Kosanicës) - Vuçalitë:
- VUJANOVA (rrethi i Jabllanicës) - Vujanovët (Janovët).
- VUKOJEVCI (rrethina e Kushumlisë).
- XHIGOLI (rrethina e Prokuplës) – Xhigolët, familje shqiptare 61 (st. turke), 16 (st.serbe).
- ZAGRAXHA (rrethina e Kushumlisë) –Zagraxhët.
- ZAGUZHANI (rrethina e Surdulicës).
- ZAPSKA E EPËRME (rrethina e Vranjës).
- ZAPSKA E POSHTME (rrethina e Vranjës).
- ZDARAVINJA (Qarku i Toplicës, rrethina e Prokuplës).
- ZEBICA (rrethina e Kushumlisë, rrethi i Kosanicës) – Zebicët.
- ZHARK (Qarku i Toplicës) – Zharkët.
- ZHDELLOVA (Qarku i Toplicës)
- ZHEGROVA (rrethina e Kushumlisë) – Zhegrovët, familje shqiptare 35 (st. turke), 25 (st. serbe).
- ZHITNI POTOK (rrethina e Prokuplës).
- ZHITNI POTOK (Pustareka, vendbanim shqiptar) – Zhinipoto-kët - Dumanët (Zhinipotokët) - Sofiqët –Zhinipotokët – Sylyshët. Familje shqiptare 21 (st. turke), 11 (st. serbe).

- ZHITORAGJA (sot qendër komunale).
- Zhugollët (rrethina e Vranjës), janë vendosur në fshatin Dabishec të Prishtinës.
- ZHUSHI - RESINCA (Qarku i Toplicës) – Zhushët.
- ZLLATA (rrethina e Prokuplës, vendbanim shqiptar) – Zllatët.
- ZLLATOKOP (rrethina e Vranjës).
- ZUBA. (E shënon dr. Sabit Uka).
- ZUÇA (rrethina e Kushumlisë) - Zuçakët – Zuçollët – Zuçët, familje shqiptare 24 (st. turke), 14 (st. serbe).

4.2. Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit

Procesin e kolonizimit të trojeve shqiptare me elementin sllav dhe shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve për të realizuar transfor-mimin e hartës etnike në favor të vet, Serbia ka vazhduar ta zbatojnë edhe gjatë viteve të Krizës Lindore (1875), respektivisht që nga Lufta ruso-turke (1877-78). Në këtë kohë Serbia pushtoi Sanxhakun e Nishit, ku bënë pjesë edhe vise etnike shqiptare si Toplica, Kurshumlia, Vranja, Masurica, Leskoci, Prokupla e deri përtej Nishit.

Sipas shënimeve serbe³³, në luftë me Turqinë, e cila ka filluar në vitin 1876, ndërsa më 1877 dhe 1878 e ka zhvilluar në aleancë me Rusinë, Principata Serbe e ka fituar pavarësinë e vet dhe e ka zgjëruar pushtetin e vetë në katër qarqe jugore (të Nishit, Pirotit, Vranjës dhe Toplicës).

Sipas shënimeve statistikore jo të plota, kjo trevë para vitit 1877 kishte një numër të konsideruar të shqiptarëve. Prokuplja, kishte 650 shtëpi myslimane (shqiptare J.O.) dhe 140 shtëpi të krishtere.³⁴ Ishte qendër e krahinës së Toplicës; Kurshumlia, kishte rreth 200 shtëpi shqiptare dhe vetëm 2 serbe;³⁵ Leskovci, kishte 2500 shtëpi të krishtera dhe 100 shtëpi shqiptare dhe turke;³⁶ Vranja, kishte 2500 shtëpi të krishtera dhe 800 shtëpi me popullatë myslimane;³⁷ Nishi, kishte 3500 shtëpi të krishtera dhe rreth 2000 shtëpi shqiptare e turke, me rreth 30.000 banorë.³⁸ Në Nish dhe në disa qendra të tjera të Sanxhakut të



³³ Stanovništvo Narodne Republike Srbije od 1834-1953, Beograd, 1953, fq. 14.

³⁴ Dr. Vidosava Stojancevic, Leskovac i oslobodjenje Leskovca, Leskovac, 1975, fq. 12; Dr. Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve ..., fq. 36.

³⁵ Dr. Vidosava Stojancevic, Leskovac I oslobodjeni krajevi ..., fq. 12; Dr. Sabit Uka, Dëbimi I shqiptarëve ..., fq. 37.

³⁶ E njëjtë.

³⁷ Jovan Trifunoski, Vranjska kotlina, Skopje, 1962, fq. 78; Dr. Sabit Uka, Dëbimi I shqiptarëve ..., fq. 40.

³⁸ Dr. V. Stojancevic, Leskovac i oslobodjeni predeli ..., fq. 12; Dr. S. Uka, Dëbimi I shqiptarëve ..., fq. 40.

Nishit ishte vendosur një pjesë e madhe e shqiptarëve që kishin jetuar në qytetet Qupri, Paraqin, Krushevc, Aleksinc, Karenovac (Kralevë), deri në vitin 1833, kur Principata e Serbisë i merrë 6 nahijet e reja: Paraqinin, Razhnjin, Soko Banjen, Timokun, Negotinin dhe Kryshecin. Ndërsa, më herët në vitin 1743, nga Beogradi u larguan 1000 familje shqiptare.³⁹ Popullatë shqiptare ka pasur edhe në qytezat Pirot, Bella Pallankë, Tërnë etj, por nuk kemi të dhëna për to. Mirëpo, këto treva sipas të gjitha gjasave kanë pasur rreth 500.000 banorë, prej tyre jetonin 200.000 – 250.000 banorë shqiptarë që jetonin në 700 e më tepër vendbanime, të pastra shqiptare, por edhe të përzira me atë serbe, çerkeze, e të tjerë.⁴⁰ Këtë e dëshmon, valiu i Vilajetit të Kosovës, Rifat Pasha, në shkurt të vitit 1878 e kishte njohtuar anglezin Cooper, se në Vilajetin e Kosovës, në atë kohë, kishte prej 200.000 muhaxhirë shqiptarë të shpërngulur nga kazatë e Nishit, Kushumlisë, Leskovcit, Vranjës etj.⁴¹ Këtu nuk janë përmendur muhaxhirët të cilët drejtëpërdrejt janë shpërngulur në pjesët tjera të territorit që administronte Turqia.

Përkritazi me shpërngulje e shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, Konsulli i përgjithshëm i Britanisë së Madhe në Selanik J.E. Blunt në raportin e tij drejtuar Foreign Office, ndër të tjera, shkruante: *“Në Vilajetin e Kosovës ishin momentalist 65.000 muhaxhirë të shpërngulur nga viset, të cilat i ishin dorëzuar Serbisë dhe Bullgarisë. Këta muhaxhirë ishin të vendosur në fshatrat e këtij Vilajeti (Kosovës): 11.000 në rrethin e Vushtrrisë, 17.000 në rrethin e Prishtinës, 13.000 në rrethin e Gjilanit, 16.000 në Sanxhakun e Shkupit dhe 8.000 në Sanxhakun e Jeni Pazarit (gjithsej 65.000)”*. Ndërsa, Johan John Ross, komisar i Komisionit ndërkombëtar për shënimin e kufijve të rinj të Serbisë shkruante: *“Pothuajse të gjithë banorët e pjesës perëndimor të Sanxhakut të Nishit ishin shqiptarë të besimit mysliman, ndërsa ata iu dorëzuan Serbisë më 1878. Ata zinin shumicën e katundeve në perëndim të vijës së tërhequr në të majtë të Moravës, afër Nishit, Leskovcit, Vranjës, Prokuplës dhe Kurshumlisë. Ajo popullsi e gjitha e deportua në Vilajetin e Kosovës duke lënë tërë vendin të boshatisur. Llogaritet se në vitin 1878 kishte deri në 70.000 muhaxhirë shqiptarë të shpërndarë nëpër Vilajet. Ata kurrë nuk do të lejohen të kthehen në fshatrat e tyre. Ata çdo gjë e kishin humbur dhe me dekada pëjetonin pikëllim dhe mjerim të madh”*.⁴²

Sipas konsullit rus në Prizren, Jastrebov, si pasojë e luftës serbo-turke, më 1877, vetëm në Vilajetin e Kosovës ishin vendosur 73.000 muhaxhirë të pastrehë dhe të rrezikuar nga shfarosja masive për shkak se nuk kishin asnjë kusht jetese. Kjo popullsi më 1879, kishte mbetur pa asgjë e mbi të gjitha ishte e rrezikuar nga sëmundjet ngjithëse.⁴³

Nga këto vise për një kohë të shkurtër u bë spastrimi etnik i mbi 700 fshatrave e vendbanimeve shqiptare me një popullsi rreth 300.000 veta.⁴⁴ Në vend të tyre u vendosën serbët dhe malazezët besnikë të regjimit. Sipas të dhënave që i ka prezantuar Komisioni për vendosjen e muhaxhirëve, për përkujdesje ndaj tyre, në valën e parë, më 1877 ishin shënuar 10.000 muhaxhirë që nuk kishin asgjë nga pasuria. Vetëm në muajt e parë të vitit 1878, statistika e

³⁹ Dr. Radmilla Trickovic, leskovac u XVIII veku (1683-1804), Leskovacki Zbornik, 11, Leskovac, 1971, fq. 20; Dr. Sabit Uka, Dëbimi I shqiptarëve ..., fq. 42.

⁴⁰ Dr. Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, 1877/78, Prishtinë, 1995, fq. 31-42.

⁴¹ Vushtrria me rrethinë, monografi, Vushtrri, 2003, fq. 110.

⁴² Skender Rizaj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1877-1878, Prizren, 77; Dr. Bujar Dugolli, Pasojat e luftës serbo-osmane, punim ndë dorëshkrim.

⁴³ V. Boban, Jastrebov u Prizrenu, Priština, 1983, fq. 142.

⁴⁴ Dr. Sabit Uka, Planet serbe, p. i c., fq. 162.

* Janë shënuar emrat e vendbanimeve të kohës kur janë vendosur shqiptarët muhaxhirë.

muhaxhirëve regjistronte 65.000 të pastrehë, ndërsa në qershor të të njëjtit vit, Komisioni për vendosje dhe përkujdesje ndaj muhaxhirëve theksonte se 240.000 muhaxhirë nuk kanë bukë për të ngrënë dhe janë të pastrehë. Sipas Komisionit vetëm në vitin 1878, në Stamboll ishin stacionuar 85.000 muhaxhirë, kryesisht të ndjekur nga viset etnike shqiptare. Në fund të vitit 1878 theksohet se 200.000 muhaxhirëve duhet siguruar ushqim dhe veshëmbadhje. Për ta zbutur këtë tragjedi, në dokumentet e Komisionit theksohet se pjesën dërrmuese të tyre duhet kthyer në Sanxhakun e Nishit, duke bërë presion që Serbia t'i zbatojë paragrafët e Kongresit të Berlinit.⁴⁵

Gjatë pushtimit të këtyre trevave shqiptare të Sanxhakut të Nishit, Serbia në këtë luftë ushtroi një gjenocid masiv ndaj popullsisë shqiptare, që u mbështet edhe në forcat ruse. Ushtarakët serbë për të realizuar këtë qëllim kishin përdorur mjetet më brutale të likuidimit fizik të shqiptarëve, duke mos i kursyer as fëmijët, gratë e pleqtë. Me dhjetra mijë shqiptarë të moshave të ndryshme gjetën vdekjen nga zjarri i armëve, i bajonetave, nga djegiet për së gjalli, nga ngrirjet në dëborë e akulli. Pati edhe shumë nëna të ngrira me foshnje në gjë. Pastaj ata plaçkitën, dogjën e shkatërruan shumë fshatra shqiptare. Djegiet e shkatërrimet e shtëpive të shqiptarëve qenë të pallogaritshme, gati të gjitha fshatrat shqiptare u bënë shkrum e hi në kulm të dimrit të ashpër. Vetëm në njërin nga lagjet e qytetit të Nishit qenë bërë shkrum e hi 300 shtëpi shqiptare. Grabitjet e pasurive ishin masive, duke nisur që nga stollitë dhe deri te mobiljet, shtrojë-mbulojë, veshjet, paratë, drithërat, bulmetrat, bagëtitë etj.⁴⁶ Në Kushumli u pushkatuan pa gjyq të gjithë nxënësit e mderesës, në një vend publik ku ishin renditur edhe shumë civilë shqiptarë të sjellë nga lokalitetet shqiptare përreth Kushumlisë.



Muhaxhirë të dëbuar nga Sanxhaku i Nishit

Dhuna dhe shfarsosja e shqiptarëve bëhej në mënyrat dhe me metodat më mizore dhe më barbare, për çka dëshmojnë edhe vetë serbët. *“Disa familje shqiptare iknin dhe tërhiqeshin në luginën e lumit të Moravës Jugore, nëpër të ftohtit e madh, pranë rrugës, nëpër grykën e Gërdelicës deri të Vranja dhe Kumanova, shiheshin fëmijët të hedhur dhe të vdekur dhe pleq të ngrirë. Tërheqja ka qenë tragjike, kuajt dhe qetë tërhiqnin ngadalë qerret nëpër borë, sepse qerre kishte pak. Disa fëmijë të hedhur, të humbur apo gjysmë të vdekur nga lodhja dhe uria*

⁴⁵ Bilall Shimshir, Rumeli dengëlçeri I dhe II; Bujar Dugolli, punim i cituar, në dorëshkrim.

⁴⁶ Shaban Braha, Vështrim mbi gjenocidin serb në Kosovë, botim nga Seksioni shkencor i Institutit shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, Tiranë, 29 qershor 1999, fq. 38.

kanë qenë të enjtur dhe të fryrë si daullja, disa i linte shpirti atëherë kur tanët i ushqenin, ose pas ngrënies".⁴⁷ Mbreti serb Millan Obrenoviq, për të arritur këtë qëllim, ushtarëve të vet serbë u kishte shpërndarë proklamata, në të cilën thuhej: "... sa më pak shqiptarë që të mbetën në territoret e çliruara nga Turqia, aq më shumë do të kontriboni për shtetin. Sa më shumë shqiptarë të shpërngulur, aq më të mëdha meritat për atdhe".⁴⁸ Shkrimtari serb Jovan Haxhivasileviq, shpjegon qëllimet e qeverisë serbe për pushtimin e territoreve në jug. Ai shkruan se dëbimi i shqiptarëve u bë me qëllim "*që Serbia të bëhej shtet i pastër nacional*" dhe të krijohet mundësia "*që aksioni serb në të ardhmen të drejtohej kah pjesët e Kosovës*"... "*Me ndjekjen e arnautëve, disa fshatra në ato anë mbetën plotësisht të shkreta. Disa fshatrave nuk u diheshin emrat, sepse nuk kishte kush t'i tregonte, prandaj ato fshatra të shkreta të Sanxhakut të Nishit - Prokuple, Leskofc, Vranje duhet të popullëzoheshin*".⁴⁹

4.3. Kolonizimi i trevave shqiptare të Sanxhakut të Nishit me elementin serbë e malazezë

Menjëherë pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, Serbia zyrtar filloi me nxitim kolonizimin e fshatrave përreth kufirit Serbi-Kosovë. Këtë kolonizim serbët do të pohojnë se e bënë sipas parimeve të Kongresit të Berlinit. Por, këtë kolonizim e kishin inicuar me sugjerimet e diplomacisë ruse dhe pjesërisht asaj austriake në shumë rajone ku konsideronin se kufiri i ri nuk mund të ruhet. Qeveria serbe kishte vendosur që edhe bereqetin e mbjellë më nga muhaxhirët ta grabisin pa asnjë shpjegim kolonët serbë. Kështu kolonët, për një kohë fare të shkurtër do të pasurohen me pronat e grabitura nga shqiptarët. Ata njehkohësisht do të gëzonin edhe benificione materiale duke u liruar nga tatimet dhe duke u aramtosur me armët më të përsosura, duke u udhëzuar se çdo kohë kanë të drejtë ta vrasin cilindo muhaxhir e të mos përgjigjen në asnjë instancë. Pse të mos vendosen dhe favorizohen kolonët serbë, kur vetëm rrethi i Kurshumlisë i kishte 127 fshata, ku kishin mbetur vetëm 2217 banorë deri në qershor të vitit 1879. Jo vetëm kaq, Toplica që i kishte 3.679 km² kishte mbetur pa popullsi. Atje në çdo kilometër katror kishin mbetur vetëm 11 banorë. Ajo pjesë, thuhet në dokumente, kishte mbetur pothuajse gjysmë e shkretë.⁵⁰

Pas fillimit të kolonizimit, pushteti serb në vitin 1879 ka bërë regjistrimin e popullsisë. Në këtë kohë ishte kjo gjendje: Qarku i Nishit më 17.561 shtëpi me 115.890 banorë; Qarku i Pirotit më 11.005 shtëpi me 76.892 banorë; Qarku i Vranjës më 10.136 shtëpi me 64.844 banorë; Qarku i Toplicës vetëm 5.968 shtëpi me 42.014 banorë, dhe të tjerë 528 shtëpi me 3.457 banorë. Gjithsej 45.198 shtëpi me 303.097 banorë.⁵¹

Për popullzimin e trevave të zbrazëta të Sanxhakut të Nishit, ishin dhënë propozime që të sillen serbë e malazezë nga viset e ndryshme, madhe edhe nga Bosnja e Hercegovina. Në këtë kohë disa serbë me kërkesë të qeverisë serbe por edhe të sigurisë nga Kosova u shpërngulën në Sanxhakun e Nishit. Dokumentet statistikore jepin të dhëna për shpërnguljen e 5280 serbëve nga viset e Mitrovicës dhe të Vushtrrisë. Ndërsa, nga viset tjera të Vilajetit të Kosovës, në asnjë kaza, numri i të shpërngulurëve serb nuk arrinte më tepër se dy a tri familje që ishin shpërngulur me

⁴⁷ Stefan L. Popoviq, Putovanje po Novoj Srbiji, Beograd, 1950, fq. 345.

⁴⁸ Dr. Jovan Haxhivasiljević, Albanska kongra, Beograd, 1909, fq. 14-15; Dr. S. Uka, Vendorsja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë 1878-1912, lib. II, Prishtinë, 1994, fq. 45.

⁴⁹ E njëjtë.

⁵⁰ Ministarstvo Unutrašnjih Dela, Beograd, Dosja 6587/1878. Listat e serbëve që u vendosën me familje në pronat e shqiptarëve; Dr. Bujar Dugolli, Pasojat e luftës serbo-osmane 1877-1879 dhe reflektimi në marrëdhëniet me shqiptarët. Dorëshkrim i dorëzuar për botim në revistën "Vjetari" i Arkivit të Kosovës, 2008.

⁵¹ Stanovništvo NRS, fq. 14.

kërkesën e qeverisë serbe dhe me dokumente zyrtare. Toplica në këtë kohë u kolonizua me masë të madhe me malazezë.⁵² Politika serbe përherë, për qëllim propaganduese është munduar që të rrisë numrin e serbëve të shpërngulur nga Kosova prej vitit 1976 – 1912 deri në 150.000 veta⁵³, çka nuk perket me realitetin. Këtë e mohon më së miri një studim që një kohë të gjatë është majtur në përdorim intern, Radosllav L. Pavllloviq, me titull: “Shpërngulja e serbëve dhe shqiptarëve gjatë luftërave 1876, 1877 dhe 1878”, thek-sohet se nga Kosova në Serbi, gjatë viteve 1876-1879, u shpërngulen 299 familje me 2512 anëtarë.⁵⁴ Sipas një burimi tjetër, sipas urdhëresës së qeverisë serbe nga Kosova në Sanxhakun e Nishit gjatë vitit 1879 janë vendosur rreth 5600 serbë.⁵⁵

Pushteti serb me 3 janar 1880 nxjerr Ligjin për viset e reja të kolonizuara. Me këtë ligj regjimi serb e përligji plaçkitjen e cila është bërë në popullatën shqiptare të Sanxhakut të Nishit.

4.4. Vendosja e shqiptarëve muhaxhirë nga Sanxhaku i Nishit në Kosovë - Vendbanimet

Popullata e dëbuar shqiptare nga Sanxhaku i Nishit, kryesisht u vendos në territorin e Kosovës së sotme, disa u vendosën në territorin e Maqedonisë, e shumë prej tyre të mjerë përfunduan jashtë Kosovës, tej Bosforit, në shkretirat e Anadollit e më gjerë.

Në territorin e Kosovës shqiptarët muhaxhirë u vendosën në fshatra dhe qytete. Pati lëvizje të mëdha, ku nga fshatrat kaluan në qytet, ose prej në fshati në fshatin tjetër.⁵⁶ Familjet muhaxhire shqiptare u vendosën kryesisht nëpër në këto vendbanime:

1. Komuna e Prishtinës

1. BADOFCI: Zhinipotokët.
2. BALLABANI: Tullarët, Maqedoncët, Sfircakët, Tërmkollët, Vranocët, Kopranët, Retkocerët, Prekorogjët, Shillovët, Cërvadikët, Mlladoshefcët, Cërnovërhet, Nësushtët, Tërhollë, Tërstenët dhe Kapitët.
3. BARILEVA: Llumnicët, Vërbocët, Rogalitë, Dëshishkët dhe Bërbatofcët.
4. BERNICA E EP. me lagjet Milefci dhe Sinidol: Dragushët, Pllanalitë, Zhushët, Toçanët, Mërkujët, Pestisët dhe Zhegrovët.
5. BERNICA E P.: Obërtincët, Tmavalitë, Prestre-shët, Qavo-tët, Zhinipotokët, Retkocerët, Pacët dhe Përperët.
6. BESIA: Bllacakët, Prebezët dhe Dragushët.
7. BUSIA: Byçmetët dhe Kullacët.
8. BUTOCI: Statofcët, Kopranët, Retkocerët, Vujanovcët, Maqedoncët, Dedincët, Cërnovërhet dhe Sfinjishtët.
9. DABISHECI: Borocët, Ramadenët, Sfircakët, Zhugollët, Mramorët, Leskovcalitë, Siaricët dhe Vranocët.
10. DRENOCI: Dobratiqët, Sogojevët, Govorët dhe Gracollët.

⁵² Dr. Bujar Dugolli, Pasojat e luftës serbo – osmane, punim në dorëshkrim, për botim në revistën Vjetari/2008, e Arkivit të Kosovës.

⁵³ Džoko Slipčević, Srpski odnosi kroz vekove, Minhen, 1974, f. 233.

⁵⁴ Gazmend Rizaj, Shqipëria dhe shqiptarët në planet sekrete të shteteve ballkanike dhe europiane gjatë shek. XIX, (Koha ditore), 14.II 2006.

⁵⁵ B. Cani - C. Milivojci, KOSMET ili KOSOVA, Referati i dr. H. Bajramit, p. i c., fq. 163.

⁵⁶ Në disa raste, disa familje mund të shënohen edhe në fshat, por më vonë edhe në qytet edhe një njërin dhe tjetrin vendbanim. Evidentimi i këtyre përsëritjeve në disa raste është i paevitueshëm. Mirëpo, ka raste kur disa pjesëtarë të një familje kalojnë në një qytet ose në fshat, ndërsa disa të tjerë mbesin aty.

11. GLLOGOVICA: Mërkojë, Cernovërhet, Vrapcët, Maqe-doncët, Vranocët, Rafunët, Starabajët, Sfircajë dhe Siarinët.

12. GRAÇANICA: Në vitin 1905 kanë jetuar 5 familje muhaxhire shqiptare dhe 5 familje muhaxhire rome. Nuk dijmë se cilat ishin dhe ku kanë shkuar.

13. GRASHTICA: Kopranët, Shillovët, Spancët, Cërvadikët, Berjanët, Retkocerët, Oranët, Stubllakët dhe Xhupollët.

14. HAJKOBILLA: Sijarinët, Gjelekarët, Borocët, Tërstenët, Retkocerët, Klaiqët, Byçmetët, Mërkojë, Taniovcët, Dërvodelët, Llapashticët, Lipovicët, Masuricët, Sijaricët, Stullcakët, Vërtopët dhe Vranocët.

15. HAJVALIA: Tullarët, Statofcët, Svinjishtet, Doshlakët, Ma-lokët, Kojçiqët, Slisbanët, Rakovicët, Prekopucët, Poroshticët, Kuçët, Gjakalitë, Bagjurët, Pllanalitë, Zhinipotokët, Bublicët, Dragidellët, Huruglicët, Stubllakët, Lipovicët, Vrapcët, Miskiqët, Gërgurët dhe Tërhollët.

16. KEÇIKOLLA: Cërvadikët, Mërkojë, Kopranët, Zagragjë, Oranët, Govorët, Maqestenët, Ramadenët dhe Shillovët.

17. KOLIQI: Tërhollët, Rukofcët, Kapitët, Mërkonjë, Cërvadi-kët, Tullarët, Oranët, Sekiraqët dhe Shillovët.

18. KOLOVICA: Në këtë vendbanim në vitin 1912 kishte 7 shtëpi shqiptare muhaxhire. Nuk kemi mundur të konstatojmë se cilat familje janë vendosur dhe ku kanë shkuar.

19. KUKAVICA: Miskiqët.

20. LEBANA: Dobratiqët, Shushnjakët, Prebezët, Prestreshët dhe Bellopojët.

21. MARECI: Poroshticët, Siarinët, Borocët, Ramabajët, Rafunët, Radinofcët, Llapashticët, Leposhtakët, Starabajt, Prekoroxhët, Bublicët, Leskovcalit dhe Lipovicët.

22. MATIQANI: Rukofcët, Llumnicët, Llapashticët dhe Tulla-rët.

23. MRAMORI: Oranët, Gajtonët, Cërvadikët, Lipovicët, Vuja-novët, Shillovët, Retkocerët, Kopranët dhe Stubllakët.

24. NISHECI: Buvcët, Konjufcët, Radecët, Rafunët, Sekiraqët, Tërpezët, Dedincët dhe Tullarët.

25. PRAPASHTICA: Radinofcët, Ramadenët, Sijarinët, Buca-llët, Martelët dhe Gajtonët.

26. PREOCI: Breznicët dhe Shutovit (Gojnofcët).

27. SHUSHICA: Pllanalitë, Toçanët, Muzaqët dhe Maqedoncët.

28. SIQEVA: Pllanalitë, Svinjishtët, Brajshorët dhe Sfircajë.

29. TRUDA: Shushnjakët dhe Dobratiqët.

30. VRANIDOLLI: Jashanicët, Reçicët, Kelanët (Danku), Vllasakët, Vrellakët, Prebezët dhe Zhushët.

31. ZLLATARI: Janë vendosur disa familje shqiptare muhaxhi-re por janë shpërngulur pas vitit 1912. Në këtë vit kishte 6 shtëpi shqiptare muhaxhire.

32. MAKOCI: Retkocerët, Maqedoncët, Kopranët dhe Shillovët.

3. MUSHTISHTI: Berjanët dhe Hoxha (nuk e dijmë si quhet, sot jeton në Prizren).

4. POPOLJANI: Në këtë vendbanim pas vitit 1878 ishte vendosur një familje muhaxhire shqiptare, por si duket ajo pas vitit 1912 shpërngulet.

5. SAVROVA: Bublicët (të shpërngulur në Magure të Lipjanit),

6. SOPIA: Konjufcët, Popovcët, Slishanët, Rafunët, Bublicët, Kamenicët, Gajtonët dhe Berjanët.

⁶¹ Shënimet për këto vendbanime janë marrë nga libri i dr. Sabit Ukës: *Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë, 1878-1912*, Prishtinë, 1994 dhe hulumtimet e autorit të librit në terren.

7. TËRNI: Obrazhdët, Llapatnicët, Berjanët, Momçillët, Vrano-cët dhe Gajtonët. Këtu jeton edhe familja Hashani të cilët janë muhaxhirë, por nuk e dijnë nga ky emër.

22. Komuna e Prizrenit

1. LANDOVICA: Nekusahu (Kamenica).

2. LUBIZHDA: Obërtincët.

3. PRIZRENI: Në Prizren u vendosën shumë familje muhaxhire dhe formuan Mahallën e Muhaxhirëve. Pjesa dërmuese e familjeve muhaxhire pas vitit 1913 dhe më vonë shpërngulën, mbesin një numër i vogël i tyre. Në Prizren janë vendosur siç u tha shumë familje, disa pasardhës nuk e dijnë prejardhjen e tyre, madje e kanë ndërruar mbiemrin. Është arritur që të regjistrohen këto familje shqiptare muha-xhire edhe pse ekzistojnë edhe të tjera: Berjanët, Bojnikët, Bunjakët, Dragidellët, Dubovcët, Govorët, Gërgurët, Kitmirët, Krushevcët, Leskovcalitë, Llapatincët, Momçillët, Nishllitë, Prepollët, Prokupët, Sijarinët, Slishanët, Sofijasit, Statovcët (Sopjanët), Xhigolët, etj.

4. ROMAJA: Bublatku e shpërngulur në Mitrovicë.

23. Komuna e Gjakovës

1. DOBLIBARE: Në fshat vjen një familje muhaxhire nga Toplica (e vetmja myslimane në fshat) dhe mbante Turben e Baba Rexhepit.

2. GJAKOVA: Në vitin 1877/78 por edhe më vonë në Gjakovë u vendosën shumë familje muhaxhire, kryesisht tregtar nga qendrat e Sanxhakut të Nishit por edhe të tjerë që nuk kemi mundur t'i regjistrojmë. Shumë prej tyre pas vitit 1913 janë shpërngulur në Shqipëri, Turqi, Siri, Bosnje, Maqedoni e vise të tjera. Familjet: Bajralitë, Buçincët, Gajtonët, Hasanovcët, Kalludrët, Kastratët, Kurshumlitë, Leskovcët, Nishlitë – Hadri, Pirotasët, Prokuplët, Stubllakët, Vllahinjët, Xhigolët, etj.

3. NIVOKAZI: Nishlitë, më vonë të shpërngulur në Prishtinë.

4. NOVOSELLA E POSHTME: Mërrnicët.

5. RRACAJ: Pollomët dhe Restelicët.

6. SKIVJANI: Nishlitë (Hadri).

24. Komuna e Pejës

1. KOSURIQI: Mërrnicët. (Të ardhur nga Novosella e Gjakovës)

2. PEJA: Pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit në Pejë u vendosën shumë familje muhaxhire nga Nishi, Leskoci, Prokupa, Kurshumia dhe qendra të tjera, duke përfshirë edhe fshatrat përreth tyre. Mirëpo, shumica e tyre pas vitit 1912 dhe në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore dhe pas saj u shpërngulën në Turqi, Shqipëri, Siri e gjetiu. Belegët (Sipas disa informatave këta janë Vllasali, të vendosur në Beleg të Deçanit dhe nga aty kanë shkuar në Pejë, në Llukaf të Begut dhe Kovragë të Istogut), Berilët, Burincët, Dragidellët, Kushumlitë, Leskovcët, Merrnicët, Muriçët, Nishlitë - Hadri, Pashincët, Pllanalitë, Prekadinët, Prokupët, Sfarçët, Simnicët, Statovcët, Toçanët, Toplicët, Verbovcët, Xhigolët, etj.

25. Komuna e Deçanit

1. BELEGU: Vllasalitë, të cilët pas një kohe shpërngulën në fshatin Llukaf i Begut dhe pastaj në Kovragë të Istogut.

2. ISNIQI: Pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit në vitet 1877/78, në këtë venbanim u vendosën më se 15 familje shqiptare muhaxhire, por ato pas vitit 1913, siç duket,

janë shpërngulur në Turqi. Mendohet se këtu një kohë ka jetuar familja Beashtica e shpërngulur në Milloshevë të Obiliqit.

3. STRELLCI I EPËRM: Kapitët.

26. Komuna e Istogut (tani e Burimit)

1. BAJA: Zagraxhët, të ardhur pas një kohe nga fshati Zallç.
2. DREJA: Raçët, Zagraxhët dhe Kapitët.
3. KOVRRAGA: Vllasalitë (Belegët), e ardhur nga Belegu i Deçanit, ku kishte jetuar një kohë.
4. LLUKAFCI I BEGUT: Gërgurët, Berbatovcit, Kutllofcit.
5. PRIGODA: Nga treva e Leskocit në këtë vendbanim ishin vendosur dy familje shqiptare muhaxhire, por ato pas vitit 1912 shpërngulën dhe nuk e dijmë se ku kanë shkuar.
6. RAKOSHI: Stubllakët.
7. VERIQI: Igrishtët.
8. ZALLÇI: Dragidellët, Kapitët, Obrazhdët, Sogojevët dhe Zagraxhët.

5. KOLONIZIMI I KOSOVËS 1912-1914


Pushteti serbë përherë përgatitej për pushtim të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare. Përkitazi me këtë, në vitin 1911 e kishte urdhëruar konsullatën e vet në Prishtinë dhe doganat në Rashkë dhe në Javor që të bënin regjistrimin e popullatës serbe, aty këtu edhe të ndonjë vendbanimi shqiptar. Në regjistrimin e popullsisë në terren ishin angazhuar mësuesit dhe

priftërinjt. Aksioni i regjistrimit ishte kryer në 230 fshatra. Përveç tjerash, këto shënime për numrin e banorëve serbë dhe të tjerë, shërbente në shfrytëzimin e tyre në luftën e ardhshme.⁶²

Në tetor të vitit 1912 shtetet fqinje të mbështetur nga disa fuqi të mëdha lidhën aleancën në mes tyre dhe i realizuan aspiratat e kahershme për pushtimin e tokave shqiptare. Armata serbe dhe malazeze kishte angazhuar elitat ushtarake më të mëdha për pushtimin e tokave. Këto pushtime u justifikuan në konferencën e ambasadorëve të mbajtur në Londër në vitin 1913, ku jashtë shtetit shqiptarë të shpallur më 28 Nëntor 1912, mbetën pjesa dërmuese e tokave shqiptare, si Kosova, Kosova Lindore, Maqedonia Perëndimore, pjesë të Malit të Zi, Çamëria etj. Shteti shqiptarë u cungua.

Nga të dhënat kadastrale të administratës osmane dëshmohet se trevat shqiptare që nga Mesjeta e hershme e deri më 1912 kishin një sipërfaqe prej 115.000 kilometra katrorë. Më pastaj në shekullin e XIX dhe XX nga 90.270 km² (Vilajeti i Kosovës më 32.900 km², Vilajeti i Shkodrës me 10.270 km², Vilajeti i Manastirit më 28.500 km² dhe Vilajeti i Janinës me 17.900 km²) u përfshinë vetëm 28.748 km² apo 32,24% të tërësisë etnike të tokave shqiptare, tregon qartë për padrejtësinë që i bëhej kombit shqiptarë qysh atëherë. Njëherit, në saje të okupimit të tokave shqiptare, shtetet fqinje rritën territoret e tyre në këto përmasa: Serbia zgjeroi territorin e vet për 82% dhe popullsinë për 55%, Mali i Zi territorin për 62% dhe popullsinë për 100%, Bullgaria territorin për 29% dhe popullsinë për 3%, ndërsa Greqia territorin për

⁶² Djordje Mikić, Društvene i ekonomske prilike kosovskih srba u XIX i pocetkom XX vek, Beograd, 1989; Dokumentet: Arhiv Srbije, Ministarstvo Inostranih Dela, PPO, raporte të ndryshme nga konsullata e Prishtinës, mësuesit, priftërinjt etj.



Ekspansioni serb në trevat shqiptare, 1804-1913

68% dhe numrin e banorëve për 67%. Prandaj, me pushtimin e 67,79% të territorit shqiptar, u bë zgjerimi i territoreve të shteteve orthodokse të Ballkanit dhe zvoglimi katastrofal i territorit të shtetit shqiptar.⁶³ Ndërsa, në aspektin demografik, serbët në Kosovë deri në vitin 1912 përbënin vetëm 5-8% të popullsisë së përgjithshme.

⁶³ Dr. Nuri Bashota, Tokat shqiptare në udhëkryqi e tanishëm ballkanik. Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, Prishtinë, 1996, fq. 275.

Menjëherë pas pushtimit të tokave shqiptare nga Serbia dhe Mali i Zi filloi dhuna dhe terrori në popullatën shqiptare me qëllim të serbizimit të Kosovës dhe pjesëve tjera të banuar me popullatë shqiptare, siç ishin Maqedonia Perëndimore, pjesë të Malit të Zi etj. Ajo iu nënshtroan spastrimit etnik dhe kolonizimit. Për këto qëllime qarqet politike serbo-malazeze shfrytëzuan përvojën e mëparshme, ushtroan terror e dhunë të pashembullt. Njësitë e ushtrisë, të policisë dhe “Narodna Odbrana” bënëin gara kush do të likuidonte më shumë shqiptarë, kush do të rrëronte shtëpitë e tyre, do të plaçkiste ose t’i kthente ata përdhunisht në fenë ortodokse sllave. Dhuna e terrori u kthyen në metoda të preferuara për të frikësuar dhe detyruar shqiptarët të shpërnguleshin ose të zhvendoseshin në vende të tjera. Elementi shqiptar kompakt ishte një problem për ta dhe ishte popullsi më e vjetër se ajo serbe, së paku dy milenium vjetësh dhe kishin për qëllim që në vend të tyre të vendosin elementin sllavë, kryesisht serb e malazez. Për këtë qëllim u përdor edhe politika agrare dhe ajo e kolonizimit të tokave shqiptare në Mbretërinë jugosllave. E tërë kjo u reflektua në shpërngulje masive të popullatës shqiptare nga atdheu i tyre, grabitjen e pronave të shqiptarëve, djegien e fshatrave të tyre dhe me kolonizimin me ardhacakë serbo-malazezë.

Përkitazi me këtë duhet theksuar disa dëshmi të kohës për dhunën e terrorin ndaj popullatës shqiptare dhe kolonizimin e Kosovës. Oficerët serbë shpallnin se “*paqja efektive në Shqipëri mund të arrihet vetëm duke i shfarosur krejtësisht shqiptarët*”. Urdhëri suprem i Beogradit ishte i prerë: “*Duhet mësuar ai popull i egër për të jetuar në një shtet modern*”. Pastaj, në gazetën serbe shkruante: “*Duhet të vdesin disa gjenerata të shqiptarëve që të harrohet çfarë bënë serbët ndaj tyre*”.⁶⁴ Ata kanë thyer dyert e shtëpive dhe kanë masakruar këdo që gjenin brenda, pa pyetur në ishte i ri apo plak, burrë a grua. Një dëshmi tjetër që dëshmon edhe këtë. Se në tregun e Prishtinës, më 18 tetor 1912 më një lirë ari të Turqisë mund të bliheshin 82 fesa turq. Më 10 nëntor 1912, po në këtë treg, një fes mund të blihej me 82 lira ari. Ngritja kaq e lartë e çmimit ishte bërë për shkak se ushtria serbe likuidonte të gjithë njerëzit me plisa të bardhë, ndërsa i kursente ata që mbanin fesin turk në krye.

Më 12.11.1912, në gazetën angleze “Daily Cronicle” publikohet se në rrethinën e Prizrenit u masakruan 5000 vetë. Një oficer serb, në praninë e tij, përshkruan masakrat e batalionit të tij.⁶⁵

Lidhur me këtë periudhë, Kosta Novakoviqi në “*Kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës*” shkruan: *Më 1912 e 1913 u shuan kështu 120.000 shqiptarë, burra, gra, djemë, pleq, fëmijë, qindra fshatra u bombarduan, një shumicë e madhe u dogj fare... Është për t’u përmendur që përfaqësuesi i politikës imperialiste ruse, ministri i Rusisë në Beograd – vazhdon K. Novakoviqi, e ka bekuar këtë politikë shfarosëse që bën Beogradit*”. Po në këtë ngjarje socialisti i njohur serb, Dimitrije Tucoviqi, thekson se pushteti serbomadhi: “*i fshihte egërsitë e veta si gjarpëri këmbët.... Fshatrat shqiptare ishin shndërruar në vatra shkrumbi. Në të njëjtën kohë këto ishin krematoriumet më barbare në të cilat kalleshin për së gjalli me qindra gra e fëmijë....*”.⁶⁶

Sipas të dhënave të Komitetit të Kosovës, nëpër burgjet e Serbisë, Malit të Zi e Greqisë, në këtë periudhë, janë mbytur ose kanë pësuar rreth 23 mijë shqiptarë. Shoqata e imamëve myslimanë pohon se në territoret etnike shqiptare, në këtë periudhë, kanë qenë 21 mijë varre dhe kufoma të masakruara nga ana e xhandarmërisë. (Në këto shënime nuk janë përfshirë të vdekurit


⁶⁴ Riza Lahu, *Golgota shqiptare*, Tiranë, 1995, fq. 43-44.

⁶⁵ M.E.Durhan, *AIH*, A.IV, 177, A. 37; Selajdin Krasniqi, *Prizreni udhëtim nëpër kohë*, Prizren, 2003, fq. 77.

⁶⁶ “Bujku”, nr. 387, Prishtinë, 12.IX.1992, fq. 2.

gjatë luftës tetor-nëntor 1912). Në Kosovë janë shënuar pesë varreza masive. Vetëm në Gazimestan në periudhën janar-maj 1913 janë likuiduar mbi 5000 shqiptarë etnikë.⁶⁷

Pas okupimit të Kosovë nga Serbia dhe Mali i Zi, pas vendosjes së pushtetit ushtarak serb e malazez, nga nëntori i vitit 1912 deri në qershor të vitit 1914, Kosova u shkatërrua më shumë se gjatë gjithë sundimit pesëshekullor osman. Serbia dhe Mali i Zi gjatë vitit 1913-1914 dogjën e rrafshuan 235 fshatra shqiptare, 133 serbët e 102 malazezët”.⁶⁸ Leo Freundlich, shkruan: *“Mijëra e mijëra burra, femra, pleq e fëmijë të vrarë e të mbytur me të therrura, fshatra të djegura dhe shtëpi të plaçkitura, gratë dhe vajzat e çnjerëzuara, një vend i shkretëtuar, i plaçkitur, i larë me gjak i turpëruar, dëshmon se serbët në Shqipëri nuk hynë si çlirimtarë, por si vrasës të shqiptarëve... Fshatra të panumërta u rrafshuan me tokë, u masakruan njerëz të panumërt në mënyrën më shtazarakë. Vendi, ku gjeneratat e zellshme të shqiptarëve të varfër, krijuan atdheun e tyre, u shndërrua në grumbuj gjërmadhash. Një popull i tërë u kryqëzua me gjak dhe Evropa hesht...”*⁶⁹



Deportimi i shqiptarëve në Beograd (1912)

M. Edit Durham, shkruan më 1913: *“Në Shalë, myslimanët ose duhet të pagëzoheshin ose do të mbyteshin. Një njeri nga Peja rrëfente: “Çdo ditë telalli thërret nëpër rrugë: - Qeveria do të pushkatojë sot një dhjetë vetë! Asnjëri nuk di se cilët janë këta njerëz dhe përse vriten. I shpiejnë përpara një grope që do të jetë varri i tyre. Pastaj 12 ushtarë shtijenë mbi ta derisa bien për dhe. Atyre u hidhet dheu përsipër, pa marrë parasysh se janë gjallë apo të vdekur. Njerëzit hidhen në ujin e akulltë të lumit, e pastaj detyrohen të qëndrojnë pranë prushit të zjarrit deri të kërkojnë mëshirë. Dhe çmimi për të gjithë këtë ishte të kthyerit në fenë e krishterë. Shumë nga këta që ishin pagëzuar në tmerr, vinin tek unë”*.⁷⁰ E. Durham, më pastaj shkruan: *“Në Shkodër mora lajme edhe më të këqia. Serbët e malazezët kishin kaluar kufirin shqiptar dhe kishin djegur krejt, të gjitha shtëpitë e fiseve të Gashit dhe të Krasniqes. Kjo ishte si hakmarrje për faktin se këto fise kishin strehuar dhe kishin mbajtur me bukë refugjatët e mjerë nga Gucia dhe Gjakova.*

⁶⁷ Dr. Hakif Bajrami, Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1945), Prishtinë, 1995, fq. 17.

⁶⁸ E njëjtë, fq. 28.

⁶⁹ Leo Freudlich, Vjenë, 1913.

⁷⁰ M. Edit Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Romë, 1942, fq. 241 (gusht 1913).

*Ndërkaq, një numër fshatrash shqiptare në afërsi të Prizrenit dhe të Gjakovës ishin djegur gjithashtu, dhe ata që kishin shpëtuar gjallë tregonin për dhunime të tmerrshme. Në një fshat vajzat i kishin kapur rob, dhe ua kishin dorëzuar ushtarëve, pastaj i kishin hedhur në fshatin që digjej.*⁷¹ Si duket fjala është për fshatin Bilushë.

Duhet theksuar se krahas metodave të gjenocidit, vrasjeve, djegieve, rrënimeve të vendbanimeve shqiptare, filloi edhe procesi i kolonizimi i trevave shqiptare me elementin serb e malazez. Kolonizimi i këtyre viseve, që zë fill prej ditëve të para të pushtetit nga ushtria serbe e malazeze, në tetor të vitit 1912 u sanksionua me dekretligje të veçanta, që dolën në të dy mbretëritë në fillim të vitit 1914. Me këto përligjeshin të gjitha padrejtësitë që u ishin bërë deri atëherë shqiptarëve. Këto ligje u hartuan në një mënyrë të tillë që të arrihej efikasiteti sa më i madh në shpronësimin e fshatrave shqiptarëve dhe që të favorizoheshin e të stimuloheshin kolonët sllavë për të jetuar në viset shqiptare.

Mbretëria serbe, më 17 shkurt 1914, ua ndaloi gjyqeve ta regjistrinin tokën perdërisa të shqyrtohej çështja e patundshmërisë si dhe derisa të studiohet çështja e tapive. Me këtë, qeveria dëshironte të injorojë realitetin e dikurshëm osman lidhur me përkatësinë e pronës në rrethanat e reja shoqërore dhe politike. Pastaj, menjëherë, Serbia që më 20 shkurt 1914, nxori *“Dekretligjin mbi kolonizimin e viseve të posaçliruara dhe të bashkuara në Mbretërinë e Serbisë”*, i cili më vonë u plotësua. Po ashtu veproi edhe Mali i Zi, i cili kishte nxjerrë *“Ligjin mbi kolonizimin e viseve të posaçliruara”* prej 27 shkurt 1914. Këto dispozita ligjore, dhe shumë të tjera, që merren më vonë, shërbejnë si mbështetje për nxjerrjen e ligjeve të mëvonshme në Mbretërinë SKS, përaktësisht jugosllave, si p.sh. Dekretligji mbi kolonizimin e viseve të reja jugore i vitit 1920, i cili në vitin 1922 aprovohet si Ligj mbi kolonizimin e viseve të reja, Ligji mbi kolonizimin i vitit 1931 dhe shumë të tjerë. Me ato ligje tërë toka shpallet pronë shtetërore, sidomos për ata që nuk kanë pasur dokumente të shkruara, edhe pse e punonin atë me vite. Pra, me këto akte juridike legalizohet dhuna ndaj shqiptarëve, të cilëve me anë të vënies në lojë të atyre tapive të pakta që i dispononin iu mohohet e drejta e tyre e pronësisë shumëshekullore mbi tokën.⁷²

Me qëllim që kolonizimi të arrinte ritme të larta e të ngutshme ashtu si në Jabllanicë, në Sanxhakun e Nishit, në vitet 1877-78, Mbretëria serbe i hapi rrugën edhe emigracionit serb jasht vendit, deri edhe jashtë kontinentit. Lidhur me këtë fletorja e Beogradit *“Ballkan”*, nr. 6, e shkurtit 1914 njoftonte urdhëresën për kolonizimin e “viseve të reja”, sipas së cilës *“edhe serbët që banojnë në Amerikë, me origjinë nga Mali i Zi, Bosnja, Serbia e nga Hungaria Jugore do të merrën parasysh. Në fakt mund të përfitojnë edhe serbët me banim në monarki”* (Austro-Hungaria, J.O.).⁷³

Ky proces gjenocidal ndaj popullatës shqiptare u shoqërua me dëbimin e tyre në Turqi e në Shqipëri. Sipas disa vlerësimeve në periudhën ndërmjet viteve 1912-1914, në Turqi u shpërngulën rreth 500.000 njerëz. Ndërsa, vetëm nga Kosova prej vitit 1913-1915 për të shpëtuar kokën nga gjenocidi shtetëror serbomalazez u detyruan të shpërngulen më se 120.000 shqiptarë.⁷⁴ Në anën tjetër një numër prej mijëra kolonëve u vendos në trevat e Kosovës, posaçërisht në tokat e shqiptarëve të ikur nga atdheu për shkak të dhunës e terrorit. Sipas disa shënimeve, organet serbe sollën në Kosovë rreth 20 mijë serbë, shumica e tyre kriminelë. Ata u vunë në funksion të grindjeve dhe të konflikteve ndërnacionale, duke u rekrutuar në xhandarmëri

⁷¹ M. E. Durham, botuar në Brenga e Ballkanit, Tiranë, 1991, fq. 274.

⁷² Dr. Jusuf Osmani, Kolonizimi i Kosovës ndërmjet dy luftërave botërore, “Bujku”, 7.XI 1998.

⁷³ Haus und Stads Archiv, Politichen Archiv, 24-38-3869, nga Mitrovica-Vjenës, raport, nr. 6/P, dt. 28.02.1914; Sh. Braha, Gjenocidi serbomadhi dhe Qëndresa shqiptare (1844-1990), Gjakovë-Tiranë, 1991, fq. 232.

⁷⁴ Dr. H. Bajrami, Konventa jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve, “Gjurmime albanologjike”, XII/1982.

dhe në provokatorë ndaj shqiptarëve. Ndërsa, në atë pjesë të Kosovës, ku okupator ishte Mali i Zi, nëpërmjet “*Ligjit special për kolonizim*”, në pronat shqiptare në Pejë e në Gjakovë u vendosën rreth 6000 kolonë malazeze.⁷⁵

Me gjithë shpronësimin e popullsisë agrare shqiptare dhe sjelljen e qindra familjeve të kolonëve, qarqet politike serbo-malazeze nuk arritën objektivat e caktuara: ndërrimin e dukshëm të përbërjes etnike të popullsisë në dëm të shumicës dërrmuese shqiptare. Ky qëllim nuk u arritë për shkak të rezistencës së armatosur të popullit shqiptar, ashtu edhe për shkak të kohës së shkurtër të sundimit të këtyre regjimeve, e veçanërisht të shprërthimit të Luftës së Parë Botërore, kur shumica e kolonëve u kthyen në vatrat e tyre.

6. KOLONIZIMI I KOSOVËS ME ELEMENTIN SLLAV 1918-1941

6.1. Vazhdimi i dhunës dhe terrorit

Me ripushtimin e Kosovës, në vjeshtë të vitit 1918 dhe vendosjen e pushtetit serbo-malazez e vënien në funksion të aparatit të veçantë administrativo-politik, administrata shtetërore e ushtarake, krahas organizimit të operacioneve ndëshkimore, të dhunës, terrorit, vrasjeve, dënimeve të mëdha etj., në të njëjtën kohë filloi një presion politik për shkombëtarizimin e popullatës shqiptare me metoda të ndryshme. Qarqet drejtuese të Beogradit rifilluan politikën e vjetër shoveniste.⁷⁶

Ndonëse kishin premtuar se do të respektonin të drejtat e shqiptarëve etnikë që jetonin në Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene, madje kishin nënshkruar edhe aktet ndërkombëtare të kohës, që përcaktonin të drejtat e pakicave kombëtare (Traktati i Sen Zhermenit, i unifikuar edhe nga Lidhja e Kombeve), këto qarqe, menjëherë pasi vendosën administratën e tyre ushtarako-policore dhe civile, rifilluan terrorin e praktikuar në vitet 1912-1915. Kështu sipas një statistike, që u botua më vonë në Itali, trupat serbe vetëm gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 1919 kishin vrarë 6.040 veta, kishin rrënuar 3.873 shtëpi.⁷⁷ Qeveria shqiptare e informon Lidhjen e Kombeve në prillin e vitit 1921 se në Kosovë ishin vrarë 2.000 shqiptarë, që nga fillimi i po atij viti; kurse katër muaj më vonë, kreu i Bashkësisë Islame në Bosnje, Reiu ul-ulema Çausheviq, i tha një diplomati se që nga nëntori i vitit 1918, në rrethin e Prishtinës ishin vrarë 5.000 veta. Sa për shifrat e përgjithshme, një dokument i hartuar nga Komiteti i Kosovës, më 1921, llogariste se deri atëherë ishin vrarë 12.371 veta, ishin burgosur 22.110 veta dhe ishin djegur përafërsisht 6.000 shtëpi.⁷⁸

Një ndër metodat e spastrimit etnik, shkombëtarizimit dhe sllavizimit të Kosovës, ishte edhe kolonizimi i Kosovës me elementin sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve nga vendlindja e tyre. Kolonizimi si metodë përfide filloi të mistifikohet dhe të kamuflohet me zbatimin e njërës nga metodat borgjeze me reformë agrare, e cila propagandohej si masë përparimtare e që në të vërtetë fsheh qëllimin e borgjezisë serbomadhe - kolonizimin e Kosovës dhe shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare, e cila ishte në shumicë absolute. Pra, borgjezia bënte përpjekje që ta rrallojë sa më tepër popullsinë shqiptare, sidomos në ato treva ku shqiptarët jetonin në numër të

⁷⁵ Dr. H. Bajrami, Politika, v. e c., fq. 27.

⁷⁶ Më gjëresisht: Dr. Jusuf Osmani, Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 1996.

⁷⁷ Dr. Liman Rushti, Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928, Prishtinë, 1918, fq. 7-81; Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë, 1998, fq. 285.

⁷⁸ Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë, 1998, fq. 289.

madh dhe Kosova ishte rajoni me popullsi më të dendur në tërë Mbretërinë jugosllave. Ekzistonte një program i gjerë i kolonizimit, i vendosjes së folësve të sllavishtes në viset e banuara me shqiptarë.

6.2. Qëllimi i kolonizimit dhe i reformës agrare

Qëllimi i borgjezisë serbe në të vërtetë ishte që nën parullën e reformës agrare të zbatojë kolonizimin e Kosovës me elementin sllav të ardhur nga viset e ndryshme të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, përkatësisht jugosllave dhe nga disa shtete të jashtme. Pra, në funksion të kolonizimit të tillë u vu edhe e ashtuquajtura reformë agrare. Kolonizimi dhe reforma agrare në Kosovë kanë pasur qëllim kryesisht nacional-politik dhe karakter eksploatues. Qëllimi kryesor i kolonizimit ishte thyerja e kompaktësisë nacionale të popullsisë shqiptare dhe ndërrimi i strukturës nacionale në dëm të shqiptarëve. Në kolonizim ishte përfshirë edhe elementi ushtarak. Pushteti e shihte të rrezikshme popullsinë shqiptare në zonat e kufirit me Shqipërinë. Andaj synohej që të bëhej pastrimi etnik i popullatës shqiptare, sidomos përreth kufirit me Shqipërinë dhe në këto pjesë të vendosë kolonët dhe të ngritën vendbanime kolonësh. Kjo kishte për qëllim që kufiri të jetë më i sigurt, të formohet një tampon zonë, të ndërpritet lidhja ekzistuese organike territoriale, kombëtare, kulturore, familjare e shpirtërore e popullsisë shqiptare, siç thuhej në dokumente me qëllim sigurimi dhe në përputhje me planin e tyre strategjik. Përkitazi me këtë dr. Hinko Krizman, deputet dhe ministër, në fjalimin e tij në Kongresin e Partisë Demokratike të Pavarur në Beograd, më 6.12.1925, ndër të tjera, thekson se kolonizimi është kërkesë e mbrojtjes popullore, forcim i popullatës nacionale në kufijt, në veri dhe në jug.⁷⁹ Përveç kësaj, ajo politikë bënte përpjekje që ta rrallojë sa më tepër popullsinë shqiptare dhe në ato treva homogjene dhe vendbanime të banuara plotësisht me popullatë shqiptare të vendoste kolonë, pra në ato krahina, ku shqiptarët jetonin në numër të madh, si dhe synohej të kolonizohen ato treva të pastra etnike shqiptare siç ishin: Drenica, Llapi, Llapusha, pjesë të Rrafshit të Dukagjinit, të Kosovës etj, dhe të thyhej homogjeniteti nacional i atyre vendbanimeve e trevave në fjalë.

Organet shtetërore dëshironin që nën maskën e reformës agrare dhe të kolonizimit të realizonin politikën për shtypjen brutale të popullsisë shqiptare, konfiskimit të tokës së fshatarëve shqiptarë, të nxiste tendencën e shpërnguljes së saj në Turqi e në Shqipëri dhe të realizonin idenë e nacionalizimit dhe të serbizimit të Kosovës. Me këtë, politika hegjemoniste jugosllave, duke e konsideruar se popullata shqiptare homogjene autoktone, e cila jeton në numër të madh dhe vështirë mund të asimilohet për shkak të kulturës dhe gjuhës tjetër nga ajo sllave, ajo gjeti metodën e terrorit, të dhunës, të marrjes së tokës dhe të shpërnguljes me dhunë të popullatës shqiptare jashtë atdheut të tyre, dhe me këtë të fitojë sipërfaqe të mëdha toke të punueshme, në të të vendosë një numër të madh të kolonëve. Me qëllim të rrëmbimit të tokave, ushtria dhe xhandarmëria shpeshherë së bashku edhe me elementin kolonë, të cilin e furnizonin me armë dhe municion, hidheshin në aksion terrori kundër shqiptarëve.

6.3. Programi i kolonizimit

Programi i kolonizimit ishte një dukuri komplekse, që kishte qëllime të ndryshme: pikësynim i përgjithshëm dhe afatgjatë i tij ishte, siç u tha ndërrimi i strukturës kombëtare të popullatës në Kosovë (si edhe në Maqedoni, e cila po ashtu po kolonizohej), por në këtë mes, u ngatërruan edhe faktorë të tjerë. Një faktor i këtillë ishte dëshira për të ndalur valën e popullatës nga Serbia dhe Mali i Zi, që po emigronte në Amerikë, duke u ofruar toka të lira afër shtëpive të

⁷⁹ Arhiv Jugosllavije (AJ), Beograd, Fondi: Hinko Krizman, 84, k.1, nj.1-4.

tyre. Një tjetër faktor ishte politika e dënimit të kaçakëve me konfiskimin e pronës së tyre: mënyra më efikase ishte ajo e zbatimit të këtij dënimi, dhënia e tokave të tyre kolonistëve. Ishte madje edhe një plan tjetër (i shqyrtuar seriozisht në Beograd, më 1921, por fare i pazbatuar) për kolonizimin në Kosovë të 7.000 ushtarëve rusë të gjeneralit Vrangeli - një lloj ekuivalence serbe ndaj politikës osmane të vendosjes së çerkezëve luftarakë në rajonet me rëndësi strategjike.⁸⁰

Me procesin e zbatimit të kolonizimit agrar në Kosovë, suksesi-visht krijoheshin vendbanime të reja kolonësh. Pushteti kishte për qëllim që të vendoste kolonë në ato treva e vendbanime të banuara plotësisht me popullatë shqiptare në mënyrë që të zbërthejë, të shkatërrojë homogjenitetin nacional shqiptar të atyre vendbanimeve dhe të sendërtojë qëllimin nacional të kolonizimit. Në zbatimin e politikës së kolonizimit të Kosovës, përkatësisht ngritjes së vendbanimeve të reja kolone, organet agrare kishin parasysh eksklusivisht interesat nacionalo-politike e shtetërore, duke lënë anash faktin se krijimi dhe zhvillimi i vendbanimeve të reja duhet të ketë qëllim të zhvillimit të natyrës ekonomike dhe sociale.

Politika agrare nuk synonte të zgjidhte problemet shoqërore dhe ekonomike në Mbretërinë jugosllave, por ndërrimin e pamjes etnike të viseve të banuara me popullatë shqiptare.

Në zbatimin e kolonizimit ishin të angazhuara të gjitha organet e pushtetit, duke filluar nga ato më të ulëtat lokale e deri tek ato më të lartat shtetërore. Pra, ishte angazhuar tërë makineria shtetërore. Ata kurrnjëherë nuk kishin marrë parasysh pozitën e fshatarit shqiptar. Përkundrazi, në aksionet e marrjes së tokës, përdorëshin metoda të llojllojshme, kështu që kishte raste kur toka iu ishte marrë deri në prag të shtëpisë, e që për të hyrë shqiptarë në shtëpi do të detyrohej të kalojë tani nëpër “pronën” e kolonit.

Në veprimtarinë e organizuar për nxitjen e vazhdueshme të shpërnguljes shqiptare dhe të kolonizimit me kolonë sllavë, në vend të tyre, administrata shtetërore i kishte lënë vend të veçantë propagandës, sidomos shtypit, i cili duhej të kontribuonte në përgatitjen psikologjike të opinionit brenda vendit për ta përkrahur shpërnguljen dhe për ta justifikuar këtë para opinionit të huaj. Ndërsa, nga kolonët, nga tërë shteti dhe jashtë t’i nxitë dhe t’i tërheqë të vendosen në Kosovë, duke u premtuar tokë më bollëk, shtëpi, vegla bujqësore, lehtësi tatimore, kredi etj. Me këtë shtyp borgjez synonte që në radhët e popullsisë shqiptare të krijojë një gjendje tensioni të vazhdueshëm, i cili duhej të ndikonte në shtimin e mëtejshëm të shpërnguljes. Në shumicën e gazetave, sidomos në ato beogradase, botoheshin artikuj shpifës, tendenciozë, duke e paraqitur shpërnguljen si “dëshirë” të popullatës “myslimane”, ndërsa kolonizimi arsyetohej për tokën e lirë dhe interesat që kishte shteti për t’i kolonizuar këto treva me elementin e krishterë nga aspekti i mbrojtjes

Sipas shënimeve statistikore Kosova në krahasim me viset tjera si Vojvodina, Sllavonia, Serbia etj., ishte shumë më e dendur me popullsi bujqësore. Kështu që nuk ka pasur kurrfarë arsye ekonomike e sociale, siç mundohet të arsyetohet nga disa “shkencëtarë” që të plotësohet me popullsi nga viset tjera.

6.4. Kolonët

Kolonët të ashtuquajtur vullnetarë, çetnikë, optantë, etj., vinin gati nga të gjitha viset e Jugosllavisë borgjeze, si nga Mali i Zi, Hercegovina, Bosna, Dalmacia, Lika, Korduni, Bania, Serbia Jugore, Vojvodina, etj. Mirëpo, kishte kolonë të ardhur edhe nga disa shtete të jashtme si nga Rusia, Italia, Hungaria, Shqipëria, Amerika, etj. Atyre pushteti u jepte prona të mëdha të

⁸⁰ Noel Malcolm, Kosova, v. e c., fq. 290.

tokës, sipërfaqja më e madhe e marrë nga pronarët shqiptarë, duke i detyruar ata që të shpërngulen ose të bëhen shërbëtorë “të agallarëve” të rinj, duke ua punuar tokën dhe duke e paguar edhe tatimin për atë tokë. Pushteti, kolonët i vendoste edhe në shtëpitë e fshatarëve vendas shqiptarë dhe të atyre të shpërngulur. Kolonëve, përveç tokës se dhënë falas, pushteti disave ua ndërtonte edhe shtëpitë, si dhe u jepte ndihmë në material ndërtimor, vegla pune, kredi, i lironte nga tatimet shtetërore për 10 vjet dhe nga ato komunale për 5 vjet, kurse të drejtën e plotë si pronarë - me të drejtë për të shitur atë - do ta merrnin pas dhjetë vjetësh, transportin falas të tyre, të materialit ndërtimor, veglave të punës, bagëti etj. deri të vendi i vendosjes etj. U formuan Kooperativat agrare nga të cilat kolonët merrnin kredi pa kamatë, material ndërtimor dhe ndihma të tjera.

Në mesin e kolonëve të ardhur, që shteti u kishte dhënë tokë, përveç fshatarëve bujq kishte edhe tregtarë, pensionistë, oficerë, xhandarë, nëpunës, ish ushtarë të frontit të Selanikut, që quheshin vullnetarë dhe “sollunci”, etj. Në shumë anë ata zuan vendet e ish bejlerëve dhe agallarëve.

Për t'i nxitur dhe për t'i tërhequr kolonët që të vijnë dhe të vendosen në Kosovë, makineria propaganduese serbe përdorte në forma të ndryshme propagandën se në Kosovë ka tokë më bollëk, shtëpi të lira etj.

6.5. Shpronësimi i shqiptarëve nga pronat

Më 24 shtator 1920 Qeveria jugosllave nxorri Rregullorën e kolonizimit, në bazë të së cilës caktoheshin tokat për kolonizim. Kjo rregullore jepte mundësi të grabiteshin tokat shqiptare, pasi pronarët e tyre, sipas zakonit të përgjithshëm, në kohën e administrimit osman nuk kanë qenë të pajisur me tapi.

Qeveria e Mbretërisë SKS përkatësisht jugosllave kishte nxjerrë ligje të posaçme, të cilat i konsideronin toka private të një ose më shumë krahinave si toka shtetërore dhe tapitë e tyre quheshin të pavlefshme. Gjithashtu konsiderohej si e pavlefshme edhe e drejta e pronësisë, që rezultonte nga posedimi i gjatë që shqiptarët kishin mbi tokat e tyre, e drejtë që vlente për ligjet e Perandorisë osmane zakonisht në një titull pronësie ose tapi. Pra, zotëruesit e tokave zhvisheshin nga e drejta e pronësisë, por këto masa zbatoheshin vetëm kundër shqiptarëve, sepse pronarëve serbë e malazezë autoritetet serbu u lëshon dokumente të reja pronësie, ligjërisht të vlefshme, kurse në bazë të urdhërave kategorikë të Qeverisë së Beogradit, autoritetet gjyqësore mbretërore jugosllave nuk u lëshonin shqiptarëve tituj të tillë pronësie. Toka të ashtuqujtura shtetërore mbeteshin dhe ndaheshin në copëza, që u dorëzoheshin mandej, pas një procedure të shpejtë, kolonistëve serbë, malazezë e të tjerë.

Shpronësimi përfshinte edhe pronat më të vogla. Në Kosovë u krijua një raport i ri feudal ndërmjet sllavëve shfrytëzues dhe shqiptarëve të shfrytëzuar. Bujku shqiptarë punonte tashmë tokën e vet jo si më parë, si pronar, por si vasal i pronarit të ri sllav, që ishte serb ose malazez dhe prodhimet i ndante me bujkun shqiptar që ia punonte tokën.⁸¹

⁸¹ Harilla Kola, Gjenocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi 1941-1967, Tiranë, 2000, fq. 36-37.



Territoret e kolonizuara shqiptare – kryesisht ato rreth kufirit me Shqipërinë (AJ, MAR – 96, hartat)

Kolonëve të ardhur sllavë, pushteti, përveç tokës “utrinë”, kullota e të tjerë, u ndante posaçërisht tokë të punueshme pjellore të marrë nga pronarët shqiptarë, të cilët ishin të detyruar të shpërngulen jashtë vendit ose të marrin nga kolonët e të punojnë tokën e vet përgjysmë ose me qesim dhe për të edhe të paguajnë më tutje tatimin. Tokën pronarëve shqiptarë pushteti ua merrte edhe me motivacion se është përfshirë në kompleksin agrar dhe për atë shpesh nuk jepte kurrfarë kompensimi, ose nëse jepte atë tokë e jepte të cilsisë së dobët. Shpronësimi në masë i fshatarsisë shqiptare pati për rrjedhojë varfërimin e saj.


6.6. Shpërngulja e shqiptarëve

Si rrjedhojë e spastrimeve etnike dhe e kolonizimit të tokave shqiptare u bë ndryshim i ndjeshëm i strukturës etnike të popullsisë. Duke u ballafaquar me pozitën e rëndë të tyre, të shkaktuar nga presionet e llojllojshme, që ushtronte pushteti policor ushtarak i Jugosllavisë borgjeze, dhe, duke mos gjetur mbrojtje elementare juridike për pronat dhe jetën e tyre, e po ashtu të ndihmuar me lehtësi të mëdha rreth përgatitjes së dokumentacionit të udhëtimit, që i ofronte po ai pushtet, një pjesë e popullit shqiptar emigroi në Turqi, e një pjesë edhe në Shqipëri. Shpërngulja e shqiptarëve nga vendlindja e tyre ka qenë e motivuar nga politika antishqiptare e diskriminuese. Ky proces i prirur nga qëndrimet negative dhe nga paragjykimet e qarqeve

sunduese ndaj shqiptarëve dhe vendeve të tyre kishte filluar edhe gjatë periudhave më të hershme historike. Për ta nxitur shpërnguljen, pushteti borgjez i ngacmonte shqiptarët edhe në ndjenjat e tyre kombëtare e fetare, si në rrënimin e xhamive, varrezave, etj.

Ultranacionalistët serbë, duke filluar nga Garashanini, Klubi Kulturor serb, Konventa famëkeqe për shpërngulje e vitit 1938, me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, vazhduan përpjekjet për realizimin e planeve, si p.sh. Elaborati i ri i Vasa Çubrilloviqit i titulluar *“Problemi i pakicave në Jugosllavi”*. Ai pushtetin e ri e “mëson” se përveç spastrimit nga ana e ushtrisë gjatë operacioneve, duhet zbatuar edhe metoda të tjera në mënyrë që pakicat kombëtare të detyrohen të shpërngulen, të krijohen për ta kampe përqëndrimi, ndërsa pasuria e tyre të konfiskohet.

Qëllimi i qarqeve sunduese, sidomos atyre policore, ishte që në radhë të parë t’i detyrojë që të shpërngulen personat e fshatit me autoritet, të pasurit, paria e fshatit, sidomos poseduesit e tapisë, sepse pas tyre do të shkonin të tjerët.



6.7. “Rezultatet” e kolonizimit dhe të reformës agrare

Të bazuar në shënimet statistikore, qeveria arriti që në Kosovë, në periudhën ndërmjet dy luftërave, siç thuhej për nevoja të reformës agrare t'i kufizojë rreth 129.212,94 ha tokë.⁸² Ndërsa, gjatë kësaj periudhe janë vendosur 13.482 familje me rreth 67.410 anëtarë në 594 vendbanime.⁸³ Mirëpo, numri i kolonëve të vendosur në Kosovë është më i madh, sesa e jep statistika zyrtare serbe, sepse ky numër ka të bëjë vetëm për familjet, të cilëve zyrtarisht u është ndarë toka. Kanë mbetur anash familjet, që e kanë rrëmbyer tokën në forma të ndryshme, ato në qytet - të ardhur si nëpunës, xhandarë, tregtarë dhe të profesioneve të tjera. Secila familje mesatarisht i kishte marrë nga 8,45 ha tokë, por kishte shumë raste kur një familje kishte marrë edhe deri 45 ha tokë. Ndërsa, familjeve shqiptare kishte raste kur toka i merrej në tërësi deri në prag të shtëpisë, kështu që nuk zbatohej edhe ai dekretligj famëkeq, i cili parashihte se familjeve shqiptare t'i mbetej 0,40 ha tokë për një anëtar të familjes.

6.8. Vendosja e kolonëve në vendbanimet shqiptare dhe formimi i kolonive – vendbanimeve të reja

Në territorin e Kosovës kolonët sllavë u vendosën në këto vendbanime dhe formuan koloni të reja sllave:⁸⁴


Komuna e Prishtinës: Badoci (13 familje⁸⁵), Ballabani (9 familje), Barileva (13 familje), Besia (2 familje), Çagllavica (3 familje), Dabisheci (17 familje), Gllogovica (6 familje), Hajkobilla (5 familje), Hajvalia (48 familje, kryesisht në pronat e familjeve shqiptare muhaxhirë të shpërngulura në Turqi pas vitit 1911 dhe 1918), Keçëkolla (5 familje), Koliçi (4 familje), Lebana (8 familje), Makoci (3

⁸² AJ B, Ministarstvo Agrarne Reforme Kraljevine Jugoslavije, 96-15-51; 96-15-55.

⁸³ AJ B, MAR, 96-21-69, Regjistri i kolonive më 8.IV.1940.

⁸⁴ AJ B, MAR, 96-21-69; 96-51; Dr. Milovan Obradovic, Agrarna reforma I kolonizacija Kosova (1918-1941), Prishtinë, 1981, fq. 306-339.

⁸⁵ Ekzistojnë të dhënat – mbiemrat dhe emrat e çdo familje që është vendosur në atë vendbanim. Emrat e tyre gjenden në kartonat e kolonëve serb, malazezë e të tjerë të vendosur në Kosovë në vitet 1918-1940. Këta kartona në sasi rreth 17.000 copë, pushteti serb gjatë gjatë masave të dhunëshme në Arkivin e Kosovës 1990-1999, së bashku me disa fonde të tjer ai ka plaçkitur dhe i ka dërguar në Arkivin e Serbisë në Beograd.



Pasqyrë e kolonizimit në viset jugore prej fillimit e deri në vitin 1941.

familje), Mareci (4 familje), Nisheci (9 familje), Prapashtica (26 familje, në pronat e shqiptarëve të masakruar dhe të dëbuar në vitin 1921), Prishtina (70 familje), Slivova (2 familje), Teneshdolli (3 familje), Truda (2 familje) dhe Vranidolli (3 familje).

Koloni sllave – vendbanime të reja:

- “Dvet Jugoviq”, vendbanim në veri të Prishtinës, i themeluar me qëllim të kontrollimit të hyrjes në Prishtinë. Aty që nga viti 1922 u vendosën 66 familje kolone sllave.

- Orloviqi, afër Prishtinës, në drejtim të Obiliqit. Në këtë lokalitet që nga viti 1921-1937 u vendosën 34 familje kolone.

Komuna e Fushë Kosovës: Batusa (1 familje), Bardhi i Madh (23 familje në pjesën afër stacionit hekurudhor dhe mbi fshat), Graboci i Poshtëm (20 familje), Harilaqi (18 familje, disa edhe nëpër shtëpi të shqiptarëve), Henci (2 shtëpi), Miradia e Epërme (80 familje nga visit e ndryshme madje edhe nga Rusia), Nakarada (3 familje), Pomozotini (40 familje, pjesë e ndarë afër fshatit të vjetër ku në vitin 1937 ndërtuan edhe kishën), Sllatina e Madhe (33 familje, në pjesë të ndryshme në fshat dhe afër fshatit) dhe Vrogolia (11 familje, afër rrugës).

Koloni sllave– vendbanime të reja:

- Krivova në rrugën që shpie nga Sllatina e Madhe për në Drenicë, lokalitet strategjik ku është kontrolluar kalimi dhe është ndërtuar stacioni i xhandarmërisë. Këtu pas vitit 1922 u vendosën 25 familje nga viset e ndryshme të Mbretërisë së Jugosllavisë.

- Fushë – Kosova: Vend afër stacioni hekurudhor më të afërt të Prishtinës, në hekurudhën e ndërtuar në vitin 1873 në relacionin Shkup – Mitrovicë. Këtu që nga viti 1921 u vendosën 142 familje kolone nga Mali i Zi, Serba, Kraina Serbe Bosnjes, Hercegovina, madje edhe nga Rusia dhe vise të ndryshme. Në vitin 1937 u lëshua në qarkullim edhe hekurudha Fushë-Kosovë – Pejë.

Komuna e Obiliqit: Babimoci (1 familje), Lokaliteti Bakshia-Nëntë Jugoviqët (48 familje); Breznica (58 familje), Caravadica (3 familje), Hadja (4 familje), Dardhishta (15 familje), Lajthishta (4 familje), Mazgiti (11 familje), Plemetini (6 familje), Raskova (6 familje) dhe Siboci (7 familje).

Koloni sllave – vendbanime të reja:

- Millosheva – Që nga vitit 1920 filluan të vendosën familjet kolone sllave, kryesisht në pronat e familjeve shqiptare e muhaxhire, por edhe çerkeze të shpërngulura në Turqi. Këtu i vendosën 68 familje kolone. Ishte krijuar si vendbnaim në vitin 1864 nga familjet çerkeze dhe e pagëzuar me emrin Azizije. Pas vitit 1877/78 u vendosën rreth 200 familje shqiptare muhaxhire të dëbuara nga Sanxhaku I Nishit, por ato në vitin 1912/13 shpërngulën në Turqi.

- Obiliqi: Prej vitit 1922 – 1928, afër stacionit hekurudhor dhe rrugës për në Prishtinë, jo larg vendbanimit të vjetër Glloboder u vendosën 122 familje nga visit e ndryshme.

- Dobrasella: Është themeluar si koloni në vitin 1923, afër minjerës së njohur të qymyrit. Këtu u vendosën 34 familje kolone me 171 anëtarë.

- Llazareva, në verilindje të Prishtinës, prej vitit 1922-1927 u vendosën 17 familje kolone sllave.

- Minjera e Kosovës, koloni xehtare. Në vitin 1927-1928 u vendosën 9 familje kolone serbe e malazeze.

- **Komuna e Podujevës:** Bajçina (12 familje), Balloci (71 fanukhe), Batllava (28 fanukhe), Bellopoja (39 familje), Bërveniku (7 familje), Braina (6 familje), Bradashi (24 familje), Burica (4 familje), Dobërdoli (28 familje), Dobratini (11 familje), Dumnica e Epërme (1 familje), Dumnica e Poshtme (137 familje), Dumoshi (12 familje), Dyzi (4 familje), Gërdoci (9 familje), Gllamniku (43 familje), Halabaku (5 familje), Hërtica (36 familje), Kaçibegu (7 familje), Katunishta (23 familje), Kërprimehu (21 familje), Konusheci (24 familje), Kushevica (13 familje), Letanci (5 familje), Lupçi i Poshtëm (14 familje), Llapashtica e Epërme (63 familje), Llapashtica e Poshtme (21 familje), Llausha (30 familje), Lluga (3 familje), Luzhani (9 familje), Majaci (8 familje), Merdari (33 familje), Metërgoci (39 familje), Metohia (7 familje), Miroci (14 familje), Murgulla (4 familje), Obrança (42 familje), Orllani (56 familje), Pakashtica (28 familje), Penuha (11 familje), Perani (21 familje), Përpollci (5 familje), Podjeva (157 familje), Pollata (1 familje), Potoku (3 familje), Repa (54 familje), Revuçi (33 familje), Sallabaja (5 familje), Sfeçla (48 familje), Siboci i Epërm (38 familje), Siboci i Poshtëm (9 familje), Sllatina (1 familje), Surkishi (17 familje), Shajkoci (17 familje), Shakovica (8 familje), Shtedimi (15 familje), Tërtnava (22 familje), Turuçica (37 familje) dhe Zakuti (15 familje).

Koloni të reja sllave:

- Radujevci, ndërmjet fshatrave Dumosh – Bellopojë – Batllavë, u vendosën 31 familje sllave.

- Livadica, afër Podjevës, në verilindje të saj, u vendosën 33 familje kolone.

Duhet theksuar se në trevën e kësaj komune, përkatësisht të Llapit deri në vitin 1912 nuk kishte asnjë familje serbe dhe malazeze. Kurse tani pothuajse në çdo vendbanim u vendosën kolonë sllavë viseve të ndryshme, kryesisht nga treva e Toplicës.

Komuna e Lipjanit: Akllapi (3 familje), Babushi i Muhaxhi-rëve (17 familje), Baica (4 familje), Banulla (9 familje), Bregu i Zi (9 familje), Bujani (8 familje), Dobraja e Madhe (6

familje), Dobraja e Vogël (10 familje), Gadime e Epërme (5 familje), Gadime e Poshtme (9 familje), Glllogoci (3 familje), Hallaçi i Vogël (6 familje), Lepia (4 familje), Lipjani (10 familje), Llugaxhia (3 familje), Magurja (11 familje), Mareci (8 familje), Medveci (13 familje), Poturoci (17 familje), Qylaga (12 familje), Radeva (6 familje), Ribari i Madh (1 familje), Rubofci (4 familje), Shala (Sedllari) (1 familje), Topliçani (5 familje), Vërsheci (13 familje).

Kolonitë – vendbanimet e reja:

- Vrella e Goleshit, prej vitit 1920 – 1930 në këtë lokalitet u vendosën 111 familje kolone serbe, malazeze, ruse etj.

- Suhadolli. Në këtë vendbanim shqiptarë afër Lipjanit, nga dhuna e terrori familjet vendëse pas vitit 1912 shpërngulën. Kthenen vetëm familjet e Hashanëve. Pushteti serb në këtë lokalitet vendos 125 familje kolone sllave nga viset e ndryshme të Mbretësisë jugosllave.

- Lluga, që nga viti 1920 në këtë vendbanim u vendosën 34 familje kolone, kryesisht të ardhur nga Lika.

- Gracka. Deri në vitin 1912, në këtë vendbanim jetonin familjet shqiptare. Në këtë vit u bë masakër të to. Kanë shpëtuar vetëm 3 gra me fëmijë që ishin në gji. Fshati mbetet i zbrazët, por në vitin 1921 kolonizohet me elementin sllavë. Këtu u vendosën 82 familje kolone serbe e malazeze.

- Rufci i Ri: Themelohet si koloni sllave në vitin 1921. Këtu u vendosën 40 familje kolone me 201 anëtarë.

Komuna e Ferizaj: Babushi i Serbëve (6 familje), Bibaj (13 familje), Cërnilla (12 familje), Doganaj (4 familje), Ferizaj (36 familje), Gaçka (rreth 20 familje), Gërlica (7 familje), Gremja (23 familje), Komogllava (5 familje), Kosharja (13 familje), Lloshkobarja (26 familje), Mirashi (22 familje), Mirosala (16 familje), Muhoci (19 familje), Nekudini (5 familje), Nerodimja (8 familje), Nerodimja e Poshtme (1 familje), Papazi (23 familje), Pleshina (25 familje),* Pojatishta (22 familje), Prelezi i Jerlive (37 familje), Prelezi i Muhaxhirëve (7 familje), Rahovica (15 familje), Rakaj (33 familje), Sazlia (10 familje), Slivova (15 familje), Softoviqi (20 familje), Sojeva (14 familje), Katuni i Vjetër (39 familje), Surqina (10 familje), Talinoci i Jerlive (5 familje), Talinoci i Muhaxhirëve (25 familje), Tërni (2 familje), Varoshi (13 familje) dhe Zaskoku (20 familje).

Kolonitë- vendbanime të reja:

- Tankosiqi 119 familje dhe e pagëzuan me emrin e Voja Tankosiqit, udhëheqës çetnik në luftën e parë botërore.

- Rakaj 35 familje kolone (kryesisht në pronat e familjeve shqiptare të shpërngulura në Turqi).

Komuna e Shtimes: Godanci i Poshtëm (14 familje), Gjurkoci (9 familje), Muzeqina (3 familje), Raçaku (1 familje), Rashinca (15 familje), Shtimja (3 familje) dhe Vojnofci (8 familje).

Koloni – vendbanime të reja:

Petrovici, shtrihet në veri të Shtimës. Prej vitit 1920 – 1923 u kolonizuan 22 familje muhaxhire dhe u pagëzua me emrin Petrovici.

Gllavica. Në lokalitetin e fshatit Rashincë, që nga vitit 1919 u vendosën 20 familje malazeze dhe një serbe dhe krijuna kolonin e quajtur Gllavicë.

Komuna e Kaçanikut: Elezaj (9 familje), Gabrica (1 familje), Kaçaniku i Vjetër (29 familje), Reka dhe Stagova (3 familje).

Koloni – lokalitet i veçantë:

Reka, në vendin e quajtur Kamenica u vendosën 12 familje kolone sllave.

Komuna e Glogocit: Abria e Epërme (1 familje), Arllati (8 familje), Baica (11 familje), Dobrasheci (12 familje), Domaneku (10 familje), Fushtica e Poshtme (12 familje), Gllanasella (27 familje), Gllabari (15 familje), Komarani (91 familje), Karratica e Epërme (5 familje), Karratica e Poshtme (18 familje), Krajкова (21 familje), Likoshani (4 familje), Llapushniku (31 familje), Negroci (9 familje), Pokleku (10 familje), Polluzha (11 familje), Çikatova e Vjetër (2 familje), Sankoci (5 familje), Shtrubulova (2 familje), Tërsteniku (22 familje), Zabeli i Poshtëm (16 familje)

Kolonitë – vendbanimet e reja:

- Qikatova e Re. Si koloni është themeluar në vitin 1930 dhe 1935 nga kolonët serbë, malazezë, rusë etj. Aty u vendosën 163 familje me 322 anëtarë..

- Ndërmjet vendbanimeve Negoc dhe Llapushnik, në vitin 1936 u kolonizuan 29 familje kolone me 140 anëtarë.

- Pakleku i Ri. Si koloni serbe e malazeze filloi të krijohet nga viti 19030. Këtu u vendosën 20 familje kolone.

- Në lokalitetin ndërmjet fshatrave Zabel dhe Krajkovë, deri në vitin 1937 u kolonizuan 26 familje me 128 anëtarë.

- Në vendin Ostrug (afër Komaranit), prej vitit 1926 deri më 1935, pushteti kolonizoi 8 familje sllave me 50 anëtarë..

Komuna Skënderaj: Buroja (39 familje), Izbica (8 familje), Klina e Epërme (30 familje), Klina e Mesme (7 familje), Klladërnica (1 familje), Kuçica (2 familje), Likoci (1 familje), Luboveci (9 familje), Makërmali (11 familje), Mikushnica (26 familje), Padalishta (1 familje), Polluzha (13 familje), Prekazi i Epërm (22 familje), Prekazi i Poshtëm (9 familje), Radisheva (2 familje), Kopiliqi i Poshtëm (15 familje kolone serbe e malazeze), Tërnafc (8 familje), Turiçeci (25 familje), Çubrel (10 familje), Vitaku (12 familje) dhe Vojniku (32 familje).

Kolonitë:

- Skënderaj, e pagëzuar me emrin Serbicë, prej vitit 1922 deri në vitin 1944 u vendosën 92 familje kolone sllave nga visit e ndryshme të Mbretërisë jugosllave.

- Kralica – lokalitet prej fshatit Palac e deri në Mikushnicë e Dubovc, prej vitit 1923 – 1926 në pronat shqiptare u vendosën 61 familje me 241 kolonë nga visit e ndryshme.

- Palaci i Ri, prej vitit 1921 e deri në vitin 1936 u vendosën 55 kolone sllave me 25 banorë.

- Kosieri i Ri, lokalitet në anën lindore të fshatit Çitak dhe Runik prej viti 1921 – 1932 u vendosën rreth 20 familje kolone malazeze dhe formuan vendbanim të ri, në bazë të vendit Kosier në Mal të Zi nga kanë ardhur.

- Në lokalitetin Çubrel – Llaushë – Vitak, prej vitit 1928 deri më 1936 u vendosën 8 familje kolone sllave me 34 anëtarë.

- Prroni i Keq, afër fshatit Klinë e Epërme, pran rrugës Mitrovicë – Pejë, me qëllim të kontrollimit të lëvizjes së popullatës në vitin 1927 ishin ndërtuar 50 shëpi për vendsjen e kolonëve.

- Novosella, në ngastrën e fshatit Llaushë prej vitit 1922-1932 u vendosën 13 familje kolone me 53 anëtarë dhe krijuan koloni të re që e pagëzuan me këtë emër.

- Në lokalitetin të quajtur Kodra e Tomës në trekëndëshin Tërnafc-Prekaz-Klinë, pranë rrugës Pejë – Mitrovicë u vendosën 51 familje kolone serbe e malazeze.

Komuna e Vushtrisë: Akrashtica (3 familje), Balinca (35 familje), Beçiqi (10 familje në vendin Lladishnjak), Bivolaku (8 familje), Brusniku (8 familje), Bukoshi (58 familje kolone

nga visit e ndryshme në vend të familjeve shqiptare të dëbuara nga pushteti dhe të shpërngulura kryesisht në Turqi), Cecelia (5 familje), Dalaku (14 familje), Druari (26 familje), Dobërluka (6 familje), Dubofci (8 familje), Dumnica e Epërme (9 familje), Dumnica e Llugave (15 familje), Dumnica e Poshtme (19 familje), Galica (6 familje), Graca (6 familje), Kolla (15 familje, kreysisht në lokalitetin Rashefci), Mavriqi (5 familje), Nedakoci (12 familje), Novolani (32 familje), Maxhunaj (8 familje), Pantina (16 familje), Pestova (15 familje), Resniku (6 familje), Ropica (5 familje), Samadrexha (29 familje), Sllakofci (1 familje), Sllatina (7 familje), Smrokonica (1 familje), Stanofci i Epërm (5 familje), Stanofci i Poshtëm (9 familje), Studimja e Poshtme (8 familje), Shalci (16 familje), Shtitarica (1 familje), Taraxha (15 familje), Tërllobuçi (1 familje), Lumi i Madh (28 familje kolone, ndërsa në vitin 1914 ishin vendosur edhe 16 familje serbe nga rrethina e Kralevës), Vërnica (17 familje), Vilanci (17 familje), Vushtrria (shumë familje), Zagori (21 familje).

Kolonitë – vendbanimet e reja kolone:

- Hercegovia, koloni e krijuar nga kolonistët e ardhur 46 familje nga Hercegovina prej vitit 1921-1924, dhe e pagëzuan në vitin 1938 me emrin Hercegovë.

- Jezera e krijuar si koloni serbe e malazeze prej vitit 1921 dhe 1928. Këtu u vendosën 41 familje.

- Svaraçaku i Epërm, është krijuar si koloni sllave prej vitit 1920 – 1932, ku u vendosën 19 familje nga visit e ndryshme të Mbretërisë jugollave.

- Svaraçaku i Poshtëm, është krijuar si koloni sllave prej vitit 1920 – 1937, ku u vendosën 52 familje kolone sllave nga viset e ndryshme të Mbretërisë jugosllave.

- Në lokalitetin Druari-Resniku u vendosën 36 familje kolone sllave me 178 anëtarë.

- Në lokalitetin Gracë-Stanofci i Epërm u kolonizuan 28 familje me 138 banorë.

- Në lokalitetin Zhilivoda-Siboci u kolonizuan 56 familje kolone.

Komuna e Mitrovicës: Brabaniqi (3 familje), Gushafci (7 familje), Kçiqi i Madh (2 familje), Kopriva (2 familje), Lisica (2 familje), Lushta (13 familje), Mitrovica (30 familje), Pirqa (12 familje), Shipoli (45 familje), Shupkoci (1 familje), Suhadolli i Epërm (10 familje), Frashëri (Svinjari) (14 familje), Vaganica (12 familje), Vërnica (10 familje), Vinarci i Poshtëm (6 familje) dhe Zhabari i Poshtëm (3 familje).

Komuna e Zveçanit: Korila (1 familje).⁸⁶

Komuna e Leposaviqit: Kijavçiqi (1 familje) dhe Kopariqi (1 familje).

Komuna e Kamenicës: Berivojca (Në vitin 1934 u vendosën 30 familje kolone sllave në vend të familjeve shqiptare të gjitha një vit më parë shpërngulur në Turqi), Bozhevc (1 familje), Bratilloci (1 familje), Busovata (2 familje), Dajkoci (6 familje), Drenoci (14 familje), Firiqeja (2 familje), Glllogoci (1 familje), Hajnoci (2 familje), Hodonoci (10 familje), Hogoshti (7 familje), Kamenica (6 familje), Karaçeva e Eperme (11 familje), Kollolleçi (29 familje), Kopërnica (5 familje), Koretini (68 familje), Miganofci (1 familje), Moçari (1 fami-je), Muçivërci (13 familje), Çarakofci (8 familje), Rubofci (6 familje), Rogana (21 familje), Shipashnica e Poshtme (12 familje), Strelica (2 familje), Cfirca (3 familje), Tërstena (2 familje) dhe Topanica (27).

Komuna e Vitisë: Ballanca (11 familje), Begunca (3 familje), Binça (2 familje), Buzoviku (37 familje), Budrika e Epërme (2 familje), Devaja (3 familje), Drobeshi (39 familje),

⁸⁶ Në territorin e komunave që ishin të banuar kryesisht me popullatë serbe, siç ishin Leposaviqi, Zveçani dhe Shterrpca, si dhe në vendbanimet serbe në komuna të tjera, pushteti nuk vendosi kolonë, kuptohet se qëllimi ishte ndërrimi i strukturës nacionale në dëm të shqiptarëve, e jo karakter ekonomik siç propagandonin. Në territorin e komunës së sotme të Dragashit, si lokalitet kodrinor-malor, në vitet e tridhjeta të shek. XX ishin vendosur disa kolonë, mirëpo ata largohen për shkak të kushteve të tokës së dobët, largësia nga qendra e Prizrenit etj.

Gërmova (50 familje), Gërçari (3 familje), Gjylekari (16 familje), Goshica (40 familje), Kabashi (34 familje), Mogilla (21 familje), Podgorci (3 familje), Poherani (54 familje), Radivojci (1 familje), Ramjani i Epërm (54 familje), Remniku (19 familje), Sadovina e Çerkezëve (62 familje), Sa-ovna e Jerlive (11 familje), Shasharja (12 familje), Sllatina e Epërme (17 familje), Smira (13 familje), Tërpeza (13 familje), Tërteniku (1 familje), Vërboci (3 familje), Vitia (25 familje) dhe Zhitia (9 familje).

Kolonitë – vendbanimet e reja sllave:

- Ramnishta, 9 familje kolone sllave duke filluar nga viti 1920 u vendosën në pronat e fshatit Beguncë dhe krijuan koloni – vendbanim të ri.

- Në lokalitetin Devajë-Vrapçiq, në vitin 1932 dhe 1935 u vendosën 17 familje kolone sllave me 89 anëtarë.

Komuna e Istogut: Banica (27 familje), Banja (42 familje), Bellopoja (14 familje), Caralluka (5 familje), Dragalefci (7 familje), Dreja (4 familje), Dubova e Vogël (7 familje), Gurrakoci (33 familje), Istogu (15 familje), Kaliçani (28 familje), Kashica (3 familje), Kërrnina (37 familje), Kovrraga (31 familje), Lluga (1 familje), Llukaci i Begut (8 familje), Llukaci i Thatë (2 familje), Lubova (84 familje), Lubozhda (11 familje), Muzhevina (6 familje), Orobërda (97 familje), Prekalla (1 familje), Prigoda (11 familje), Rakoshi (32 familje), Shalinovica (20 familje), Staradrani (9 familje), Studenica (4 familje), Suhogërla (Syrigana) (2 familje), Shushica (70 familje), Tomoci (5 familje), Tuçepi (39 familje), Uça (1 familje), Veriqi (62 familje), Vrella (16 familje), Zallçi (25 familje) dhe Zhakova (7 familje).

Kolonitë:

- Dubrava, si koloni serbe e malazeze është themeluar në vitin 1924 – 1930, ku u vendosën 122 familje me rreth 522 banorë.

- Dobrusha është themeluar si koloni sllave që nga viti 1919-1920 u vendosën 77 familje kolone, kryesisht malazeze.

- Sërbobrani, si koloni sllave, kryesisht nga banorët e Serbobranit nga Vojvodina dhe viset te tjera u krijua prej vitit 1925, ku u vendosën 30 familje.

Komuna e Klinës: Biça (17 familje), Bokshiqi (14 familje), Budisallci (12 familje), Caraviku (8 familje), Çabiqi (4 familje), Deiqi (14 familje), Dollci (2 familje), Dollova (13 familje), Dranoshiqi (29 familje), Dërsniku (3 familje), Drenoci (24 familje), Dugajeva (24 familje), Gjyrgjeviku i Madh (7 familje), Gjyrgjeviku i Vogël (28 familje), Gllareva (13 familje), Grabanica (5 familje), Gremniku (4 familje), Jagoda (43 familje), Jashanica (73 familje), Kërnica (24 familje), Klinafci (18 familje), Klina (14 familje), Këpuzi (44 familje), Krysheva e Madhe (23 familje), Pjetërqi i Epërm (15 familje), Pjetërqi i Poshtëm (13 familje), Pograxha (7 familje), Qeskova (6 familje), Qypeva (5 familje), Radulloci (disa familje), Ranoci (10 familje), Shtupeli (41 familje), Stupa (u vendosën 25 familje kolone dhe e quanin me emrin “Naseljenije”), Ujmiri (14 familje), Videja (19 familje), Volljaka (6 familje), Zabërgja (1 familje), Zajmi (12 familje) dhe Zllakuçani (23 familje).

Kolonitë:

- Në lokalitetin ndërmjet fshatrave Zajm-Deiqi-Vide-Drenoc, u kolonizuan 51 familje me 233 anëtarë.

- Në lokalitetin Jashanicë-Resnik, prej vitit 1932-1937 u kolonizuan 52 familje kolone sllave me 235 banorë.

- Në lokalitetin Klina-Zallkuçani u kolonizuan 41 familje me 187 anëtarë.

Komuna e Malishevës:⁸⁷ Banja (18 familje), Bellanica (14 familje), Bubaveci (14 familje), Bubli (11 familje), Carralluka (22 familje), Damaneku (10 familje), Dragobili (në vendin Pallanka, 25 familje), Jançishta (1 familje), Lashkadrenoci (47 familje), Kjeva (9 familje), Lladroviqi (20 familje), Llazica (42 familje), Lubizhda (23 familje), Malisheva (20 familje), Millanoviqi (Shkoza) (4 familje), Mirusha (12 familje), Mleçani (26 familje), Pagarusha (3 familje), Plloçica (9 familje), Panorci (25 familje), Seniku (8 familje), Shkarash-niku (9 familje), Verrmica (9 familje), Tërpeza (23 familje) dhe Turjaka (8).

Koloni – vendbanime të reja:

- Garaçeva, rithemelohet si vendbanim kolonë sllavë në vitin 1935, ku u vendosën 12 familje kolone më 50 banorë, që llogaritej si lagje e fshatit Panorci.

- Në lokalitetin Tërpeza-Arllati, në vitin 1936 dhe 1938 u vendosën 19 familje kolone.

- Në lokalitetin Panorci – Bubël, u kolonizuan 31 familje sllave me 128 banorë.

- Në lokalitetin Mleçan-Plloçicë, në vitin 1936 dhe 1938 u kolonizuan 20 familje kolone me 80 anëtarë.

Komuna e Rahovecit: Bellacërka (19 familje), Bërnjaça (11 familje), Brestofci (2 familje), Celina (1 familje), Çifllaku (20 familje), Deja (12 familje), Gexha (8 familje), Kramoviku (7 familje), lokaliteti Kramovik-Çifllak (23), Krusha e Madhe (41 familje), Mrasori (3 familje), Nushpala (13 familje), Radosta (20 familje), Rahoveci (9 familje), Ratkoci (21 familje), Saroshi (11 familje), Sopniqi (31 familje), Vrajaka (7 familje) dhe Xërxa (46 familje).

Kolonitë – vendbanimet e reja:

- Në lokalitetin Kramovik-Çifllak, në vitin 1934 u kolonizuan 23 familje kolone me 102 anëtarë.

- Në lokalitetin lokaliteti Bellacërka-Xërxa-Gexha-Radosta, prej vitit 1928-1938 u kolonizuan 119 familje kolone me 533 anëtarë.

- Në lokalitetin Ratkoci-Vranjaku-Nushpala, në vitin 1936-1937 u kolonizuan 24 familje kolone me 116 anëtarë.

Komuna e Gjakovës: Babaj Bokës (3 familje), Bardhaniqi (11 familje), Batusha (27 familje), Beci (82 familje), Berjahu (5 familje), Bardosana (24 familje), Bishtazhini (5 familje), Brekoci (36 familje), Brovina (3 familje), Cërmjani (37 familje), Dallashaj (25 familje), Damjani (20 familje), Deva (16 familje), Doblibare (28 familje), Dobrixha (30 familje), Dobroshi (9 familje), Doli (17 familje), Dujaka (11 familje), Firaja (4 familje), Firza (33 familje), Gërçina (12 familje), Gërgoci (16 familje), Godeni (8 familje), Gjakova (26 familje), Guska (7 familje), Hereçi (66 familje), Jabllanica (15 familje), Jahoci (21 familje), Janoshi (22 familje), Kodralia (14 familje), Korenica (55 familje), Kralani (37 familje), Kusari (6 familje), Kushaveci (6 familje), Lipoveci (18 familje), Llugaxhia (11 familje), Madanaj (1 familje), Marmulli (79 familje), Meça (37 familje), Moglica (9 familje), Mulliqi (13 familje), Morina (5 familje), Neci (77 familje), Nivokazi (19 familje), Novosella e Epërme (2 familje), Novosella e Poshtme (8 familje), Osek Hyla (21 familje), Osek Pasha (2 familje), Pacaj (7 familje), Palabardhi (4 familje), Pjetërshani (11 familje), Plançori (26 familje), Ponosheci (51 familje), Popoci (5 familje), Qerimi (3 familje), Raça (35 familje), Radoniqi (128 familje), Rakoci (37 familje), Ramoci (10 familje), Rashkoci (31 familje), Rogova (47 familje), Rracaj (22 familje), Rrypaj (7 familje), Sheremetaj (34 familje), Shishmani (34 familje), Shishmani i Bokës (11

⁸⁷ Në Anadrini dhe në Llapushë, duke përfshirë edhe territorin e kësaj komune në vitet 1932-35 vendosën shumë familje të ashtuquajtura optane kolone sllave të ardhura nga Vrraka e Shqipërisë. Ato familje kah mesi i shek. XIX kishin kishin gjetur strehim pasi që ishin ikur nga krahina e Zetës në Mal të Zi, tani një pjesë e tyre vendosët në Kosovë me qëllim të caktuar.

familje), Skivjani (27 familje), Smaqi (17 familje), Smolica (19 familje), Stublla (21 familje), Trakaniqi (8 familje), Ujzi (14 familje), Vogova (20 familje), Vraniqi (32 familje), Zylfaj (7 familje), Zhabeli (8 familje), Zhdrella (7 familje) dhe Zhubi (7 familje).

Kolonitë:

- Në trevën e Dushkajës, prej vitit 1928 në Biteshin e Poshtëm u kolonizuan 41 familje, ndërsa në Biteshin e Epërm 36 familje kolone.

- Gradisha, afër Urës së Fshejt, prej vitit 1926-1931 u kolonizuan 44 familje kolone serbe e malazeze.

- Fusha e Gjakovës, u kolonizuan 42 familje me 120 anëtarë.

- Në vendin e quajtur Nakaradë, në hyrje të Gjakovës, në rrugën Prizren-Gjakovë, u kolonizuan 59 familje kolone serbe e malazeze.

- Piskota, afër Gjakovës, në drejtim të Pejës, u vendosen 43 familje kolone.

- Zidi i Sadik Agës, në anën juglindore të Gjakovës, u kolonizuan 5 familje kolone sllave.

- Në lokalitetin Bardhaniq – Llugaxhi, në vitin 1932-1933 u vendosën 26 familje kolone me 116 anëtarë.

- Në lokalitetin Bishtazhin – Lipovec – Smaç, në vitet 1929-1933 u kolonizuan 33 familje kolone me 164 anëtarë.

- Në lokalitetin ndërmjet fshatrave Dobrosh dhe Junik, në fushën Kallavaj, u kolonizuan 92 familje kolone serbe e malazeze.

- Në lokalitetin Malet e Hereçit, u kolonizuan 58 familje serbe e malazeze.

- Në lokalitetin Luginari, që ishte kullota të fshatrave, prej vitit 1927-1933 u vendosën 122 familje kolone malazeze, serbe etj. Ata ia ndërruan emrin këti lokaliteti të etimologjisë shqipe, së pari në Zimonjiq e pastaj në Petrovac.

- Në lokalitetin afër Marmullës, të quajtur Milena-Rezina u kolonizuan 19 familje kolone.

- Në lokalitetin Meja – Orize u kolonizuan 31 familje kolone, kryesisht malazeze.

- Në lokalitetin Meqa – Cërmjani, në vitet 1932-1933, u kolonizuan 43 familje kolone malazeze me 192 anëtarë.

- Në lokalitetin Moglicë-Raçë-Dol, prej vitit 1929-1936 u kolonizuan 39 familje me 175 banorë.

- Në lokalitetin Dobrixha – Dubrava, në vitin 1930 u kolonizuan 14 familje me 64 banorë.

- Në lokalitetin Jabllanicë – Luti – Vardishtë, në vitin 1931-1936, u kolonizuan 27 familje kolone me 123 anëtarë.

- Në lokalitetin Drini-Cërmjani u vendosën 13 familje kolone serbe e malazeze.

- Në lokalitetin Brovinë-Morinë, prej vitit 1929-1936 u kolonizuan 37 familje kolone me 169 anëtarë.

- Në lokalitetin Zhubi – Dol, prej vitit 1931-1936 u kolonizuan 111 familje kolone malazeze me 501 anëtarë.

Komuna e Prizrenit: Grazhdaniku (4 familje), Hatmaxha (5 familje), Hoça e Qytetit (16 familje), Kabashi (14 familje), Kabashi i Hasit (9 familje), Kushnini (8 familje), Landovica (2 familje), Lugini (14 familje), Lutogllava (37 familje), Prizreni (shumë familje), Romaja (6 familje), Trepetnica (8 familje), Tupeci (18 familje), Vërmica (3 familje), Vllashnja (20 familje) dhe Zhuri (4 familje).

Kolonitë- vendbanimet e reja:

- Dushanova, prej vitit 1928-1936 u kolonizuan 98 familje kolone me 498 banorë.

- Petrovasella, u themelua si koloni në vitin 1924, ku u vendosën 14 familje serbe e malazeze.
- Shumadia e Re, u themelua si koloni në vitin 1925 nga 55 familje kolone serbe e malazeze, kryesisht të ardhura nga Toplica dhe u pagëzue me emrin sllav.
- Në lokalitetin Korisha – Kabashi, në vitin 1934-1935, u kolonizuan 11 familje kolone sllave me 53 anëtarë.
- Në lokalitetin Lugishta – Kabashi, në vitin 1934 u kolonizuan 10 familje kolone me 51 anëtarë.



*Ndërtimi i shtëpive për kolonë në fshatin "Shumadi e Re"
në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore*

Komuna e Suharekës: Dubrava (3 familje), Duhla (30 familje), lokaliteti Goranca-Novaci (4), Grejkoci (11 familje), Gjinoci (15 familje), Javori (3 familje), Leshani (7 familje), Njëpërbishti (2 familje), Reshtani (7 familje), Savrova (4 familje), Semetishti (7 familje), Suhareka (5 familje) dhe Tërni (17 familje).

Koloni – vendbanime të reja:

- Shiroka, afër Suharekës, në drejtim të Prizrenit, u vendosën 13 familje kolone serbe, malazeze dhe ruse.
- Topliçani, afër fshatit Gjinoc, duke filluar nga viti 1928, u kolonizuan 26 familje kolone, kryesisht serbe, nga Toplica dhe e pagëzuan me emrin Topliçan.
- Kosançiqi, afër fshatit Studençan, në vitin 1934 u vendosën 17 familje kolone me 83 anëtarë, dhe e pagëzoi me këtë emër.

6.9. Dokumentet arkivore

Përkitazi me kolonizimin e Kosovës me elementin sllav dhe shpërnguljen e shqiptarëve jashtë vendlindjes së tyre, ekzistojnë dokumente të shumta arkivore, të cilat e dëshmojnë këtë. Këto dokumente sot ruhen në arkiva të ndryshme në Beograd, Tiranë, Londër, Prishtinë, Stamboll, Shkup, Vjenë, Romë etj. Për këtë qëllim do t'i paraqes vetëm disa burime arkivore dhe gazeta të kohës, të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, të cilat e ndriçojnë këtë. Këto dokumente pasqyrojnë metodat, format, mënyrën, qëllimin, propaga-ndën e tjerë, të përdorura nga pushteti për realizimin e kolonizimit dhe të shpërnguljes, rezistencën kundër kolonizimit dhe shpërnguljes e pasojat e tyre.

Viti 1919

Shpërngulja e shqiptarëve kishte fillur prap në vitin 1918 dhe vazhduar me intezitet të shtuar gjatë tërë kohës së Mbretërisë jugosllave. Përveç në Turqi, një kohë ishin strehuar edhe në vise të tjera dhe menjëherë kishta vazhduar ardhja e kolonëve. Kështu me datën 12.01.1919, në shkresën nr. 13 - Kompania I e Batalonit III të regjimentit jugosllav e njoftonte Komandantin e Batalionit III nga Plava për ardhjen e 30 shqiptarëve nga Dukagjini, të cilëve atje u janë djegur shtëpitë.⁸⁸ Ndërsa, sipas raportit të Komandës së Divizionit të Ibrit, dërguar Komandës së territorit të Armatës III, nga Novi-Pazari me shkresën rez. nr. 2773, të dat. 20.V 1919. njoftohet për kërkesën e kaçakëve që të dorëzohen armët, që malazezët të kthehen në Mal të Zi, që vendasit të mbesin nëpër shtëpi, ndërsa ushtria të shkojë në Mitrovicë.⁸⁹

Lazër Mjeda, Kryepeshkop i Shkupit, nga Prizreni më 29 gusht 1919 i shkruan Eminencës T. ztr. G.M. Kardinal Von Rossum, Prefekt i Kongregacionit të Shenjtë, De Propaganda Fide, Romë, në mes tjerash edhe këtë: “.....E ndërsa serbëve (qeveria) u jep armë e municion, muhamedanët dhe katolikët arbnor i torturojnë për t’u nxjerrë ato armë që nuk i kanë....”.⁹⁰

Ministria e Ushtrisë dhe Marinës me datën 12.IX.1919 në Beograd e informon Ministrinë e reformës agrare për leje që komandat e qarqeve të regjimenteve mund t’u japin armë, sipas nevojës kolonëve në Dukagjin, Drenicë, Kosovë, rrethin e Dojranit dhe Maleshikut. Po ashtu mund t’u japin armë zjarri dhe municion edhe komandave të regjimenteve të qarqeve në kufijt e nevojave të vërteta, pushtetit policor dhe komunal për mbajtjen e rendit dhe kryerjen e shërbimit të rojës nëpër fshatra.⁹¹

Viti 1920

Në këtë kohë menjëherë filloi edhe rrëmbimi i tokave dhe pasurive të ndryshme, sidomos nga të shpërngulurit. Në këtë drejtim ishin angazhuar edhe vetë qeveritarët serbë, si psh. Nikolla Pashiqi me disa borgjezë të tjerë si pop Miniqin, Jakov Çobriqin etj. i kishin rrëmbyer më se 300 ha tokë rreth Tyrbës së Sulltan Muratit, pasuritë e fshatrave Mazgit e Azizi (banorët e këtij të fundit me tepër se 100 shtëpi kishin qenë të detyruar të shpërngulën në Turqi në vitet 1912-1914).⁹² Tokë në Kosovë, përveç kolonëve fshatarë, merrnin edhe kategori të ndryshme të popullsisë, persona të cilët nuk e kishin profesion bujqësinë, si nëpunësit, xhandarët, tregtarët, oficerët, pensionistët etj. Siç shkruan gazeta “*Socijalistička Zora*”, Shkup, nr. 31, datë 16.V.1920 - dhënia e utrinave komunale edhe ashtu të pamjaftueshme për kullota si dhe marrja e tokës fshatarëve të varfër të dëshmuar me tapi, dhe dhënia e saj papunëtorëve, oficerëve, inxhinierëve, tregtarëve etj.

Për zbatimin e të ashtuquajturës reformë agrare si maskë për zbatimin e kolonizimit, disa gazeta të kohës dhe dokumente dëshmojnë qëllimet dhe keqpërdorimet. Kështu gazeta “*Pravda*” nr. 70, Sarajevë më 10.VII 1920, në mes tjerash shkruan: “...Se tërë Mbretëria jonë është përplotë me prona të mëdha feudale dhe kapitaliste, e sidomos të domenit të madh shtetëror, por prapë tërë çështja kryesore agrare është bartur në Bosnje dhe në Serbi të Vjetër (Kosovë J.O.). Pse? Kroacia është plotë latifonde, Sllavonia gjithashtu, Banati, Baçka dhe Baranja poashtu, por prapë për këto krahina nxjerren dispozita dhe dekretligje të tjera, ndërsa Shumadia, e cila gjithashtu ka mjaft shumë latifonde kapitaliste e feudale, të cilat punohen me ndihmën e

⁸⁸ Arhiv Vojno Istorijiskog Instituta (AVII), Beograd, R.4/3, K.54, f.41.

⁸⁹ AVII, R/43, K. 54, f.2.

⁹⁰ Gjergj Gashi, Kosova altari i Arbërisë, 1910-1941, I-III, imzot Lazër Mjeda, Onufri, Tiranë.

⁹¹ AJ B., MAR, 96-1-4.

⁹² “Socijalistička Zora”, Shkup, nr. 36-38, 6-09 qershor 1920.

punëtorëve dhe mediterraneve, është shkëputur nga reforma agrare. Parulla, se toka do t'u takojë atyre, të cilët e punojnë, ka të bëjë vetëm në Bosnje dhe në Serbi të Vjetër, Pse?...".

Viti 1921

Përveç dhunës e terrorit bëhej edhe masakër ndaj popullatës shqiptare, me qëllim të realizimit të kolonizimit. Kryetari i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, Mithat Frashëri më 29.IV 1921, i drejtohet Sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, ku e njofton për ekceset serbe kundër shqiptarëve, të cilët kanë qenë subjekt i sundimit serb që nga vitit 1912, dhe se ato po vazhdojnë dhe po bëhen edhe më të shpeshta, kështu që elementi shqiptar është i rrezikuar nga shkatërrimi total. Shqiptarëve, të cilët i banojnë territoret e veta, po u plaçkiten pasuritë e tyre, po ndiqen me dhunë prej fshatrave të tyre dhe në vend të tyre po vendosen kolonët rusë. Vetëm gjatë tre muajve të fundit më se 2.000 shqiptarë janë mbytur pa kurrfarë arsye, duke mos përmendur shtëpitë e tyre të shkatërruara, pasuritë e tyre janë plaçkitur, kështu që ata kanë qenë të detyruar të ikin dhe të vendosen në Shqipëri. Mirëpo, Serbia ka proklamuar se familjet e atyre refugjatëve do të internohen dhe tërë pasuria e tyre do të konfiskohet.⁹³

Më 10.V.1921. z. Aubrey Herbert, bënë pyetje në parlamentin britanik për masakrat serbe ndaj shqiptarëve: *"Se a janë në dijeni se më 28 janar dy batalione serbe të komanduara nga një major vajtën në fshatrat e Llapit, afër Prishtinës Keçekollë, Prapashticë dhe Sharban, ku i dërguan banorët meshkuj të moshës prej 12 vjet afër një mali i masakruan me mitraloza, pastaj kaluan në fshatra dhe ua futën zjarrin shtëpive dhe i masakruan të gjitha gratë dhe fëmijët, duke i lënë vetëm 14 përjetues nga popullata prej 1.680 vetave në 320 shtëpi dhe a janë kërkuar informata nga qeveria jugosllave lidhur me këtë?"*.⁹⁴

Drejtorati kryesor në Mal të Zi i Ministrisë së Reformës Agrare në Cetinë, me shkresë nr. 2547, datë 20.VII.1921 - raporton përkitazi me angazhimin e pushtetit ushtarak për kolonizimin e Pejës. Ministria e Ushtrisë dhe e Marinës urdhëron që Komandanti i Territorit të Armatës II t'i përcjellë kolonët nga Berani deri në Pejë, ndërsa Komandanti i Armatës III nga Peja në Drenicë dhe kërkon që kolonëve t'u jepen armë dhe municion.⁹⁵

Viti 1922

Disa banorë të fshatit Prapashticë, në ankesën e tyre në vitin 1922, shkruajnë për vrasjen e fshatarëve të tyre dhe se nëpunësit e Ministrisë së Reformës agrare po ua masin tokat e tyre dhe po ua marrin.⁹⁶

Revista *"Policija"* nr. 3-4 e vitit 1922, e boton fjalimin e V. Bojlozeviqit, prefekt i Rrethit të Graçanicës, ku ai paraqet se një numër i madh i të ashtuquajturëve kolonë banojnë në qytetza dhe jetojnë komod, kanë profesion tjetër, e jo bujqësinë, se në mesin e tyre ka nëpunës, shërbëtorë, zejtarë dhe tregtarë, dhe ata në atë mënyrë bëhen pronarë dhe "agë" të rinjë, tokën e tyre e japin me qesim që ta punojnë të tjerët. Kështu që, në vend se reforma agrare t'i zhdukë marrëdhëniet feudale, ajo prapë po krijon, por vetëm me ndryshim që agallarët serbë po i zëvendësojnë ata "turq".

Viti 1923

Gazeta *"Vreme"*, e datës 2.01.1923, përkitazi me çrregullimet e "myslimanëve" në të ashtuquajturën "Serbi Jugore" thekson se ato nuk bëhen, kinse nga irredenta, por nga administrata e dobët, e cila i ka përfshirë të gjitha kategoritë e nëpunësve.

⁹³ Public Record Office, London, FO-371-5727.

⁹⁴ PRO L, FO-371-5725.

⁹⁵ AJ B, MAR, 96-2-6.

⁹⁶ AJ B, Ministarstvo Pravde, Versko odeljenje, 63, k. 135.

Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretësisë SKS me shkresën nr. 11079 e dat. 26.IV 1923 e njofton Ministrin e drejtësisë për vërejtjen e lëvizjes së shqiptarëve dhe të turqve në pjesën jugore të vendit, për shkuarje në Turqi, e kryesisht në Thraki, që atje përherë të vendosen dhe të bëhen nënshtetas turq. Kërkon që t'i urdhërohet pushteti lokal që të mundësojnë shpërnguljen, e njofton edhe për çështje të tjera dhe kërkon që të merren masa dhe të mundësohet shpërngulja e atyre, që “e dëshirojnë” atë.⁹⁷

Gazeta “Pravda” nr. 81 e vit. 1923, që dilte në Sarajevë, përkritazi me këtë thekson edhe këtë: “... kolonizimi ka pasur sukses në luginën e Llapit.... sot turqit po shpërngulën nga Llapi, që do të thotë se kolonizimi ka pasur sukses në atë trevë”. Në një artikull tjetër të gazetës “Pravda”, nr. 196, datë, 11.XII 1923, Sarajevë, shkruhet për vrasjen e tre malazezëve në fshatin Vërnice, komuna e Qyqavicës nga ana e një kaçaku, të nesëmren kolonët malaziaz me armë në dorë i kanë sulmuar shqiptarët duarthatë, kanë rrahur kë kanë gjetur, pastaj kanë vrarë 15 dhe lënduar 3 shqiptarë. Pushteti ka qëndruar pasiv.

Gazeta “Politika” e datës 6.VIII.1923 përkritazi me shpërnguljen shkruan, në mes të tjerash edhe “... se interesi ynë nacional, në përgjithësi, është serbizimi i Kosovës dhe i luginës së Vardarit dhe se çështja e shpërnguljes është më aktuale dhe me rëndësi se shumë çështje të tjera”.

Shoqata Kulturore Shqiptare në Sofje “Dëshira”, në protestat e veta të shumta, sidomos në vitet 1923 e 1924 në mes tjerash lidhur me grabitjen e tokave dhe kolonizimin shkruan: “Pasuritë e patundshme të familjeve që janë deyrar ta braktisin vendin e tyre, janë grabitur nga familjet serbe dhe malazeze të vendosura nga autoritetet serbe, para debimit të pronarëve të ligjshëm shqiptarë. Kurrfarë e drejte nuk u është dhënë atyre që të mundë të dispononin me pasuritë e veta, qoftë direkt, qoftë nga fondet e pushtetit. Aq më tepër, pushteti serb ka konfiskuar të gjitha pasuritë e shqiptarëve, që gjenden përkohësisht për një arsye ose një tjetër, jashtë limiteve të territorit të vet”.⁹⁸

Viti 1924

Revista “Agrarni Pregled” nr. 1/1924, thekson se kolonizimi ka filluar para reformës agrare, e pastaj ka shkuar paralel me të, në vend që të vijë pas saj. Ajo zbatohet pa plan, pa kurrfarë kuptimi, pa institucione të organizuar dhe pa mjete. Administrata agrare është e paafte, pa njohuri, në mungesë të intelegjencës. Me tokë po spekulohet, 40% të tokës nuk e kanë marrë bujqit, por spekulantë të ndryshëm, papunëtorët, parazitët.

Kundër shpërnguljes së popullatës shqiptare, në Kosovë e gjetiu vepronin disa shoqata nacionaliste, patriotë shqiptarë etj., të cilët propagandonin në popull që të mos shpërngulen, bënë rezistencë, kritikonin pushtetin dhe protestonin për shkak të terrorit, gjenocidit, shtypjes, dhunës, kolonizimit, zbatimit të padrejtë të reformës agrare etj. Në këtë drejtim prej patriotëve shqiptarë më së shumti është angazhuar dhe ka kontribuar Hasan Prishtina, i cili disa herë deri në vdekje i drejtohet me shkresa, ankesa, memorandume etj. Shoqatës së Kombeve në Gjenevë etj. përkritazi me kolonizimin dhe marrjen e tokave shqiptare nga serbët, malazezët dhe emigrantët rusë, duke i dëbuar shqiptarët nga tokat e tyre. Në një letër nga Vjena të datës 10.II.1924 shkruan: se ata janë të terrorizuar me metodat më gjakatare dhe të rrezikuar në çdo pikëpamje nga pushteti me qëllim që ata të detyrohen të largohen nga atdheu, edhe pse janë banorët më të vjetër të Gadishullit Ballkanik.⁹⁹

⁹⁷ AJ B, F. Min. Pravde, 82-147-23.

⁹⁸ Dr. Hakif Bajrami, Politika, v. e c., fq. 100-101.

⁹⁹ PRO L, FO-371-9961.

Bajram Curri dhe Hasan Prishtina, si përfaqësues të Komiteteve të Bashkuara Shqiptare të paçlirura me datën 26.IV.1924 i drejtohen Kryesisë së Këshillit të Lidhjes së Kombeve dhe e njoftojnë për protestat kundër regjimit të Shtetit SKS, për mosrespektimin e të drejtave të minoriteteve dhe mohimin e së drejtës së shqiptarëve për të jetuar. Lidhur me kolonizimin thuhet: *“Çdo goditje për shkatërrimin e Shqipërisë pasohet nga një operacion vendosje kolonësh rusë, malazezë e serbë. Nga ana e tyre këta kolonë terrorizojnë sistematikisht fshatrat fqinje duke i detyruar banorët t’i braktisin vatrën dhe tokat e tyre, të cilat konfiskohen dhe kolonizohen menjëherë. Janë pikërisht një pjesë viktimash të kësaj manovre tragjike, që bredhin rreth vatrave të tyre që quhen kaçakë.... Kosova, vend kryekëput bujqësor... tani vuan nga mjerim i tmerrshëm, fshatarëve dhe qytetarëve bujq në përgjithësi u janë marrë tokat me pretekst të zbatimit të ligjit agrar... Ky regjim i hekurtë, i zjarhtë dhe i plaçkitjes përbën faktorin kryesor të emigrimit në masë të popullsisë shqiptare në Turqi, i cili po kryhet në kushte të tmerrshme, duke u kushtuar jeta qindra familjeve e duke dënuar pjesën tjetër në një mjerim të patregueshëm....”*¹⁰⁰

Viti 1925

Gazeta “Pravda” nr. 27 e datës 29.01.1925, Beograd, e boton një depeshë të N. Petroviqit, ku thuhet se në të gjitha anët ka paligjëshmeri të ashpër dhe dhunë mbi qytetarë të mirë e të urtë. Organet policore duke filluar nga zhupani e deri të xhandarët, e kanë hedhur nën këmbë kushtetutën dhe Ligjin dhe ndaj të gjithë qytetarëve, të cilët nuk kanë dhënë shenja të dukshme se janë me pushtetin e tanishëm, po përdorin mjete të palejueshme. Kjo gazetë paraqet të dhënat se kolonizimi në masë të madhe po ndikon në nxjerrjen e pasaportave, se po shpërngulet Sanxhaku e Kosova, se toka po blihet mjaft lirë nga ata, të cilët po shkojnë, dhe se ka raste kur toka falet ose lihet krejtësisht nga të shpërngulurit, dhe thekson edhe këtë: *“..se ky është akt i madh historik i kësaj shpërnguljeje”* dhe propozon: *“Më mirë të kemi krizën ekonomike, sesa atë politike treqindjeçare”*. Dokumente të tjera të kohës theksojnë se shpërngulja në Turqi po merr përmasa të mëdha dhe se fshatrat dhe qytezat po i humbin karakteristikat e vjetra, sidomos tregtia dhe zejtaria.

Lidhur me vrasjet dhe masakrat gazeta beogradase “Rad”, e datës 5 gusht 1925, shkruan: *“Qe disa ditë shtëpitë shqiptare digjen në flakë. Është vështirë të dëgjosh britmën e fëmijëve dhe pleqve që keqtrajtohen dhe merren nëpërkëmbë me qëllim që të plaçkiten”*..., *“Në Arnautlluk jetojnë pushkët. Vise të tëra të banuara me shqiptarë vlojnë nga trazirat e ngjashme me ato në Irlandë... Serbia ka formuar... një provincë me qytetarë të rendit të dytë. Atje kallen fshatra të tëra, vriten shumë njerëz, mizoritë janë të pakufishme. Askush më në këtë vend nuk ka turp. Si kanibal i fundit, pushteti predikon shfarosjen e një popullsie për shkak të urrejtjes fetare dhe nacionale. Askush nuk pyet se kush i shtyri ata njerëz të arratisen. Askush nuk do të shohë se duhet ndaluar policët dhe nëpunësit tanë, që janë fajtorë për gjakun që atje po derdhet që nga “çlirimi”. Mirëpo po predikohen therje e gjakderdhje të reja. Fshatrat shqiptare ngjajnë në kaspahane të vërteta”*... *“Punisha deri më tash ishte më dorëmbarë, gratë dhe fëmijët shqiptarë i therrte me sukses. Ai dinte që t’i vriste me një plumb nga gjashtë. Derisa lodhej therrte me thikë njerëz në Kosovë”*.

Viti 1927

Nedelko Simonoviq, ish-deputet në një raport të vetin të datës 13.VII 1927 njoftonte për rezultatet negative për shkak të zbatimit të politikës nacionale nga plaçkitësit dhe vagabondët. Ai thotë, tokën e huaj e kanë marrë ardhacakët e pasur ose nëpunësit e pensionuar, në mënyrë jonormale dhe plotësisht joligjore, atë tokë e cila nuk ishte e përfshirë në goditje të

¹⁰⁰ AQH T, F. 252, D.208, f.04; Hasan Prishtina, Dokumente, Tiranë, 1983, fq. 163-164.

agrarit. Tokën e marrë e kanë shitur, e pastaj përsëri kanë marrë tokë tjetër, ose ia kanë dhënë tjetërkujt ta punojnë, ndërsa ata nëpër kafene po e kritikojnë rregullimin e tanishëm shtetëror.¹⁰¹

Hasan Prishtina, vazhdon me protestat e tij. E ngrit zërin edhe kundër tatimeve të mëdha, dënimeve të shumta, ndalimit të shkollimit në gjuhë amtare, shtypjes, terrorit etj., duke theksuar se po bëhet shtypje në 1 milion shqiptarë, që jetojnë në Mbretërinë SKS që të shpërngulen në Turqi, në Shqipëri dhe në vende të tjera, ku jetojnë në mjerim. Në një dokument protestë nga Vjena më 15.III.1927 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve ser Erik Drummond, shkruan: *“Afër një milion shqiptarë, që jetojnë në Kosovë e Maqedoni nuk kanë asnjë shkollë në gjuhën e tyre amtare. Po kështu, atyre u është ndaluar të hapin shkolla me mjetet e tyre private; Qeveria e Mbretërisë së Jugosllavisë përdorë të gjitha mënyrat e mundshme për t’i shfarosur shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë. Është fakt, është e njohur dhe e qartë që masakrat dhe zhdukja e fshatrave të tëra, vrasjet e shqiptarëve dhe plaçkitja e shtëpive të tyre, janë bërë dhe po bëhen sipas urdhërave të agjentve dhe të autoriteteve më të larta; Si pasojë e konfiskimit pa zhdëmtim të pasurisë së bujqëve shqiptarë, e cila u është dhënë serbëve dhe malazezëve, shqiptarët janë shtrënguar të braktisin në masë vendin e tyre, truallin e të parëve të tyre. Shqiptarët myslimanë e katolikë duhet të paguajnë taksa 60% më të larta, masë kjo e marrë për t’i rrënuar ekonomikisht, e më këtë mënyrë, për t’i detyruar të emigrojnë.”*¹⁰² Si pasojë e kësaj është se popullata serbe e qarkut të Gjakovës, e cila para 10 vjetësh, nuk kapte 1% të popullsisë, sot arrinë 20% të popullsisë, kurse 20% të popullsisë autoktone u larguan nga toka e saj.¹⁰³ Ankesat dhe memorandumet e Hasan Prishtinës, pushteti jugosllav i ka përcjellë përherë, është mundur t’i mohojë të dhënat e vërteta, pra ka përdorur kontrapropagandën.

Viti 1928

Me shkresën nr. 529/27, datë 30.IV 1928, Ministria e Refomës Agrare e njofton Ministrinë e Drejtësisë në Beograd dhe ia dërgon një urdhëresë rreth pronave të marra të kaçakëve. Në mes tjerash thuhet – Rrezikimi i sigurisë publike në “Sërbinë jugore” në vitet e para nga arratisja e shpeshtë nga pushteti I lementit shqiptar dhe formimi I bandave kaçake, të cilat e kanë rrezikuar sigurinë personale dhe pronësore të qytetarëve. Nxjerrja e vendimit të Këshillit Ministror dhe plotfuqishmëria e tij, J.B. nr. 1639/21 për internimin dhe shpërnguljen e përhershme të atyre familjeve të shpallura kaçake në afatin e caktuar (10.III 1921), nëse nuk iu dorëzohen pushtetit kompetent, si dhe me disponimin me pronat e kaçakëve për qëllime kolonizimi. Lëshimi i Urdhëresës të Ministrisë së Refomës Agrare nr. 17.194/21, që pronat e kaçakëve konsiderohen të bakrisura, pa pronarë, të lira, prona në dispozicion për t’u dhënë kolonëve në kuadrin e reformës agrare. Në fillim pronat e kaçakëve u dhanë kolonëve nga ana e pushtetit policor, kurse pastaj nga ana e pushtetit agrar...¹⁰⁴

Viti 1929

Diktatura e 6 Janarit 1929 e bëri shtypjen edhe më të egër. Me rastin e vizitës që i bëri mbreti Gjilanit, fshatarëve shqiptarë të Pozheranit lidhur me padrejtësinë e qarqeve agrare, iu përgjigj me zemërim: *“Shkoni në Turqi, nëse nuk jeni të kënaqur”*!

Gazeta „Proletet“ më 1.XII.1929, nr. 6, thekson në mes tjerash se në Kosovë po zbatohet kolonizimi më brutal. Po rrëmbehen prona të tëra të fshatarëve nëpërmjet proceseve tradhtarë, po dëbohen shqiptarët dhe tokat shqiptare po kolonizohen me serbë të dëgjueshëm ndaj regjimit.

¹⁰¹ AJ B, Ministarstvo Unutrasnjih Dela, 14, k.27.

¹⁰² Drzavni Arhiv Saveznog Sekretarijata Inostranih Poslova, Beograd, (DA SIIP), F. Drustvo Naroda u Zenevi (DNZ), sek. nr. 96, Gjenevë, 22.05.1927; AQSH, F. 263, D.11, f.1.

¹⁰³ “Shqipëria e Re”, Kostancë, 10.01.1931. Letër e Hasan Prishtinës - Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

¹⁰⁴ AJ, Ministarstvo Pravde, 63, 12-124-28.

Dhënia e tokës më të mirë bandave bellogardiste dhe vrangeliste. Ndarja e Kosovës në tri banovina është bërë me qëllim të serbizimit më të shpejt të këtyre viseve.

Viti 1930

Dokumentet e shumta arkivore dëshmojnë se pushteti, për të realizuar qëllimin e shpërnguljes dhe krijimit të tokës së lirë për vendosje të kolonëve, përdori edhe metoda të ndryshme të dhunës. Këtë më së miri e dëshmon artikulli i botuar në gazetën “Proleter” nr. 10, të datës 20 janar 1930, me titull “Smrt albancima - Zemlja belorukcima” - (“Vdekje shqiptarëve - Toka dorëbardhëve”). Në fillim të artikullit të shkruar nga fshatari i Pejës thuhet: “Në këtë trevë shumica e fshatarëve janë shqiptarë. Kjo është toka jonë që nga kohërat më të vjetra. Mbi ne deri më tani kanë sunduar pushtetmbajtës të ndryshëm, beglerë e pashallarë. Ne fshatarët kemi luftuar kundër tyre, prandaj edhe jemi mbajtur nën sundim. Një kohë, në Mesjetë, neve na kanë sunduar edhe feudalët serbë. Në vitin 1912 prapë serbët i kanë pushtuar këto toka dhe që nga ajo kohë i ndjekin shqiptarët, ua marrin tokën, i ngarkojnë me gjoba, ua djegin shtëpitë, i mendojnë gratë dhe fëmijët, ndërsa të rriturit i vrasin...”. Në të dëshimohet, në mes të tjerash, edhe mënyra e marrjes së tokës së punueshme nga komisionet agrare me ndihmën e xhandarëve, për vendosjen e kolonëve në shtëpitë e fshatarëve shqiptarë, të cilët ishin të detyruar që t’i mbanin me ushqim, t’ua punonin tokën, t’ua ndërtonin shtëpitë etj., siç thuhet në dokument: “Ne shqiptarët, pos tjerash duhet t’u ndërtojmë kolonëve edhe shtëpitë me të hollat tona, na duhet ta blejmë litarin me të cilin duhet të na varin ata. Gjatë kohës kur ne ndërtonim shtëpi, kolonët vendoseshin te ne, sepse duhej menjëherë të mbesin në fshat dhe menjëherë të fillojnë serbizimin e kësaj treve. Ata jetojnë në shtëpitë tona deri sa ne ua ndërtojmë shtëpitë e tyre ose deri sa mos t’i dëbojnë familjet tona shqiptare dhe për këtë asgjë nuk paguanin. Çdo shqiptar, të cilit i vinte ai “mysafir” i cili ia kishte marrë tokën, duhej që atë dhe familjen e tij ta ushqejë deri te korrja e re dhe duhej që me bagëtinë e vet t’i ndihmojë në punimin e tokës, atë tokë të njëjtë e cila shqiptarit i është grabitur. Me atë metodë të xhandarëve dhe të komisionit agrar bellorukas, kolonët në të vërtetë po bëhen bashibuzukë, ndërsa shqiptari rob i thjeshtë, i cili duhet vetëm të punojë, duke heshtur, ku përveç tatimit që duhej dhënë shtetit dhe komunës, duhet që gjysmën e bërëqetit t’ia japë kolonit, nëse nuk ia merr në tërësi. Toka në librat tatimore është e regjistruar pronë e shqiptarit dhe ata duhet ta paguajnë tatimin edhe për atë tokë, e cila i është marrë...”. Këtu pastaj jepen fakte për burgosjet, vrasjet e mbajtësve të familjeve, montimin e proceseve të ndryshme, gjobitjeve, maltretimeve, vrasjeve etj. e tërë kjo i ka detyruar ato familje, të cilat i shpallnin si kaçake, të uritura e të zbathura të marrin rrugën e mërgimit, duke ua lënë tokën kolonëve ardhacakë. Sipas kësaj, terrenin për shpërnguljen e shqiptarëve e përgatisnin organizatat terroriste “Bella ruka” dhe “Narodna Odbrana”.

Raporti i revistes “Vullneti” me titull “Qetësia e Kosovës” i vitit 1930, në të cilin, në mes tjerash theksohet, se po bëhet kolonizimi sistematik në këto treva me qëllim që të rritet përqindja e serbëve në 80% në të gjitha viset, e sidomos në ato kufitare. Kolonizohet eksklusivisht elementi serb në atë mënyrë që të krijohet penda në mes të shqiptarëve dhe shtetit.¹⁰⁵

Naçellniku i rrethit të Zveçanit - Kujunxhiq, në vitin 1930 lavdërohet se gjatë shërbimit të tij janë shpërngulur në Azi, prej nga nuk do të kthehen më, më se 32.000 shqiptarë të rrezikshëm për shtetin, ndërsa tokën e vet ua kanë shitur me çmime shumë të ulëta kolonëve malazezë dhe vendësve, kurse 6.000 të tjerë kanë vajtur në Shqipëri.¹⁰⁶

Sekretarit gjeneral të Shoqatës të Kombeve në Gjenevë i dërgojnë peticione edhe atdheadashës të tjerë, por më i njohur prej tyre pa dyshim është ai i datës 5.V.1930, i dërguar nga

¹⁰⁵ AJ B, Centralni Press Biro, 38-28.

¹⁰⁶ AJ B, “Dvor”, 74, k. 56, gr. 77.

tre priftërinjtë shqiptarë: dom Gjon Bisaku, dom Shtjefën Kurti nga Prizreni dhe dom Luigj Gashi nga Shkupi. Në peticionin e tyre, në mes të tjerash, thuhet se qëllimi i pushtetit është që me çdo kusht ta ndryshojë karakterin etnik të viseve, ku jetojnë shqiptarët, duke mos zgjedhur mjete për arritjen e qëllimit të shpërnguljes së tyre në Turqi, në Shqipëri dhe në vende të tjera, siç ishin përdorimi i mjeteve të dhunës, djegia e shtëpive dhe e fshatrave, vrasjet, plaçkitjet, maltretimet, dënimet etj. Vrasjet masive të shkaktuara për shkaqe më të vogla mbi njerëzit e pafajshëm, faj i vetëm i të cilëve ishte pse ishin shqiptarë. Therrja në Dumnicë (rrethi i Vushtrrisë) më 10 shkurt 1924 - masakri mbi 25 shqiptarë (prej tyre 10 gra, 8 fëmijë nën 8 vjeç, 7 burra mbi 50 vjeç) Pra, për këtë krim askush nuk është dënuar. Djegia e Rugovës. Në dokument përkitazi me dëbimin e shqiptarëve, kolonizimin e Kosovës me elementin sllavë thuhej: *“Shpërngulja në Shqipëri nuk shikohet me sy të mirë. Qeveria jugosllave ka interes të plot, që të gjithë të ndjekurit dhe të plaçkiturit t’i shoh të vendosur sa më larg kufirit të vet. Për këtë shkak u shkaktohen njëmijë fatkeqësi atyre njerëzve, që dëshirojnë të shkojnë te të afërmit e tyre në Shqipëri”*..... *“Në fshatin prej nga shpërngulën shqiptarët dhe në pronat e tyre të konfiskuara dhe të ekspropriuara po sillen malazezët dhe sllavët nga Bosnja, Sremi e Banati. Ata po vendosën me qëllim të ndërrimit të pamjes etnografike të Krahinës. Shartime të ngjashme po bëhen pak a shumë çdokund dhe ky proces po vazhdon me forca të shtuara.. Ka ndodhur që banorët me prejardhje shqiptare, që janë larguar përkohësisht nga vatrat e tyre, kur janë kthyer i kanë gjetur në to sllavët”*.... *“Viktimat e të ashtuquajturës, reformës agrare janë të shumta. Popullsia shqiptare po i shkaktohen vështirësi të mëdha. Për qytetarët, që kanë kryer shërbimin ushtarak, reforma parasheh që të mbajë nga 5 ha tokë të punuar për kokë. Familjet shqiptare, që e kanë ruajtur formën patriarkale, të përbëra prej 6-10 anëtarë, do të kishin të drejtë në 30-50 ha. Mirëpo sot nuk ka asnjë familje shqiptare në territorin e Jugosllavisë, që kanë pronë të këtillë. Shqiptarëve, madje u janë ekspropriuar edhe pronat prej një hektari.*¹⁰⁷ Ata në peticion theksojnë se deri në këtë kohë kanë migruar më se 10.000 emigrantë të pafat në Shqipëri dhe 130.000 në Turqi, ndërsa Qeveria e Beogradit dhe e Angorës po bëjnë marrëveshje për dëbimin e 300.000 - 400.000 shqiptarëve nga Kosova, në tokat e të cilëve do të sillen malazezët dhe boshnjakët. Si mjet më efikas për t’i detyruar shqiptarët që të shpërngulen ishte shpronësimi i pronave të tyre pa kurrfarë kompensimi. Qeveria serbe është munduar që me makinacione e rrena të ndryshme t’i mohojë dëshmitë e pamohueshme të këtyre tre priftërinjve dhe të tjerëve.

Dëshmi të shumta ndriçojnë se toka u merrej në tërësi familjeve shqiptare bujqësore, e u jepej atyre, që nuk merren me bujqësi. P.sh në një raport të Konsullit të Përgjithshëm të Mbretërisë Shqiptare në Shkup, nr. 320.C.III, datë 8.VIII.1930 thuhet: është marrë toka e Sokol Hajdarit nga Janoshi i Gjakovës, i cili ka mbetur në rrugë me 30 anëtarë të familjes dhe i është dhënë sekretarit të Bashkësisë së Gjakovës, malazezit Jovo Joksiq. Është marrë toka nga disa fshatarë të fshatit Nec të Gjakovës dhe i është dhënë anëtarit të bashkësisë Boko Tomoviq dhe drejtorit të shkollës fillore në Gjakovë Vojiq Tomoviq. Këta tokën në fjalë, e përdorin si çiflig dhe të zotët e tokës - shqiptarët i përdorin si bujq. Marrja e tokës edhe të familjeve të tjera si në Cërmjan, Bec etj.¹⁰⁸

Viti 1931

Në një dokument në formë broshure me titull: *“Tërë Shqipëria e të gjithë shqiptarëve”*, botuar në Romë më 1931, për të cilin njofton Gjeneralshtabi kryesor i Armatës në Beograd,

¹⁰⁷ DA SSIP, DNZH, f.13, d.1; AVIII B, k27, f.1, d.20, rez. Dj.,ob.b. 17.013, Beograd, 23.VIII 1930.

¹⁰⁸ Arkivi Qëndror i Shqipërisë, dok. nr. 320 C.III, 8.08.1930, F. “Komiteti i Kosovës”, Mikrofilm në Arkivin e Kosovës.

theksohet se po bëhet shpronësimi i tokës në masë, sidomos rreth kufirit, ku jetojnë shqiptarët, në mënyrë që të lirohen trojet për fshatarë serbë dhe kolonë.

Zbatimi i këtij shpronësimi po bëhet në mënyrë barbare dhe me dhunë. Fshatarët serbë në mënyrë të thjeshtë dhe të padrejtë po e marrin tokën, e cila është rrëmbyer nga shqiptarët. Shqiptarët kanë rënë në mjerim, po shpërngulen në Amerikë ose në Mbretërinë e Shqipërisë. Për këtë, siç thuhet në dokument, Hasan Prishtina i drejtohet kryetarit të Shoqatës së Kombeve, ku e paditë regjimin e terrorit, sepse shqiptarët me forcë po dëbohen nga vatrat e tyre, ndërsa pronat e tyre po u jepen serbëve, malazezve dhe rusëve, të cilët po vendosen në këto vise si kolonë.¹⁰⁹

Viti 1932

Në një analizë të K. Kërstiqit, shef i Zyrës së Mbretit, drejtuar Drejtoratit suprem të reformës agrare në Shkup me 23 janar 1932, në mes tjerash përkitazi me marrjen e tokës thotë: Ajo është bërë ashtu që shqiptarët autoktonë për shkak të mosinformimit se toka i është marrë, e ka mbjellë dhe ka përjetuar që koloni t'i thotë: *Ndal, kjo është e imja*". Ose e ka thirrë pushteti agrar dhe i ka thënë: *"Dëgjo, ti, atë dhe atë arë e ke mbjellë në këtë vit, t'i për atë ke me paguar qiranë"*. Ekziston tokë pjellore, ku koloni nuk ka ardhur; atë tokë pushteti agrar e ka dhënë me qira dhe e kanë marrë atë; ka edhe tokë të pambjellë as nga shqiptarët e as nga kolonët, të cilët nuk kanë ardhur, kështu ajo ka mbetur djerrinë, e papunuar. Rastet në komunën e Vogovës dhe të Ponoshecit, ku vendësit e tërë fshatrave kanë mbetur pa asnjë hektar tokë. Rasti i Abdyl Tahirit nga Vogova, i cili ka 79 anëtarë të familjes dhe ka mbetur pa kurrfarë prone për jetesë. Ka raste, që vetë kolonët kanë treguar, që të gjitha familjet rreth shtëpisë i është marrë toka, kështu që tani për të hyrë në shtëpi duhej të kalonte nëpër pronën e kolonit.¹¹⁰

Shpesh si shpërblim në vend të honorarit, nëpunësve shtetërorë u jepej toka e kaçakëve. Një kolon në ankesën e vet drejtuar mbretit Aleksandër me datën 6.IX.1932, për shkak se ia kishin marrë tokën, sepse nuk ishte vendosur në të, thekson se ka pensionistë e nëpunës, që kanë marrë tokë nga shteti, të cilët jo vetëm që nuk po e punojnë, por edhe po e shesin. Edhe pasurinë e mëparshme në trevat e vendlindjes e kanë shitur. Kështu, p.sh. një kolone nga Peja me 10 janar 1927, në ankesën e saj në mes tjerash thekson se tërë pasurinë e prindërve, të cilën e ka pasur në rrethin e Kollashinit, e ka shitur për 60.000 din.¹¹¹

Viti 1933

Në dokumente ka shumë të dhëna për sipërfaqe të mëdha të tokës që iu është dhënë kolonëve. Kështu koloni Bojan Zoriq, I vendosur në Lipovec të Gjakovës, deklaroi në mes tjerash, se kishte marrë 29 ha tokë.¹¹²

Viti 1934

Ekzistojnë dokumente të shumta për ankesat e fshatarëve shqiptarë lidhur me marrjen e tokës, pastaj të korrave verore nga ana e pushtetit dhe të kolonëve. Ata ankoheshin, por kujt, kishte raste kur edhe dënoheshin. P.sh. Me datën 19.IX.1934, një kolon nga Kushnini i Hasit e paditë Rexhë Sylën se ai e ka mbjellë dhe punuar tokën dhe nuk po e lejon ta punojë ai. Syla deklaroi në polici se prona e tij ishte e madhe, ia kanë marrë 2/3 e tokës dhe u kanë dhënë kolonëve. I kanë lënë vetëm pak tokë. I është ankuar organeve më të larta, por nuk ka marrë përgjigje, dhe se i ka 14 anëtarë të familjes dhe do të mbetet pa bukë. Gjyqi i Rrethit të Prizrenit

¹⁰⁹ AVII B. P.17, K. 95.a, f.8, d.1.

¹¹⁰ AJ B, "Dvor", 74, k. 56, gr. 77.

¹¹¹ AJ B, "Dvor", 74, k. 56, gr. 77.

¹¹² AK, Gjyqi i Rrethit Prizren, K.4-Kps-10-1934.

e shpall fajtor R. Sylën, e dënon atë me 300 din. dhe e detyron që ta kthej pronën kontestuese, sipërfaqën prej 6,92 ha dhe shtëpinë.¹¹³

Me qëllim që në vitin 1934 të nxitet shpërngulja dhe të intensifi-kohet edhe më tutje kolonizimi, Ministria e Bujqësisë e Mbretërisë jugosllave, nëpërmjet Bankës hipotekare kishte lidhur kontratën në shumë prej 15.000.000 din. me qëllim të blerjes së tokave private në Kosovë. Kjo Ministri kërkon që të organizohet shërbimi te drejtoratet e Banovinës për dhënien e pasaportave pa pagesë për ata të cilët e shesin tokën dhe shpërngulen jashtë shtetit, ndërsa Ministria e Ushtrisë dhe e Marinës që t'i lëshojë para kohe të gjithë ushtarët e familjeve, të cilat shpërngulen jashtë shtetit.¹¹⁴

Viti 1935

Në konferencën ndërministrorë përkitazi me shpërnguljen e popullatës me prejardhje josllave nga e ashtuquajtura Serbi Jugore, të mbajtur me datën 1 tetor 1935, në Beograd në Ministrinë e Punëve të Jashtme u diskutua edhe për angazhimin rreth shpërnguljes së shqiptarëve, lidhjes së një marrëveshjeje me Turqinë etj. Në këtë Konferencë u nxorën këto konkluzione:¹¹⁵

1. Shpërngulja duhet të rregullohet sa më parë me konventë speciale me Turqinë dhe Shqipërinë;

2. Nëse me Shqipërinë nuk mund të lidhet marrëveshja dhe shtetasit tanë nuk dëshirojnë të shpërngulen në Turqi duhet bërë këtë:

- a. shpërnguljen graduale të popullatës me prejardhje shqiptare e turke nga zona kufitare në brendësi dhe të kolonizohet ai vend me popullatë të nacionalitetit jugosllav;

- b. këmbimi i popullsisë me Shqipërinë.

3. T'i bëhen lehtësime popullsisë, e cila shpërngulet, si trans-porti, dhënia e pasaportave pa pagesë, lirimi nga taksat, rekrutimi;

4. Të pamundësohet edhe të pengohet propaganda kundër shpërnguljes;

5. Zbatimi i rreptë i të gjitha dispozitave mbi kolonizimin e viseve jugore, dhe

6. Nacionalizimi i emrave gjeografikë.

Përveç këtyre dhe shumë formave të tjera, përkitazi me shpërnguljen e shqiptarëve ndërmjet Mbretërisë së Jugosllavisë dhe Repub-likës së Turqisë në vitin 1938 ishte lidhur konventa e njohur famëkeqe. Si organ ishte formuar Komiteti për Shpërngulje, në kuadrin e të cilit funksiononte Inspektorati Suprem për Shpërngulje me seli në Shkup, si dhe inspektoratet lëvizëse. Këta të fundit kishin për detyrë të caktonin terrenin për kolonizim me elementin sllav, përkatësisht t'u jepnin urdhra për shpërngulje të shqiptarëve. Qeveria jugosllave nuk dëshironte që shqiptarët të shpërngulen në Shqipëri, për shkak të rritjes së numrit të banorëve në Shqipëri dhe hyrjes në të të një elementi, i cili ishte i disponuar armiqësisht ndaj serbëve. Ajo dëshironte që shqiptarët të vendosën sa më larg vendlindjes, në shkretëtirat e Anadollit, duke mos pasur kështu kurrfarë kontakti me vendlindjen dhe duke mos mundur të kthehen kurrë më në atdheun e vet. Po ashtu, edhe qeverisë turke i konvenonte vendosja e shqiptarëve në kufi me kurdët rreth kufirit me Irakun dhe Iranin. Kjo ndikon që nxjerrja e vizave për pasaporta për në Turqi të bëhej për dy ditë, ndërsa ato për Shqipëri për dy muaj apo hiq.¹¹⁶ Këtë e dëshmojnë dokumentet e shumta, të ruajtura në arkivat e ndryshme.

Viti 1936

¹¹³ AK P, F. Gjyqi i Rrethit Prizren, K.4, KPS-303-1936.

¹¹⁴ AJ B., Min. Poljoprivrede, 67, k. 28, gr. 256.

¹¹⁵ AJ B, Min. Poljoprivrede, 67, k.1, f. 17.

¹¹⁶ AQSH T, "Komiteti i Kosovës", Mf. AK.

Stacioni i xhandarmërisë në Landovicë të Prizrenit me shkresën nr. 680, datë 7.VI.1936 e njofton Prefektin e Rrethit të Sharrit përkitazi më këtë: *“....Kolonët, të cilët e kanë marrë tokën në kompleksin “Tupec”, janë marrë në mbrojtje nga ana e këtij stacioni sa është e mundur. Mirëpo, shumica e këtyre kolonëve ia kanë dhënë tokën shqiptarëve që edhe më tutje t’ua punojnë përgjysmë me marrëveshje të ndryshme, ndërsa disa sish gjenden nëpër Serbi dhe Mal të Zi, në shtëpitë e tyre, në vend se ata vetë ta punojnë tokën që e kanë marrë. Pastaj, ka raste të tilla që disa nuk ishin personalisht të pranishëm me rastin e dhënies së tokës, kështu që madje, nuk dinë as mezhdat e vërteta të parcelave të veta...”*¹¹⁷

Pastaj shumë dokumente dëshmojnë se shqiptarët tokën e vet që i është marrë, duke mos pasur tjetër detyroheshin ta marrin dhe ta punojnë me qesim ose përgjysmë, si p.sh. Shaqir Xhemaili nga Pirana,¹¹⁸ Nik Prenku nga Dedaj¹¹⁹ e shumë të tjerë. Janë paraqitur raste gjatë kufizimit, ku janë marrë edhe frytet nga toka e kufizuar, kështu që ajo popullatë e varfër ka mbetur edhe pa mjete më elementare për jetesë. Marrja e tokës është dashur të bëhet në fund të vitit ekonomik, pas vjeljes së fryteve. Përkitazi me këtë shumë veta nuk kanë bërë ankese për shkak se nuk kanë ditur dhe se ishin të varfër.¹²⁰

Në Beograd disa herë kanë shkuar delegacione të ndryshme shqiptare nga Kosova - persona me autoritet, patriotë etj., ku kanë kërkuar intervenimin e qeverisë që të mos u merret toka shqiptarëve dhe që të mos shpërngulen shqiptarët. Por kujt t’i ankohej, kur vetë qeveria ishte organizatore dhe qëndronte pas tërësaj. Edhe disa deputetë në parlamentin mbretëror, disa herë kishin kërkuar intervenimin e qeverisë, por kot. Kështu, p.sh. Mustafë Derguti, deputet popullor i rrethit të Anadrinit, në parashtresën e vet të datës 19.IX.1936, ankohet për marrjen e tokës pjellore fshatarëve shqiptarë dhe ndarjen e saj kolonëve. Thekson se atyre u lihet edhe më pak se 0,40 ha për anëtarë të familjes, edhe ajo tokë e dobët, pyll, e paçelur dhe tokë jopjellore.¹²¹

Gruaja shqiptare ka bërë rezistencë edhe ndaj marrjes së tokës dhe të shtëpisë popullatës shqiptare nga të ashtuquajturat komisionet agrare dhe nga xhandarmëria. Këshu, p.sh. më 29 nëntor 1936, në fshatin Budrikë e Poshtme, xhandarmëria serbe vjen në fshat për ta marrë shtëpinë e familjes Musliu dhe t’ia dorëzojë kolonit Jovan Dishlakoviqit. Të gjithë anëtarët e familjes e kundërshtojnë këtë, por xhandarmëria i lidhë ata, ndërsa e bija e tyre Havushja, arrinë që të godas me dru nëpunësin policor të rrethit të Gjilanit Petar Kavadarin.¹²²

Viti 1937

Në “Elaboratin mbi Shqiptarët”, botuar më 1937, autori serb Ivo Vukotiq, shkruan: “Në kombinimet tona politike dhe diplomatike dhe në politikën tonë ballkanike, gjithmonë kemi synuar, të menjanojmë, të gjitha kërkesat shqiptare, për krijimin e shtetit të pavarur, nga arsyeja e thjeshtë se ky shtet do të mund të krijohet vetëm kundër nesh dhe kundër aspiratave tona kombëtare. Shqipëria, për vetë shtrirjen e saj gjeografike është pengesë e zhvillimit ekonomik të Jugosllavisë”.

Me rëndësi është të paraqitet edhe një letër konfidenciale e Mirko Protiqit, kryetar i Bashkisë së Pejës, drejtuar njëfarë Miliqit, kryetar i një bashkie në rrethin e Prizrenit, për nxitjen e lëvizjes çetnike serbe kundër shqiptarëve dhe malazezëve, më 22 gusht 1937, Pejë: *“.... Më në fund arritëm me ndihmën e zotit dhe Beogradit të kemi kryetarë në katër komunat fshatare të*

¹¹⁷ Arkivi i Kosovës, Prishtinë, F. Gjyqi i Rrethit Prizren, k.3, KPS-303-1936.

¹¹⁸ AK P, F. Gjyqi i Rrethit Prizren, K.3, KPS-303-1936.

¹¹⁹ AK P, F. Gjyqi i Rrethit Prizren, K.4, KPS-356-1936.

¹²⁰ AJ B, F. M. Stojadinovic, 37, f. 22. dok. i datës 12.09.1938.

¹²¹ AJ B, M. Stojadinovic, 37, f.4.

¹²² Dr. Jusuf Osmani, Lënda arkivore, v. e c., fq. 179.

këtij rrethi, serbët tonë “vendas”, me njerëzit e tyre, madje edhe kryetarin e bashkisë së qytetit të Pejës. Në qoftë se do të tregohemi të shkathët, me ndihmën e serbëve të një mendimi me ne, do të mundim që tërë turqit (shqiptarët J.O) t’i dëbojmë ose ti pagëzojmë të krishterë. Malazezëve duhet t’ua bëjmë jetën të pamundur dhe t’i detyrojmë të kthehen në strofkat e tyre të kusarëve, pastaj do të kemi deputetët dhe senatorin tonë. Kur t’i kryejmë këto deri në fund, atëherë do të jemi çliruar përgjithmonë dhe do të jemi hakmarrë me ta.

Programi jonë është: 1. Të hiqet nga rendi i ditës Sefedin beu, i cili mban mbi kurriz dhe shpëton turqit, në këtë mënyrë nuk do të ket asnjë myslimanë të aftë që ta zëvendësojë; 2. Të theksohet dhe të punohet gjallërisht për spastrimin e shqiptarëve 30 km në brendësi, përgjatë gjithë kufirit. Këta të dëbohen në Turqi e në Shqipëri. Në këtë rast Peja, Gjakova dhe Prizreni do të spastrohen përgjithmonë nga jo të krishterët. Për këtë po punohet tani. Në këtë rast në na jepet satisfaksioni i plotë në ndërrimin e robërisë; 3. Gjenerali Veshoviq të dëbohet nga Peja së bashku me njerëzit e Vasojeviqit, të cilët janë malazefilët më të hidhur dhe që shoqërohen shumë me shqiptarët, sigurisht për shkak të bashkimit Mali i Zi – Shqipëri lidhur me synimet e italianëve për të vendosur princin Mihajl si kral të këtij shteti të ri; 4. Të bojkotohen malazezët e turqit në të gjitha dyqanet e në vendet publike. Si të thuash këtë në Pejë e kemi arritur; 5. Kolonistët malazefë të kthehen nëpërmjet Kotorrit, andje nga kanë ardhur me gjysmë opinge kurse në vendet e tyre të dërgohen serbjanët; 6. Kur kjo të mbarojë, të ndahemi nga kisha e malazezëve, dhe kështu ne serbët (vendës) dhe serbjanët (të ardhur) t’i lutemi zotit veçant. Për këtë do të shërbente kisha e vjetër e Ruzhicës në Pejë, e cila gjatë kohës që kishim fuqinë shqiptarët u shndërrua në xhami, edhe sot është e tillë. Nëpër fshatra do të merremi vesh më vonë; 7. Të krijohet garda e njerëzve tonë të sigurtë, e cila, si çetnikët, do të kryejë detyrat e vëna për qëlimet e mësipërme, por sidomos gjatë zgjedhjeve etj.

Tashmë e din si i kemi rregulluar turqit në Beranë dhe kjo le të shërbejë si provë se jemi të fort në J.R.Z.

Duhet ta dish se malazezët janë tradhtarë, sepse kur në atë mënyrë të turpshme tradhëtua kralin e tyre dhe dinastinë që denjësisht i përfaqësoi serbët në Ballkan plot 207 vjet, atëherë ata janë të prirur për gjithçka dhe krejtësisht të pabesë, prandaj nuk mund të mosçuditemi përse ti je me ta.....¹²³

Sipas një raporti të diplomatit anglez R.T. Hon Anthonu Eden, Beograd, 8.XI 1937, nr. 216/101/4/37, në mes tjerash shkruan: Përkitazi me shpërnguljen dhe kolonizimin shumica e ish-popullatës turke (kryesisht shqiptare J.O) ka emigruar në Turqi dhe në vend të tyre janë vendosur kolonët nga veriu, kështu që minoriteti turk është i vogël, ndoshta jo më shumë se 100.000 banorë. Ndikimi mysliman ende është i madh për shkak të pranisë së numrit të madh të popullatës shqiptare, e cila sillet prej 600.000 – 800.000 veta, ku shumica prej tyre është e fesë myslimane. Ata kryesisht jetojnë në jug të Mitrovicës.¹²⁴

Në një afishe të Rinisë përparimtare të Kosovës dhe të Jugosllavisë, të marsit 1937, në mes tjerash thuhet: “Prej vitit 1918 shqiptarët në Jugosllavi u janë ekspozuar vrasjeve, djegieve së tërë fshatrave, dëbimit nga vendi; u grabiten shtëpitë, pasuria, kullotat dhe pyjet e fshati dhe ato fisnore. Shqiptarëve u ndalohej përdorimi i gjuhës amtare, u zhdukën doket e zakonet popullore. Pas të gjithave vijnë plaçkitjet e fejdexhinjve të bankave, si dhe plaçkitja në forma të tatimeve dhe kullukut. Zotërinjtë serbë, me qeverinë reaksionare Stojadinoviq - Koroshec - Spaho me të gjitha forcat punojnë në shkatërrimin e popullatës shqiptare, si bënë më parë

¹²³ AQSH, F. 251, viti 1938, dos. 107/1, f. 322-323; Marenglen Verli, Kosova në fokusin e historisë, 1, Tiranë, 200-2002, fq. 354-356.

¹²⁴ PRO, L. FO-371-211197; Dr. J. Osmani, Lënda arkivore ..., fq. 358.

qeveritë antipopullore, prandaj, në vend të lirive të premtuara kabineti i JRZ vazhdon terrorin dhe vrasjet masive të luftëtarëve popullorë. Në të gjitha plaçkitjet dhe goditjet me dhunë, shqiptarët bëjnë rezistencë heroike. Edhe pse gjithnjë të poshtëruar, të ndjekur me kundak dhe bajoneta, përsekutohen nga armiqtë përkatës, nga qeveria, ata me këmbngultësi vazhdojnë të rezistojnë.....”¹²⁵

Duke parë se kolonizimi me elementin sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve nuk po jep rezultatet e duhura, sipas dëshirës dhe mendimeve të qarqeve borgjeze sunduese, në këtë drejtim të gjitha ministritë shtetërore dhe organet tjera, u angazhuan edhe më tepër. Në këtë drejtim u angazhua edhe Klubi Kulturor serb, i cili bëri plane dhe hartoi elaborate se si të zbatohet me sukses kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi e në Shqipëri. Po i paraqesim disa nga ato:

Në elaboratin voluminoz të Vasa Çubrilloviqit, me titull “Shpërngulja e Shqiptarëve” i 7 marsit 1937, veçojmë: “Shqiptarët nuk është e mundur t’i thyesh vetëm me kolonizim gradual; ky është i vetmi popull që arriti në këto një mijë vjet të fundit... të mbijetojë drejt bërthamës së shteti tonë... pse nuk patëm sukses nga viti 1912, ky është faj yni mbasi pushtetin nuk e shfrytëzuam si duhet. Mënyra e vetme dhe mjeti i vetëm, është dhuna brutale e një shteti të organizuar, në ç’drejtim ne prorre ishim përpara tyre”. “Përpos njerëzve të besueshëm këtë konflikt duhet përgatitur mirë; konflikti duhet të masivizohet, që të jetë më lehtë të shpjegohet se shqiptarët kanë ngritur krye, ndërsa gjithë gjendjen duhet paraqitur si një konflikt vëllazërie a fisi dhe sipas rastit t’i jepet edhe dimension i ekonomik. Në shkallë të fundit, mund të shkaktohet edhe kryengritje lokale, të cilat do të shuheshin me gjak dhe me mjete efikase, por jo gjithaq me ushtri, sa me kolonistë, fise malazeze dhe çetnikë. Mbetet edhe një mjet, të cilin Serbia në mënyrë shumë praktike e kishte përdorur pas vitit 1878: djegia e fshehtë e fshatrave shqiptare dhe të lagjeve të qyteteve...”. “Deri në fund të shfrytëzohen ligjet për t’ua bërë shqiptarëve jetën sa më të hidhur: gjrobat, arrestimet, zbatimet i pakufishëm i gjithë ndjekjeve policore, dënimi i kontrabandës, i prerjes së pyjeve, ndjekja për lëshimin e qenëve, detyrimi me angari dhe të gjitha mjetet tjera, që mund t’i ketë në dorë një polici..”. “Me rastin e krijimit të psikozës për shpërngulje, duhet bërë gjithë ç’është e mundshme të largohen fshatra të tëra, ose së paku familje të tëra. Duhet përdorur të gjitha mjetet për të penguar mbetjen e një pjese të familjes këtu...”. “Me rastin e krijimit të kolonive të reja, sa herë që i kërkon nevoja, duhet përdorur forca ushtarake...”. “.... duke ditur çfarë dëshirohet dhe duke mos kursyer as para as gjak, shteti ynë do të mund të bëjë që Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit të shndërrohen në Toplicë të re”...“politikën tonë të kolonizimit e munda pjelloria e grave shqiptare”¹²⁶

Lideri tjetër, Gjoka Perina në ligjëratën e vet me 16.VI.1937 - Propozon, që pasi kolonizimi i elementit serb nuk po mund të arrijë të jetë në shumicë në Vojvodinë dhe në Serbinë Jugore, të bëhet këmbimi i popullsisë në krahinat përkatëse, sepse “elementi i huaj do të zvogëlohet, ndërsa yni do të rritet”¹²⁷.

Në referatin e Drejtoratit Suprem të Lidhjes së Bashkësive Agrare në Shkup me titull “Për nevojën e zbatimit intensiv të kolonizimit të lirë në Serbinë Jugore”, shkruan, se: Përparësitë e kolonizimit të lirë ndaj kolonizimit shtetëror dhe zyrtar janë: vazhdimi i kontinuitetit në zbatimin e kolonizimit; mundësimi i kolonizimit në vendet, ku nuk ka tokë të lirë shtetërore, e sidomos në kufirin shqiptar; moskrijimi i pakënaqësisë ndër vendësit, krishterët

¹²⁵ AJ B, F. M. Stojadinovic, 37, k.40; Arhiv Istorijskog Instituta Crne Gore, dok. 8931.

¹²⁶ AVII B, Arhiv bivse jugoslovenske vojske, nr.2, f.4, k.69; AK P, XXVII/k.2-31-1937.

¹²⁷ AVII B, Arhiv bivse jugoslovenske vojske, nr.4, f.4, k.69; AJ B, F. Jovan J. Pizhon, 8, k.55; AKK. XXVII/K.2-29-1937.

dhe myslimanët; blerja dhe oferta gati eksklusivisht nga myslimanët; kolonizimi në tokat e punuara, të cilat menjëherë mund të punohen dhe të shfrytëzohen; vendosja menjëherë pas blerjes, pasi që ekzistojnë ndërtesat, ofrimi i stabilitetit, dëshirës dhe sigurimit të kolonëve; vendosja e lehtë e personave të shkolluar në disa koloni; zgjedhja e vendit për kolonizim etj. Sigurimi i mjeteve të nevojshme për zbatimin e këtij kolonizimi. Ky kolonizim do të shkaktonte shpërnguljen e popullatës myslimane pa pasoja dhe pa jehonë, meqenëse kjo llogaritet si iniciativë private. Ai propozon, se në aspektin e kolonizimit në Serbinë Jugore duhet punuar mjaft. Këtë e kërkojnë në mënyrë imperative interesat ekonomike e nacionale dhe se për këtë aksion nuk duhet të ankohen mjetet, sepse ato triherë ia kthen popullit dhe shtetit.¹²⁸

Viti 1938

Orestije Kërstiq në ligjëratën e vet me 4 prill 1938, në Klubin Kulturor Serb, në mes tjerash shkruan: *“Lufta për tokë në Serbinë Jugore - është luftë nacionale - ekonomike, e jo thjesht këmbim me të mira. Konflikti i dy elementeve nacionale “ne dhe shqiptarët”. Pushtimi i maleve nga shqiptarët si fise të ilirëve të vjetër”*. Propozon vazhdimin e kolonizimit dhe ndihma kolonëve, vendosjen e familjeve të nacionalitetit serbë në fshatrat e pastra shqiptare.¹²⁹ Në referatin tjetër të Klubit kulturor serb të datës 16 maj 1938, thuhet: Ndërmarrja e masave që elementi shqiptar të bëhet i parrezikshëm, të shpërngulet në Shqipëri ose në Turqi, ose blerja e pronave të tyre dhe dhënia *“elementit tonë nacional”* dhe kështu të detyrohen të shpërngulen. Pastaj thuhet: *“nëse çështja shqiptare te ne nuk zgjidhet në mënyrë diplomatike, d.m.th. me shpërngulje, ajo do të zgjidhet me kolonizimin e mëtejshëm, atëherë duhet ditur, që për atë duhet kolonizuar një numër të madh të popullatës sonë, që të arrihet superioteti i madh ndaj shqiptarëve”*.¹³⁰

Në afishën e studentëve të Kosovës, të muajit qershor 1938, në mes tjerash thuhet: *“Shqiptarë - Policët, xhandarët dhe spiunët janë bërë të pafrenueshëm në pronat dhe jetën tuaj, trefish ua marrin tatimin, ju plaçkisin, ju rrahin dhe ju vrasin. Për të gjitha këto krime askujt nga ata zullumqarë nuk u ka rënë asnjë fije floku nga koka, por, madje, për këtë marrin shpërblime dhe dekorata...”*.¹³¹

Legata britanike nga Durrësi, më 27.VI 1938, njohton për çështjen shqiptare, se është duke u folur me të madhe prej vitit 1936-37 për një marrëveshje në mes të Turqisë dhe Jugosllavisë për shpërnguljen e madhe të shqiptarëve myslimanë prej Kosove në Turqi. Dështim i marrëveshjes së vitit 1936 për transferimin e 50.000 shqiptarëve kosovarë në Shqipëri. Mendimi i diplomatit britanik së marrëveshja në mes të Turqisë dhe Jugosllavisë vështirë do të realizohet. Deklarimi i një diplomati turk se Ministria shqiptare lejon shkuarjen në Turqi vetëm të kosovarëve. Konstatimi se numri i vërtetë i turqve këtu është shumë i vogël. Marrëveshja turko-jugosllave për shpërngulje të 250.000 – 300.000 personave, madje sipas një shkrimi edhe të 480.000 vetash. Konstatimi se ky numër aq i madh për shpërngulje të kosovarëve nuk mund t’i takojë kombësisë turke, por ato duhet t’i takojnë asaj shqiptare. Deklarimi i Ekrem Libohovës së gjuhën turke siç e flasin edhe gjuhën shqipe, e flasin një numër i vogël i banorëve të qyteteve, se popullata nuk ka dëshirë të shpërngulet në Turqi, sepse, nëse shkojnë, atje do të bëjnë një jetë mizore....¹³²

¹²⁸ AVII B, Arhiv bivse jugosl. vojske, nr. 7, f. 4, k. 69.

¹²⁹ AVII B, Arhiv bivse jugosl. vojske, nr. 3, f. 4, k. 69.

¹³⁰ AVII B, Arhiv bivse jugosl. vojske, nr. 1, f. 4, k. 69.

¹³¹ AJ B, F. M. Stojadinovic, 37, f.29.

¹³² PRO, L. FO-371-22305; Dr. Lënda arkivore, fq. 360.

Në një ankesë të datës 27.VII 1938, flitet se, organet e pushtetit në forma të ndryshme merrnin pronat shqiptare pa kurrfarë kompensimi. Por, nëse e jepnin ate e bënë në sasi jo të mjaftueshme dhe në vendet jopjellore dhe që duhej çelur tokën. Pushteti agrar u bënte të pamundshme punonjësve nga një anë të gjejnë dokumente, me të cilat do të dëshmonin bazën e pronësisë së saj, ndërsa në anë tjetër po ai pushtet kërkonte që t'i paraqesin ato dokumente, nxjerrjen e të cilave ata e bënë të pamundshëm.¹³³

Ministri i komunikacionit dr. Spaho kishte marrë shumë ankesa nga shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë. Ai për këtë e njofton kryetarin e qeverisë M. Stojadinović, kështu në shkresën e datës 29.VII 1938 shkruan: *“Puna e tanishme e pushtetit agrar në Serbinë Jugore është në kundërshtim me dispozitat ekzistuese ligjore dhe tërë rendit juridik. Kjo dhunë që po bëhet ndaj myslimanëve në Serbinë Jugore ka jehonë mjaft të pavoritshme edhe te ne në Bosnje. Bota po pyet, pse po bëhet kjo vetëm kundër shqiptarëve, dhe pse nuk po bëhet, p.sh. ndaj hungarezëve, të cilët janë në të njëjtën pozitë sikurse shqiptarët. Nuk ka shembull në botë që me reformën agrare t'u merret toka bujqëve”*.¹³⁴

Kolonët serbë, që merrnin tokën ishin të liruar nga tatimi. Ndërsa, shqiptarët ishin të detyruar që të paguajnë taksat për 5 vjet për tokat shqiptare të marrë para 3-4 viteve. Duke mos pasur të holla për t'i bërë ballë pagesave autoritet, jugosllave i nxirrnin rrobat në mënyrë arbitrare e të çuditshme në ankand, i shisnin me çmime të lira si edhe teshat e nuseve.¹³⁵ Në një referat të një deputetit T. Diniq, të marsit 1938 - në mes tjerash shkruan: Ngarkimi me tatim në mënyrë jo të drejtë. Pagesa e tatimit edhe për tokën, të cilën shteti e ka marrë. Dhënia me qesim e tokës për të cilën paguajnë tatimin. Shkatërrimi sistematik i bujqve, nga shtëpiaku krijohen persona pa strehë dhe proletarë. Shkatërrimi i amvisnive shtëpiake. Pasojë e një pune të tillë është që bujku po ik nga toka, shtëpiaku po shndërrohet në proletar dhe punëtorë të vrazhdë të papunë.¹³⁶

Nga dosja *“Pakica shqiptare”* dhe *“Kolonizimi”* i Shtabit të Territorit të Armatës III, sek.gj.ob.r. 1859/1938, në mes tjerash i shkruan Prefektit të Gjeneralstabit Kryesor, i propozon masat, sipas tyre efikase, për zbatimin e kolonizimit dhe të shpërnguljes së shqiptarëve, siç ishin: që në viset kompakte shqiptare në Kosovë të vendosen së paku 50% të kolonëve serbë në mënyrë që të shthuret masa kompakte shqiptare, të formohen garnizone të reja ushtarake, sidomos nga zona kufitare, ndërsa elementi turk të shpërngulet vetëm sa të mund të zbatohet shpërngulja e shqiptarëve, të zbatohet kolonizimi, sidomos në zonë kufitare; dëbimi i të gjithë emigrantëve politikë; në viset e pastra shqiptare, të mos kërkohet që fëmijët të shkojnë në shkollë, d.m.th. të mos arsimohen, të mos mbahen, kurse të arsimimit fizik për të rinjë dhe mos të përgatiten të rinjtë para kohe për luftëtarë. Përveç kësaj, sidomos duhet të shpërngulet elementi fshatar në mënyrë që të fitohet toka e lirë për kolonizim.¹³⁷ Ndërsa, në shkresën tjetër rez.gj.o.nr.3550/1938 që i shkruan Ministrit të ushtrisë dhe marinës thekson: Nevoja për krijimin e garnizoneve të reja në Rahovec, Suharekë, Podjevë, Vushtrri, Gjilan si mbështetje për shkatërrimin e masave kompakte shqiptare dhe sigurimin e kolonizimit në këto vise. Dihet se ekziston Konventa sipas së cilës një numër i madh i familjeve, të cilat nuk i takojnë popullatës serbe do të shpërngulen para së gjithash nga zona kufitare në largësi që kap 50 km. Pastaj, në mes tjerash paraqet edhe këtë: *“Për pushtimin definitiv të këtyre viseve në aspektin nacional është e nevojshme, siç u tha*

¹³³ AJ B, F. M. Stojadinovic, 37, f. 22.

¹³⁴ AJ B, F. Milan Stojadinovic, 37, f. 222.

¹³⁵ AQSH T, “Komiteti i Kosovës”, dok. nr. 333, E. V., Sek. 27.08.1930.

¹³⁶ AJ B., F. M. Stojadinovic, 37, f. 39,

¹³⁷ AVII B, P.17, k. 26, f.3, d.40.

nga paraqitja e mëparshme, kolonizimi sa më i afërt i elementit tonë të shëndoshë pranë shpërnguljes së shkallëshkallshme të popullatës shqiptare. Nëse ky kolonizim nuk zbatohet në kohë sa më të shkurtër dhe në mënyrë sa më racionale, ekziston rreziku, që ajo në një kohë të ardhshme për shkak të shtimit të madh vjetor të elementit shqiptar do të bëhet e pamundshme. Kolonizimi efikas në vendbanimet e pastra shqiptare mund të mbështetë-tet vetëm në garnizonet e propozuara të formuara në Territorin e Divizionit të Kosovës”.¹³⁸

Në një dokument arkivor, në të cilin po e paraqesim në formë faksimili - Elaborat të inspektorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 23 dhjetor 1938, me titull “*Problemet dhe metodat e shpërnguljes së shqiptarëve nga Serbia Jugore për Turqi në vitin 1939*”, paraqiten dispozitat ligjore, metodat e zbatimit dhe mjetet. Në këtë elaborat është paraqitur sasia e tokës që iu është dhënë kolonëve, si: 5 ha për familje, nga një ha për fëmijë meshkull, nga 2 ha fëmijë meshkull 16-20 vjeçar, ata më të vjetër, të pamartuar edhe nga 3 ha, ndërsa të martuarve nga 4 ha. Iu është ndarë tokë si inventar deri në 2 ha, për pyllzim 2 ha iu është dhënë tokë edhe në rast të kualitetit të dobët deri 1/3 e tërë e tokës që i ka takuar. Ndërsa, pushteti agrar ka marrë nga shqiptarë dhe turqit, duke u lënë 0,40 ari për anëtar të familjes, nëse toka ishte e kualitetit të dobët deri në 1 ha. Toka tjetër e marrë iu është ndarë kolonëve. Mirëpo, duhet theksuar se edhe kjo nuk është zbatuar, kolonëve në forma të ndryshme iu është dhënë në sipërfaqe shumë më të madhe, ndërsa, shqiptarëve iu është marrë edhe pllëmba e fundit e tokës, siç thuhej “deri në prag të shtëpisë”. Në dokument për kolonizim thuhej: “*Kolonizimi duhet të vazhdojë, në radhë të parë nga trevat përgjatë kufirit me Shqipërinë, kështu që shpërnguljen e shqiptarëve dhe e*

¹³⁸ AVII B, P.17, k. 26, f.3, d. 40.

ПРОБЛЕМ И МЕТОДИ

исељавање Арнаута и Турака из Јужне Србије за Турску

I. Законски прописи (озакоњени и у изградњи)

II. Методи спровођења и

III. Средства

I. Законски прописи

По досадашњим прописима Аграрне реформе, сва слободна имања ограничавала су се и делила насељеницима. Додељивано је на старешину породице 5 хектара. На свако мушко дете до 16 година по 1 хектар, а на свако мушко дете преко 16-20 година 2 хектара, преко 20 година мушки нежењени у породици добијали су 3 хектара, а жењени 4 хектара. Давало се на инвентар до 2 хектара и за подумљавање 2 хектара; а давало се још и на слаб квалитет земље до 1/3 целокупне компетенције следовања.

Добровољцима - борцима 5 хектара, а неборцима 3 хектара а давао се и насељенички податак по Закону о насељавању. Ово је важило само за добросољце земљораднике.

У последње време вршиле су наше аграрне власти одузимање земљишта од Арнаута и Турака, остављали су 0,40 хари на члана породице оба пола, а ако је земља слабог квалитета онда им је остављено по 1 хектар и више на члана породице. Остало ограничено земљиште додељивано је насељеницима. Овај рад аграрних власти имао је великог ефекта и у моменту када су се Арнаут и Турци колебао и решавали на општу сербу, настали су избори који су челу ову акцију аграрних власти омели и бацили је у позадину.

Сама колонизација од Виђењева до данас подбацила је и даде је минус, како у Војводини тако и у Јужној Србији; док је колонизација у Италији - Абисинији дала позитивне резултате иако под много тежим околностима.

Закључена конвенција између наше Краљевине и Турске Републике, за иселавање Арнаута и Турака већ је парафирана, али парламенти о томе још нису решавали.

Покушаји од стране Албаније (пут Мехмеда Ковице, бив. Претседника Албанске владе, Србета Цалулија, албанског отправника послова у Анкари, немачких посланика у Тирани и Анкари), да се осујети примаме конвенције од стране Турске Републике

Faksimil nga dokumeti i poshtë shënuar (23 dhjetor 1938, Beograd)

turqëve duhet bërë në brendësi prej 80 km. Nëse merren familjet me numër të madh, me 10 dhe më shumë anëtarë, atëherë shifra do të ngritet nga 200.000 në mbi 300.000 anëtarë të familjesë dhe me atë do të arrihet sukses më i madh dhe me atë nevojave nacionale në këtë rast do t'u ofrohej mundësi më e madhe të realizimit ... Kjo shpërngulje nuk guxon të ndërpritet me asnjë kusht, por në të kundërtën të mundësohet forcimi i procedurës së tanishme të pushtetit agrar në të kufizimit dhe ndarjes së tokave dhe në shpërnguljen nga Serbia jugore. Nuk duhet hiqur nga mendja edhe atë se turqit dhe shqiptarët nuk dëshirojnë të shpërngulen. Ata mundohen të gjejnë

mënyra dhe rrugë që këtë ta pengojnë, por këtë nuk duhet ta lejojmë dhe të mbesim në gjysmë të rrugës, sepse këtë në mënyrë imperative e kërkojnë interesat e shtetit dhe kombit...”.¹³⁹

Në një dokument tjetër të Shtatmadhorisë Kryesore në Beograd, i vitit 1938, në mes të tjerash shkruan: *“Po vërehet dekurajim i madh i shqiptarëve për shkak të marrjes së tokës dhe po frikësohen se edhe toka tjetër do t’u merret dhe do të shpërngulën në Turqi. Versioni për shpërngulje i ka goditur mjaft. Në Turqi nuk po shkojnë, sepse besojnë se vendi, i cili iu ka dhënë për vendosje është i sëmurë dhe se për shkak të klimës së papërshtatshme të gjithë po vdesin”*.¹⁴⁰ Organet e pushte-tit, përveç metodave të dhunës e terrorit, të marrjes së tokës populla-tës shqiptare nëpërmjet reformës agrare dhe kolonizimit me element sllav, si formë për nxitjen e shpërnguljes, e përdori edhe propagandën dhe angazhoi edhe organizatat, shoqëritë nacional-shoveniste, agjencitë dhe agjentë të ndryshëm si dhe shumë persona vendës e kolonë, por kishte të përzierë edhe disa fanatikë të blerë me paratë e qeverive borgjeze. Tërë këta vepronin anembanë Kosovës dhe jasht saj. Në tërë këtë ishte i angazhuar edhe shërbimi informativ jugosllav. Të shpërngulurit më parë plaçkitëshin mirë nga aparati burokratik, avokatët e ndryshëm si dhe nga vetë agjencitë dhe agjentët. Lumi i të shpërngulurëve në këtë periudhë kryesisht shkonte në dy drejtime: nga Shkupi për në Selanik dhe më tutje në Turqi, kurse drejtimi tjetër drejt Sofjes.

Sherif Voca, duke diskutuar në parlament, në mes të tjerash, kishte thënë: *“Shqiptarët nuk po kërkojnë rrugë të asfaltuara, hekurudha, lidhje ajrore, nuk kërkojnë punë - shërbim, nuk shkojnë të lypin, nuk presin prej askujt pension dhe as t’i jap kush toka të huaja, ose me përgjysmë, por duan t’i punojnë tokat e veta. Për shqiptarët çdo qiell tjetër është i huaj. Ata dëshirojnë dhe do të jetojnë në tokën e tyre. Ata dëshirojnë të jetojnë në liri, me dinjitet dhe të kënaqur”*.¹⁴¹

Viti 1939

Në një afishe të Rinisë shqiptare, të qershorit 1939, në mes tjerash shkruan: *“..... Ju kanë marrë tokën të cilën me shekuj e keni punuar dhe me të cilën i keni ushqyer fëmijët tuaj. Politikisht të lënë anash, ekonomikisht të shterrur, në fushën kulturo-arsimore të lënë në terr dhe në padije, ju ishit ekspozuar terrorit të paparë. Kulminacionin e ndjekjeve shqiptarët e kanë përjetuar gjatë kohës trivjeçare të qeverisë antipopullore të JRZ të Millan Stojadinoviçit. Është shtuar marrja e tokës. Nën goditjen e njëfarë “agrari” është vënë toka në të cilën jeton fshatari shqiptar. Është hartuar Konventa me Republikën e Turqisë për shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve. Terror të paparë, keni përjetuar vitin e kaluar kur në çdo anë trumbetohej njëfarë “kryengritje” të shqiptarëve....”*.¹⁴²

Një delegacion prej rreth 50 shqiptarëve nga komuna e Shtimes dhe Kosinës para Shtabit të Armatës III në Shkup, ishin ankuar dhe kishin deklaruar: Se ankohen në pushtetin agrar, për shkak të marrjes së tokës në mënyrë joligjore, e cila nuk është beglere, por tokë e punueshme e varfanjakëve, pronë e trashëguar nga pararadhësit, se për të paguajnë tatimin dhe kanë tapitë turke. Toka nuk është utrinë, e as pronë e fshatit, por e individëve. Se kufizimi me dhunë është bërë gjatë ditës së Shën Mitrit të vitit 1939 nga ana e xhandarëve, pa praninë e pronarëve.¹⁴³

Viti 1940

¹³⁹ Arkivi i Kosovës, Prishtinë, Kolesioni: Kolonizimi dhe reforma agrare. Dokument i paregjistruar, i dt. 23 dhjetor 1938, Beograd.

¹⁴⁰ AVII B, P.17, K. 94, f.1, d.5, rez. 8261/1938.

¹⁴¹ Sluzbene Novine Narodne Skupstine KJ, 14.03.1938.

¹⁴² AVII B., P.17, K. 26, f. 2, d. 47.

¹⁴³ AVII B, P.17, k.519, f.7, d.46.

Në një raport nr. 57, datë 25.VII 1940, në mes tjerash thuhet se - shqiptarët nuk do të ankoheshin nëse u lehej 40 ari për anëtarë të familjes, por që ajo tokë të jetë e punueshme, e jo rrah dhe pyll.¹⁴⁴

Ekzistojnë edhe shumë burime të tjera që dëshmojnë për marrjen e tokës, kolonizimin dhe detyrimin e popullatës nga presioni e dhuna të migrojnë nga atdheu, si p.sh. Elaborati i Ivo Andriqit, më 1 janar 1939. Ky akademik, zgjidhjen definitive të çështjes së Kosovës e sheh duke e ndarë Shqipërinë në dy pjesë: njërën pjesë duhej ta pushtonte Italia, kurse pjesën tjetër, sipas Andriqit, duhej ta pushtonte Jugosllavia.

7. PLANET SERBE PËR SPASTRIMIN ETNIK DHE KOLONIZIMIN E KOSOVËS GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore e ndërpreu procesin e koloni-zimit të Kosovës me elementin sllav. Pjesa dërmuese e shqiptarëve, hyrjen e gjermanëve dhe të italianëve në Kosovë e morën si lehtësim, duke thënë më parë gjatë sundimit të Mbretërisë jugosllave se “*edhe dreqi i zi le të vijë, veç serbi jo*”. Pas hyrjes së ushtrive gjermane e italiane, në vitin 1941, Kosova u nda nga forcat italiane, gjermane dhe bullgare. Pushteti fashist, duke shfrytëzuar gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptarë në Mbretërinë jugosllave, u përpoq të tërhiqte nga ana e tyre atë, duke përdorur gjithë demagogjinë dhe propagandën e vetë. Ata arritën deri në atë shkallë sa të paraqitnin veten si çlirimtarë të popullit shqiptarë. Kjo ishte edhe e arsyeshme, për këto arsye se fashistët italian e ndërpreu shtypjen e egër dhe terrorin pushtetar serb ndaj popullsisë shqiptare, u dha shqiptarëve lirinë e gjuhës dhe hapjen e shkollave shipe, popullsisë iu kthyen tokat që u kishin marrë nga reforma agrare dhe të tjera.¹⁴⁵

Nga frika e hakmarrjes, në gjysmën e dytë të prillit të vitit 1941, pasoi ikja e kolonëve serbë, malazezë nga Kosova. Qindra serbë e malazezë u përcollën nga popullata shqiptare nëpër vendet e tyre pa i prekur askush. Madje, shqiptarët, për t'i shpëtuar, i veshën një pjesë kolonësh në rroba grash e burrash shqiptarë, dhe ashtu të veshur i përcollën pa therrë në këmbë përtej kufirit, nga kishin ardhur gjatë historisë. Ndërsa, disa të tjerë në mënyrë të organizuar i transferuan, siç ishte rasti me malazezë, kur shumë prej tyre u përcollën deri në Çakor. Një numër i kolonëve u vendos në vendbanimet kompakte serbe e malazeze, e kishte edhe që kishin mbetur në vendbanime të tyre, përkundër të gjitha të këqijave të bëra ishin mbrojtur nga popullata vendase shqiptare.

Nga synimi i ndërrimit të strukturës nacionale dhe kolonizimit të Kosovës, Serbia nuk hoqi dorë as në rrethanat më të vështira, siç ishin ato gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në këtë kohë Serbia, veç luftës këmbëngulte rreth vijave të demarkacionit ndërmjet pushtuesve italianë e gjermanë, i kushtoi kujdes të veçantë kolonëve të saj në Kosovë. Qeveria e Nediqit përpigjej përherë që nga një pjesë e Kosovës, që, me marrëveshje e sipas së drejtës historike e natyrore i takoi Shqipërisë së pushtuar nga Italia fashiste, të shpërngulen sa më pak serbo-malazezë. Kur nuk ia arrinte dot qëllimit, kjo qeveri kolonët e shpërngulur i vendoste përreth kufirit të Kosovës dhe pandërprerë i përgatiste për rikthimin e tyre duke i indoktrinuar në domosdonë e kthimit, si edhe duke i përgatitur ata në fushën ushtarake, duke formuar njësitë të armatosura çetnike prej

¹⁴⁴ AJ B, CPB, 38, k. 63.

¹⁴⁵ H. Kola, Genocidi ..., fq. 50-51.

çetave e deri te korpuset ushtarake. Çështjen e shpërnguljes së kolonëve serbo-malazez nga Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore Qeveria e Nediqit e shfrytëzoi edhe në luftë kundër synimeve çlirimtare të forcave të ndryshme shqiptare, veçanërisht të Komitetit të Kosovës e të Qeverisë Shqiptare, por edhe në fushën diplomatike. Qeveria e Nediqit, duke politizuar çështjen e kolonëve të shpërngulur përpiquej ta bindte Gjermaninë naziste që ajo të përkrahte për rishtrirjen e mëparshme të Serbisë së madhe në këto anë.¹⁴⁶

Për sendërtimin e qëllimeve të parashtuara, Qeveria e Nediqit që nga ditët e para, u organizua në shkallë shtetërore. Në fillim kjo detyrë iu ngarkua Sigurimit Shtetëror e më vonë, kur çështja u masivizua edhe më shumë, sendërtimin e këtyre qëllimeve e moren për sipër prefektët e qarqeve dhe të rretheve. Shteti përgatiti pyetësorët, të cilët duhej t'i plotësonte çdo kryefamiljar i shpërngulur, e ku kërkohej, veç të tjerash, të deklaroheshin se sipas urdhërit të kujt shpërnguleshin, çfarë qëndrimi kishin ndaj serbo-malazezve organet e pushtetit, organi-zatat e individët dhe a shpërnguleshin për shkak të torturave apo pse nuk donin të mbeteshin jashtë Serbisë. Kuptohet, sipas skenarit të Qeverisë së Nediqit deklaratedhënësit duhej të flisnin sa më keq për Qeverinë shqiptare, veçanërisht për qëndrimin e saj ndaj kolonëve serbo-malazezë që këto pastaj ata t'i shfrytëzonin në arenën diplo-matike ndërkombëtare. Për këtë arsye nuk janë të rralla deklaratat në të cilat në mënyrë të paskurpullt sulmohet jo vetëm Qeveria shqiptare, por edhe populli shqiptar në tërësi. Të kësaj fryme janë veçanërisht raportet e hieromonahut të kishës së Deçanit. Veç kësaj, shumë deklaratedhënës të manipuluar nuk mund të fshehnin faktin se me shqiptarët deri në kohën e “kreyengritjes”, siç e quanin shumë prej tyre fillimin e Luftës së Dytë Botërore, patën fqinjësi të mirë. Bile disa prej tyre u detyruan disa herë të pohojnë se edhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore shumica e popullsisë shqiptare nuk ndërroi qëndrimin e saj të mëparshëm.¹⁴⁷

Përveç kësaj, qarqet shoveniste serbe bënë plane për pushtimin e trojeve shqiptare, kolonizimin me elementin sllavë, përkatësisht të ndërrimit të strukturës etnike të popullsisë së Kosovës, të bazuar në projektin e Ilija Garashaninit. Po i theksojmë disa nga ato: Sipas projektit të hartuar prej avokatit nga Sarajeva Stevan Moleviq, të titulluar “*Serbia homogjene*” i 30 qershorit 1941, parashihej që Serbia të përfshinte në lindje dhe në juglindje Kosovën dhe Maqedoninë, Vidinin dhe Qystendilin në Bullgarinë e sotme; në perëndim - banovinën e Vërbasit, Dalmacinë Veriore, Likën, Kordunin, Baninë dhe një pjesë të Sllovenisë; në jug - Malin e Zi dhe Hercegovinën, duke përfshirë edhe Dubrovnikun, të cilit do t'i jepej status i veçantë, dhe pjesën veriore të Shqipërisë. Sipas Moleviqit, në gjirin e Serbisë së Madhe duhej të përfshiheshin të gjitha trevat ku ka serbë, apo ku Stevan Moleviqi supozonte se kishte serbë. Për te serbë ishin edhe maqedonasit dhe malazezët. Ndërkohë ai kërkonte shpërnguljen në masë të kroatëve, myslimanëve dhe të shqiptarëve nga rajonet, ku ata përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë.¹⁴⁸

Në programet e çetnikëve më 1941 planifikohej: “*Të krijohet Jugosllavia e Madhe në të Serbia e Madhe, etnikisht e pastër në kufijtë e Serbisë dhe të Malit të Zi, të Bosnjes e Hercegovinës, të Sremi të Banatit. Të pastrohen të gjitha territoret nga elementët joserbë*”. Të krijohen kufijtë e drejtpërdrejtë, kufijtë e përbashkët ndërmjet Serbisë e Malit të Zi, si dhe Serbisë dhe Sllovenisë, nëpërmjet spastrimit të Sanxhakut dhe të disa pjesëve të Bosnjes nga myslimanët dhe kroatët. Në përputhje me planet e sipërpermendura, Lëvizja Çetnike synonte ta

¹⁴⁶ Dr. Izber Hoti, Çështja e kolonizimit të Kosovës Gjatë Luftës së Dytë Botërore, “Fjala”, Prishtinë 5 korrik 1993.

¹⁴⁷ E njëjtë.

¹⁴⁸ Rexhep Qosja, Çështja shqiptare, historia dhe politika. Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994, fq. 171; Dr. Muhamet Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, fq. 46.

kultivonte dhe ta mbante gjallë në Kosovë frymën e hakmarrjes, të shfarosjes së shqiptarëve dhe të gllabërimit të trojeve të tyre etnike. Kështu në një nga elaboratet e përgatitura në atë kohë, me titull: *“Krahina e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit”*, midis të tjerave thuhej, se *“Kosova ka qenë serbe dhe ajo do të mbetet patjetër serbe, jo vetëm për nga pozita shtetërore juridike, por edhe nga struktura e popullsisë së vet, e cila duhet të jetë me shumicë serbe”*. *“Pas përfundimit të luftës do të shpërthejë hakmarrja e serbëve ndaj shqiptarëve. Kjo nuk do të pengohet e sidomos aksioni i Vasojeviqëve, të cilët duhet të zgjerohen në Rrafshin e Dukagjinit.”*¹⁴⁹

Ndërkaq, me ligjin mbi kolonizimin e brendshëm duhet të parashihet që shqiptarët, për shkaqe strategjike të transferohen në Srem, në Shumadi dhe në trevat e tjera, ku do të jenë të parrezikshëm dhe me kohë do të asimilohen.¹⁵⁰

Më 12 shtator 1941 gjenerali Lubo Novaković në letrën që i dërgonte Kosta Peçancit, të njohur edhe më parë për krimet e pashembullta mbi shqiptarët, i përkujtonte: *“Kur të nisem në rrugën fatlume, e di çfarë planesh ke për jugun tonë. Besoj se në Sanxhak, në Dukagjin dhe në Fushë të Kosovës, nuk do të mbetet asnjë plis për farë. Lumenjt Sitnica dhe Llapi do të bartin dy muaj koka shqiptarësh”*.¹⁵¹ Programi i Drazha Mihailovićit për spastrime etnike dhe krijimin e Serbisë së Madhe në Jugosllavinë e Madhe më 20 dhjetor 1941, në mes tjerash parasheh: *“..... Të spastrohen territoret shtetërore prej të gjitha pakicave dhe elementëve jonacionalë.... Pjesët e spastruara të kolonizo-hen me malazezë, ndërsa çështjen e myslimaneve duhet rregulluar me Turqinë përmes Londrës”*.¹⁵² Agjentët e D. Mihailovićit paralajmëronin se *“çetnikët do të çlironin Kosovën nga shqiptarët dhe të gjithë ata do t'i zhdukjin, pa lënë njeri të gjallë”*. Në mars të vitit 1942 në fshatin Suhadoll, Voja Dragović, prijës çetnik, deklaronte se *“pas fitores së luftës nga aleatet, duhet zhdukur të gjithë shqiptarët, duke mos përjashtuar as fëmijët në djep”*.¹⁵³

Për nxitjen e urrejtjes kundër popullit shqiptar, krahas Levizjes Çetnike, një rol shumë agresiv luajti edhe Kisha ortodokse serbe. Për klerikët serbë *“shqiptarët ishin gjarpinj helmues që duheshin zhdukur, mbytur ose u duhej shtypur koka”*.¹⁵⁴ Gazeta “Borba”, në nëntor të vitit 1944, shkruante se *“në Kosovë, pas 6 prillit të vitit 1941 serbët dhe malazezët kishin përjetuar nën shtypjen e shovinistëve shqiptarë, që i shndërruan këto treva në arenë të tmerrshme të vrasjeve dhe të djegieve”*. Sipas saj, *“mbi kolonistët e lodhur e pa ndihmë, që luftonin në front kundër keqbërësve italianë e gjermanë u bënë krime të tmerrshme.”*¹⁵⁵

8. KOLONIZIMI SERB GJATË JUGOSLLAVISË SOCIALISTE

8. 1. Planet për zbatimin e kolonizimit

¹⁴⁹ Gojko Medenica, Cetnicki pokret na Kosovu i Metohiji u vreme II svetskog rata, “Vjetari” X-XI, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1979, fq. 347-375; Dr. M. Shatri, Kosova në Luftën e Dytë, v. e c., fq. 47.

¹⁵⁰ E njëjtë.

¹⁵¹ Vojna organizacija četnika u okupiranoj Srbiji 1941-1942, VIG, Beograd, 1968, fq. 205-214; Dr. Hakif Bajrami, Planet për Serbinë homogjene dhe tragjedia ballkanike, 1941-1945, “Rilindja”, 13.IX 1995; AVII B, K.111, fas. 4, d.14; Dr. M. Shatri, Kosova në, v. e c., fq. 47.

¹⁵² Dr. Hakif Bajrami, Politika, v. e c., fq. 144.

¹⁵³ Dr. Sh. Braha, Gjenocidi serbomadh, v. e c., fq. 207; Dr. M. Shatri, Kosova në, v. e c., fq. 53.

¹⁵⁴ Arkivi i Institutit Historik të Kosovës në Prishtinë, k.14/8, 181; Dr. Muhamet Shatri, LNÇ në Prizren dhe rrethinë (1941-1945), Prishtinë, 1987, fq. 186.

¹⁵⁵ “Borba”, Beograd, 21.IX 1944, fq. 1.

Qëndrimi i Serbisë ndaj kolonizimit të Kosovës dhe ndërrimit të strukturës etnike të saj nuk ndryshoi as pas largimit të pushtetit gjermanë. Për zbatimin e projekteve të njohura antishqiptare, udhëheqja jugosllave përdori po ato mjete dhe metoda, që ishin përdorur edhe përpara luftës. Ndryshonin vetëm pretekstet. Përpara vitit 1941, shqip-tarët u trajtuan si të huaj e të rrezikshëm për ekzistencën e shtetit jugosllav. Pas luftës kjo politikë e këto masa u justifikuan e u paraqitën si veprime që drejtoheshin kundër “shqiptarëve reaksionarë”, kundër-revolucionar”, “bashkëpunëtorë të okupatorit” e “banditë” etj.

Përpjekjet për spastrimin etnik të Kosovës dhe të trevave të tjera etnike shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia, së pari filluan në zonat periferike, por shpejt u shtrinë në mbarë trevat shqiptare. Në operacionet e tilla të organizuara morën pjesë disa divizione me një efektiv prej 40.000 vetash.¹⁵⁶ Menjëherë u hap çështja e kthimit të kolonëve. Këto veprime luftarake, veç formave të tjera, u shoqëruan me projektin e ri antishqiptar të Vasa Çubrilloviqit “*Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re*”, datë 3 nëntor 1944. Çubrilloviqi, në projektin e tij, në fillim pranon faktin se serbët, pas Luftës së Parë Botërore, përkatësisht pas formimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene (Jugosllavisë) me 1918, fituan një pjesë të territoreve me popullsi të huaj, të cilat u bënë rrezik për Jugosllavinë, jo për shkak të kundërpeshës së tyre ndaj popujve sllavë, por për shkak të trevave ku jetojnë dhe të vazhdimësisë gjeografike që kanë këto treva me vendet e tyre amë.¹⁵⁷

V. Çubrilloviqi, para udhëheqjes më të lartë të LNÇJ e të UNÇJ, i propozon shpërnguljen masive të miliona njerëzve, sepse, sipas tij, “*zgjidhja e vetme dhe e drejtë e kësaj çështjeje është shpërngulja e këtyre pakicave*”. Mbështetje dhe shembull për një veprim të tillë ai merrte veprimet e Rajhut të Tretë dhe dëbimet e kolonizimit e shumë popujve në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet tjera evropiane. Autori i projektit parashihte edhe hollësi për realizimin e këtij projekti. Për sendërtimin e projektit, V. Çubrilloviqi parashihte edhe kohën, mjetet dhe mënyrat e veprimit. Sipas tij, koha më e përshtatshme për shpërnguljen efikase ishte lufta, pra shpërngulja më e suksesshme ishte shfarosja fizike dhe e plotë e njerëzve. Rol vendimtar, sipas Çubrilloviqit, kishte ushtria, prandaj ai propozonte që në Shtabin e UNÇJ të formohej një seksion i posaçëm për këtë çështje. Në rast se nuk arrihej shfarosja e plotë fizike, ai parashihte edhe masa tjera, siç ishte mohimi i të gjitha të drejtave, krijimi i kampeve të përqendrimit, plaçkitja e pronave, shfarosja e intelegjencies dhe e shtresave të pasura shoqërore dhe pastaj kolonizimi i menjëhershëm i viseve me elementin sllav.¹⁵⁸ Për këtë qëllim, ai propozonte formimin e një ministrie të veçantë, apo së paku, një komisarariat në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë. Pastaj, që bartësit kryesorë të misionit të bëheshin këshillat nacionalçlirimtare, prej instancave më të ulëta deri tek ato më të larta, ndërsa kolonët të zgjidheshin nga radhët e luftëtarëve më të dëshmuar dhe, sipas mundësive, serbë e malazezë që më parë nuk ishin kolonizuar. Për bartësit e këtij misioni, sipas tij, duheshin siguruar paga të larta, poste dhe status më të privilegjuar në shoqëri.

Në mes tjerash ai propozon: “*Ushtria në kohën e operacioneve luftarake, duhet t’i spastrojë me plan dhe në mënyrë të pamëshirshme... ato vise që dëshirojmë t’i kolonizojmë me elementin tonë kombëtar....*” “*Ne duhet t’i përzëmë të gjitha pakicat nga tokat tona. Për këtë duhet punuar. Gjithë këtë që e them për Vojvodinë, Sllavoni, Serbi të Vjetër (Kosovë) dhe Maqedoni, ky është minimumi që duhet të arrihet nëse duam t’i sigurojmë për të ardhmen vetës*

¹⁵⁶ Dr. M. Shatri, Kosova, v. e c., fq. 207.

¹⁵⁷ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, Tiranë, 1990, fq. 546-550; Dr. M. Shatri, Kosova, v. e c., fq. 207.

¹⁵⁸ E vërteta mbi Kosovën, v. e c., fq. 546-550; Dr. M. Shatri, Kosova, v. e c., fq. 209.

*pronën e atyre tokave”... “Tash për tash po theksoj vetëm se gjermanët duhet të spastrohen patjetër nga Vojvodina, kurse shqiptarët nga Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe Pollogu....”; “Çfarë mund të them së pari: luftërat japin mundësitë më të mëdha për zgjidhjen e këtyre problemeve. Ato si tufan, duke kaluar nëpër shtete, nxjerrin me rrënjë popuj. Atë që duhet bërë me dhjetëvjetësh e shekuj, gjatë luftës bëhet për ndonjë muaj apo ndonjë vit”. “Duhet bërë plane detaje, se cilat fshatra dhe cilat rrethe në Serbi të Vjetër dhe në Maqedoni duhet të spastrohen, dhe në bazë të atij plani duhet vepruar”.... “ Përpos spastrimit nga ana e ushtrisë gjatë operacioneve, duhet përdorur edhe mjete të tjera që pakicat kombëtare të detyrohen të shpërngulen. Para së gjithash, për shkak të qëndrimit të tyre në këtë luftë, minoriteveve duhet t’u merren të gjitha të drejtat. Duhet të nxirren pamëshirshëm para gjykatës së luftës të gjithë ata anëtarë të pakicave kombëtare që në çfarëdo mënyre kanë qenë në shërbim të okupatorëve. Për këtë duhet të formohen kampet e përqendrimit, pasuritë e tyre duhet t’u konfiskohen, familjet duhet t’u dërgohen në kampe dhe në rastin e parë të dëbohen”.*¹⁵⁹

Me planin terrorist të Çubrilloviçit parashihej amnestia e përgjithshme e çetnikëve, që u bë nga Kryesia e AVNOJ-it më 21.XI.1944. Pas amnestisë, formacione të tëra çetnikësh u transferuan në Kosovë për të realizuar planin e Çubrilloviçit. Për t’i pasur duart të lira në zbatimin e terrorit dhe të gjenocidit mbi popullin shqiptar, udhëheqja jugosllave mobilizoi me dhunë forcën më vitale të shqiptarëve. Shqiptarët e moshës madhore u mobilizuan me dhunë në formacionet ushtarake dhe u dërguan në Srem të Vojvodinës, në Bosnje e në Kroaci. Të rinjtë shqiptarë u nisën në front pa armë. Në rrugë për në Tivar u vranë me dhjetëra shqiptarë të mobilizuar në Ushtrinë Jugosllave, kurse në Tivar të Malit të Zi vetëm brenda një nate u vranë dhe u masakruan nga trupat përcjellëse serbe rreth 1500 shqiptarë të mobilizuar.¹⁶⁰ Si rrallë ndonjëherë në histori, vetë komandantët, pa asnjë shkas, kishin urdhëruar të hapet zjarr ndaj ushtarëve të tyre - vetëm pse ishin shqiptarë. E vrasja e të rinjve shqiptarë të mobilizuar vazhdoi edhe më tej në “udhëtimin” e tyre në “front”, kështu që as sot e kësaj dite nuk dihet numri i saktë i atyre që janë ekzekutuar nga ushtria jugosllave ose që vërtet janë vrarë si “mish për topa” në ndonjë front. Sepse, ishte ky edhe motiv për ndjelljen e frikës e të pasigurisë në tërë popullsinë shqiptare, që kishte mbetur në Jugosllavi.

Për realizimin e këtij projekti, pushteti jugosllav me 8 shkurt 1945 në Kosovë dha Urdhëresën për vendosjen e pushtetit ushtarak. Pushteti ushtarak, që iu imponua popullit shqiptar të Kosovës, nuk ishte formë e panjohur represioni, gjenocidi e terrori ndaj shqiptarëve, sepse pushtuesit jugosllavë e kishin zbatuar atë edhe më parë. Kështu kishte ndodhur sa herë që trupat serbe, malazeze apo jugosllave kishin pushtuar e ripushtuar viset shqiptare. Në vitin 1913, në viset shqiptare, që iu aneksuan Serbisë, organizimi i pushtetit iu ngarkua ushtrisë dhe administratës ushtarake.¹⁶¹ Kjo u bë në bazë të propozimit të Komandës së Zonës III të Armatës, datë 12.XII.1912. Në këto treva, Komanda Supreme e Ushtrisë serbe e drejtonte vendin nëpërmjet organeve të sistemit ushtarak e policor.¹⁶² Në vjeshtë të vitit 1918, krahas ripushtimit të Kosovës dhe të viseve të tjera etnike shqiptare u vendos diktatura ushtarake-policore e gërshtuar me pushtetin civil serb, i cili ushtroi gjenocidin shfarosës mbi popullin shqiptar. Në trevat shqiptare nuk vlente kurrfarë legjislacioni, “rregullin” dhe “qetësinë” e siguronte ushtria serbo-jugosllave me ndihmën e aparatit policor.¹⁶³ Administrimi Ushtarak, që u vendos në

¹⁵⁹ “Bujku”, Dosja jonë, 7 nëntor 1998.

¹⁶⁰ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, BULETINI, nr. 14, janar-mars 2000, fq. 20.

¹⁶¹ L. Nasi, Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1945), Tiranë, 1994, fq. 163.

¹⁶² Z. Cana, Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare, Prishtinë, 1984, fq. 75.

¹⁶³ Liman Rushiti, Rregullimi administrativ-territorial i Kosovës gjatë viteve 1919-1929, Kosova 1, Prishtinë, 1972, fq. 253.

Kosovë në vitin 1945, të cilit iu besua udhëheqja ushtarake e pushtetit civil dhe gjyqësor “deri në rregullimin e rrethanave”, përkatësisht deri në aneksimin e saj nga Serbia.

Për t’i mashtruar disa qarqe të brendshme përparimtare e internacionaliste dhe mbarë opinioni ndërkombëtar, serbomëdhenjtë, me ndikim të dukshëm në mbarë Jugosllavinë, emërtimit *Ministria e Kolonizimit* i shtuan atributin sintagmor *reformë agrare*, kështu që kjo ministri më vonë do të quhet Ministria e Reformës Agrare dhe e Kolonizimit. Se kjo ministri nuk kishte kurrfarë karakteri agrar dhe nuk punonte fare për ndonjë reformë agrare shihet edhe nga fakti se kjo “reformë” dhe ky kolonizim u zbatua vetëm në Vojvodinë, në Kosovë e në Maqedoni, pra në territoret ku jetonin kryesisht nacionaliteti shqiptar, hungarez, gjerman, maqedonas etj. Po këtë konstatim e vërteton edhe e dhëna se revizioni i reformës agrare u bë mbështetur në Dekretin Jugosllav dhe në Ligjin për revizionin e ndarjes së tokave kolonëve dhe të interesuarve të tjerë agrarë në Maqedoni dhe në Kosovë e Metohi me 5 nëntor 1945.¹⁶⁴

8.2. Rikolonizimi - kthimi i kolonëve në Kosovë

Çështjen e rikolonizimit dhe kinse të reformës agrare në Kosovë në muajt e parë të vitit 1945, Serbia nuk e aktualizoi, përkundrazi Drejtoria e Punëve të Brendshme të Jugosllavisë Federative Demokra-tike me vendimin e datës 5 mars 1945, përkohësisht ua ndalonte kthyerjen e kolonëve në vendet e vendosura gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore.¹⁶⁵ Kjo e bëri atë, jo pse ajo nga ky synim kishte hequr dorë, por nga se në këtë kohë në Kosovë zhvilloheshin luftëra të rrepta, sepse shqiptarët nuk pajtoheshin me ripushtimin dhe ngase pozita e Kosovës ende nuk ishte e qartë. Mirëpo, edhe përkundër kësaj ishte marrë Direktiva e Politbyros së KQ PKJ e datës 1 prill 1945 për kthyerjen e të gjithë kolonëve në Kosovë (përkundër qëndrimit të 5 marsit 1945). Pasi kundërvënia e shqiptarëve u shua me gjak dhe deri diku u ndriçua pozita e Kosovës, çështja e kolonizimit të Kosovës në mbledhjen prej 6-8 shtatorit 1945 të Këshillit agrar u fut në procedurë të shpejtuar, duke sqaruar se Kosova futet në kuotën e Serbisë dhe se në këtë krahinë me kolonizim e reformë agrare do të përfshihen 28.750 hektarë ose 50.000 jutë.¹⁶⁶ Po në këtë mbledhje u miratua Ligji për revizionin e reformës agrare për Maqedoni dhe Kosovë e Metohi.¹⁶⁷

Në kohën kur në qarqet jugosllave heshte çështja e reformës agrare dhe e kolonizimit, në Kosovë dhe në Serbi zhvillohej veprimtaria e madhe e përgatitjeve për kolonizimin e serishëm të Kosovës. Këtë konsatim e vërtetojnë depeshat e shumta të kolonëve dhe autoriteteve serbe, që ua dërguan Këshillit Agrar me kërkesa që edhe në këtë krahinë të fillojë kolonizimi dhe reforma agrare, të cilat u shqyrtuan në mbledhjen e 5 tetorit të vitit 1945. Po të kësaj fryme ishin vendimet e Këshillit Agrar të mbledhjes së tij më 16 tetor 1945. Në këtë mbledhje, veç të tjerash, u vendos që kolonët serbo-malazezë të vendosur në Vojvodinë të kthehen në Kosovë, ndërsa “kolonët” e Shqipërisë sa më parë të shpërngulën nga Kosova. Veprimtaria e organizuar mirë në Kosovë për kolonizimin e saj u hetua edhe në Këshillin Agrar të Ministrisë së Kolonizimit. Në mbledhjen e këtij këshilli me 7 dhjetor 1945, veç të tjerash, u trajtua çështja e zbatimit të Ligjit të revizionit dhe të ndarjes së tokave në Kosovë dhe për referim sa më të shpejtë u autorizua njëri nga ministrat e kësaj ministrie. Veç kësaj për sendërtimin e këtij qëllimi ky

¹⁶⁴ Dr. Izber Hoti, “Fjala”, 5 korrik 1993.

¹⁶⁵ “Sl. List DFJ”, nr. 56/1945.

¹⁶⁶ Dr. I. Hoti, “Fjala”, 5 korrik 1993.

¹⁶⁷ “Sl. List DFJ”, nr. 56/1945.

këshill, në mbledhjen e njëjtë, kolonëve të Kosovës ua ndau 5.000.000 dinarë, që për atë kohë paraqiste një shumë të madhe të hollash.¹⁶⁸

Veprimet e organizuara në të gjitha shkallët për kolonizimin e Kosovës gjatë vitit 1946, veçanërisht pas angazhimit të madh të Serbisë, nuk mbetën shterpë. Qysh në fillim të vitit 1946 u përgatitën të dhënat për kolonët e interesuar të rretheve të ndryshme të Kosovës, të cilët kërkesat e tyre ua kishin dërguar Komisionit agrar të Kosmetit, Komisionit të revizionit agrar dhe Ministrisë për kolonizim. Kërkesat e tyre ishin shqyrtuar dhe pothuajse për të gjithë ishin miratuar vendimet përkatëse nga organet kompetente. Ndërkohë në terren vepronin komisionet kolonizuese agrare në punën e të cilëve pati shumë vërejtje dhe ankime në organet e shkallëve të ndryshme. Punë të vështirë patën veçanërisht organet të cilat duhej të vendosnin për pasurinë e patundshme, tokës dhe shtëpive për banim. Një punë e tillë “bëhej më e vështirë”, veçanërisht kur kontestet ishin serbo-malazeze - shqiptare. Në të vërtetë në kohën e kolonizimit pas Luftës së Parë Botërore ndaj shqiptarëve u bënë aq lëshime sa asnjë komision në çfarëdo përbërjeje qoftë në rrethana të reja nuk mund t’i kapërcente këto padrejtësi. Mirëpo, në këtë kohë kishte kundërshtime të mëdha rreth korrigjimeve të këtyre padrejtësive. Veç kësaj, për një veprim të tillë nuk u treguan të interesuara as organet e atëhershme krahinore e republikane dhe as organet federative. Për këtë arsye shumica absolute e pasurive të patundshme gjatë punës së komisioneve nuk preken fare (të 1.515 familjeve), apo u preken vetëm pjesërisht (1.253), ndërsa vetëm disa kolonëve iu mor toka e tërë (445), që kurrësi nuk mund t’u takonte as me këto ligje diskriminuese. Shumë më lehtë e kishin organet e angazhuara për rikthimin e kolonëve dhe vendosjen e kolonëve të rinj. Për rikthim të kolonëve duhej vetëm angazhim i veçantë në aspektin organizativ-administrativ për grumbullimin e të dhënave dhe populla-rizimin e krijimit të gjendjes së re në Kosovë. Këto organe u angazhuan mjaft, madje, edhe në bindjen e kolonistëve që të ktheheshin në Kosovë, që ishin vendosur në Vojvodinën e pasur e të cilët ishin të sigurt për ardhmërinë e tyre. Mirëpo, kolonizimi i Kosovës me të interesuar të rinj bëhej shumë më lehtë. Ata vendoseshin kryesisht në pronat shoqërore e të interesuarit për kolonizim ishin thuajse të gjithë nëpunës e punëtorë.¹⁶⁹

Duke u bazuar në shënimet statistikore, gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë kishin mbetur 3.150 familje të cilat ishin kolonizua në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Ishte e dukshme edhe dukuria e kthimit të kolonëve para fundit të kësaj lufte (5.545 familje), përkrah numrit të kolonëve që u shpërngulën nga Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore (7.397 familje). Mjaft kolonë, edhe pse nga Komisioni revizor fituan vendimet e rikolonizimit, nuk u kthyen në Kosovë deri me 11 korrik 1947 (2.471 familje të kolonizuara). Kolonët e tillë, kishin vendosur të jetonin në Vojvodinë apo gjetkë, ku perspektiva e jetës së tyre ishte më e dukshme. Duhet shtuar se në katër rrethet e Kosovës (Pejë, Vushtrri, Llap dhe Gjilan) deri në kohën e përmendur u kthyen më shumë kolonë sesa ishin shpërngulur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Marrë në përgjithësi nga të gjithë kolonët e shpërngulur gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk u kthyen sërish në Kosovë më tepër se 1.500 familje apo afër 7.500 veta, nëse supozohet se çdo familje në këtë kohë kishte nga pesë anëtarë.¹⁷⁰

Përveç masave kolonizuese, në trevat shqiptare, pas vitit 1945, janë vendosur e dhe me mijëra familje të tjera në qytetet dhe fshatrat shqiptare, me qëllim që të ngritet përqindja e serbëve dhe malazezëve. Këta u sollën si nëpunës, udhëheqës të ndërmarrjeve që formoheshin,

¹⁶⁸ Dr. I. Hoti, “Fjala”, 5 korrik 1993.

¹⁶⁹ E njëjtë.

¹⁷⁰ Milovan Obradovic, Revizija agrarne reforme na Kosovu, “Kosova”, nr.3/1974, Prishtinë, fq. 411; Dr. I. Hoti, “Fjala”, 5 korrik 1993.

mësues, sidomos mësuese, me qëllim të martesës me intelektualët shqiptarë, policë, oficerë dhe shumë të tjerë.

8.3. Presionet për shpërngulje të shqiptarëve

Duke mos pasur mundësi realizimi të plotë të projektit të Çubrilloviqit dhe të projekteve të tjera, pas Luftës së Dytë Botërore, pushteti serb e vazhdoi zbatimin e fazave të mëtejshme të dhunës e të terrorit ndaj shqiptarëve, të shpërnguljes së tyre nga atdheu dhe kolonizimin me elementin serb në Kosovë.

Kjo periudhë u përcoll edhe me gjykime masive e dënime drastike të shqiptarëve përsëri për gjoja “kolaborim me okupatorin” për të vazhduar me vonë, pas Rezolucionit të Inforbyrosë (1948) për gjoja bashkëpunim me Shqipërinë, madje edhe me Bashkimin Sovjetik e shtetet e tjera të Bllokut Lindor. Arrestoheshin, vriteshin, masakro-heshin dhe internoheshin në burgjet e kampet e ndryshme të Jugosllavisë (Goli-Otok, Bileçë, Nish, Gradishkë etj.). Gjithë kjo ishte pjesë e fushatës së egër antishqiptare për të shkaktuar frikë e pasiguri dhe nxitje për largimin e shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre shekullore.

Si presione më të drejtëpërdrejta për ndjekjen dhe për shpërnguljen e shqiptarëve, përveç keqtrajtimit të personave të pafajshëm dhe veçanërisht të intelgjencës së pakët dhe punëtorëve të arsimit, që u shpallën armiq të rendit socialist dhe u burgosën, u internuan e, madje, një pjesë edhe u pushkatuan pa gjyq - ishin deklarimi i dhunshëm për kombësi turke, aksionet e mbledhjes së drithit, aksioni i mbledhjes së armëve me arsyetim se shqiptarët kinse po përgatiten për kryengritje të armatosur dhe bashkim me Shqipërinë, inskenimi i organizatave të fshehta politike “irredentiste”, redukimi i të drejtave sa i përket përdo-rimit të gjuhës shqipe dhe simboleve kombëtare, mbyllja e disa shkollave në gjuhën shqipe, nxjerrja e flamurit shqiptar në ditën e festës kombëtare nga ana e organeve të sigurimit si provokacion për t’i burgosur njerëzit e pafajshëm etj. E gjithë kjo strategjemë mizore u sajua për të gjetur shkak për shpërnguljen masive të shqiptarëve jashtë Jugosllavisë. Në këtë periudhë “u zbuluan” kinse gjithato “organizata irredentiste e diversioniste”, “shqiptaromëdha”, të cilat, në fakt, nuk ekzistonin.

Me qëllim të lehtësimit të shpërnguljes, në vitin 1958 shqiptarëve iu krijoi një lehtësi tjetër për lënien e shtetësisë jugosllave, e mila nga 12.000 dinarë u ul në 2.000 dinarë për një person dhe në vitin 1963 u haq fare.¹⁷¹

Siç po shihet, presionet për shpërngulje ndaj shqiptarëve ishin aq të shumta e të shumëllojshme, sa jeta e tyre në Kosovë e në viset e tjera të Jugosllavisë u bë e padurueshme. Prandaj, një numër jo i vogël u detyruan të regjistroheshin si turq që të shkonin në Turqi për të shpëtuar sa më parë nga ferri i pushtetit serb. Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova mori përmasa të gjera me intensitet të lartë, sidomos gjatë viteve ‘50 e ‘60 të shekullit XX. Gjatë këtyre viteve u shpërngulën në Turqi 283.000 shqiptarë, do të thotë afër një e treta e popullsisë së atëhershme.¹⁷² Maqedonia ishte etapa përfundimtare e shpërnguljeve pa kthim të shqiptarëve në Turqi. Të gjithë lumenjtë e popullsisë të dyndura nga Jugosllavia vërshonin në Maqedoni dhe pastaj i drejto-heshin Turqisë. Procesi u realizua “fshehtazi”, ndërsa motivet e shpërnguljes ishin sikurse të paraluftës, kryesisht të natyrës politike, vetëm që u modifikuan dhe iu përshtatën kushteve të reja të sistemit socialist.

Në anën tjetër në Kosovë vinin një numër i madh i serbëve dhe malazezëve si nga territoret e afërta, ashtu edhe nga ato të largëta të Sërbisë dhe të Malit të Zi, si kuadro dhe me familje. Punësohen kryesisht në organizatat dhe institucionet shtetërore, shoqërore, kulturore etj.

¹⁷¹ H. Kola, vep. e cit. fq. 174.

¹⁷² KMDLJN, Prishtinë, BULETINI, nr. 14, janar-mars 2000, fq. 21.

Vlerësohet se në Kosovë prej vitit 1945 deri me 1965 janë vendosur 12.300 familje sllave, ose rreth 64.000 persona me prejardhje sllave.¹⁷³

Ky proces u ndërpre në vitin 1966 (pas Plenumit të IV të Brionëve), kur u kritikua ashpër shërbimi i Sigurimit Shtetëror të Jugosllavisë së asaj kohe, që kishte goditur rëndë të gjithë të tjerët pikërisht shqiptarët e Kosovës, por edhe të viseve të tjera të ish-Jugosllavisë.

8.4. Ndërpreja e përkohshme e kolonizimit dhe kthimi i disa kolonëve në vendlindje

Pas vitit 1966, e posaçërisht pas nxjerrjes së Kushtetutës të vitit 1974, serbët e malazezët, duke i humbur privilegjet dhe duke mos e duruar barazinë e shqiptarëve me ta, një numër i tyre, sidomos ai me origjinë kolonizuese kthehen në vatrat e para të saj si dhe në viset më të zhvilluara të ish Jugosllavisë. Ata pasurinë, tokën, banesën e tjerë të marrë falas në Kosovë e shisnin me çmime të larta dhe me ato mjete blenin tokë, shtëpi, objekte ekonomike dhe gjëra të tjera në viset e Serbisë, në krahasim me Kosovën me çmime shumë më të ulta, kështu që i mbeteshin mjete të bollshme edhe për kursim. Shpërnguljen e këtillë ekonomike të serbëve e malazezëve, qarqet politike shtetërore të Serbisë dhe disa edhe të Jugosllavisë e shfrytëzonin si presion të mëtejshëm ndaj shqiptarëve. “Presioni” mbi serbët dhe malazezët ishte floskulë politike dhe shpifje. Gjendja faktike nuk përkon me kualifikimi se serbët dhe malazezët po shpërngulën nga Kosova për shkak të “presioneve”, “diskriminimit”, “terrorit”, “gjenocidit” etj. nga ana e shqiptarëve. “Presioni” i shqiptarëve mbi serbët dhe malazezët ishte një shpifje e rëndë dhe mbi këtë konstruksion u krijua një klimë dhe një strategji antikosovare dhe antishqiptare pothuajse në tërë Jugosllavinë. Sipas burimeve serbe prej vitit 1967-1980 nga Kosova u shpërngulën 57.118 serbë e malazezë.¹⁷⁴

Duhet theksuar se popullata shqiptare e Kosovës që nga vitit 1968 e deri në vitin 1981 përjetoi deridiku një transformim në aspektin arsimor, kulturor, shkencor, ekonomik etj. Ajo ishte njëfarë pauze në valën e shpërnguljeve dhe u bë për të evituar ndonjë situatë shpërthyes në Jugosllavi dhe për të vendosur njëfarë ekuilibri politiko-etnik në federatë, me shpresën që ajo të mos shpërbëhej në të ardhmen.

8.5. Planet e reja dhe veprimet për rikolonizimin e Kosovës me popullatë serbo-malazeze

Forcat hegjemoniste serbe deri në vitin 1981 vepruan hapur e fshehur, me propagandë e veprime konkrete, në ndërrimin sa më të madh të strukturës etnike të Kosovës dhe të kolonizimit të saj. Për sendërtimin e këtij qëllimi, forcat në fjalë nuk ngurruan që, në njërën anë, të montojnë procese të ndryshme politike dhe shtypje të tjera ndaj shqiptarëve, ndërsa, në anën tjetër, të gjitha këto veprime i arsyetonin kinse me padrejtësitë që u janë bërë serbëve dhe synimet nacionale e separatiste shqiptare.

Pas demonstratave të rinisë e studentëve shqiptarë të vitit 1981, veprimtaria dhe qëndrimet antishqiptare të qeverisë së Beogradit u intensifikuan. Në këtë vit, qeveria e Beogradit iu fut punës për aprovimin e masave kundër shqiptarëve dhe për përgatitjen e terrenit politik për sllavizimin e Kosovës. Duke marrë shkak nga kërkesat e drejta të demonstruesve dhe në emër të luftës kundër nacionalizmit, irredentizmit dhe separatizmit shqiptar, nëpër mbledhjet e ish-LKJ-së, pastaj të organeve politike e ekzekutive, nga ish-federata, republikat e deri në krahina, u hap një luftë frontale kundër rinisë shqiptare, kundër atyre që kishin kërkuar statusin e Republikës

¹⁷³ KOSMET ili KOSOVA, v. e c., Punim i dr. H. Bajramit, fq. 170.

¹⁷⁴ E njëjtë.

për Kosovën në kuadër të ish-Federatës. Kundër demonstruesve u përdor fjalori më fashist dhe u nxorën me mijëra vendime shoveniste e nacional-fashiste, si dhe u sanksionua dhuna.

Pas demonstratave të vitit 1981, pushteti jugosllav, përkatësisht ai serb, i hyri planit të ri me qëllim të rikonizimit të Kosovës me popullatë sllave, përkatësisht organizimin e aksionit kinse të kthimit të serbëve dhe malazezëve të shpërgulur nga Kosova. Pushteti serb i mbështetur nga ai jugosllav e herëherë edhe nga ai kosovar, duke e shfrytëzuar këtë klimë filluan të aprovojnë vlerësime, platforma, rezoluta e programe kinse për kthimin e serbëve dhe malazezëve në Kosovë, në të vërtetë përgatitej vala tjetër e kolonizimit të Kosovës me elementin sllav.

Të nxitura nga memorandumit i ASHA të Serbisë (1986), madje, individë e parti të ndryshme çështjen e rikonizimit të Kosovës, e ngrenë edhe në Parlamentin serb me arsyetim se gjatë Luftës së Dytë Botërore u bë kolonizimi i Kosovës me shqiptarë nga Shqipëria. Siç dihet në fillim flitej më mëse qindra mijëra kolonë shqiptarë, më vonë për dhjetëra mijëra e më në fund u konstatua nga ana e Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme, se në Jugosllavi prej vitit 1949-1956 nga personat e ardhur kishin mbetur vetëm 754 emigrantë shqiptarë, kurse nga ai numër vetëm 243 banorin në Kosovë. Megjithatë, kjo e vërtetë nuk pengon këto qarqe dhe qeverinë e Serbisë që të propaga-ndojë e të veprojë haptas për ndërrimin e strukturës kombëtare në Kosovë dhe për kolonizimin e saj me elementin serb. Një veprimtari të tillë Serbia edhe e ligjësoi.

Përveç kësaj, qeveria e Beogradit arriti të mobilizojë gjithë popullin nën parullën “Serbi unike”. Disa vjet rresht u organizuan me qindra mitingje e demonstrata antishqiptare. Për të bërë kthesa naciona-liste nga Qeveria Serbe u organizuan marshime dhe demonstrata shoveniste në Kosovë, në Serbi dhe para organeve serbo-jugosllave në Beograd. Parullat e tyre ishin: “*Kosova është Serbi*”, “*Kosova është zemra e Serbisë*”, “*Kosova është tokë e shenjtë serbe*”, “*Ne do të luftojmë për këtë vend të tokës së vjetër serbe*”, “*Serbi mos e lësho Kosovën nga dora*” etj. Kjo qeveri serbe para organeve shtetërore përdori si paravan shpërnguljen nga Kosova të serbo-malazezëve. Ky ishte vetëm një pretekst i pabazë dhe jashtë realitetit.

Përkitazi me politikën e punësimit, vetë pushtetarët serbë bënë propagandë dhe nxitje të serbëve dhe të malazezëve kinse për shpërngulje, por me qëllim të punësimit të tyre pa kurrfarë kriteriumi. Kështu, në vitin 1987, në komunën e Prishtinës punë pritinin 18.500 njerëz, nga të cilët vetëm 2600 ishin serbë e malazezë. Mirëpo, në Prishtinë për nëntë muaj të vitit 1987 janë punësuar 442 serbë dhe 42 malazezë, nga 2263 të papunësuar në atë kohë. Rëndësi të posaçme nga organet e atëhershme i kushtojë punësimit të personave që përherë të parë vijnë e punojnë dhe të jetojnë në Kosovë. Kështu, vetëm në komunën e Prishtinës në vitin 1987 janë punësuar 110 persona që përherë të parë punojnë e jetojnë në komunën e Prishtinës. Shumica nga këta ishin punësuar në Elektroekonominë e Kosovës, në organet e administratës etj. Kjo ishte një prej formave të kolonizimit të Kosovës me elementin sllav.¹⁷⁵

Më 23 mars 1989, kur Kosovës iu morë subjektiviteti i saj në ish-RSFSJ dhe iu shfuqizua Kushtetuta e vitit 1974, veçanërisht pas 5 korrikut 1990, kur Serbia në mënyrë klasike e okupoj Kosovën, mbretëron një politikë tejet nacional-shoveniste dhe ekspansioniste e Serbisë ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Ndërsa, në anën tjetër, më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës dhe aprovoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Më 7 shtator 1991 qytetarët e Kosovës u deklaruan me referendum për pavarësinë e Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës i bëri kërkesë komisionit të Badinterit në kuadër të Konferencës ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë që në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë të njohë

¹⁷⁵ Arkivi i Qytetit Prishtinë, Fondi: Lidhja Socialiste e Popullit Punues të komunës së Prishtinës, raport. Fondi i parregulluar dhe i paevidencuar.

shtetin e pavarur të Kosovës. Më 1992, në Kosovë u mbajtën zgjedhjet presidenciale e parlamentare. Mirëpo, kërkesave demokratike të popullit të Kosovës, pushteti serb u është përgjigjur me dhunë e terror të organizuar shtetëror që ka pasur për qëllim spastrimin etnik të Kosovës dhe serbizimin e saj.

Krahas përcaktimit politik për serbizimin e Kosovës, Serbia me vazhdimësi ka nxjerr ligje dhe akte normative me prmbajtje diskrimi-nuese, të veçanta për Kosovën. Pushteti serb kishte aprovuar rreth 1360 akte politike, juridike, të përgjithshme e të veçanta, në funksion të rikolonizimit të Kosovës me serbë e malazezë. Ato kanë qenë ligje thjesht kolonizuese. Me to u krijua mbështetja ligjore për kolonizimin e Kosovës me elementin sllav. Me ligje të tilla u shndërrua Kosova në koloni të tipit monarkik të Serbisë.

Ish Federata jugosllave dhe republikat e saj ndanin mjete të mëdha për stimulimin e ardhjes sa më masive të serbëve në Kosovë. Privilegjet e serbëve ishin shumë të mëdha: sigurimi i punësimit, i banesave, i trojeve falas, i kredive afatgjate pa kamatë, për të njëjtin vend pune të ardhurat shumë më të mëdha dhe benificione të tjera. Në këtë periudhë filloi ngritja e reparteve industriale në enklavat serbe dhe ndërtimi i objekteve segregacioniste të banimit dhe të tjera.

Vala e re e kolonizimit filloi me sjelljen e policëve, të instruk-torëve të lartë ushtarakë, të gjykatësve dhe administratorëve për t'i ndjekur e torturuar sa më tepër shqiptarët. Me 1988 dy Kryesitë e Jugosllavisë Socialiste (Kryesia e LKJ-së dhe Kryesia e Jugosllavisë) dhe qeveria kërkuan kolonizimin e Kosovës përmes një aksioni për kinse dhënien e ndihmës kuadrore Kosovës: në arsim, kulturë, jurisprudencë, polici etj. Ish Federata jugosllave dhe njësitë e saj në këtë mënyrë stimulonin represionin dhe segregacionin në Kosovë dhe ndihmonin realizimin e synimeve të kahmotshme të politikës hegjemo-niste të Serbisë.

Serbia, më 8 mars 1990 abrogoi *“Ligjin mbi revizionin e ndarjes së tokave kolonistëve në Kosovë e në Maqedoni”*, me të cilin sipas llogarive do të duhej t'u kthehej toka rreth 14 mijë familjeve serbe, që kishin ardhur si kolonë në Kosovë ndërmjet dy Luftërave Botërore, çka si pasojë pati që shumë ish familje kolone serbe e malazeze të marrin prona të reja toke të kooperativave bujqësore, apo para të majme si “kompensim”. Ndërsa, në *“Ligjin për formimin e fondit për kthimin e serbëve dhe malazezëve në Kosovë”*, parashihej sigurimi i mjeteve për kolonizim nga tatimi në të ardhura, legata dhe dhuratat, nga kamatat dhe burimet tjera.

Pasojat e këtij diskriminimi në aspektin legjislativ goditën pa mëshirë të gjitha sferat e jetës shoqërore në Kosovë. Nëpërmjet të sjelljeve të ligjeve dhe akteve normative diskriminuese, shqiptarët u përjashtuan nga jeta ekonomike, politike e shoqërore. Kështu u paralizua tërë jeta ekonomike e shoqërore në Kosovë dhe më gjerë, duke thelluar edhe më tepër krizën ekonomike me pasoja katastrofale, sidomos për rreth 130.000 punëtorë shqiptarë, që mbetën pa punë dhe pa mjete për ekzistencën e tyre dhe të familjeve të tyre, shumica e të cilëve u detyruan që ta marrin rrugën e mërgimit në vende të ndryshme të botës, sa për të siguruar një ekzistencë. Politika e pabarazisë dhe e diskriminimit u manifestua në një formë të veçantë edhe në sferën e arsimit.

Për këtë qëllim ishte hartuar edhe *“Platforma politike për Kosovën”* e LKJ që parashihej kolonizimi i Kosovës përmes aksionit të kinse kthimit të serbëve dhe malazezëve. Pastaj, ishte hartuar Projekti për kthimin e rreth 200.000 serbëve e malazezëve për të jetuar në Kosovë. Ky projekt ishte një dokument, ku bëhej ngarkim kolonizues i Kosovës me serbë dhe me malazezë, përkundër faktit se Kosova kishte dendësinë më të madhe të popullsisë, 200 ban/1 km² (dy herë e gjysmë më shumë se mesatarja në ish-Jugosllavi). Për kolonizim të tipit klasik Kosova nuk ka pasur kurrfarë kushtesh, sepse është territor me i dendur i banuar në këtë pjesë të Evropës, sidomos në pikëpamje të dendësisë agrare, me potenciale të mëdha të fuqisë punëtore të papunësuar, me zhvillim të pamjaftueshëm të kapaciteteve përpunuese dhe me një shkallë shumë

të ulët të finalizimit të lëndëve të para që disponon vetë. Në anën tjetër shkatërrimi i bazës ekonomike të Kosovës, plaçkitja e fondeve dhe e teknologjisë nga ana e pushtet-mbajtësve serbë nuk shkon në favor të popullzimit plotësues. Por qëllimi kryesor i pushtetit okupues ishte tendenca për ndërrimin e përbërjes kombëtare të Kosovës. Në anën tjetër, shume vendbanime, madje edhe krahina të tëra rurale agrare në Serbi kishin mbetur të zbrazëta, pa popullsi. Por pushteti nuk ka vendosur atje refugjatë serbë, ku kishte tokë të mjaftueshme dhe kushte elementare për arsye se nuk e kishte këtë qëllim, por qëllimin e kolonizimit të Kosovës me serb dhe ndërrimin e strukturës nacionale.

Nga pushteti i asaj kohe ishte hartuar edhe i ashtuquajti Programi jugosllav për Kosovën, i datës 9 shkurt 1990. Nëpërmjet të këtij programi, pushteti mendohej që në mënyrë të rafinuar dhe perfide, në dallim nga regjimet e mëparshme serbe të ndryshojë strukturën etnike dhe të vëjë baraspeshën etnike në Kosovë, duke bërë presion pa presedan në shqiptarët që t'i lëshojnë vatrat e veta, ndërsa në vend të tyre të sjellë serbë e malazezë me qëllim të sllavizimit dhe të kolonizimit të Kosovës. Ai program synonte marrjen e masave konkrete në të gjitha fushat: politike, ekonomike, kulturore, arsimore, shëndetësore, gjyqësore, informative, të punësimit, të urbanizmit, zhvillimit demografik etj. Programi i tillë i cili barte një titull mjaft cinik *“Programi për realizimin e paqës, lirisë, barazisë dhe prosperitetin e Kosovës”*, i njohur si *“Programi për Kosovën”*, thjeshtë ishte program diskriminues dhe racist. Me të parashihej hapja e vendeve të reja të punës, përparësi në punësim, stimulime të veçanta për investime në programet për punësim, të gjitha për kthyerje, përkatësisht ardhje të një numri më të madh të serbëve dhe malazezëve në Kosovë që të jetojnë e punojnë këtu dhe të pengojnë shpërnguljen e tyre nga Kosova; parashihet zvogëlimi i të gjitha kuadrave shqiptare në institucionet shoqërore dhe organizatat ekonomike, parashihte nxjerrjen e ligjit të posaçëm me të cilin do të themelohej Fondi për sigurimin e kushteve materiale për zhvillimin e Kosovës, në mënyrë që të pengohet shpërngulja e serbëve dhe e malazezëve, kthyerja dhe ardhja e të rinjve. Gjithashtu, parashihej shqyrtimi i mundësisë së punësimit të shqip-tarëve në vendet tjera të Jugosllavisë në pajtim me *“Programin për Kosovën”*; parashihte ndërtimin e 30 reparteve të ndërmarrjeve serbe në vendet ku kryesisht në to jetonin serbët, malazezët, myslimanët, goranët, përkatësisht në vendet ku serbët dhe malazezët dëshirojnë të kthehen që të punojnë e jetojnë në Kosovë - në Leposaviq, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Zubin Potok, Novobërdë, Shtërrpc, Lipjan, Gjilan, Obiliq, Ferizaj, Kamenicë dhe në bashkësitë lokale në Graçanicë dhe në Prishtinë, ku jetojnë serbët dhe malazezët.¹⁷⁶

Krahas planeve të Jugosllavisë Socialiste, të inicuar nga Serbia, edhe ajo kishte hartuar plane dhe projekte për rikolonizimin e Kosovës. Në një plan operativ parashihej ndërtimi i 30 lagjeve, ndërtimi i banesave në Gjakovë, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Novobërdë, Shtërrpcë, Lipjan, Zubin-Potok dhe në Kamenicë. Më 12 dhjetor të vitit 1991 me qëllim të kolonizimit të ri të Kosovës, në lokalet e pushimores të fëmijëve dhe të rinisë në Deçan u vendosën 100 familje me prejardhje serbe e malazeze të ikur nga Shqipëria.¹⁷⁷ Më vonë aty dhe gjetiu u vendosën edhe shumë familje të tjera.

Në kuadër të aksionit për kolonizimin e Kosovës, Jugosllavia Socialiste, më 16 shkurt 1990 kishte aprovuar Ligjin për sigurimin e banesave për nevojat e kuadrit dhe kthyerjen e personave të shpërngulur nga Kosova në periudhën 1989 deri 1993, si dhe Ligjin për realizimin e

¹⁷⁶ KOSMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i dr. Rifat Blakut, Srbija institucionalno radi na kolonizaciji Kosova, fq. 204-205.

¹⁷⁷ Cen Mazreku, Përpjekje për kolonizimin e ri të Kosovës, “Fjala”, dhjetor 1991; Kosova në vështrim enciklopedik, v. e c., fq. 51.

atij programi.¹⁷⁸ Sipas atij programi, përkatësisht ligji, parashihej ndërtimi i 2.000 banesave në sipërfaqe 115.273 metra katrorë dhe ndarja e 711 trojeve dhe kredive për ndërtimin individual, me vlerë të mjeteve për realizimin e atij programi në shumë prej 20.075.712 dinarë. Pas shkatërrimit të ish Jugosllavisë, apetitet për kolonizim të Kosovës ishin ngritur edhe më tepër. Për këtë qëllim Kuvendi i të ashtuquajturës RFJ, më 17 mars 1994 kishte aprovuar Ligjin për sigurimin e banesave për nevoja të kuadrit dhe kthyerjen e personave të shpërngulur në Kosovë.¹⁷⁹ Sipas atij ligji parashihej që në periudhën prej vitit 1994 deri 1998 për këto nevoja, të ndërtohen ose të blehen 1.564 banesa. Në vitin 1994 ishte paraparë që të kryhet ndërtimi i 1.024 banesave të filluara më parë.¹⁸⁰

Me dispozita ligjore ishin përcaktuar kushtet dhe kriteret për dhënien e kredive dhe ndarjen e banesave kategorive të caktuara të “kuadrave” dhe personave të cilët kthehen në Kosovë. Pastaj, përcaktohej ndarja e placeve për ndërtimin e shtëpive për kolonë etj.

Më 6 gusht 1992, Serbia aprovoi një “Program për formimin e fondit për zhvillimin e Serbisë”, në të cilin siguroheshin mjetet për vazhdimin e fushatës së kolonizimit.

Një ndër aktet juridike sistimore më ekstreme është “Ligji për Organizimin Territorial të Serbisë”.¹⁸¹ Sipas nenit 7 të këtij Ligji “*Qeveria e Serbisë mund t’ua ndryshojë emërtimin (toponimin) vendbanimeve ekzistuese sipas përcaktimeve me atë ligj, pas mendimit paraprak të marrë nga kuvendi i komunës*”. Me dispozitat e nenit 72, paragrafi 1, të Ligjit të sipërsëhënuar, “*Organet e Komunës së Malishe-vës pushojnë se punuari ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji*”. Në anën tjetër, formohen komunat e reja si Zubin Potoku, Zveçani, Shtërpca dhe Gora. Me dispozitat e nenit 73 të Ligjit në fjalë, kuvendet komunale detyrohen t’i “*rishqyrtojnë emërtimet ekzistuese të vendbanimeve dhe të caktojnë emërtime të reja në afat prej një viti nga dita e hyrjes së tij në fuqi*”. Kjo do të thotë se së pari përmes akteve juridike fillohet me sllavizimin e toponomisë autoktone shqiptare.

Me ligjin e Serbisë mbi transformimin e pasurisë shoqërore në ate privatë parashihej që nga shitja e pasurisë shoqërore 60% të mjeteve të ndaheshin për fondin për zhvillimin e Serbisë, me të cilin siç u pa financohej kolonizimi i Kosovës.¹⁸²

Përveç organeve të pushtetit, edhe organizatat e ndryshme, personat, shoqatat e tjerë jepnin propozime të ndryshme për kolonizimin e Kosovës. Ishte dhënë propozimi për sjelljen e 400.000 serbëve nga Rumania¹⁸³ mendohej madje edhe versioni izrailit i kolonizimit të Kosovës, pastaj propozimi që kolonizimi i Kosovës të bëhet menjëherë, duke e bërë Prishtinën kryeqytet të Serbisë e të Jugosllavisë, ku do të bartën të gjitha institucionet shtetërore, shkollat ushtarake e policore, shumë oficerë, nëpunës, policë etj. me familje. Kjo valë e kolonizimit do të kapte një numër prej 100.000 serbësh e deri të kërkesa e disa funksionarëve kosovarë serbë që në Kosovë menjëherë të vijnë së paku 300.000 serbë e malazezë.¹⁸⁴

Shoqata e serbëve dhe e malazezëve “Bozhuri” e Fushë-Kosovës përcaktoi një program për kolonizimin e Kosovës. Ky program operativ, nuk dallon shumë nga programet e tjera të mëhershme, sepse në esencë ai është një konglomerat i kërkesave të prezantuara tash e sa vjet, si në tubimet serbo-malazeze, po ashtu edhe në forumet e pushtuara të Kosovës. Si kërkesë e parë e tij veçohet obligimi për ndërtimin e lagjeve dhe të paralegjeve me më se paku nga njëqind

¹⁷⁸ “Sl. List SFRJ”, nr. 9/1990; KOSOMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i Dr. Rifat Blakut, fq. 206.

¹⁷⁹ “Sl. List SRJ”, NR.24/1994; KOSMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i Dr. Rifat Blakut, fq. 206.

¹⁸⁰ KOSMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i Dr. Rifat Blakut, fq. 207.

¹⁸¹ “Sl. Glasnik RS”, nr. 47/94.

¹⁸² Dr. Hakif Bajrami, Politika, v. e c., fq. 189.

¹⁸³ “Jedinstvo”, Prishtinë, 7.X 1989; Dr. Hivzi Islami, Kosova, v. e c., fq. 173.

¹⁸⁴ “Jedinstvo”, Prishtinë, 28-30.XII 1989; Dr. Hivzi Islami, Kosova, v. e c., fq. 173.

ekonomi shtëpiake anekënd Kosovës, obligim ky që duhet ta jetësojë Serbia, përkatësisht drejtoria për zhvillimin e “Kosmetit”. Më pastaj radhiten kërkesat e tjera, si ajo për fillimin e menjëhershëm të përgatitjes së lokacioneve për ndërtimin e vendbanimeve të reja dhe atyre ekzistuese, kthimi i maleve të uzurpuara nga shqiptarët (!) në pronësinë shtetërore, me kusht që ato pastaj t’u ndahen serbëve dhe malazezëve; vendosja e familjeve serbe në trojet, që u shitën në kundërshtim (!) me ligjin sikundër dhe në tokat e ekspropriuara, siç janë ato në Brezovicë, Gazivodë, Radoniq e gjetiu; kërkesa për nxjerrjen e Ligjit për ndalimin e ndarjes së tokave të punëshme shoqërore shqiptarëve; kërkesa për anulimin e Ligjit për ndalimin e kthimit të serbëve në Kosovë; kërkesa për nxjerrjen e vendimit për përzënie të emigrantëve shqiptarë që nuk kanë shtetësinë jugosllave; ndalimi i punës së partive, të shoqatave dhe të asociacioneve të tjera që po eksponohen “armiqësisht” etj. Natyrisht, “Bozhuri” nuk harroi të kërkojë edhe nxjerrjen e ligjit diskriminues, atij për planifikimin e familjes.¹⁸⁵

E ashtuqytura qeveria jugosllave, më 12 janar 1995 e kishte aprovuar dekretin, ku sipas tij nga buxheti federativ për këtë vit, për ndërtimin e kolonive në Kosovë duhet të ndahen 4,1 milion dinarë. Me këtë dekret plotësisht antishqiptar përkrahej kolonizimi i Kosovës me popullatë serbe e malazeze; *“Të gjithë qytetarët e shpërngulur nga Kosova e Metohija, të cilët janë të ineresuar që të kthehen dhe kuadrat të cilët dëshirojnë të vijnë në këtë krahinë, për ndërtimin e shtëpive ose blerjen e banesave do të marrin kredi me afat kthimi prej 40 vjetve, ndërsa place - pa pagesë”*. Sipas këtij dekreti përparësi kishin: a) kuadrat e domosdoshme për organe të administratës, gjyqësi, shërbime ekonomiko-shoqërore dhe të kthyerit, të cilët janë shpërngulur para 31.12.1991; b) kuadrat dhe personat tjerë, të cilët punojnë në administratën e shërbimeve shoqërore-ekonomike të KAKM (kuadrat e sjellura pas okupimit të sërishëm); c) personat, të cilët kanë numër të madh të anëtarëve të familjes. Me aprovimin e këtij dekreti zyrtarët beogradas parashihnin mundësinë e realizimit të programit për vendo-sjen e 100.000 serbëve dhe malazezëve në Kosovë.¹⁸⁶

Edhe në lëmin e pronësisë, në kontest të kolonizimit u bë kalimi i kompetencave nga organet e Kosovës në ato të Serbisë. U nxorr Ligji, i cili e përkufizonte shitblerjen e patundshmerisë.¹⁸⁷ Sipas tij, Sekretariati Republikan i Serbisë për Financa mund të lejojë shitblerjen e patundshmerisë vetëm nëse vlerëson se me atë nuk do të ndikojë në ndërrimin e strukturës etnike të popullsisë, ose shpërnguljen e popullit të caktuar. Ky ligj aplikohet vetëm për Kosovë, ndërsa “populli i caktuar” ishin serbët dhe malazezët. Sipas këtij ligji dhe të tjerëve me qindra kontrata të shitblerjes u anuluan. Shumë hektarë tokë dhe dhe me qindra shtëpi e banesa iu morën shqiptarëve.

Një aksion konkret të kolonizimit të Kosovës, Serbia ndërmori edhe përmes ndryshimit të planeve urbanistike të Kosovës dhe të komunave të saj. Ato ndryshime janë bërë në kundërshtim me Ligjin e rregullimit hapësinor, të mbështetura vetëm në dispozitat (diskriminue-se) të Ligjit për punën e organeve republikane në rrethana të veçanta. Kuvendi i Serbisë në këtë drejtim, ka aprovuar edhe vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për planin detaj urbanistik të lagjes “Ulpiana” në Prishtinë, me të cilin ishte paraparë që në vend të objekteve sportive të shkollës fillore, kanë ndërtuar objektet për banim të 110 banesave për serbë e malazezë nga trevat tjera të Jugosllavisë të cilët dëshirojnë të kthehen ose të vendosën në Kosovë që aty të jetojnë e punojnë. Për këtë qëllim Kuvendi i Serbisë, ka marrë vendimin për ndërrimin dhe

¹⁸⁵ E. Bajçinovci, Variante të reja për kolonizimin e ri të Kosovës, “Bujku”, 14.VI 1991.

¹⁸⁶ “Sl. Novine SRJ”, nr.4/1995; KOSMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i Rifat Blakut, fq. 207.

¹⁸⁷ Hysen Ibra, Shkatërrimi i hapsirës së Republikës së Kosovës nga okupatori serb (1989-1997), Prishtinë 1998, fq. 97.

plotësimin e planit urbanistik të lagjes “Dardania” në Prishtinë, në të cilin ishte e paraparë që në vend të lokalitetit për gjelbërim të ndërtohen objekte për banim të 98 banesave për serbë e malazezë.¹⁸⁸

Serbizimin e Kosovës pushteti aktul serb e ka zbatuar edhe me ndërtimin e kishave në qendrat urbane, ndërrimin e emrave të shkollave, rrugëve, shesheve, organizatave të ndryshme dhe emërimi me emra mitologjikë serb. Shkrimi i çirilicës dominonte kudo.

Siç po shihet shqiptarët në Kosovë ishin të diskriminuar në shkollim, kulturë, punësim, mbrojtje shëndetësore e sigurim social, në mbrojtjen juridike të integritetit fizik dhe moral, në informim, në ekonomi, politikë dhe në të gjitha sferat e jetës dhe të punës së tyre.

RFJ, për kolonizimin e 100.000 serbëve dhe malazezëve në Kosovë me Dekretin mbi mënyrën dhe kushtet e kolonizimit të Kosovës të datës 12 janar 1995, përcakton dhënien falas për kolonët serbë troje, tokë, banesa, shtëpi dhe mjete financiare shumë të mëdha. Sipas gazetës serbe “Jedinstvo”, organet e qeverisë serbe të Obiliqit kanë planifikuar ta ndërtojnë një vendbanim ndërmjet Millosheviqit dhe Obiliqit, me 247 shtëpi (familje) për kolonët serbë të Kroacisë. Po ashtu, parashihet që kolonëve serbë, që duan të merren me bujqësi, t’u jepet edhe tokë bujqësore prej tre hektarësh”.¹⁸⁹

Pas rënies së të ashtuquajturës Krainë Serbe në Kroaci (gusht 1995) u intensifikua kolonizimi i Kosovës me serbë të ikur nga Kroacia. Brenda një kohe të shkurtër në Kosovë, u vendosën 13.895 kolonë serbë. Përveç Kroacisë në Kosovë u vendosën edhe shumë serbë nga Bosnja, por edhe nga vetë Serbia. Sipas planeve të mëhershme serbe, të inicuar nga kryetari serb Millosheviq, planifikohej që në Kosovë të vendoseshin disa dhjetëra mijëra refugjatë, rebelë (kryengritës) dhe kriminelë serbë që do të largoheshin nga Kroacia e nga Bosnja e Hercegovina. Refugjatët serbë u vendosën në 23 objekte shkollore, 8 konvikte të nxënësve dhe të studentëve, 7 çerdhe fëmijësh, 21 hotele dhe pushimore, në 2 shtëpi shëndeti, në 9 objekte kulturore-sportive dhe në 35 objekte të tjera të Kosovës.¹⁹⁰ Në ndërkohë, apo më vonë u vendosën edhe në shumë objekte të tjera të organizatave punuese, enteve, institucioneve, fabrikave e të tjera, nga një apo dy familje, ku punësoheshin dhe vendoseshin aty. Madje, çka është kundër të gjitha normave ligjore ndërkombëtare, u vendosën edhe në objekte të arkivit, ku ruhet lënda arkivore si monument i kulturës, siç është rasti me Arkivin e Kosovës, Arkivin e Qytetit të Prishtinës etj. Ata përveç, rrogave të majme, ishin të liruar nga të gjitha pagesat, si p.sh. të rrymës elektrike, telefonit, taksave e tatimeve komunale, madje edhe të udhëtimit etj. Numri i kolonëve të vendosur nëpër ato objekte dita më ditë rritej.

Në bazë të një dokumenti të Këshillit Krahinor të të ashtu-quajturës “SPS” për “Kosovë e Metohi”, me titull “*Predlog mera za rešavanje aktualnih problema na Kosovu i Metohiji*”¹⁹¹ (“Propozimi i masave për zgjedhjen e problemeve aktuale në Kosovë e Metohi”), Prishtinë, 15 dhjetor 1998, nën pikën 7, jepën shënimet për numrin e personave të hikur (sipas komunave) dhe propozimi i masave për kujdesjen e tyre të përhershme dhe se a dojnë të mbesin këtu. Sipas atyre shënimeve në Kosovë ishin vendosur këta refugjatë:

- Në komunën e Gjakovës - jetojnë 250 refugjatë, dhe se të gjithë dëshirojnë të mbesin aty;
- Në komunën e Gorës nuk ka refugjatë;

¹⁸⁸ KOSMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i Rifat Blakut, fq. 205.

¹⁸⁹ Hysen Ibra, Shkatërrimi, v. e c., fq. 156.

¹⁹⁰ E njëjtë, fq. 190.

¹⁹¹ Arkivi i Kosovës në Prishtinë, Fondi: Këshilli Ekzekutiv Krahinor. (Fondi i parregulluar dhe dokumenti i paevidencuar).

- Në komunën e *Suharekës* nga 470 personave të dëbuar prej 8.08.1995, kanë mbetur 80 persona, nga të cilat 24 familje dhe 21 individë. Arsyja e largimit nga kjo komunë është moszgjidhja e problemit të banimit sepse një kohë të gjatë kanë jetuar në vendosje kolektive;

- Në komunën e *Rahovecit*, sipas evidencave janë lajmëruar 82 refugjatë. Nga këta 52 kanë shkauar në Prishtinë, kështu që sot jetojnë në këtë komunë 52 persona refugjatë;

- Në komunën e *Prizrenit*, momentalisht përkujdesën 380 persona, të cilët shumica janë të vendosur në vendosje kolektive dhe se për zgjidhjen e problemit të tyre të përhershëm duhet ndarë banesat përkatëse dhe të sipërfaqeve të caktuara të tokës bujqësore;

- Në komunën e *Novabërdës*, momentalisht jetojnë 42 refugjatë, dhe se asnjë nga ata nuk dëshiron të mbetet aty për shkak të se thojnë nuk kanë perspektivë;

- Në komunën e *Kamenicës* jetojnë 55 refugjatë. Që këta të mbesin këtu duhet ndërtuar shtëpi, ndarë tokë dhe eventualisht të punësohen;

- Në territorin e komunës së *Vitisë* momentalisht jetojnë rreth 150 refugjatë, 50% nga të ardhurit në vitin 1995. Më ndërtimin e shtëpive, ndarjen e trojeve, punësimi dhe ndarja e tokave ata përherë do të zgjidhet çështja e plotësimit të nevojave të tyre;

- Në territorin e komunës së *Gjilanit* qëndrojnë rreth 300 refugjatë nga Republika e Krainës Serbe. Gjysma e tyre janë të punësuar, dhe për përkujdesjen e tyre duhet zgjidhur çështjen e banimit duke ndërtuar lagjen e refugjatëve, e cila është e paraparë në lokacionin “Przhin Breg” të Jugopetrolit;

- Në territorin e komunës së *Leposaviqit* jetojnë 253 refugjatë, 40 familje dhe 12 individë, nga të cilët 140 kanë shprehur dëshirën që të jetojnë dhe punojnë në komunën e Leposaviqit duke u siguruar lokalitete banesore dhe punësimin;

- Në komunën e *Zubin Potokut*, jetojnë 195 refugjatë nga Kraina, ndërsa persona të çvendosur përkohësisht nga Kosova 154 dhe shumica nga ata kanë shprehur dëshirën që të mbesin përherë në territorin e komunës;

- Në komunën e *Mitrovicës* momentalisht jetojnë 470 refugjatë. Dëshirën që përherë të jetojnë dhe punojnë këtu e kanë shprehur 47 familje. Ndërtimi i lagjes së refugjatëve dhe ndërtimin e banesave si dhe punësimi i përhershëm të tyre do të zgjidhet problemi i refugjatëve;

- Në territorin e komunës së *Zveçanit* momentalisht gjenden 199 persona të ndjekur dhe 186 persona të ikur. Shumica nga ata dëshirojnë të shkojnë jashtë dhe kthim në vendlindje. Problemi i përkujdesit të përhershëm të këtyre personave të cilët do të mbetnin në këtë komunë lehtë do të zgjidhet duke përfunduar punët e ndërtimit të lagjes së refugjatëve në Zveçanin e Vogël, e cila ka hyrë në vitin e pestë të ndërtimit;

- Në komunën e *Shterrpcit* jetojnë 55 persona të ikur. Të gjithë janë të interesuar të mbesin dhe të jetojnë në këtë trevë me kusht që të zgjidhet çështja e banimit dhe punësimi;

- Në komunën e *Skënderajt* ka ende edhe 20 refugjatë të cilët dëshirojnë që përherë të mbesin në këto treva;

- Në komunën e *Kaçanikut* janë të vendosur 41 persona të ikur dhe të dëbuar dhe 16 familje. Të gjithë këta kanë shprehur dëshirën që të jetojnë në këtë mes, dhe se të gjithë të aftët për punë janë të punësuar në veprimtaritë ekonomike dhe shoqërore të KK Kaçanikut;

- Komuna e *Ferizaj* - Në këtë qytet jetojnë rreth 200 refugjatë, nga të cilët 56 janë të punësuar, mbi 95% kanë shprehur dëshirën që të mbesin në këto treva nëse zgjidhet çështja e banimit;

- Komuna e *Glllogocit* - Në këtë qytezë ka 60 refugjatë, të cilët momentalisht janë çvendosur dhe nuk kanë ambicje që përherë të mbesin në Glllogoc;

- Komuna e *Shtimes* - Në këtë trevë jetojnë dy familje refugjatës me 7 anëtarë të cilët dëshirojnë të mbesin këtu nëse iu ndërtohen shtëpitë familjare;

- Në territorin e komunës së *Obiliqit* jetojnë 970 refugjatë, nga të cilët afër 400 dëshirojnë të mbesin duke u siguruar vendosjen adekuate;

- Në territorin e komunës së *Pejës* jetojnë 129 refugjatë të cilët janë të vendosur në Qendren kolektive “Shkolla Ekonomike”, 27 refugjatë të cilët janë të vendosur në Qendrën kolektive Hotel “Park” në Karagaç, 43 refugjatë të cilët janë të vendosur në Qendrën kolektive “Shtëpia për fëmijë të verbët”, 33 refugjatë të cilët janë të vendosur në Hotelin “Dardania” dhe në Konviktin e studentëve;

- Në territorin e komunës së *Klinës* deri në vitin e kaluar kanë jetuar 150 persona të dëbuar nga territori i Krainës Serbe. Mementalisht jetojnë në Klinë 30 persona të dëbuar. Nga këta 6 familje ka shprehur dëshirën të mbesin që të jetojnë dhe të punojnë në trevën e kësaj komune, por kërkojnë që shteti t’ua ndërtonë shtëpitë dhe t’iu siguron punësim në komunë;

- Në komunën e *Deçanit* ka persona të ikur nga Bosnja, Hercegovina dhe Kroacia. Për gjendjen e Serbëve dhe Malazezëve të ikur nga Shqipëria, ata janë të vendosur në lagjet e reja të ndërtuara në Baballoq dhe Junik. Por ata sot nuk kanë kurrfarë burimi të të ardhurave por jetojnë nga ndihmat e komunës;

- Në komunën e *Istogut* gjithësej kanë ardhur 802 persona të ndjekur, nga të cilët 220 kanë mbetur dhe janë vendosur në këto objekte: Stacionar 1 në Banjë - 32; Hotelin “Terminal” në Banjë - 66; Shtëpinë ndëshkimore përmirsuese në Gurakoc - 37; Hotelin “Gërmeç” - në Gurakoc - 27; Në ndërtesën e Komeasarijatit në Istok - 29; Vendosje private në Istok - 29;

- Në komunën e *Fushë-Kosovës* jetojnë 524 refugjatë. Edhe pse komuna kishte pranuar rreth 2000 refugjatë, për shkak të mungesës së banesave ata e kanë lëshuar këtë mes. Në mënyrë që të mbesin këta duhet të vazhdojë ndërtimi i vendbanimit të kolonëve në Miradi të Epërme dhe se atyre që dëshirojnë të merren me bujqësi t’iu ndahet tokë bujqësore;

- Në territorin e komunës së *Lypianit* mementalisht ekzistojnë 269 persona të dëbuar dhe 17 të ikur më 1997. Nga anketa, 26 familje janë shprehur se dëshirojnë të integrohen;

- Komuna e *Podujevës* - Në vendosjen kolektive mementalisht jetojnë 34 persona të ikur nga Kroacia. 6 familje me 16 anëtarë janë shprehur se dëshirojnë përherë të jetojnë në territorin e Podujevës nëse iu sigurohet lokali banesor;

- Komuna e *Vushtrrisë* - Në vendbanimin Lumi i Madh jetojnë 323 refugjatë, në qendër kolektive 104 dhe në motel 61 të cilët dëshirojnë të mbesin këtu;

- Në territorin e komunës së *Prishtinës* gjenden 1.750 persona të dëbuar. Nga ai numër 690 janë shprehur të jetojnë në territorin e Kuvendit të Qytetit të Prishtinës.

Sipas këtij dokumenti, në tërë territorin e Kosovës janë evidencuar gjithsej 8.425 persona të ikur dhe refugjatë.

Kolonëve të vendosur në Kosovë dhe atyre që do të vendosën u janë dhënë dhe u janë premtuar 30 mijë ha tokë bujqësore, pasuri e popullit të Kosovës, kryesisht e shqiptarëve. Sidomos u ishte ndarë toka e kooperativave bujqësore, të marrë më parë nga popullata shqiptare, të bazuar në “*Ligjin mbi kushtet, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së tokës bujqësore qytetarëve, të cilët dëshirojnë të jetojnë e të punojnë në territorin e KA të Kosovës e Metohisë*”.¹⁹² Ndërsa, shumë familjeve serbe e malazeze, pushteti nëpërmjet kinse të kthimit të tokave më parë të konfiskuara, të nacionalizuara apo të ekspropriuara edhe pse ishin bërë pagesa për to ua “kthente” ato prona, ose iu jepte ndërrim ose prapë paguante shuma të mëdha të

¹⁹² “Sl. Glasnik RS” nr. 43/91, datë 20.VI 1991.

hollash, ku kishte raste edhe pse i kishin marrë të hollat, ato prapë paguheshin. Raste të tilla ishin të shumta.

Përkitazi me këtë, Këshilli Krahinor i “SPS” për “Kosovë e Metohi”, në programin e vet - “Predlog mera za rešavanje aktuelnih problema na Kosovu i Metohiji”, Prishtinë, dhjetor 1998, nën pikën tre parashihte - Sipërfaqet tokësore të cilat mund t’u ndaheshin familjeve të varfura (kuptohet serbe e malazeze J.O.) dhe familjeve të cilat dëshirojnë që përherë të kolonizohen në këto treva, siç ishte:

- Komuna e *Gjakovës* ka relativisht sipërfaqe të mira bujqësore dhe mundësi për rritjen, përkatësisht hapjen e sipërfaqeve të reja. Komuna disponon 29.436 ha tokë në sektorin shoqëror (lavruese dhe kopshte, pemishte, vneshta, livadhe, kullosa dhe pyje);

- Komuna e *Gorës* posedon me sipërfaqe punuese, utrina etj. prej 174 ha që mund të shndërrohen në tokë punuese bujqësore për familjet që dëshirojnë të vijnë dhe të jetojnë në këtë komunë dhe për pengimin e shpërnguljes së goranëve nga kjo komunë;

- Në komunën e *Suharekës* ekziston mundësia e ndarjes së tokës punuese të sektorit shoqëror në shfrytëzim në sipërfaqe prej 120 ha;

- Komuna e *Rahovecit* ka mbi 920 ha sipërfaqe punuese që t’iu ndihmojë atyre familjeve të cilat dëshirojnë të jetojnë në këtë mjedis;

- Komuna e *Prizrenit* posedon me 160 ha tokë bujqësore punuese e cila mund të iu ndahet familjeve të varfura dhe familjeve të cilat dëshirojnë të vijnë dhe të jetojnë në territorin e kësaj komune;

- Tokë punuese që posedon KK i *Novo Bërdës* është 205 ha dhe se mund të iu ndahet qytetarëve rreth 35-40 ha;

- Komuna e *Kamenicës* posedon me 260 ha pronë e Kooperativës Bujqësore “Kriva Reka” e cila punohet dhe mund t’iu ndahet familjeve të cilat dëshirojnë të vijnë dhe të jetojnë në këtë mes;

- Komuna e *Vitisë* - Nga toka në pronësinë shoqërore të cilën momentalisht e shfrytëzon Kombinati “Agromorava” është e përshtatshme për ndërtimin e vendbanimit dhe ndarjes së tokës punuese atyre serbëve dhe malazezëve të cilët dëshirojnë të jetojnë në Kosovë janë rreth 250 ha;

- Komuna e *Gjilanit* nuk ka sipërfaqe tokësore punuese e cila mund t’iu ndahej familjeve të varfëra;

- Komuna e *Leposaviqit* nuk posedon me sipërfaqet punuese, untrina dhe shkurre, sepse ato janë në pronësinë e Republikës së Serbisë dhe iu janë dhënë në pronësi NP “Srbijashuma”;

- Komuna *Zubin Potoku*. - Për ndërtimin banesor individual disa ari komuna mund të siguronte 50 troje dhe ato afër qendrës që qytetit për të kthyerit dhe refugjatët;

- Komuna e *Mitrovicës*. - Sipërfaqe punuese të cilat gjenden në pronën shoqërore, të cilat eventualisht mund të ndaheshin, është pronë e KB “Fidanishtja” në Mitrovicë, në BL Shipol - 15 ha dhe BL Frashëri - 11 ha;

- Në territorin e komunës së *Zveçanit*, në territorin malor të Rogoznës gjenden rreth 60 ha tokë punuese të cilat janë pronë shoqërore si dhe rreth 40 ha në territorin e bashkësive të tjera lokale;

- Në komunën e *Shterrpcit* nuk ka sipërfaqe punuese të cilat mund t’iu ndahen familjeve të varfëra;

- Në komunën e *Skenderaj* sipërfaqe punuese ka 3.200 ha;

- Komuna e *Kaçanikut* posedon me 42 ha sipërfaqe e cila mund t’iu ndahet familjeve të varfëra dhe familjeve të cilat dëshirojnë të jetojnë në këtë mes. 250 ha sipërfaqe është kontestuese. Kur të zgjidhet ky kontest mund të ndahen;

- Komuna e *Ferizaj*. - Ekonomia bujqësore Ferizaj posedon 1000 ha sipërfaqe punuese; Ndërmarrja “Plantazha” posedon 550 ha (325 ha në komunën e Ferizaj dhe 225 në territorin e komunës së Shtimes, Kooperativa në Tankosiq posedon 120 ha tokë punuese). Nga ajo tokë poseduese mund të ndahen 20% nga sipërfaqja e përgjithshme;

- Në territorin e komunës së *Glllogocit* mund të ofrohen 500.000,00 tokë bujqësore punuese me qëllim të kolonizimit me serbë dhe malazezë;

- Në territorin e komunës së *Shtimes* në sektorin shoqëror posedojnë me sipërfaqe punuse prej 12.827,00 ha, ndërsa në Shtime posedohet me 516.000,00 ha;

- Në territorin e komunës së *Obiliqit* ka 1333 ha sipërfaqe punuese e cila mund të ndahej familjeve të varfëra;

- Komuna e *Pejës*. - Sipërfaqja e tokës bujqësore me të cilën udhëheq organizata bujqësore në sektorin shoqëror KBI “Bujqësia”, “Kooperacioni”, “Fidanishtja” dhe Kooperativa Bujqësore është rreth 3.500 ha, nga të cilata rreth 500 ha gjenden në territorin e KK Klinës. Mund të ndahen rreth 1.200 ha sipërfaqe bujqësore punuese me qesim prodhuese bujqësor;

- Komuna e *Klinës*. - Sipërfaqe punuese në sektorin shtetëror e shoqëror e cila mund t’iu ndahej familjeve të cilat dëshirojnë të vijnë dhe të jetojnë në këtë komunë është 3.422,86 ha;

- Komuna e *Deçanit*. - Serbëve dhe malazezëve të ikur nga Shqipëria të cilët janë vendosur në vendbanimet Baballoq dhe Junik iu është ndarë 600 ha tokë punuese. Kjo komunë momentalisht posedon edhe më 40 ha tokë punuese e cila eventualisht mund të ndahet për punim;

- Në komunën e *Istogut* në pronësin shtetërore dhe industriale ka gjithsej 3.796 ha tokë. Këtë e punon NB “Juko-Dubrava”. Për ndarjen e kësaj toke duhet marrë pelqimin e ndërmarrjes dhe të Qeverisë së Republikës së Serbisë;

- Komuna e *Fushë-Kosovës*. Në territorin kadastral të fshatit Uglar dhe Miradi e Epërme ka 75 ha tokë punuese e cila mund t’iu ndahet familjeve të varfura dhe familjeve të cilat dëshirojnë të vijën dhe të jetojnë në këtë komunë;

- Në komunën e *Lipjanit* ekzistojnë këto sipërfaqe që mund t’iu ndahet familjeve të varfëra dhe atyre që dëshirojnë të vijnë dhe të jetojnë më këtë mes: ara - 131,65,13 ha; kullota - 904,56,46 ha; livadhe - 23.00,37 ha; male 296.50,94 ha dhe tokë jopjellore 14.75,42 ha;

- Komuna e *Podujevës*. - Kooperativat bujqësore posedojnë me sipërfaqe punuese e cila mund t’iu ndahet familjeve të varfëra dhe atyre që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në këtë mes dhe atë në këto fshatra: Ballofci 15 ha; Shajkoci 20 ha; Merdari 10 ha; Merdari 2 - 4 ha; Obranhja 20 ha; Shamalluku 30 ha; Dyzi 25 ha dhe Zakuti 15 ha. Gjithsej: 139 ha;

- Komuna e *Vushtrrisë*. - Fshati Gracë - 100 ha tokë punuese, në vendin “Bregu”, 7 ha sipërfaqe punuese, vendi “Korrizi” 3 ha sipërfaqe punuese, në vendin të Llapi; Fshati Maxhunaj - 60 ha sipërfaqe punuese. Gjithësej 170 ha;

- Komuna e *Prishtinës*. - Sipërfaqe bujqësore të cilat mund t’iu ndahen familjeve të varfëra dhe familjeve që dëshirojnë të vijnë dhe të jetojnë në këtë mes është 72,36,80 ha. Sipërfaqja gjendet në BL Nëntë Jugoviqët, Hajvali, Graçanicë, Llapllasellë, Kolovicë dhe Sofali. Në territorin e Kuvendit të Qytetit të Prishtinës në sektorin shoqëror ka 1000 ha tokë punuese në pronë të KB “Ratar” në Llapllasellë dhe KB “Nëntë Jugoviqët”.

Në Kosovë sipas këtij projekti janë paraparë 1.077.148,34 ha sipërfaqe bujqësore për ndarje.

Gjatë një vizite të një delegacioni zyrtar holandez, në qershor të vitit 1995, Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të Kosovës, kryetari i këtij Këshilli, zoti Adem Demaçi, në mes tjerash e kishte njoftuar atë delegacion edhe për kolonizimin serb të Kosovës,

duke thënë: Se gati një e katërta e popullatës shqiptare, madje ajo më vitalja ka emigruar jasht vendit. Serbia po i ndërmerr të gjitha masat për krijimin e kushteve për vendosjen e 100.000 kolonëve serbë dhe malazezë në territorin e Kosovës dhe ajo në mënyrë intensive po vepron dhe që nga viti i kaluar pushteti serb ka filluar ndërtimin e qendrave të banimit për kolonë serbë dhe malazezë në territorin e Kosovës.¹⁹³

Në anën tjetër, duke e parë se për ndërrimin e shpejtë të strukturës kombëtare të popullsisë së Kosovës, kolonizimi përmes programit të përmendur të ish-Jugosllavisë, programit të Serbisë të vitit 1990 dhe sjelljes së refugjatëve serbë, nuk dha rezultate inkurajuese, pushteti policor e militarist serbë vazhdoi, por tani edhe me intensitet më të shtuar një terror sistematik mbi shqiptarët, veçanërisht mbi të rinjtë me qëllim që Kosova të braktiset dhe të boshatiset. Ndërsa, si pretekst përdorej mbledhja e armëve, të cilat shqiptarët nuk i kanë, sipas skenarëve të aksionit të mbledhjes së armëve në vitet e 50-ta, si dhe ndjekja e rekrutëve shqiptarë, numri i të cilëve çdo vit është prej 18.000 deri 20.000 si dhe provokime të shumta të bëra të rinjve shqiptarë si nga vetë organet policore, pushteti, administrata si edhe nga vetë popullata serbe e malazeze, që jetonte në Kosovë. U dëbuan nga puna 130.000 të punësuar shqiptarë të Kosovës, nga 150.000 të tillë gjithsej. Funksionet shtetërore, juridike, policore si dhe të gjitha në vendet udhëheqëse kaluan tërësisht në dorë të serbëve. Sipas disa shënimeve më se 1.600 serbë e malazezë u emëruan drejtorë dhe kuadër tjetër udhëheqës në organizatat ekonomike, institucione dhe në organizata të tjera në sektorin shoqëror (kështu thonin vetë serbët dhe malazezët në paraqitjet publike).¹⁹⁴ Janë keqtrajtuar nga policia me qindra mijëra shqiptarë. Në çdo vit janë vrarë e masakruar me dhjetra persona. Vrasje e masakrime, kinse janë bërë “vetëvrasje”, bëhej sidomos ndaj ushtarëve shqiptarë në kazermat serbojugosllave.

Qeveria serbe kolonizimin e Kosovës me serbë dhe dëbimin e shqiptarëve e konsideronte si aksion të shenjtë kombëtar. Kurse për shqiptarët këto veprime përbëjnë akte gjenocidi me prapavijë deshqiptarizimi. Megjithë pompozitetin e propagandës serbe se aksioni ishte i karakterit humanitar, është e qartë se qëllim kryesor ishte ndryshimi i strukturës etnike të popullsisë dhe kolonizimi i Kosovës.¹⁹⁵

Për kolonët serbë e malazezë pushteti aktual ndërtoi shtëpi, por edhe koloni vendbanimi. Kështu ndërtoi rreth 119 shtëpi afër Junikut, mbi 180 shtëpi (1996) afër fshatit Baballoq dhe fillimi i ndërtimit të vendbanimit të ri në anën tjetër të rrugës, ndërtimi i 76 shtëpi në Lum të Madh të Vushtrisë, në Kodrën e Diellit në Prishtinë 160 shtëpi, kompleksi banesor në lagjet “Ulpianë”, “Dardani” etj., në Shirokë të Suharekës, në Miradi të Epërme 80 banesa për kolonë etj. Kishte ndryshuar planin urbanistik të shumë qyteteve dhe fshatrave si dhe të zonave industriale për ndërtimin e vendbanimeve kolone, si në Gjilan, Prishtinë, Prizren, Klinë, Sufrekë, Vushtrri, Istog, Deçan, Zveçan etj.¹⁹⁶ Mirëpo, kishte raste kur kishin dështuar planet serbe për kolonizimin e Kosovës. Këtë e dëshmon rasti në komunën e Istogut, kur tri blloqesh banesash, të cilat ishin ndërtuar për kolonët përkatësisht për malazezët nga Vrraka e Shqipërisë, i ndanë mes tyre serbët dhe malazezët që jetonin në këtë komunë.

Përkitazi me numrin e kolonëve të vendosur në Kosovë në këtë periudhë nuk kemi shënime të sakta, sepse vetë pushteti nuk ka dashur që ato t’i paraqesë, mu për shkak të politikës dhe qëllimit të caktuar. Mirëpo, sipas disa shënimeve që posedojmë mund të theksojmë këtë: Pas

¹⁹³ “Bujku”, 7 qershor 1995.

¹⁹⁴ KOSMET ili KOSOVA, v. e c. Punimi i Dr. R. Blakut, fq. 207.

¹⁹⁵ Dr. Fehmi Rexhepi, Kolonizimi i Kosovës pas heqjes së autonomisë së saj nga ana e Serbisë 1990-1995, “Kosova” nr.6/1997, fq. 20. Prishtinë, 1997.

¹⁹⁶ Shif: “Sl. List RS” nr. 68/91; 61/93; 4/92; 47/92; 35/94; 68/94; H. Ibra, Shkatërrimi, v. e c., fq. 156.

rënies së të ashtuquajturës Krainë Serbe në Kroaci (gusht 1995) u intensifikua kolonizimi i Kosovës me serbë të ikur nga Kroacia. Brenda një kohe të shkurtër në Kosovë, u vendosën 13.895 kolonë serbë.¹⁹⁷ Përveç nga Kroacia në Kosovë u vendosën kolonë edhe nga Bosnja, por edhe nga vetë Serbia; Sipas një shënimi tjetër në Kosovë deri në vitin 1997 janë vendosur rreth 20.000 kolonë serbë, malazezë e të tjerë.¹⁹⁸ Sipas disa shënimeve që i jep dr. Hakif Bajrami,¹⁹⁹ Serbia prej vitit 1981 e deri në vitin 1995 ka ndarë për kolonët serbë së paku 5.519 banesa e shtëpi. Nëse një familje mesatare ka 5 anëtarë, atëherë del se përmes planeve të ndryshme të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë në Kosovë janë sjellë 27.595 kolonë. Ky numër deri në vitin 1998-99 është rritur edhe më shumë.

Edhe pse në Kosovë kishte filluar lufta për çlirim kombëtar nga ana e popullatës shqiptare në krye me UÇK-së, ushtria, policia dhe paramilitarët serbë bënë gjenocid mbi popullatën shqiptare, partia politike serbe në pushtet “SPS” siç u theksua më lartë në fund të vitit 1998 hartonte plane, siç thonte - “Propozim i masave për zgjedhjen e problemeve aktuale në Kosovë e Metohi”. Në hyrje të atij projekti në mes tjerash theksohej: *“Për mbetjen e Kosmetit në Serbi më e rëndësishma është që Serbët dhe Malazezët të mbesin në këto treva. Që të ruhet Kosova dhe Metohia duhet që shteti të ndërmerr masa urgjente për shkatërrimin e terrorizmit dhe para-shtetit shqiptarë, në ngritjen e pozitës ekonomike dhe sociale të serbëve dhe malazezëve dhe krijimit të kushteve për kolonizimin e këtyre viseve”*.²⁰⁰

Në hyrje të projektit propozohen masat adekuate që duhet ndërmarrë shtetit në këtë drejtim. Po i theksoj disa më kryesoret:

- Vetëm serbët dhe malazezët e fort dhe të organizuar mirë mundën me sukses me e mbrojtë këtë pjesë të Serbisë. Për këtë shteti duhet urgjentisht të aprovon planin për ngritjen ekonomike të popullatës serbo-malazeze në këto vise;

- Duhet që urgjentisht të kryehen ndërtimi i banesave të filluara në Kosovë me të gjitha aspektet. Momentalisht ndërtohen rreth 1300 banesa dhe ato duhet të kryhen në afatin sa më të shkurtër;

- Duhet të sigurohen mjete për ndërtimin e banesave dhe shtëpive të reja. Janë evidencuar se në trevën e Krahinës ka 4286 familje serbo-malazeze të rrezikuara nga aspekti social dhe ato kryesisht në mjediset fshatare të cilët jetojnë në objektë të papërshtatshme të banimit dhe në varfëri e mjerim;

- Në Kosovë ka 7300 të interesuar për ndërtimin e shtëpive. Mendojmë se duhet të sigurohen troje me kushte shumë të volitshme;

- Rreth 500 familje serbe dhe malazeze ka mbetur pa kulm mbi krye pas sulmeve të “bandave terroriste”. Ndihma e tyre e përhershme në Kosovë duhet që të jetë prioritare;

- Ky është rasti që refugjatëve nga B e H dhe Kroacia, të cilët tani gjenden në vendosjet kolektive, që t’iu sigurohet banim i përhershëm dhe të lidhen për këto treva;

- Ndërtimi i banesave dhe i shtëpive në Kosovë do të sjell edhe një numër të madh të serbëve dhe malazezëve të cilët nuk janë gjetur në viset tjera të Serbisë;

- Ekziston mundësia reale që këtyre kategorive të popullsisë t’iu ndahet toka punuese. Është konstatuar se në Krahinë ekzistojnë 44.529 ha të cilat janë kryesisht në pronësi të

¹⁹⁷ Dr. Hakif Bajrami, Politika, v. e c., fq. 189.

¹⁹⁸ Hysen Ibra, Shkatërrimi, v. e c., fq. 156.

¹⁹⁹ Dr. Hakif Bajrami, Politika, v. e c., fq. 190.

²⁰⁰ Pokrajinski odbor SPS Kosova i Metohije, Predlog mera za resavanje aktualnih problema na Kosovu i Metohiji, Pristina, 15.12.1998, fq. 3.

kooperativave ose kombinateve bujqësore. Me rëndësi është që organet shtetërore të thjeshtojnë procedurën e ndarjes së tokave, përcaktojnë kriteriumet për këtë proces;

- Pjesa më e madhe e serbëve dhe malazezëve punon në ndërmarrjet shoqërore dhe shtetërore. Pak janë ata që merren me biznesin privat. Eksitojnë mjedise ku të punësuarit me disa vite nuk kanë marrë të ardhura, që ka ndikuar në varfërimin e tyre. Për këtë arsye duhet që të gjenden mjete për lëvizjen e prodhimtarisë në ato ndërmarrje ku janë të punësuar serbët dhe malazezët;

- Duhet gjetur rrugë për stimulimin e serbëve dhe malazezëve për biznesin privat. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet të lehtësimeve dhe benificioneve;

- Përkrahja institucionale e të gjitha formave të integrimit të Kosovës me Serbinë. Në këtë duhet posqërisht të insistohet, sepse përvoja po tregon se numri më i madh i kolektiveve dhe ndërmarrjeve nga trevat tjera të Serbisë gjatë integrimit me ndërmarrjet kosovare kanë hy të motivuar parçialisht, të paqartë, nganjëherë edhe me interesa personale, duke mos llogaritur se procesi i integrimit është me rëndësi strategjike për ekzistencën e shtetit Serbisë në këto treva. Tani është shansa që nëpërmjet të transformimit të ndërmarrjeve në Kosovë ekonomisht të forcohen familjet serbo-malazeze, kështu që nën kushte të përshtatshme t'iu ndahen aksionet. Në këtë mënyrë edhe transformimi do të jetë në funksion të ekzistimit të Kosovës në Serbi;

- Me qëllim të ndërrimit të pasqyrës etnike në Kosovë, ngritjes ekonomike të popullatës serbo-malazeze duhet domosdo që në shërbimet shtetërore dhe ndërmarrjet shtetërore të punësuarve t'iu caktohet "shtesa e Kosmetit". Kjo do të ishte masë efektive stimuluese jo vetëm për ekzistencë, por edhe për kolonizimin e këtyre viseve. Në të kaluarën kjo ka dhënë efekte të mëdha;

- Si masë me rëndësi shtetërore dhe çështje politike është matja e tokës dhe regjistrimi kadastral në Kosovë.

- Propozohen edhe çështje të tjera, si krijimi i kushteve më të mira për shkollimin e fëmijve serb e malazezë, lidhjen urgjente të të gjitha vendbanimeve serbe me qendrat komunale me rrugë, furnizimin normal, vuarjen e telefonave, përmirsimin e sistemit të informimit etj.

Përkritazi me kolonizimin e Kosovës, në pikën 6 të atij Projekti, parashifen lokacionet e vendeve se ku mund të ndërtohen vendbanimet, kush mund të jetojë në to dhe burimet për ekzistencë:

- **Komuna e Gjakovës:** Vendbanimi mund të ndërtohet pranë rrugës magjistrale Gjakovë-Prizren në të dy anët e rrugës ku është bërë parcelizimi nga 21 ari. Lokacioni i dytë është pranë rrugës rajonale Gjakovë-Prishtinë në të dy anët ku mund të ndërtohen më shumë se njëqindë objekte. Propozohet që përveç shtëpisë dhe oborrit banuesve t'u ndahet edhe nga 2-3 ha tokë bujqësore, 2-3 ha pyell dhe 0,5 deri 1 ha vëneshta. T'iu ndahet edhe nga një traktor dhe një lopë që do t'i paguanin në natyrë. Të gjitha këtë familje do të merren kryesisht me bujqësi.

- **Komuna e Gorës:** Kuvendi i komunës së Gorës ka aprovuar Programin për kthyerjen e serbëve dhe malazezëve dhe ndërprerjen e shpërnguljes së goranëve dhe ka siguruar 9 troje për ndërtimin e shtëpive familjare në vendbanimin Dragash. Tri troje ua ka ndarë familjeve serbe e malazeze, por ndërtimi nuk ka filluar.

- **Komuna e Suharekës.** Vendbanimi mund të ndërtohet në lokacionin në vendin Shirokë, në afërsi me Suharekën pranë rrugës magjistrale Suharekë - Prizren. Është siguruar komplet infrastruktura. Në Shirokë komuna e ka hartuar dhe aprovuar planin urbanistik për këtë vendbanim dhe ka bërë parcelizimin për 50 troje për ndërtimin banesor individual, si dhe 50 troje për ndërtimin e vendbanimit për refugjatët. Ekziston lokacioni në fshatin Mushtisht për ndërtimin e 50 shtëpive familjare. Infrastruktura është siguruar si dhe punësimi në ekonomi dhe

në komunë dhe në organet shoqërore. Për këto vendbanime ka të interesuar. Burimet e ekzistencës të këtyre familjeve do të siguroheshin nga punësimi në ekonomi, organet shtetërore, administratët lokale dhe në institucionet tjera në komunë.

- **Komuna e Rahovecit:** Në territorin e kësaj komune vendbanime mund të ndërtoheshin në Xërxë, Bërnjaqë dhe Hoçë të Madhe. Këtu do të vendoseshin familjet e hikura nga fshatrat tjera. Këta duhet të punësohen dhe t'iu ndahet tokë punuese për ata që dëshirojnë ta punojnë.

- **Komuna e Prizrenit:** Lokalitetet ku mund të ndërtohen vendbanimet: Dushanovë - 150 troje x 5 ari = 75 ha; Lubizhda (te objekti i Perllonkës) 60 troje x 5 ari gjithsej 3 ha; Novaku 10 troje; Jagllanica në Prizren 30 deri 35 troje. Burimet e ekzistencës nga bujqësia, përveç kësaj të fundit nga puna në subjektet ekonomike.

- **Komuna e Novobërdës:** Sipas planit urbanistik është parapa ndërtimi i dy komplekseve banesore për banim individual e kolektiv në fshatin Prekoc 60 banesa dhe Bostan 76 banesa. Ata do të punësohen në administratën lokale dhe organet shtetërore, në minjerë etj.

- **Komuna e Kamenicës:** Vendbanimi mund të ndërtohet në ngastrën e fshatit Kololeq, në vendin "Pjesa e Dytë" ku janë afro 25 ha tokë punuese. Kjo do të shërbejë si për refugjatë dhe për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në këtë komunë. Punësimi do të bëhej në qytet.

- **Komuna e Vitisë:** Për shkak të shpërnguljes së kroatëve nga BL në Letnicë janë krijuar kushtet për kolonizimin e 3000 serbëve dhe malazezëve. Në ngastrën e fshatit Sadovinë, në pronat që i shfrytëzon "Agromorava" për arsye strategjike propozohet ndërtimi i vendbanimit me ekzistencë nga bujqësia dhe pjesërisht punësimi në ekonomi.

- **Komuna e Gjilanit:** Në këtë komunë ka lokalitete të shumta të përshtatshme për ndërtimin e vendbanimit. Në lagjen "Park" në qytet janë ndarë 100 troje dhe 120 të tjerë duhet të u ndahen familjeve serbe. Duhet mjete për infrastrukturë, sepse me planin urbanistik është parapar ndërtimi i Lagjës serbe. Në fshatin Livoçi i Poshtëm ekziston lokacioni shoqëror prej disa ha, mjaft të përshtatshëm për vendbanim me 100 shtëpi. Ka mjetë të interesuar dhe ekzistenca e tyre sigurohet nga puna në ekonomi, bujqësi dhe institucione të tjera.

- **Komuna e Leposaviçit:** Vendbanimi do të ndërtohet në Soçanicë (dy vendbanime) dhe në Leshak, në të cilët do të vendoseshin familjet e refugjtëve të cilat dëshirojnë të jetojnë dhe të punojnë në Kosovë. Burimet e ekzistencës do të ishin bujqësia dhe puna në ndonjë ndërmarrje bujqësore.

- **Komuna e Zubin Potokut:** Ekzistojnë dy parcella të arave nga 2 ha, të cilat mund të shfrytëzoheshin për ndërtimin e vendbanimit për refugjatë dhe të kthyerit.

- **Komuna e Mitrovicës:** Lokacionet për ndërtimin e vendbanimeve gjenden në BL të Suhadollit dhe BL Frashërit.

- **Komuna e Zveçanit:** Me planin urbanistik të vitit 1996, si mundësi të lokacioneve për ndërtimin e lagjeve të reja të banimit në shtatë blloqe banimi dhe mundësia e ndërtimit e një numri të objekteve të banimit në të gjitha Bashkësitë lokale. Me këtë numri i të shpërngu-lurëve do të zvoglohej.

- **Komuna e Shterrpcit:** Janë caktuar tri lokacione për ndërtimin e vendbanimeve në këtë komunë, në të cilin do të vendose-shin kuadrat e nevojshme të komunës, refugjatët dhe personat social.

- **Komuna e Skënderaj:** Është hartuar projekti urbanistik për ndërtimin e vendbanimit prej 74 shtëpive të parapara për refugjatë, në afërsi të qendrës së Skënderaj.

- **Komuna e Kaçanikut:** Është planifikuar ndërtimi i vendbanimit në ngastrën e rrugës magjistrale Prishtinë-Shkup, në lokacionin „Ruga e Partizanit“ në sipërfaqe prej 42 ha. Sipas

projektit do të ndërtohen 230 njësi banesore. Vendbanimi iu dedikohet personave të ikur dhe të dëbuar nga ish republikat e Jugosllavisë dhe disa qytetarëve të varfër, në funksion të pengimit të shpërnguljes dhe kthimit të personave të shpërngulur. Ata do të punësoheshin në Fabrikën “Sharri”, doganë, ushtri, polici, organe të administratës dhe punimi i tokës bujqësore.

- **Komuna e Ferizaj:** Parashifej ngritja e këtyre vendbanimeve: Babushi serb (punësimi në Fabrikën e pjesëve të biçikletave që është ndërtuar afër këtij fshati); Nerodime të Poshtme (ndarja e tokave bujqësore dhe se ekziston infrastruktura); Talinofc (ndarja e tokës bujqësore punuese) dhe Kosinë (ndarja e tokës punuese bujqësore dhe utrinës së fshatit).

- **Komuna e Glogocit:** Ndërtimi i vendbanimit në Komaran, në anën e djathtë të rrugës Prishtinë-Pejë (ekzistimi bujqësia), Karrotica e Epërme, në anën e djathtë të rrugës magjistrale Prishtinë - Pejë. Burimi i ekzistencës punësimi në komunat e afërta Fushë-Kosovë, Glogoc ose Prishtinë.

- **Komuna e Shtimës:** Mund të ndërtohen vendbanimet në disa vende si në Shtime në vendin “Koshtanë” dhe jashtë Shtimës në vendin “Fidanishtë” dhe “Gllavicë”. Punësimi në Fabrikën e gypave në Ferizaj dhe aktivizimi i bujqësisë.

- **Komuna e Obiliqit:** Eksistojnë dy lokacione për ndërtimin e vendbanimit: në Milloshevë është hartuar plani i parcelizimit për ndërtimin e 250 objekteve individuale, në tokën e cila është pronë shtetërore në drejtimin e rrugës Prishtinë-Mitrovicës, dhe në Obiliq në qendër të vendbanimit në sipërfaqe prej 100 ari, në të cilën mundet menjëherë ndërtimi i objekteve individuale.

- **Komuna e Pejës:** Janë përcaktuar këto lokacione: 1. Vendbanimi pranë rrugës rajonale Pejë-Deçan, rreth 4 km larg qytetit, në anën e majtë të rrugës në sipërfaqën shoqërore ku mund të ndërtohet vendbanimi me 40 njësi banesore me sipërfaqe të një njësie 10-15 ari. Eksiton infrastruktura; 2. Vendbanimi pranë rrugës magjistrale Pejë-Prishtinë, në anën e majtë të rrugës rreth 8 km larg nga qendra e Pejës, ku ekziston prona shoqërore e cila mundëson ndërtimin e vendbanimit prej 100 e më tepër njësi banesore. Çdo njësi do të merrte nga 20 ari; 3. Vendbanimi në ngastrën Pejë-Gorazhdec, në lagjen Orashje, ku gjendet kompleksi shoqëror pranë rrugës në të cilin mund të ngritëshin 30 njësi banesore me sipërfaqe prej 10-15 ari. Për këtë lokalitet ekziston infrastruktura.

- **Komuna e Klinës:** Vendet ku mund të ndërtoheshin vend-banimet: Kompleksi në sipërfaqe prej 6 ha i cili gjendet pranë motelit Nora, pranë rrugës Prishtinë-Klinë; Sipërfaqja, pronë e Fabrikës së sheqerit në Zajm, pranë rrugës Prishtinë-Pejë; Sipërfaqët e Fabrikës së sheqerit në Budisalc, ku ekziston rruga lokale e asfaltuar; Fshati Biçë, sipërfaqja pronë e Kombinatit Bujqësor “Malishgan”; Fshati Jashanica, sipërfaqet e Kombinatit “Malishgan”, larg 3 km nga rruga asfaltuar Klinë-Ujmir.

- **Komuna e Deçanit:** Ndërtimi i vendbanimit, në të cilin do të jetonin serbët dhe malazezët e shpërngulur nga fshatrat e kësaj komune, në lokalitetin në ngastren “Rrafshi i Koshtanit” (3 km) dhe në fshatin Rastavicë (8 km).

- **Komuna e Istogut:** KK i Istogut në mbledhjen e jashtëzakonshme më 14.09.1998 ka pruar vendimin për ndarjen e 97,66 ha tokë në kompleksin Bellopojë-Dubravë. Janë lëshuar 147 vendime me nga 20 ari troll për ndërtimin e shtëpive familjare. Mirëpo, refugjatët që ishin të vendosur në këtë komunë janë larguar dhe kanë shkuar në Amerikë.

- **Komuna e Fushë-Kosovës:** Lokacioni – „Kompleksi 300“ është paraparë ndërtimi i objekteve banesore shumëkatshe, përkatësisht 327 banesa sipas programit JU, për kolonizimin e të kthyerve. Deri me tani në këtë lokacion janë ndërtuar 42 banesa sipas JU programit të cilat janë në funksion nga viti 1992 dhe 49 banesa për treg të cilat i ka ble Armata jugosllave, të cilat

gjithashtu janë në funksion. Gjatë vitit 1997 në këtë lokacion ka filluar ndërimin edhe i 36 banesave sipas JU programit dhe 24 banesa nëpërmjet të Fondit të solidaritetit. Në këtë lokacion mund të fillon ndërtimi edhe i 168 banesave. Popullata e këtyre vendbanimeve do të punësohet në Elektroekonominë e Kosovës, Ndërmarrjen hekurudhore, NSH “Therrtorja”, Kombinatin e teksilitit “Jumko” dhe në organizatat tjera që gravitojnë në komunën e Fushë-Kosovës.

- **Komuna e Lipjanit:** Mundësia e ndërtimit të vendbanimeve në fshatrat Magure dhe Suhadoll. Në Magure që nga viti 1995 ka filluar iniciativa për ndërtimin e lagjes së refugjatëve. Për këtë qëllim u ndanë 10.54,96 ha tokë, punësimi i të cilëve do të bëhet në Minjerën e magnezitit “Golesh”. Në këtë kohë është ndërmarrë iniciativa edhe për ndërtimin e shtëpive në vendbanimin Suhadoll.

- **Komuna e Podujevës:** Në largësi prej 2 km nga qendra e qytetit mund të ndërtohet vendbanimi prej 100 shtëpive familjare në vendin e quajtur “Fusha e Livadhisë”, 20 troje të parcelizuar përmbi hekurudhën, të kisha ortodokse dhe 106 troje për shtëpi familjare të NSH “Fagar”. Këto vendbanime parashihen për ata të cilët jetojnë dhe punojnë në territorin e kësaj komune dhe nuk e kanë të zgjidhur çështjen banesore, ata të cilët dëshirojnë të vijën dhe jetojnë në këtë komunë dhe refugjatët nga Kroacia të cilët dëshirojnë të mbesin këtu. Punësimi i tyre në ndërmarrjet e kësaj komune.

- **Komuna e Vushtrrisë:** Në këtë komunë planifikohej ndërtimi i vendbanimeve në këto lokacione: fshatin Maxhunaj, Lokacioni i qytetit “Kooperativa”, Lokacioni i qytetit “A repartit”, Lokacioni i qytetit “Polet”, Lokacioni “Prilluzha 1-2-3”, Stanofci i Poshtëm, Stanofci i Epërm, Novolani, Samadrexha, Pantina, Vërmica, Bukoshi, Nadakoci, Druari dhe Begaj. Në këto do të jetonin refugjatët, familjet në gjendje të vështirë materiale, ato të cilat nuk kanë tokë ndërtimore. Punësimi i tyre do të bëhet në ndërmarrjet dhe fabrikat e qytetit dhe të tjera.

- **Komuna e Prishtinës:** Kuvendi i Qytetit të Prishtinës ka siguruar dhe nga aspekti urbanistik ka caktuar për ndërtimin e shtëpive: në Hajvali 141 troje me nga 10 ari, me mundësi punësimi në Minjerën e Hajvalisë; në Leban 175 troje me nga 7,5 ari, me mundësi të punësimit në Elektroekonominë e Kosovës; në fshatin Nëntë Jugoviqët 59 troje me nga 5 ari, me mundësi të punësimit në Elektroekonominë e Kosovës dhe në kolektivët e Prishtinës. Në ndërkohë është duke u përgatitur ndarja e 150 trojeve me nga 7 ari në fshatin Badovc për “Vendbanimin e solidaritetit serb”.

Si pasojë e dhunës e terrorit qysh heret kishte nisur vala e shpërnguljes së shqiptarëve në formë refugjatësh, azilantësh politikë, stinorë etj. Sipas të dhënave të ndryshme, rezultoi se deri më 1996, nëpër shtete të ndryshme të Evropës gjendeshin rreth 350.000 azilkërkues shqiptarë nga Kosova. Numri i tyre të shpërngulur deri në vitin 1999 është shumfishuar.

8.6. Vrasjet, masakrat dhe dëbimi masiv i shqiptarëve

Platforma antishqiptare e pushtetarëve serbë për asgjësimin e shqiptarëve ka gjetur zbatimin e saj në vazhdimësi kohore në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Ajo ka pasur kulmet e veta herë në fushën ekonomike, herë në atë politike, herë në atë fetare apo në atë ushtarake, por vazhdimisht të gërshetuara. Strategjia serbe është strategji e tokës së djegur dhe të vdekur. Spastrimi etnik që të pushtohet tërësisht territori. Pushtetarët serb kanë zhvilluar strategjinë e vet me një parim të luftërave të mëparshme të vjetra me shekuj, që thotë se “*asnjë popull nuk mund të pushtohet*”. Për të pushtuar territorin ata kanë zgjedhur taktikën e spastrimit etnik. Kanë pasur për qëllim që të okupojnë tokat, por nuk kanë dashur që ato toka të kenë popull joserb, lëvizja për çlirim do të ishte e vazhdueshme dhe një ditë patjetër ai popull do të gëzonte lirinë.


Ndaj popullatës dhe vendbanimeve shqiptare, policia, ushtria dhe paramilitarët serbë në masë të gjërë, duke filluar në mars të vitit 1998 e deri në pranverë të vitit 1999 ndërmorën

ofensiva për vrasjen e popullatës shqiptare dhe rrënimin e vendbanimeve të tyre. Kulmin kjo shtypje e arriti në muajt mars - qershor 1999. Përkitazi me këtë, me rëndësi është të përmendet Operacioni famkeq serb “Patkoj”. Pas marrëveshjes Hollbruk-Milloshëviq (tetor 1998), forcat serbe erdhën në përfundim se nuk mundën fare ta zhdukin UÇK-në deri sa ajo e ka përkrahjen dhe ndihmën e popullit. Për ta dobësuar atë duhet shkatërruar prapavia. Andaj u punua me të madhe (tetor ’98 – janar ’99) në këtë drejtim. Duke u nisur nga parimet se “nuk vriten të gjithë” ajo e përpiloi planin “Patkoj” ku emri i tij të japë me kuptue se për çfarë qëllimi ishte dedikuar. Qëllimi ishte që 1.000.000 shqiptarë të dëbohen jashtë Kosovës; deri në 500.000 të vriten dhe likuidohen, 500.000 të tjerë të mbesin në Kosovë, por t’i nënshtrohen Serbisë dhe se ky numër nuk do të paraqiste kurrë më problem për Serbinë. Deportimi i këtyre do të bëhej duke u lënë të hapur Grykën e Kaçanikut – Bllaca dhe Gryka e Lumës – Vërrmica që njëherit t’i destabilizoi edhe shtetet nga numri i madh i refugjatëve. Likuidimet do të bëhen në ato lokalitete ku do të bëhet rezistencë pushtetit dhe përkrahje UÇK-së. Mediave dhe organizatave ndërkombëtare nuk do t’u lejohet hyrja në vend edhe për një kohë të gjatë, kështu që nuk do të zbulohen fare. Popullata që do të mbetet duhet t’i nënshtrohet gradualisht dhunës dhe ndjekjeve që në këtë mënyrë edhe ata pak banorë të detyrohen që “vullnetarisht” të largohen. “Fryti” i parë i këtij aksioni ishte masakra e 15 janarit 1999, në Raçak.

Ky plan do të filloj në janar 1999 dhe do të kryhet shumë shkurt, prej katër deri në gjashtë muaj. Së pari ishte planifikuar të pastrohet i tërë Rrafshi i Dukagjinit, në tri faza: 1. Via kufitare që nga trekëndëshi kufitar Kosovë – Mal i Zi – Serbi e deri në Vërrmicë (e tërë Reka e Keqe dhe Hasi), të pastrohen dhe të shkatërrohen të gjitha fshatrat dhe lokalitetet. Qëllimi ishte i trefishtë: a. Të pastrohet etnikisht, sepse përmbante 99% shqiptarë; b. Që forcat e UÇK-ës të mos kenë prapavi gjatë furnizimit me aramtim; dhe c. Që popullata e deportuar nga Kosova Veriore dhe Qendrore, gjatë deportimit të tyre në Shqipëri, të mos kenë vend për pritje apo qëndrim. 2. Që të zgjerohen pastrimet deri në rrugën magjistrale Pejë – Deçan – Gjakovë- Prizren; 3. Zgjerimi prej burimit të Drinit të Bardhë, nëpër rrjedhën e tij e deri në Vërrmicë.

Edhe pse pastrimet në këtë anë ishin filluar nga vera e 98-shit, këto vetëm se u zgjëruan, duke filluar aplikimi i “tokës së djegur”. Me këtë u formua ana e majtë e “Patkoit” që gradualisht shkonte duke u zgjëruar kah vija e Kosovës. Kurse ana e djathtë ishte paraparë nga Llapi e Karadaku, duke u zgjëruar kah përfundimi i Kosovës, ku njëkohësisht do të filloi shtypja nga veriu në drejtim të jugut.... Përpos Ushtrisë jugosllave dhe MPB të Serbisë, në këtë aksion morën pjesë edhe një numër forcash paraushtarake serbe siç janë: “Tigrat e Arkanit”, “Beli Orlovi” të Sheshelit, “Vukovi iz Vuçjaka”, ushtarë dhe epëorë nga republikat ruse. Nga ushtria e rregullt, përpos korpusit të Prishtinës ishte edhe korpusi i Nishit, Beogradi, Uzhicës, Podgoricës dhe shumë brigada dhe çeta nga tërë Jugosllavia.²⁰¹

²⁰¹ Shënime për planin “Patko” janë marrë: Analiza Politiko-ushtarake, Operacioni famëkeq “Patkoj”. Analizë ekskluzive për Kosovën, Islam Sadiku, epror ushtarak, Islam.Sadiku@kosova.nu.sakidu@blueëien.ch.



Plani serb "PATKOR", sipas të cilit planifikohej dëbimi masiv i popullsisë shqiptare nga Kosova. E publikoi Ministri Gjerman i Mbrojtjes, Rudolf Sharping.

Në këtë fundshekulli, kur bota përgatitet të hyjë në mijëvjeça-rin e tretë me arritje njerëzore e qytetare, shqiptarët e Kosovës pësuan një tragjedi të vërtetë: ata u ndodhën përpara mizorive dhe reprezaljeve makabre si dhe përpara një spastrimi të egër etnik të ushtruar nga ana e forcave policore e ushtarake si asnjëherë tjetër më parë. Millosheviqi dhe bashkëpunëtorët e tij, në zbatimin e planeve të përgatitura në fshehtësi, hodhën kundër shqiptarëve kosovarë armatën 45-mijëshe të policëve, ushtarakëve dhe paraushtarakëve serbë. Repartet e saj me uniforma e pa uniforma nxirrnin dhunshëm brenda disa minutave shqiptarët nga banesat dhe shtëpitë e tyre, disa nga të cilave ua vinin flakën, ndërsa njerëzit i nisnin drejt kufirit shqiptar e maqedonas. Millosheviqi kishte vendosur që t'i qëronte hesapet përgjithmonë me shqiptarët e Kosovës, ta spastronte etnikisht tokën sa më parë nga këta banorë autoktonë. Kështu planifikonte që 610 - Vjetorin e Betejës së Kosovës ta "festonte" në Gazimestan pa shqiptarë në Kosovë.

Edhe përkundër vrasjeve, masakrave e dëbimeve të shqiptarëve, pushteti serb me qëllim të kolonizimit të Kosovës bënte propagandë dhe vazhdonte ndërtimin e objekteve të banimit për popullatën serbe. Kështu, siç njofton gazeta "Jedinstvo" e Prishtinës, e datës 11 mars 1999, në lagjen "Bazhdarhane" në Prizren me 10 mars 1999 filloi ndërtimi i 236 banesave për nevoja të Ushtrisë jugosllave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe kuadrave të nevojshme për ekonominë e Prizrenit.

Vala e terrorit të institucionalizuar shtetëror serb, e vrasjeve, e masakrimeve, e ekzekutimeve të shqiptarëve përfshiu mbarë Kosovën. Paramilitarët e policët, por dhe ushtarët e egërsuar serbë mund të vrisnin dhe vrisnin kë të donin e kur të donin - pa ndërje kurrfarë përgjegjësie as morale, as njerëzore e as ligjore. Mund të vrisnin edhe vrisnin të rinj e të reja, pleq, plaka e burra, duke mos kursyer as fëmijë e as foshnja. Vrisnin - me apo pa motiv. Vetëm pse ishin shqiptarë. Vetëm pse donin t'i zhduknin nga faqja e dheut, t'i zhduknin nga Kosova, në

mënyrë që ata, që mund të shpëtonin nga plumbi ose nga thika e tyre, të iknin, të detyroheshin të largoheshin nga Kosova, në qoftë se rastësisht mund të shpëtonin nga arrestimi apo deportimi i dhunshëm i tyre.

Vrasjet dhe masakrat barbare më monstruoze, që bëri pushteti kundër popullit shqiptar në Kosovë, me synim plotësisht të qartë për shfarosjen totale të tërë popullatës shqiptare të Kosovës demaskoi plotësisht politikën dhe karakterin gjenocidal të pushtetit dhe të shtetit serb. Falangat dhe kordonet serbe të vdekjes nuk kursyen jo vetëm civilët e paarmatosur shqiptarë, por as gratë, as fëmijët, as foshnjat e as pleqtë e tyre. Duke treguar haptas tërë egërsinë e tyre dhe duke u munduar t'i fshinin gjurmët e dhunës makabre, forcat serbe dogjën viktimat e terrorit të tyre, ose edhe i zhvarrosën dhe i dërguan trupat e tyre në drejtime të panjohura.

Me fillimin e luftës së armatosur në Kosovë (mars 1998), spastrimi etnik e gjenocidi morën formën e një veprimtarie barbare, që sfidoi gjithë bashkësinë ndërkombëtare në prag të shekullit XXI. Bombardimet e NATO-s të filluara më 24 mars 1999, kishin për synim ndaljen dhe ndërprerjen e spastrimit etnik të Kosovës me vrasje, masakrime e ekzekutime, me plaçkitje, rrënimë e djegie të vendbanimeve të tëra dhe me deportimin masiv të popullsisë shqiptare nga trojet e veta etnike, që ushtronte pushteti ushtarako-policor serbë mbi popullatën shqiptare. Pra, populli i Kosovës, krahës torturave, vrasjeve, ekzekutimeve, masakrave, rrënimëve, djegieve e plaçkitjeve të shtëpive e të pasurisë së tij, përjetoi edhe dëbimin me dhunë, zhvendosjen dhe deportimin masiv nga vatrat e veta dhe spastrimin etnik të Kosovës - masën më të rreptë të gjenocidit serb mbi shqiptarët.

Në vitin 1998 dhe veçanërisht në vitin 1999, në sytë e të gjithë botës, idetë dhe synimet e kahmotëshme të regjimeve dhe qarqeve të ndryshme serbe brenda tyre u shndërruan në gjenocid faktik masiv ndaj shqiptarëve. Planet serbe, të propozuara edhe nga Dobrica Qosiq e akademikë të tjerë serbë, deri edhe nga qarqe të politikës zyrtare të Beogradit, kanë planifikuar zbrazjen e Kosovës nga shqiptarët. Për të arritur këtë qëllim, është ushtruar gjenocid i plotë mbi një popullsi të tërë në Kosovë. Është masakruar gjithë ajo popullsi civile, për t'u poshtëruar në atë masë aq barbare e për t'u deportuar ajo në tri drejtime: Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi. Ky dëbim ishte eksoduesi, përkatësisht zhvendosja më masive në Evropë që nga Lufta së Dytë Botërore.

Dëbimi - nxjerrja e njerëzve me dhunë nga shtëpitë dhe banesat e tyre, ku para tytave të automatikëve urdhëroheshin që të vazhdojnë drejt stacionit të trenit ose të motorizuar, madje edhe këmbë iknin drejt Shqipërisë, kufirit me Maqedoninë, por edhe drejt viseve me popullatë kryesisht shqiptare e boshnjake në Mal të Zi. Nga të katër anët e Kosovës kolona njerëzish në këmbë, me traktorë, me makina e me tren kishin marrë rrugën e mërgimit, të ndjekur e të persekutuar nga forcat serbe. Në mesin e tyre kishte edhe të sëmurë e të moshuar dhe të hendikepuar, gra shtatëzëna e fëmijë dhe foshnja të posalindura. Udhëtonin këta të ndjekur ose ecnin këmbë kilometra e kilometra në kushte të vështira atmosferike e me përjetime e kujtime tronditëse për njerëz të vrarë e të pavarrosur, kufoma të hedhura anës rrugëve, djegie të tyre e të shtëpive të tyre. U sendërtuan në vepër thëniet e kriminelit Sheshel, i cili vazhdimisht theksonte se shqiptarët duhet të ndiqen përtej Bjeshkëve të Nemura, të vdekur ose të gjallë... Ndërsa, pushteti serb kishte bërë plane që pas kësaj të gjithë refugjatët nga Kroacia e Bosnja të sillen në Kosovë si dhe një numër i popullatës serbe nga e ashtuquajtura "Srpska Republika", p.sh. pjesë e popullatës së Banja Llukës në Prishtinë e kështu me radhë.



*Dëbimi masiv i popullsisë shqiptare nga Kosova, mars-qershor 1999.
Fotografi e publikuar në shtypin çek.²⁰²*

Për të dëbuarit në Maqedoni vend i ferrit ishte Bllaca, ku njerëzit ballafaqoheshin me vdekjen. Të moshuarit, të sëmurit, fëmijët, të lodhur e të rraskapitur, të mërdhirë e të uritur erreshin, por nuk gjenin dot të gjallë. Bllaca ishte një katastrofë njerëzore e politikës antihumane ndaj një populli të pambrojtur. Bllaca, si e këtillë, u dënua nga opinioni demokratik e humanitar botëror.

Pas asaj rrëmuje të invazionit të policëve dhe të paramilitarëve, shtëpitë shqiptare mbetën dyerhapur. Mbetën edhe shporetat e ndezur, edhe buka në shporetë, gjellëra mbi të e përgatitur, tryeza e shtruar.

Gjatë dëbimit iu plaçkitën të hollat, gjërat me vlerë, automo-bilët. Ata që nuk kishin keqtrajtoheshin, rraheshin apo edhe vriteshin. Dokumentet personale u merreshin dhe menjëherë ua grisinin, me qëllim që ata të mos kenë dëshmi legjimiteti. Ata ishin të bindur se shqiptarët nuk do të kthehen kurrë. Edhe gjatë dëbimit paramilitarët serbë u thonin: *Se kurrë nuk do ta shohin Kosovën më, e nëse e shohin ate do ta shohin nëpërmjet ekranit të televizionit!; Se vetë e keni kërkuar këtë, shkoni në Shqipëri se ajo është juaja, kjo është Serbi!; Qe kjo është NATO-ja, vetë e keni kërkuar atë, etj.*


Para tërheqjes, paramilitarët serbë ekzekutonin shqiptarët në vend, ndërsa gjatë tërheqjes ndanin burrat nga gratë, nga anëtarët e familjes dhe i kanë ekzekutuar apo i kanë humbur, ndërsa gratë dhe vajzat ka raste kur i kanë dhunuar. Dhunimi - kjo ishte një ndër alibitë e shumta të aplikuara në Kosovë gjatë ditëve të tmerrit, ku serbët kanë zbatuar modelet më çnjerëzore për të nënshtruar një popull, i cili donte të jetonte i lirë e i qetë në vatrat e tij.

Vandalizmi i pushtetit serb krahas krimeve çnjerëzore mbi shqiptarët, rrënimit të fshatrave shqiptare me tërë infrastrukturën, në shënjestër të shkatërrimeve sistematike pati edhe objektet shkollore, ambulanca, shtëpi të kulturës, objekte me vlerë të trashëgimisë historiko-kulturore, si p.sh. shumë kulla të vjetra shqiptare, me 27 mars 1999 ndërtesën e kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Çarshinë e Gjakovës, Çarshinë e Pejës, më se 209 xhami, shumë teqe, shtëpi të vjetra me vlerë të madhe arkitektonike etj., si dhe shumë dokumente arkivore, libra, ekspozate muzeale etj.

²⁰² Mr. Mehmet Gjoshaj, Dëshmi të të përndjekurëve dhe mikpritja çeke'99, Prishtinë, 2005.

Gjatë kësaj periudhe pushteti serb kishte plaçkitur nga kuvendet komunale, zyret e vendit etj., tërë dokumentacionin e ofiçarive, siç ishin librat amë të të lindurve, të të kurorëzuarve, të të vdekurve, librat e nënshtetësisë, pastaj dokumentacionin e shërbimeve kadastrale etj. Ato i kishte shpërndarë nëpër qytete të Serbisë. Ndërsa, dokumentet e tilla personale dhe pronësore që posedonin shqiptarët, soldateska serbe u kishte djegur së bashku me shtëpitë dhe gjithë pasurinë që kishin, ose ua kishin grisur gjatë dëbimit të tyre. Qëllimi i tërë kësaj ishte, që dokumentet e gjendjes civile, së bashku me librat e shërbimeve kadastrale dhe dokumentet e tjera me vlerë që dëshmojnë qenësinë dhe indentitetin shqiptar të Kosovës, ajo i plaçkiti për t'i fshehur gjurmët e spastrimit etnik që bënte në Kosovë dhe për të ndërruar me dhunë strukturën demografike të popullsisë në favor të pakicës serbe e malazeze dhe për t'ua ndaluar me dhunë të dëbuarve përgjithmonë kthimin në Kosovë, duke tundur para syve të opinionit botëror mungesën e këtyre dokumenteve, si argument të mjaftueshëm se ata nuk kanë qenë kinse asnjëherë banorë të kësaj treve.

Sipas të dhënave të UNCHR në fillim të qershorit 1999, nga refugjatët e dëbuar prej Kosovë 443.300 ishin vendosur në Shqipëri; 247.800 në Maqedoni, 69.300 në Mal të Zi; 21.700 në Bosnje e Hercegovinë, gjithsej 782.100. Në vendet tjera të botës u vendosën gjithsej 76.475 refugjatë, duke përfshirë 13.639 në Gjermani, 7.581 në Turqi, 5.829 në Itali, 5.730 në SHBA, pastaj në Francë, Norvegji, Suedi, Britani të Madhe, Poloni, Spanjë, Portugali, Finlandë, Izrael etj.²⁰³



"INTERNATIONAL EKPRESS", Tuesday, August 11, 1998.

Njësitë militare e paramilitare anticyvile serbe kanë bërë në Kosovë krime të rënda, përmasa të krimeve kundër njerëzimit. Kriminelët serbë, përkundër gjithë egërsisë që kanë treguar duke vrarë, ekzekutuar, masakruar dhe torturuar në mënyrën më të tmerrshme viktimat, gjatë tërë kohës janë munduar t'i fshehin gjurmët e krimeve të veta duke varrosur e zhvarrosur trupat e vrarëve e të të masakruarve, duke i bartur nga një vend në vendin tjetër, duke i hedhur në

²⁰³ Raport i departamentit të shtetit të SHBA, Fshirja e historisë, Pastrimi etnik në Kosovë gjatë vitit 1999, maj 1999, fq. 27.

puse e humnera²⁰⁴ ose edhe duke i djegur e zhdukur në mënyra të ndryshme. Megjithatë, edhe në Kosovë po shihet se krimet nuk mund të fshehen. Këtë e ka vërtetuar edhe zbulimi i rreth 550 varrezave masive dhe i qindra e mijëra varreve individuale me trupat e dekompozuar e skeletet e viktimave që ende po gjenden nëpër vise të ndryshme të Kosovës të shkaktuar nga kriminelët serbë.

Duhet theksuar se nga Kosova mbi 15 mijë shqiptarë civilë, ku kishte fëmijë, gra dhe pleq, u vranë, u masakruan ose u dogjën të gjallë dhe u futën në qindra varreza masive, shumë prej tyre ende janë të zhdukur; fillimisht më se 2.000 shqiptarë ishin marrë peng dhe burgosur në burgjet e ndryshme të Serbisë, disa prej të cilëve më vonë janë liruar. Numri i objekteve të shkatërruara, të djegura ose të dëmtuara - i shtëpive dhe i banesave, i lokaleve afariste dhe i fabrikave, i shkollave dhe i objekteve të tjera arsimore, kulturore e shkencore, i objekteve fetare (218 xhamia), i monumenteve kulturore e historike që nga lashtësia e deri në ditët e sotme, lokaleve afariste, punëtori zejtare, fabrika etj. - është tejet i madh. Vlerësohet se gjatë luftës në Kosovë (mars 1998 - qershor 1999) sipas të dhënave jokomplete janë shkatërruar dhe djegur 204.285 shtëpi, pastaj banesa, lokale afariste, punëtori zejtare, fabrika, në 1100 vendbanime të 29 komunave, 534 shkolla dhe 240 institucione shëndetësore, kurse 617 vendbanimeve janë shkatërruar instalimet dhe objektet për furnizim me rrymë, ujë të pijes dhe kanalizim.²⁰⁵ Rreth një milion shqiptarë u deportuan jashtë Kosovës me mjete të ndryshme, me trena, kamionë, autobusë, vetura, këmbë nëpër male, gjithnjë rrugës duke u poshtëruar, torturuar e dhunuar. Disa qindra mijëra të tjerë nën dhunë e kërcënime u ndoqën nga shtëpitë e tyre, duke bredhur brenda territorit të Kosovës, me tëper nëpër terrenet malore.

8.10. Mbrojtja e popullit, lufta e UÇK-së dhe NATO

Mirëpo, populli shqiptar, rinia e tij përherë iu kishte kundërvënë këtij terrori e kësaj dhune, e atë me forma të ndryshme. Në fillim me organizimin e organizatave ilegale, pastaj marrjes së aksioneve kundër organeve të pushtetit si dhe në vitet e fundit edhe me rezistencën aktive - forminin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në të cilën ishin përfshirë bijt dhe bijat më të mira të popullit shqiptar në mbrojtje dhe çlirim të atdheut. Përveç luftës së organizuar ekzistonte edhe një rezistencë gjithëpopullore.

Dëshira për ta çliruar vendin, të rinjtë tonë nuk morën parasysh numrin e madh të njerëzve në anën e kundërshtarit dhe as në armatimin e shumëllojshëm të tij, ata lanë shkollën, lanë punën, shumë u kthyen nga jashtë edhe nga shtetet të largëta si nga Amerika, etj. (të kujtojmë formimin e Batalionit “Atlantiku”) rrokën armët dhe iu bashkangjitën e i plotësuan rradhët e UÇK-së, të cilët nuk kursyen as jetën për çlirimin e Kosovës. Luftëtarët tonë (UÇK-ja) kishin përparësi: luftonin në vendin e vet, për çlirim të popullit të vet shumë kohë të robëruar, dhe kjo sillte armë shumë të fortë, e cila i mungonte palës tjetër, e ky është morali i lartë luftarak. UÇK-ja e ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës. Në agjendat ndërkombëtare, Kosova doli në plan të parë.

Me qëllim të evitimit të kësaj tragjedie njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve u bë interevenimi i NATO-së, në krye me SHBA-të. Filluan sulmet ajrore ndaj forcave serbe që nga 24 marsi e deri me 12 qershor 1999, kur forcat tokësore të NATO-s hyn në Kosovë triumfalisht.

²⁰⁴ Libri i norvegjezit....

²⁰⁵ KMDLNJ - Prishtinë, Raport mbi shkeljen e të drejtave e të lirive të njeriut në Kosovë gjatë vitit 1999; “Bota Sot”, 12 qershor 2000.

Pas fillimit të sulmeve të NATO-s ndaj çaqeve ushtarake e policore serbe, ato filluan një fushatë të re ndaj pozicioneve të UÇK-së dhe filluan dëbimin masiv të popullatës civile të fshatrave dhe qyteteve shqiptare. Mirëpo, UÇK-ja edhe pse nuk kishte mundësi në masë të duhur t'i mbrojë banorët shqiptarë, ajo çdo herë forcohej, pasi që tani kishte pas vetës edhe një aleatë të fortë ushtarak, NATO-n. Forcat okupuese serbe nënshkruan kapitullimin dhe u detyruan të tërhiqen nga Kosova.

7.11. Tërhiqja e forcave ushtarake serbe dhe kthimi i popullatës shqiptare në vendlindje

Pushteti ka luajtur lojën e dyfishtë, atë të krimit të organizuar e të krijimit të bindjes te popullsia lokale serbe e malazeze se me dëbimin e shqiptarëve kjo anë do të jetë gjithmonë Serbi. Disa serbë vendorë naivë janë nxitur të bëjnë krime e mizori mbi fqinjët e vet shqiptarë, madje edhe pronat e shqiptarëve u janë ndarë serbëve lokalë.

Ndjenja e frikës objektivisht ekzistonte te serbë, sepse shumica dërmuese, në mënyra të ndryshme, ishte e implikuar në operacionet kriminale kundër civilëve shqiptarë. Një numër i konsiderueshëm i serbëve e kishte braktisur Kosovën dhe ishte nisur për në Serbi së bashku me tërheqjen e forcave ushtarako-policore dhe paramilitare serbe pa u kthyer ende shqiptarë. Prandaj, nuk ka ekzistuar asnjë formë e presionit dhe konceptit i ndjekjes së tyre. Disa prej tyre edhe më parë kishin ndërtuar shtëpitë e tyre nëpër Serbi.

Kur ikën ushtarët, policët e paramilitarët serbë ata bartën me automjetet e vjedhura dhe automjetet e tyre çdo gjë, që mund të merrnin me veti e pastaj disa prej tyre, shtëpive të mbetura dhe objekteve të tjera ua vënin zjarrin.



Hyrja e trupave të NATO-s në Prizren dhe pritja nga popullata vendore shqiptare, më 12.06.1999.

Pas tërheqjes së trupave serbe ushtarake nga Kosova, rreth 47.000 trupa ushtarake përpara afatit të pranuar në Marrëveshjen ushtarako-teknike të nënshkruar nga NATO dhe komandantët ushtarakë të ish RFJ-së me 9 qershor 1999, janë tërhequr afro 800 tanke, transportuese të blinduara, topash dhe gryka zjarri artilerie.



*Hyrja e luftëtarëve të UÇK-së në Prizren
(Marrë nga gazeta: "The Australian", 17 qershor 1999)*

Me mbarimin e luftës, hyrjes së trupave të forcave paqësore të NATO-së filloi kthyerja e shqiptarëve, brenda një kohe shumë të shkurtër, madje përkundër apeleve të bashkësisë ndërkombëtare që të mos ngutën të kthehen, sepse nuk ka kushte për ekzistencë, me shtëpi të rrënuara e të dëmtuara, pa ushqim, pa ujë, me rreze të mëdha nga minat që i kishin vënë forcat serbe, duke mos pritur fare kthimin e organizuar që paralajmëronin organizatat dhe institucionet ndërkombëtare humanitare. Kthimin e tyre së pari e bënë refugjatët nga Maqedonia, pastaj ata nga Shqipëria e kështu me radhë.

Kthimi i shpejtë i refugjatëve nga Maqedonia, nga Shqipëria dhe nga vendet perëndimore e të largëta, si SHBA, Kanada, Australia etj. është një fakt mahnitës për botën, që tregon se sa shumë janë të lidhur shqiptarët për tokën e vet.

Me kthimin e popullatës vendore filloi organizimi i jetës politike, ekonomike, shoqërore, etj. Filloi një jetë re re në liri, e cila u konkretizua më vonë, më 17 shkurt 2008, me shpalljen e Pavarësisë – Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, një pjesë e kolonëve dhe serbëve të shpërngulur dhe një pjesë që mbeti në Kosovë, edhe pas përfundimit të luftës vazhduan instrumentalizimin e tyre për qëllimet e Beogradit, për ta penguar procesin e pavarësisë, zhvillimit dhe rindërtimit të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, të mos integrohen në jetën institucionale të Kosovës.



*Pas qëndrimit nëpër male, kthimi në shtëpi
(Foto: Bota Sot, 16 qershor 1999)*

PËRFUNDIM

Kosova, edhe pse truall etnik i shqiptarëve, vazhdimisht u balla-faqua me pretendimet e pushtetit serb për kolonizim dhe kështu me dhunë të ndryshohet struktura e popullsisë që pastaj do të bënte sllavizimin dhe shkrirjen graduale të popullit autokton shqiptar.

Kolonizimi i trojeve në Kosovë është një proces, që pikësynim kryesor i gjithë politikës dhe i makinerisë ushtarake serbo-malazeze e jugosllave, në të gjitha periudhat kohore, ka qenë sllavizimi i Kosovës. Ndërkaq, gjatë historisë janë vërejtur edhe oshilime, herë ngadalësim e herë shpejtësim i hovshëm të procesit kolonizues, gjë që varej nga rrethanat politike, ekonomike e shoqërore që ishin të pranishme. Mirëpo, si proces, ai nuk është ndalur asnjëherë.

Për të realizuar serbizimin e territoreve shqiptare mbi popullin tonë u veprua me masa e me mjete të ndryshme politike e ushtarako-policore, kuptohet edhe me ato ekonomike e sociale. Masat ishin sa antinjerëzore, aq edhe fashiste e të egra. Ato shkonin nga ato të ngacmimit e të kontrollimit të vazhdueshëm policor, deri tek rrahjet, vrasjet e zhdukjet masive të vendësve.

Për realizimin e qëllimeve pushtuese të kolonizimit të Kosovës me elementin serb dhe dëbimin e shqiptarëve nga atdheu i tyre, në politikën e tyre antishqiptare ishin angazhuar akademikë serbë, politi-kanë, statistë, shkrimtarë, nobelistë, historianë, ushtarakë madhorë, mësues, pedagogë, diplomatë të karrierës, të cilët në bazë të udhëzi-meve të kupolës së piramidës shtetërore serbe hartuan projekte, platforma, memorandumë, programe, mbajtën tribuna të fshehta e të hapura, u tubuan në konferenca e simpoziume “shkencore”, organizuan tryeza të rrumbullakta në emër të “Serbisë së Vjetër”, çuan mesha drejt qiellit, shenjtëruan ose mallkuan luftëtarët serbë e shqiptarë, shkruan libra e monografi plot mllefe, shpërndanë fletushka me subjekte të trilluara dhe me ngjarje të stisura, me heronj të paqenë, me teza demagogjike që profanonin popullin shqiptarë dhe kulturën, moralin dhe traditat e tij shekullore.

Studiuesit shqiptarë, historianët, analistët, shkencëtarët tanë, u janë kundërvënë si propogandës serbe, ashtu edhe deformimeve e shtrembërimeve që akademikët, shkencëtarët, letrarët, etj. serbë u kanë bërë fakteve historike. Por, botimet serbe me trillime antishqiptare, me shpifje dhe me shtrembërime të fakteve historike janë aq të shumta dhe në triazhe aq të mëdha, sa këtë të keqe mund ta shlyejë vetëm një punë vëllimore dhe e gjatë shkencore e me përkushtim atdhetar, e histori-anëve, e studiuesve dhe e analistëve të paanshëm të mbështetur në të vërtetat historike, duke mbajtur një qëndrim politik e dinjitoz me qitje të largët të akademive tona dhe të institucioneve tona shkencore.

SUMMARY

SERBIAN COLONIZATION OF KOSOVA

Since the Slavic incursion into Albanian lands in the 12th century, the permanent objective of the Serbian rulers was denationalization and Serbianization of Albanian territories. Besides oppression, terror, violence and physical liquidations, the most drastic method used to fulfill such objective was ethnic cleansing of Albanian territories, and their colonization by populating them with the Slavic element. Throughout the history, Serbian regimes employed all possible strategies to accomplish colonization of Albanian territories, Kosova first and foremost, which in fact is the focus of this study.

In accomplishing their objectives, the Serbian rulers got use of myriad ways and models, depending on internal and external circumstances, socio-political developments, and other circumstances that made possible the realization of such projects.

A wide range political, police and military instruments, as well as economic pressures were employed for Serbianization of Albanian lands, Kosova in the first place. The Serbian regimes pursued permanently the strategies of cleansing of Albanians from their Illyrian-Albanian lands, including by killings, terror, expulsion of Albanians in big numbers, their denationalization and assimilation.

One of the methods used to accomplish ethnic cleansing and denationalization of Albanians was colonization of Kosova with Slavic elements, and forceful expulsion of Albanians. Kosova's colonization and redressing of ethnic composition was a permanent process and one of the key objectives of the Serbian-Montenegrin policies, carried out through the use of military and police campaigns. During different periods of history, the process of colonization varied from time to time, in some of the periods speeding up, slowing down in others, depending on political, economic and social circumstances. But, as a process, it never stopped.

The most drastic form of Kosova's colonization and its population with Slavic elements took place in the aftermath of Kosova's occupation in 1912; between the two World Wars; and after 1989. During the period between the two World Wars, the colonization was carried out in a most perfidious fashion, under the disguise of the agrarian reform.

Colonization and agrarian reform in Kosova were utterly national and political, Kosova's exploitation being the in the core of such policies. Through colonization processes, the Serbian regime aimed at undoing the Albanian national compactness and changing of ethnic composition at the detriment of Albanians. As it has been proven with documents, the area along the border was considered as priority, because by colonizing it the Serbian regime intended to cut off autochthonous Albanian population in the territories of Albanian, Kosova and Macedonia. Furthermore, the bourgeoisie made all efforts to decrease the Albanian population density, as Kosova was the region with the densest population in the whole Yugoslavia. There existed detailed

programs for colonization of Albanian inhabited territories, and for settling of Serb and Montenegrin population in them.

All such efforts culminated with the 1998-99 armed conflict in Kosova when ethnic cleansing and genocide was carried out in the most barbarous fashion to finally challenge the international community as well. The en masse expulsion of Albanians during that period represented the biggest displacement of population in Europe since the World War II.

There is ample archival data on colonization of Kosova disclosing the Serbian ambitions throughout history. So, the intention of this book is to shed light on colonization of Albanian territories through certain historic periods, focusing mainly from the occupation of Kosova in early 20th century to the en masse expulsion of Albanians in March-April 1999.

In this book the public is offered historic evidence and archival data on colonization of Kosova and Serbian regime drives to change the ethnic composition of Kosova by settling Serb and Montenegrin elements in it. Various archival sources, published and unpublished materials, as well as adequate literature was employed in writing this book.

R é s u m é

LA COLONISATION SERBE DE KOSOVË

Dès la pénétration (aux XII^e siècles) les Slaves avaient comme objectif permanent la slavisation et le serbisation des terres albanaises. Les moyens les plus drastiques (à part l'oppression, la violence et la terreur, la dénationalisation et l'assimilation) étaient la liquidation physique et la purification ethnique qui se suivaient de la colonisation des terres albanaises. Pour réaliser toutes ces intentions, les Slaves utilisèrent donc tous les moyens culturels et économiques, politiques et militaires.

La colonisation des territoires albanais par les Slaves (Serbes et Monténégrins) et le changement de la structure ethnique, dépendaient de divers facteurs et circonstances politico-militaires et économique-sociaux qui ont été présents plusieurs siècles et dont le processus ne s'est pas encore arrêté.

Les périodes et les formes les plus marquées de colonisation ont eu lieu surtout après l'occupation de Kosovë en 1912, entre les deux guerres mondiales (1918-1941) et, aussi, après l'année 1989. La colonisation entre les deux guerres mondiales était effectuée sous une forme très camouflée et perfide, sous nom de Réforme agraire, dont le caractère n'était que politique et exploiteur. Le but principal de cette Réforme était la destruction de la compacité et de la cohésion ethnique albanaises et le changement de la structure ethnique. Était, surtout, très accentuée la colonisation des parties qui se limitaient avec l'Albanie pour interrompre ou interrompre la continuité de la population autochtone albanaise des territoires de l'Albanie, Kosovë et Macédoine. Toutes ces entreprises et actions serbes, selon les documents serbes, étaient effectuées sous prétexte de "sécurité" et de stratégie. Malgré sa très haute densité démographique il a eu plusieurs projets et programmes de colonisation de Kosovë. Le point culminant de l'expulsion et de la purification ethnique est atteint pendant la conflit albanokosovar et serbe qui eut lieu pendant les années 1998-1999, quand la violence, la terreur,

les crimes, la purification ethnique prirent la forme d'une action barbare et génocidale; l'expulsion des Albanais de Kossovë était l'exode le plus massif en Europe depuis la Deuxième Guerre mondiale.

Dans cette étude notre but principal était de présenter à l'opion, d'une manière acceptable et documentée, les entreprises, et les actions colonisatrices, purificatrices et génocides serbes au cours des siècles.

Pour la rédaction de cet ouvrage on a utilisé la documentation recueillie dans de nombreuses archives et on a consulté la littérature adéquate.

ZUSAMMENTFASSUNG

SERBISCHE KOLONISIERUNG VON KOSOVA

Seit der Einöanderung der Slaëen in die albanischen Territorien im XII jahrhundert hatte das serbische Regime als Ziel die Entnationalisierung und Serbisierung der albanischen Länder.

Außer der Unterdrückung, dem Terror, der Gewalt, der physischen Liquidierung usw., ist auch die ethnische Säuberung und die Kolonisierung mit slawischen Elementen, als drastischste Mittel, verendet worden. Während der Geschichte hat Serbien alle Methoden der Kolonisierung besonders in Kosova, was auch in diesem Buch erörtert wird, verendet.

Um diese Ziele zu erreichen, verendet Serbien die verschiedensten Formen der Gewalt, die von vielen inneren und äußeren politischen Faktoren und von dem politischen, sozialen Ablauf abhängen.

Um die Serbisierung der albanischen Territorien, besonders von Kosova, zu realisieren wurden keine polizeilichen, militärischen, sozialen und wirtschaftlichen Mittel ausgelassen. Das serbische Regime hat immer eine unveränderte Linie verfolgt, die der ethnischen Säuberung der albanischen Länder von ihren illyrisch-albanischen Ureinwohnern diene. Dabei hat das Regime alle Mittel wie Mord und Terror verendet, soviel wie möglich Albaner aus ihrem Vaterland vertrieben und sie entnationalisiert und assimiliert.

Einer der Methoden der ethnischen Säuberung, Entnationalisierung und Slawisierung war auch die Kolonisierung von Kosova durch slawischen Kolonisten und die Vertreibung der Albaner aus ihren Ländern. Die Kolonisierung und die Änderung der Nationalstruktur der Bevölkerung in Kosova war das Hauptziel der serbischen, montenegrinischen und jugoslawischen Politik und des Militärs. Während der Geschichte gab es Oszillationen des Kolonisierungsprozesses. Das hing von den politischen, wirtschaftlichen und sozialen Umständen ab, aber als Prozess hörte er nie auf.

Die Kolonisierung durch serbische Kolonisten hatte nach Kosovas Okkupation im Jahre 1912, zwischen den beiden Weltkriegen und nach 1998 besonders zugenommen. Zwischen den beiden Weltkriegen als Mittel für die Kolonisierung wurde die Agrarreform verendet.

Die Kolonisierung und die Agrarreform haben in Kosova ein nationalistisches und politisches Ziel und einen exploitierenden Charakter gehabt. Das Hauptziel der Kolonisierung war die Änderung der Nationalstruktur des albanischen Volkes. Einigen strategischen Dokumenten nach war die Kolonisierung der Grenzzonen sehr stark, denn man dachte das würde die Grenzen sicherer machen und gleichzeitig die Kontinuität des albanischen Volkes nach Albanien und Mazedonien unterbrechen. Die Bourgeoisie versuchte besonders in den Regionen, wo die Albaner in der Mehrheit lebten, ihre Zahl zu verringern. Auch war Kosova eine Region war, die größte Bevölkerungsdichte in Jugoslawien hatte, existierte ein gut ausgedachter Plan für Kosovas Kolonisierung durch serbische und montenegrinische Kolonisten.

Der Höhepunkt wurde mit dem Anfang des beäffneten Konflikts (März 1998) erreicht, als das Genozid und die ethnische Säuberung die Form eines barbarischen Akts, dass die internationale Gemeinschaft vor einer großen Herausforderung stellte, nahm. Die Vertreibung der Albaner aus ihren Häusern war der massivste Exodus in Europa seit dem zweiten Weltkrieg.

Dies Buch dient, um in einer kurzen Fassung die Kampagne der ethnischen Säuberung in Kosova die Kolonisierung mit serbischen und montenegrinischen Elementen durch Fakten und Argumenten zu präsentieren.

In diesem Buch sind veröffentlichte und unveröffentlichte Texte aus verschiedenen Archiven und die dafür entsprechende Literatur verendet worden.

BURIMET DHE LITERATURA

A. BURIMET

a. *Lënda arkivore*

ARKIVI I KOSOVËS - PRISHTINË

Fondet:

1. Gjyqi i Qarkut, Prizren, 1918-1941, nr. 45.
2. Gjyqi i Qarkut, Prishtinë, 1919-1941, nr. 80.
3. Gjyqi i Shkallës së Parë, Prishtinë, 1919-1941, nr. 71.
4. Këshilli Popullor Krahinor - Revizioni i Reformës agrare, Prishtinë, 1945-1948.
5. Kartoteka e objekteve dhe subjekteve të reformës agrare, 1919-1940, nr. 115.
6. Kartoteka e zejtarëve në Kosovë, 1920-1927.
7. Fotokopije të sjellura nga arkivat e Institutit Historik Ushtarak të Jugosllavisë dhe Arkivit Diplomatik të Sekretariatit Fedrativ të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në Beograd.
8. Këshilli Ekzekutiv Krahinor 1943-1989.

ARHIV JUGOSLAVIJE (Arkivi i Jugosllavisë) BEOGRAD

Fondet:

1. Ministarstvo Agrarne Reforme KJ, Beograd, 1918-1941, nr. fondit 96.
2. Ministarstvo Poljoprivrede KJ, Beograd, 1918-1941, nr. 67.
3. Ministarstvo Finansije KJ, Beograd, 1919-1941, nr. 70.
4. Ministrstvo Unutrašnjih Dela KJ, Beograd, 1919-1941, nr. 14.
5. Ministarstvo Pravde KJ, Beograd, 1919-1941, nr. 63.
6. "Dvor" KJ, Beograd, 1918-1941, nr. 74.
7. "Dr. Milan Stojadinović", 1933-1939, nr. 37.
8. "Jovan Jovanović Pižon", Beograd, 1859-1939, nr. 80.
9. "Dr. Hinko Krizman", 1882-1939, nr. 84.
10. Centralni Press Biro, Beograd, 1919-1941, nr. 38.

ARHIV VOJNO-ISTORIJSKOG INSTITUTA (Arkivi i Institutit Historik Ushtarak) BEOGRAD

Fondet:

1. Treca armijska oblast Skoplje, 1919-1941.
2. Kosovska Divizijska oblast u Prištini, 1919-1941.
3. Moravska Divizijska oblast u Nišu, 1919-1941.
4. Zetska Divizijska oblast u Cetinji, 1919-1941.
5. Vojska Kraljevine Jugoslavije, Glavni generalni stab u Beograd, 1920-1941, Popisnik

ARHIV SRBIJE (Arkivi i Serbisë) - BEOGRAD

Fondi:

- Ministarstvo inostranih dela - PPO.

DIPLOMATSKI ARHIV SAVEZNOG SEKRETARIJATA
INOSTRANIH POSLOVA (Arkivi Diplomati i Sekretarijatit
Fedrativ të Punëve të Jashtme) BEOGRAD

Fondet:

1. Stalna kraljevska delegacija pri Društvu Naroda u Ženevi, 1927-1947.
2. Ambasada Kraljevine Jugoslavije u Turskoj, Ankara, 1919-1945.
3. Ambasada Kraljevine Jugoslavije u Velikoj Britaniji, London, 1919-1945.
4. "Hartija Nikole Pašića", Beograd, 1890-1927.
5. Zbriha arhivalija "Marambo - Vojislav Jovanović", Beograd, 1911-1950.

PUBLIC RECORD OFFICE, London
(Arkivi Publik Shtetëror, Londër).

Fondi:

1. Foreign office, nr. 371.

HAUS HOF UND STATS ARCHIV - VJENË
(Arkivi Shtetëror në Vjenë)

Fondi:

1. Politischen Archiv, Albanien, 24.

ARKIVI QENDROR I SHTETIT - TIRANË

Fondet:

1. Komiteti i Kosovës, Tiranë.
2. Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Tiranë.

ARHIV MAKEDONIJE SKOPJE
(Arkivi i Maqedonisë, Shkup):

Fondet:

1. Savez Agrarnih Zajednica, Skopje (Lidhja e Kooperativave Agrare, Shkup) 1921-1939.
2. Vrhovno Povereništvo Agrarne Reforme Banovine Vardar-ske, Skopje (Drejtorati Suprem i Refomres Agrare të Banovinës së Vardarit, Shkup) 1919-1940.
3. Vrhovni Agrarni Sud, Skopje (Gjyqi Suprem Agrar, Shkup) 1931-1969.

ARKIVI I QYTETIT TË PRISHTINËS

Fondi:

1. Kuvendi i Komunës Prishtinë - Drejtorati për Çështje Pronësoro-juridike, 1945-1994.
2. Lidhja Socialiste e Popullit Punues të Prishtinës. 1960-1989.

b. Dokumentet e botuara:

1. Hasan Prishtina, dokumente, Tiranë, 1983.

2. Këshilli Popullor i KAKM, 1943-1953, Prishtinë, 1955.
2. Raport i Departmentit të Shtetit të SHBA, maj, 1999.
3. Službene Beleške Narodne Skupštine Kraljevine Jugoslavije. 1938.
4. Dokumente të shekullit XVI-XVII për historinë e Shqipërisë I, Tiranë, 1989.
5. Stanovništvo Narodne Republike Srbije od 1834-1953, Zavod za statistiku i evidenciju N. R. Srbije, Beograd, 1953.
6. Kraljevina SHS, Recnik mesta, Rijecnik mjesta, 1925, Beograd.

B. LITERATURA

- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Insitituti i Historisë, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990.
- Bajrami, dr. Hakif, Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941, Prishtinë, 1981.
- Bajrami, dr. Hakif, Konventa jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve, “Gjurmime Albanologjike”, Seria e shkencave historike, Prishtinë, XII/1982.
- Bajrami, dr. Hakif, Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995), Prishtinë, 1995.
- Bošković, dr. Branko - Apostolov, dr. A., Stav KPJ prema agrarnoj reformi i kolonizaciji na Kosovu i Metohiji 1919-1941, “Kosova”, nr. 1. Prishtinë, 1972.
- Braha, Shaban, Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1944-1990), Tiranë, 1992.
- Bytyçi Abdullah, Terrori Shtetëror dhe gjenocidi serbo-malazias në Kosovë 1878-1991, Prishtinë, 2001.
- Cana, dr. Zekirja, Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare, Prishtinë, 1984.
- Cani Bahri - Milivojević Cvijetin, KOSMET ili KOSOVA, Beograd, 1996.
- Čolić Mladen, Četnička oružane formacije na Kosovu 1941-1944, Kosovo, nr.2, Prishtinë, 1973.
- Doçi, dr. Rexhep, Popullsia në Kosovë gjithmonë 5-10% në krahasim me popullsinë shqiptare, Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, Prishtinë, 1996.
- Durham, Edit, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Romë, 1942.
- Djordje Mikić, Društvene i ekonomske prilike kosovskih srba u XIX i početkom XX veka, Beograd, 1988.
- Djordjević Radoslav, Srbija pre 100 godina, Beograd, 1946.
- Erić, dr. Milivoje, Agrarna reforma u Jugoslaviji 1918-1941, Sarajevo, 1958.
- Feliks Kanic, Srbija – Zemlja i stanovništvo I, II, Beograd, 1985.
- Freundlich Leo, Albaniens Golgotha, Vien, 1913.
- Hadri, dr. Ali, Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945, Prishtinë, 1971.
- Hadjibegić Hamid, Handžić Adem i Kovačević Ešref, Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455, Sarajevo, 1972.
- Hadjivasiljević, Jovan, Albanska kongra, Beograd, 1909. Historia e Popullit Shqiptarë, II, Prishtinë, 1969.
- Hoxha, dr. Hajredin, Politika e dëbimit të shqiptarëve nga trolli i Jugosllavisë së Vjetër, Përparimi, nr.5/1970.

- Hrabak dr. Bogomil - Janković dr. Dragoslav, Srbija 1918, Beograd, 1968.
- Ibra, Hysen, Shkatërrimi i hapsirës së Republikës së Kosovës nga okupatori serb (1989-1997), Prishtinë, 1998.
- Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit islam, Gjenocidi serb në Kosovë, Tiranë, 1999.
- Islami, dr. Hivzi, Kosova dhe shqiptarët, çështje demografike, Prishtinë, 1990.
- Jens Reuter, Shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 2003.
- Kelmendi Muhamet, Realiteti dhe perspektivat e çështjes kombëtare, Tiranë, 1998.
- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, Buletini nr. 14, janar-mars 2000.
- Kola Harila, Genocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi, 1941-1967, Tiranë, 200.
- Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë, 1999.
- Krasniqi, dr. Mark, Savremene društveno-geografske promene na Kosovu i Metohiji, Priština, 1965.
- Krstić Djordje, Kolonizacija u Južnoj Srbiji, Sarajevo, 1928.
- Kujundžić Zvonimir, Politika i Korupcija, Zagreb, 1963.
- Lahu, Riza, Golgota shqiptare, Tiranë, 1995.
- Malcolm Noel, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë, 1998.
- Medenica, Gojko, Četnički pokret na Kosovu i Metohiji u vreme II svetskog rata, Vjetari X-XI i Arkivit të Kosovës, Prishtinë, 1979.
- Miličević, dr. M. Gj., Kraljevina Srbije, Beograd, 1987.
- Nasi Lefter, Ripushtimi Kosovës (shtator 1944-korrik 1945), Tiranë, 1994.
- Nushi, Pajazit, Karakter i osobenosti prilaza izučanjanju iselje-nistva naroda i narodnosti pokrajine Kosova, në librin Iseljeni-stvo naroda i narodnosti Jugoslavije, Zagreb, 1978.
- Obradović Milovan, Revizija agrarne reforme na Kosovu, Kosovo, nr. 3, Prishtinë, 1974.
- Obradović, dr. Milovan, Agrarna reforma i Kolonizacija në Kosovu 1918-1941, Priština, 1981.
- Osmani, dr. Jusuf, Kolonizimi i refugjatëve kolonë - optantë nga Shqipëria në Kosovë në vitet 1933-1935, “Kosova në rrjedhat ballkanike”, Prishtinë, 1996.
- Osmani, dr. Jusuf, Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 1996.
- Popović, L. Stefan, Putovanje po Novoj Srbiji, Beograd, 1950.
- Pulaha Selami, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XV-XVI, Tiranë, 1984.
- Qosja, Rexhep, Çështja shqiptare, historia dhe politika, Prishtinë, 1994.
- Rexhepi, dr. Fehmi, Kolonizimi i Kosovës pas heqjes së autono-misë së saj na ana e Serbisë, 1990-1995, Kosova, nr. 6/1997.
- Rushiti, Liman, Rregullimi administrativ-territorial i Kosovës gjatë viteve 1919-1929, Kosova, 1, Prishtinë, 1972.
- Rushiti, dr. Liman, Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928, Prishtinë, 1981.
- Stojančević, dr. Vladimir, Iz istorije Leskovačkog kraja u drugoj polovini XIX veka, Leskovački Zbornik IV, Leskovac, 1966.
- Shatri, dr. Muhamet, Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997.
- Trifunovski Jovan, Vranjska kotlina I, Skoplje, 1969,
- Uka, dr. Sabit, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878, lib. I, Prishtinë, 1994.

- Uka, dr. Sabit, Vendorsja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë, 1878-1912, lib. 2, Prishtinë, 1994.
- Uka, dr. Sabit, Planet antishqiptare të shteteve fqinje në sheku-lin XIX, Kosova në rrjedhat ballkanike, Prishtinë, 1996.
- Zadužbine Kosova, Prizren-Beograd, 1987.

C. SHTYPI

Gazetat:

- “Borba”, Beograd.
- “Bota sot”, Prishtinë.
- “Bujku”, Prishtinë.
- “Demokratija”, Beograd.
- “Fakti”, Shkup.
- “Flaka”, Shkup.
- “Jedinstvo”, Prishtinë.
- “Koha ditore”, Prishtinë.
- “Kosova sot”, Prishtinë.
- “Obzor”, Zagreb.
- “Përlindja shqiptare”.
- “Politika”, Beograd.
- “Pravda”, Sarajevë.
- “Rilindja”, Prishtinë.
- “Socijalistička Zora”, Shkup.
- “Shqipëria e Re”, Kostancë.

Revistat:

- “Agrarni Pregled”, Shkup.
- “Agrarna Misao”, Beograd.
- “Fjala”, Prishtinë.
- “Gjurmime Albanologjike”, Prishtinë.
- “Južni Pregled”, Shkup.
- “Kosova”, Prishtinë.
- “Leskovački zbornik”, Leskovac.
- “Policija”, Beograd.
- “Vjetari” i Arkivit të Kosovës, Prishtinë.

Gazetat zyrtare:

- “Fletore Zyrtare e KSAK”, Prishtinë
- “Službene novine”, Beograd.
- “Službeni glasnik”, Beograd.

Shënimet për autorin